

Shërbimi i  
Seancës Plenare  
07-09/03/2022

KUVENDI  
NR 1044 DATE 09.03.22



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KUVENDI  
KOMISIONI HETIMOR “PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË  
VEPRIMEVE TË ORGANEVE PUBLIKE NË PROCEDURAT PËR NDËRTIMIN  
DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTEVE TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE  
URBANE”

Nr. \_\_\_\_\_ Prot. Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2022

**Lënda:** Dërgim i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar “ Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane” .

**Drejtuar: Znj.Lindita Nikolla**  
**Kryetare**  
**Kuvendi i Republikës Së Shqipërisë**

E nderuar znj.Kryetare,

Lutem, gjeni bashkëlidhur raportin përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar “ Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane”, së bashku me mendimin e pakicës palamentare, drejtuar Seancës Plenare.

Duke Ju falënderuar.

**KRYETARE**  
Jorida TABAKU



**KUVENDI  
KOMISIONI HETIMOR**

**V E N D I M**  
*(përfundimtar)*

**Datë 07.03.2022**

***“PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE TË ORGANEVE PUBLIKE NË  
PROCEDURAT PËR NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTEVE TË  
TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE”***

Në mbështetje të neneve 20 dhe 22 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, dhe vendimit nr. 81/2021 të Kuvendit të Shqipërisë, me propozim të kryetares të Komisionit,

**KOMISIONI HETIMOR**

**V E N D O S I:**

- I. Miratimin e Raportit Përfundimtar, bashkëlidhur këtij vendimi.
- II. Raporti Përfundimtar i dërgohet Kuvendit për miratim në seancë plenare.
- III. Komisioni i kërkon Kuvendit që Raporti Përfundimtar dhe dokumentacioni i administruar t’i përcillet Prokurorisë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për fillimin e çështjes penale.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARJA**

**Jorida TABAKU**



*Komisioni hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane”*

## **RAPORTI I KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR**

**“ Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane”**

### **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

- 1.Vendimi i kuvendit të shqipërisë për ngritjen komisionit hetimor parlamentar
- 2.Objekti i veprimtarisë së komisionit hetimor parlamentar
- 3.Të dhënat paraprake të hetimit , plani hetimor
- 4.Baza ligjore e hetimit parlamentar
5. Shqyrtimi i praktikave dokumentare të kontratave koncesionare dhe dëshmime të zyrtarëve publikë
- 6.Konkluzione
- 7.Mendim i pakicës parlamentare

## **1.VENDIMI I KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR NGRITJEN KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR**

Më datë 25.10.2021, me Vendimin Nr.81, sipas kërkesës së opozitës, Partia Demokratike e Shqipërisë, Kuvendi i Shqipërisë, miratoi ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar, me objekt “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane” .

Hetimi synonte nxjerrjen e përgjegjësiwe institucionale, garantimin e transparencës, mbrojtjen e konkurrencës dhe tregut të lirë dhe garantimin e të drejtës së qytetarëve për një mjedis më të pastër, në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Sipas vendimit Nr.81/2021 të Kuvendit të Shqipërisë , Komisioni Hetimor Parlamentar duhej të bënte transparencë të plotë për çdo çështje të përfshirë në objektin e veprimtarisë së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, vecanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve .

## **2.OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR**

Detyrat e Komisionit në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij ishin:

Kontrolli i veprimeve dhe mosveprimeve të organeve publike të përfshira në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane Elbasan, Fier dhe Tiranë;

Verifikimi i pasojave që secila prej procedurave të mësipërme ka pasur në buxhetin e shtetit dhe kryerja e vlerësimit cilat do të ishin procedurat më eficente për ndërtimin e tre incineratorëve;

Verifikimi i pasojave që secila prej procedurave ka sjellë në mjedis, mbi konkurrencën dhe tregun e lirë;

Vlerësimi i nevojës për ndërhyrje ligjore me qëllim mbrojtjen e konkurrencës, tregut të lirë, mjedisit dhe përafrimin e legjislacionit me BE-në.

Për përmbushjen e këtyre detyrave, Komisioni, në bazë të ligjit Nr.8891 datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve hetimore të Kuvendit”, pasi miratoi me konsensus të gjithë antarëve të tij, Rregulloren e Komisionit, mblodhi të dhëna paraprake për çështjen nga institucione të ndryshme publike dhe jo publike, miratoi Planin Hetimor, për të vijuar më tej, me shqyrtimin e praktikave dokumentare për secilin nga impiantet e trajtimit të mbetjeve urbane në Elbasan, Fier dhe Tiranë, konstatimin në vend të secilit prej këtyre të fundit dhe pyetjen e dëshmitarëve për të cilët nuk kishte pengesë ligjore për pyetjen.

**Më datë 25.02.2022**, Komisioni Hetimor Parlamentar, miratoi përfundimin e hetimeve duke konfirmuar kështu përmbushjen e të gjithë pikave të Planit Hetimor të miratuar më parë nga komisioni.

### 3. TË DHËNAT PARAPRAKE TË HETIMIT , PLANI HETIMOR

#### VEPRIME TË KOMISIONIT HETIMOR

Në mbështetje të neneve 14, 15 dhe 17 të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, vendimit Nr. 81/2021 të Kuvendit të Shqipërisë dhe Planit Hetimor Paraprak, u kërkua vendosja në dispozicion e dokumenteve dhe informacioneve, si më poshtë:

- Është kërkuar informacion, nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Agjencia e Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, Këshilli i Ministrave, lidhur me të gjitha procedurat e ndjekura për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Elbasanit, Fierit dhe Tiranës
- Është kërkuar informacion nga Qendra Kombëtare e Biznesit
- Është kërkuar informacion nga bankat e nivelit të dytë
- Është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tësarit, lidhur me të gjitha transaksionet e kryera nga institucionet publike për llogari të tre shoqërive koncesionare
- Është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Është kërkuar informacion nga bashkitë Elbasan, Fier, Kavajë, Durrës dhe Tiranë, lidhur me planet e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe vendimeve të këshillave bashkiakë për menaxhimin e mbetjeve urbane, për periudhën 2011 – 2021
- Është kërkuar informacion nga tre shoqëritë koncesionare të impianteve të trajtimit të mbetjeve
- Është kërkuar informacion nga Bashkia Tiranë lidhur me shpronësimin e tokës për ndërtimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve në Sharrë
- Është kërkuar informacion nga Ministria e Drejtësisë
- Është kërkuar informacion nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, lidhur me hyrjet daljet e shtetasve
- Është kërkuar informacion nga deputetë
- Është kërkuar informacion nga Prokuroria e Posacme
- Është kërkuar informacion nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit lidhur impiantet e trajtimit të mbetjeve urbane që operojnë në Shqipëri, vendimet për shpalljen e emergjencës mjedisore, praktikat dokumentare për kontraktimin e ndërtimit të landfillit në qytetin e Durrësit dhe impianteve të trajtimit të mbetjeve në Tiranë, Fier dhe Elbasan;
- Është kërkuar informacion nga Bashkia Tiranë lidhur me menaxhimin e integruar të mbetjeve, komunikime shkresore ndërmjet bashkisë dhe Ministrisë së Mjedisit për venddepozitimin e Sharrës dhe cdo kontratë riciklimi të lidhur në periudhën 2011 – 2015
- Është kërkuar informacion nga Bashkia Elbasan, lidhur me shpalljen e emergjencës mjedisore, komunikime shkresore me Ministrinë e Mjedisit sa i përket impiantit të Elbasanit dhe studimet që adresojnë çështjen e mbetjeve në Bashkinë Elbasan
- Është kërkuar informacion nga Banka Botërore lidhur me menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe pastrimin e zonës bregdetare;

- Është kërkuar informacion nga INSTAT lidhur me të dhënat për situatën mjedisore në Shqipëri
- Është kërkuar informacion nga Top Channel për përfitimin nga z. Jamarbër Malltezi të projektit mjedisor në menaxhimin e plehrave në vitin 2010, me financim të Bankës Botërore
- Është kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare Ujësjellës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, lidhur me impiantet e Elbasanit, Fierit dhe Tiranës
- Është kërkuar informacion nga OSHEE lidhur me prodhimin e energjisë nga impiantet e Elbasanit dhe Fierit
- Është kërkuar informacion nga Agjencia e Prokurimit Publik, lidhur me shpalljet dhe ankesat lidhur me kontratat koncesionare të impianteve të Elbasanit, Fierit dhe Tiranës
- Është kërkuar informacion nga Gjykata Administrative e Tiranës
- Është kërkuar informacion nga Bashkia Vlorë lidhur me planin për menaxhimin e integruar të mbetjeve Vlorë
- Është kërkuar informacion nga Gjykata Administrative e Apelit
- Është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Është kërkuar informacion nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan

### PLANI I HETIMIT

#### **Veprimet e Komisionit dhe afatet përkatëse**

**Fillimi i hetimeve:** 07.02.2022

**Afati i përfundimit:** 25.02.2022

1.	Shqyrtimi nga Komisioni i dokumentacionit lidhur me impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Elbasanit.  Vizita tek impianti i trajtimit të mbetjeve urbane të Elbasanit.	8 Shkurt 2022	Analizohet dhe shqyrtohet informacioni i përgatitur nga specialistët e caktuar nga Komisioni. Cdo anëtar analizon çështjet përkatësi, në varësi të informacionit.
2.	Shqyrtimi nga Komisioni i dokumentacionit lidhur me impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Fierit.  Vizita tek impianti i trajtimit të mbetjeve urbane të Fierit.	9 Shkurt 2022	Analizohet dhe shqyrtohet informacioni i përgatitur nga specialistët e caktuar nga Komisioni. Cdo anëtar analizon çështjet përkatësi, në varësi të informacionit.
3.	Shqyrtimi nga Komisioni i dokumentacionit lidhur me impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Tiranës.  Vizita tek impianti i trajtimit të mbetjeve urbane të Tiranës.	11 Shkurt 2022	Analizohet dhe shqyrtohet informacioni i përgatitur nga specialistët e caktuar nga Komisioni. Cdo anëtar analizon çështjet përkatësi, në varësi të informacionit.

4.	Thirrja e grupit të parë të dëshmitarëve. Lista e personave që do të thirren si dëshmitarë përcaktohet në Aneksin bashkëlidhur këtij Plani Hetimor.	Brenda datës 18 Shkurt 2022	Lista e dëshmitarëve është përcaktuar sipas kërkesave që ka cdo anëtar i Komisionit.
5.	Thirrja e grupit të dytë të dëshmitarëve. Lista e personave që do të thirren si dëshmitarë përcaktohet në Aneksin bashkëlidhur këtij Plani Hetimor.	Brenda datës 18 Shkurt 2022	Lista e dëshmitarëve është përcaktuar sipas kërkesave që ka cdo anëtar i Komisionit.
6.	Prezantimi i konkluzioneve të hetimit dhe deklarimi i përfundimeve të hetimit.	Brenda datës 23 Shkurt 2022	Konkluzionet prezantohen nga kryetarja i Komisionit dhe më pas vijohet me diskutimin dhe miratimin e tyre.
7.	Prezantimi i Raportit Final të Komisionit.	Brenda datës 25 Shkurt 2022	Raporti prezantohet nga Kryetarja, së bashku me mendimin e pakicës.

### **Vështrim i përgjithshëm/Të dhëna për situatën mjedisore në Shqipëri**

Situata e menaxhimit të mbetjeve urbane, deri në vitin 2013 ishte katastrofike:

Në vitin 2013 mjedisi e për më tepër menaxhimi i mbetjeve, nuk konsiderohej nga askush as si prioritet dhe as si një urë lidhëse për zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit, ndërkohë që sot diskutohet se si të ecim me hapa të shpejtë, për të qenë në një linjë me vendet evropiane, sa i takon menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe promovimit të ekonomisë qarkulluese.

Përpara vitit 2013, panorama e menaxhimit të mbetjeve ishte në nivele shumë të dobëta. Kjo dukej qartë pasi:

U trashëguan venddepozitime nga ish komunat, të cilat në pjesën më të madhe ishin ndërtuar në brigjet lumore apo vende të cilat ishin jashtë çdo standarti mjedisor, duke ndotur lumenjtë dhe detet.

Nuk ka pasur një metodologji të qartë e të unifikuar për të përcaktuar sesa kushton menaxhimi i mbetjeve.

Lejohej importi i një liste mbetjesh, por sistemi i kontrollit nuk ka qenë në nivelin e duhur duke lënë hapësira për hyrjen e mbetjeve të rrezikshme në vend.

Shërbimi i pastrimit ishte i kufizuar dhe koshat ndodheshin vetëm në pjesë të caktuara të zonave urbane.

Kishte pamjaftueshmëri financiare që reflektohej në mungesë infrastrukture të menaxhimit të mbetjeve.

Me buxhetin 2022, janë 500 milionë lekë, fond i vënë në dispozicion të trajtimit apo menaxhimit të integruar të mbetjeve.

ndërgjegjësimi i publikut në raport me diferencimin e mbetjeve që në burim, ngelet në nivele shumë të ulëta

Pas vitit 2013, u bë imperative zgjidhja e problematikave të trashëguara .

Komiteti Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, me vendim të datës 05.02.2014, shpalli fillimin e gjendjes së emergjencës mjedisore në territorin e Republikës së Shqipërisë, së bashku me marrjen e masave të nevojshme për rehabilitimin e cilësisë së mjedisit.

Ky vendim, është pasuar nga vendime të ngjashme të Këshillave Bashkiakë të Elbasanit dhe Fierit. Të gjitha këto vendime të administruara rregullisht në Komisionin Hetimor, shprehin qartë kontekstin në të cilin filloi implementimi i strategjive ose masave të reja për menaxhimin e mbetjeve urbane, veçanërisht në territore të rënduara, si Elbasan, Fier dhe Tiranë/Sharrë.

Në fushën e menaxhimit të mbetjeve, aktualisht ka pasur një sërë zhvillimesh, nga cilat vlen të veçohen ;

- fuqizimi i kompetencave Bashkive në administrimin e territoreve dhe menaxhimin e mbetjeve
- përgatitjet për ofrimin e një metodologjie për llogaritjen e kostos së shërbimit që do të ndikojë në përmirësimin e tarifave për ofrimin e një shërbimi cilësor për menaxhimin e mbetjeve;

- përgatitjet për ofrimin e metodologjisë për ngritjen e një databaze të unifikuar me të dhëna të sakta të mbetjeve të gjeneruara brenda territorit të çdo bashkie.

- Miratimi i strategjisë së re 2020-2035 në fushën e mbetjeve

- Investimet përmes financimeve nga buxheti i shtetit dhe donatorët e ndryshëm, për ngritjen e infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve sipas standardeve evropiane duke filluar me ndërtimin e landfillit sanitar të Bajkaj që mbulon Vlorën jugore, landfillit sanitar të Maliqit që mbulon zonën e mbetjeve të Korçës, impiantit të Elbasanit që mbulon zonën e mbetjeve të Elbasanit, të Fierit, i cili do të mbulojë zonën e mbetjeve në Fier dhe ai në Tiranë, që do të mbulojë zonën e mbetjeve Tiranë-Durrës.

**Këto impiante do të bëjnë të mundur edhe trajtimin dhe shndërrimin e mbetjeve të ngurta, të papërdorshme nëpërmjet incenerimit, në energji elektrike .**

- Financimet e kryera për mbylljen apo rehabilitimin e 10 venddepozitimeve ekzistuese jashtë çdo lloj standardi, si mbyllja e Porto Romanos dhe shndërrimi i tij në një ekopark, me buxhet të shtetit apo reabilitimi i venddepozitimeve në bashkitë Berat, Dimal, Kuçovë, Çorovodë dhe Gjirokastër .

- ka dhe bashki të tjera ku planifikohet të financohet për reabilitimin e venddepozitimeve si ; Bashkia Këlcyre, Përrenjas, Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë.

Investimi për ndërtimin e landfillit në Vlorë që do të mbulojë Vlorën dhe Selenicën.

Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve, filloi në kushtet e një konteksti të caktuar, kur venddepozitimet ekzistuese kishin mbaruar **de jure** dhe **de facto** funksionalitetin e tyre, moment ky që në vetvete përcaktoi dhe shpalljen e emergjencës mjedisore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky fakt nuk mund të lihet jashtë vëmendjes; edhe në Komisionin Hetimor Parlamentar, ai u analizua në mënyrë të hollësishme, si nëpërmjet përmbajtjes së vendimeve të këshillave bashkiakë të bashkive Elbasan, Fier, (Durrës) që pasuan vendimmarrjen e Komitetit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve për emergjencën mjedisore, ashtu dhe të dhënave dokumentare të bashkive, dëshmime të kryetarëve të pushtetit lokal dhe informacionit shkresor të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit. Ish fushat e mbetjeve, në bashkitë Elbasan, Fier dhe Tiranë kishin dalë jashtë funksionimit të tyre, si fusha të ngritura që 25 vite më parë (Sharra/ Tiranë) apo që në kohën e regjimit ish komunist, në vitet '70-të.



Mjafton në vetvete, **nënvizimi i afatit kohor** të lartpërmendur, për secilin nga impiantet, për të kuptuar qartësisht alertin mjedisor përballë të cilit gjendeshim në vitin 2014-2015 e që me të drejtë është përshkruar në dokumenta të ndryshëm zyrtarë, pamje filmike dhe fotografike të administruara rregullisht në komision, si një katastrofë e vërtetë mjedisore, vecanërisht në bashkitë në fjalë, për të cilat dihej botërisht se dhe e kaluara industriale e tyre, në kohën e rregjimit komunist, ishte një arsye themelore për situatën tejet të rënduar mjedisore, sidomos në periudhën post tranzitore të qeverisjes, kur vendi ndryshoi sistemin politik të qeverisjes duke kalur në një demokraci parlamentare.

#### **4.BAZA LIGJORE E HETIMIT PARLAMENTAR**

Hetimi parlamentar lidhur me procedurat e ndërtimit dhe vënies në funksion të impianteve të trajtimit të mbetjeve, përsa i takon përfaqësuesve të mazhorancës në këtë komision, duhej të ngelej i ndarë nga hetimi penal i cili po zhvillohet nga strukturat e SPAK, në respekt të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7 të saj, në të cilin sanksionohet sa më poshtë vijon;

##### **Neni 7 i Kushtetutës**

*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë, bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.*

E vërteta është se ky parim u shkel që në krye të herës nga kërkuesit, të cilët që në nisje të këtij komisioni, në cdo qëndrim verbal dhe në cdo dokument parlamentar të paraqitur nga ana e tyre, ngritën akuza penale, shpallën akuza penale dhe fajtorë, kërkuan të ushtrojnë ndikim në organin e ndjekjes penale, të cilit ligji themeltar i Republikës së Shqipërisë, Kushtetuta, në nenin 148.1.2 të saj, i jep ekskluzivitetin e ngritjes së akuzës dhe pavarësinë në ushtrimin e funksionit.

##### **Neni 148.1.2 i Kushtetutës**

*1.Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen dhe detyra të tjera të caktuara me ligj.*

*2. Prokuroria është organ i pavaruar që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.*

Morespektimi i sa më lart, coi në shkelje të rëndësishme përmbajtësore dhe proceduriale nga ana e Komisionit Hetimor Parlamentar, të reflektuara hapur në drejtimin dhe zhvillimin e mbledhjeve, në kërkesat për mbledhje informacioni, në mënyrën e pyetjes së dëshmitarëve dhe në përfundimet e kërkuesve.

Qëllimi i cdo hetimi parlamentar, është të hetojë sjelljen e subjekteve publike në raport me ligjin dhe detyrën, duke u kujdesur të identifikojë mangësi të ligjit, vakume të parashikimeve të duhura ligjore, për të cilat Kuvendi si përfaqësues dhe mbajtës i pushtetit legjislativ, ka detyrë të përmirësojë, të orientojë, të detyrojë dhe të sanksionojë, gjithmonë përmes instrumentit ligjor, sjelljen e përshtatshme, rregullimin e duhur të fushave të ndryshme të veprimtarisë shoqërore apo marrëdhënieve socio -ekonomike dhe politike.

Është po ashtu detyrë e Kuvendit, që në një rast eventual e që jo domosdoshmërisht ka lidhje me këtë hetim, të paraqesë dhe mjetet e kufizimit të bartësve të pushtetit ekzekutiv.

Sjellja e subjekteve privatë, qofshin persona juridikë apo fizikë, në raport me ligjin, nuk mund dhe nuk duhet të jetë objekt i hetimit parlamentar në kuptimin e e ngritjes së akuzave penale nga ana e parlamentit, sepse kjo nuk është as në tagrin dhe as në interesin publik të veprimtarisë parlamentare.

Sidoqoftë, në këtë raport, pavarësisht qasjes sonë sesi duhej të funksiononte ky hetim parlamentar, në respekt të detyrës së tij për të mbledhur fakte dhe të dhëna në lidhje me një çështje të rëndësishme të interesit publik, ne do të përcjellim konkluzionet tona për të gjithë situatën faktike në të cilën u operua me ndërtimin dhe vënien në funksionim të impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane, në Elbasan, Fier dhe Tiranë, duke analizuar vecmas secilën prej praktikave dokumentare si dhe dëshmitë e marra në Komisionin Hetimor.

## **5.SHQYRTIMI I PRAKTIKAVE DOKUMENTARE TË KONTRATAVE KONCENSIONARE DHE DËSHMIVE TË ZYRTARËVE PUBLIKË**

### **I.PRAKTIKA KONCENSIONARE ELBASAN**

#### **Impianti i trajtimit të mbetjeve urbane Elbasan**

#### **Të dhëna kryesore të kontratës**

Autoritet kontraktues: Ministria e Mjedisit

Koncensionari; “Albtek Energy” shpk

Forma e koncensionit : BOT (Ndërtim-Operim- Transferim)

Data e lidhjes së kontratës : 16.12.2014

Periudha e koncensionit : 7 vjet

Vlera e kontratës ; 21 600 000 (njëzet e një milionë e gjashtëqindmijë ) euro

Vendndodhja: në juglindje të ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan, në vendin e hedhjes së mbeturinave të këtij kombinati, 33 km nga Tirana.

Në qoftë se qytetarët shqiptarë përpara këtij momenti, do ishin pyetur se cili qytet është më i ndoturi, më i kontaminuari në Republikën e Shqipërisë, pa dyshim do shpreheshin “Elbasani”, sepse ka qenë dhe ngelet ndoshta ende nje perceptim I përgjithshëm publik, për shkak të së kaluarës së këtij qyteti, një e kaluar e rënduar industriale, e cila ne vitet e tranzicionit e deri në ditët e sotme, sigurisht që ka ndikuar në një mënyrë të jashtëzakonshme cilësinë e ajrit dhe të mjedisit në këtë qytet.

Megjithatë në vitet 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012, për Agjencinë Rajonale të Mjedisit të Qarkut Elbasan e që asokohe drejtohej nga zyrtarë të Partisë Demokratike, sipas një raporti të saj të datës **17/09/2012** , situata nuk ka qenë fiks kështu , pasi që në raport thuhej se “ka përmirësime të

dukshme”, se “ në vitin 2009 ky përmirësim ishte i dukshëm , megjithatë si në të gjithë qytetet e tjera, problem ngelej pluhuri”.

Në vitin 2009, cilësia e ujrave nëntokësore plotëson normat e lejuara për ujë të pijshëm, ndërsa cilësia e ujrave të lumit Shkumbin, është mesatare.

Në vitin 2009 dhe viti 2010 ajri urban rezulton I pastër. Viti 2011 meqënëse materiali I plotë nuk është botuar akoma, duhet thënë që edhe për 2011 dhe vazhdimin, pra dhe në 2012 ka të njëjtin konkluzion.

Kushdo që vjen nga Elbasani dhe jeton në Shqipëri, e di shumë mirë se situata mjedisore në Elbasan nuk ka qenë aspak kaq rozë sa e përshkruanin ish zyrtarët e qeverisjes së Partisë Demokratike; Elbasani ka pasur një situatë tejet të rënduar mjedisore, prej vitesh, sikundër dhe kryeqyteti, edhe Fieri, një tjetër qytet I madh ish industrial, situatë e cila kërkonte vlerësim real dhe ndërhyrje serioze në nivel qendror më së pari e mandej dhe lokal.

Këshilli i Ministrave me vendimin **Nr .175, date 19.01.2011**, kishte miratuar “Strategjinë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planifikimit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve në RSH.

Qeveria e kohës, ka bërë një përshkrim të situatës e gjendjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve , si nga pikëpamja e infrastrukturës ligjore ashtu edhe nga ajo e menaxhimit dhe administrimit të mbetjeve, si dhe ka përcaktuar hapat për të ardhmen deri në vitin 2025.

Raport progresi i vitit 2009 për Shqipërinë, nga Bashkimi Europian, nuk ishte pozitiv për sa i përket mjedisit. Administrimi i mbetjeve shihej si shumë i dobët.

Strategjia e mësipërme, ishte parashikuar për periudhën 2010-2025, si periudhë e rëndësishme para dhe menjëherë pas pranimit në BE .

Sipas kësaj strategjie, Qeveria angazhohej për një program të përmirësimit të mjedisit, si pjesë e një agjende më të gjerë politike për të fituar anëtarësimin e plotë në BE të Shqipërisë.

Në ndërkohë, fakti është që për shkak të situatës së degraduar mjedisore që u trashëgua pas vitit 2013, kohë e cila përkon dhe me fillimin e qeverisjes së majtë , në shtator 2013 kur qeveria e re mori votëbesimin në parlament, më datë 05 Shkurt 2014 , Komiteti Kombëtar I Menaxhimit të Mbetjeve, shpalli fillimin e gjendjes së emergjencës mjedisore në territorin e Republikës së Shqipërisë, nisur jo vetëm nga Elbasani, por edhe nga një sërë qytetesh qe kishin problematikë të ngjashme dhe urdhëroi marrjen e masave të nevojshme për rehabilitimin e cilësisë së ajrit.

Në vijim dhe reagim të kësaj vendimmarrje, Bashkia Elbasan , më datë 04 Korrik 2014 , i dërgon një shkresë Ministrisë të Mjedisit, në të cilën i ngrë shqetësimin se “grumbullimi dhe sistemimi i mbetjeve urbane, përbën një problem shumë shqetësues për Bashkinë Elbasan dhe se duhej marrë një zgjidhje imediate dhe e shpejtë për këtë problem” .

Në të gjithë dokumentacionin e administruar lidhur me këtë çështje, prej Bashkisë Elbasan, paraqiten një sërë avantazhesh për ndërtimin e impiantit me rikuperim të energjisë, në krahasim me një landfill tradicional.

Rezulton, gjithmonë nga ky dokumentacion, se Këshilli Bashkiak Elbasan, pa asnjë ndarje, në të majtë dhe të djathtë, i kërkonte Kryetarit të Bashkisë që nëpërmjet kontakteve të tij , duke iu

drejtuar edhe Kryeministrit, ministrave përkatës e me radhë, të ndërhynte dhe të zgjidhte këtë çështje .

Më datë 09 Korrik 2014 , pra disa ditë pasi Bashkia Elbasan, ia bën prezent Ministrit të ri të Mjedisit, çështjen e emergjencës mjedisore në Elbasan , Ministria kthen përgjigjen që “kërkesa juaj pranohet sepse paraqet interes publik” dhe kështu ftohet Bashkia e Elbasanit që të paraqesë të dhëna të detajuara , vlerësime për fizibilitetin teknik , ekonomik financiar , vlerësim të ndikimit në mjedis etj .

Këshilli Bashkiak Elbasan po ashtu, më datë 18 Shtator 2014 , ka vendosur që të shpallë emergjencën mjedisore në fushën e mbetjeve në qytetin e Elbasanit, një fushë mbi 25 vjecare dhe tejet e rënduar nga mosadministrimi sipas standarteve, por trajtimi thjesht dhe vetëm si një venddepozitimi .

Këshilli Bashkiak ka vendosur edhe që të hartojë planin e masave të nevojshme për përmirësimin e situatës së krijuar si dhe të kërkojë mbështetje teknike nga institucionet, për të bërë të mundur realizimin e planit të masave.

Në këtë pikë , duhet të pohojmë dhe kjo nuk ka sesi të mos jetë e gjithëpranuar, se vijimisht ka pasur mungesa ne kapacitetet intelektuale që lidhen me njohjen dhe trajtimin e mjedisit.

### **Le të kthehemi te hetimi;**

Autoriteti Kontraktor në tre rastet e kontratave koncensionare të Elbasanit, Fierit dhe Tiranës, ka qenë Ministri I Mjedisit dhe kjo në bazë të ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” I cili në përkufizim të termave të përdorur, sipas nenit 3 të tij “Përkufizime”, pika 26 dhe 27 të tij, parashikon se termi “Ministër” dhe “Ministria” I referohen përkatësisht ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

Më tej akoma, në nenin 65 të këtij ligji, parashikohet se ;

### **Neni 65**

#### **Nxjtja e investimeve private dhe e partneritetit publik privat**

*1.Këshilli i ministrave nxit angazhimin e sektorit privat dhe partneritetin publik privat, në veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve.*

*2.Projektet që në gjykimin e ministrisë, synojnë të realizojnë masat e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, jepen me koncension, në përputhje me ligjin nr.9663 datë 18.12.2006 “ Për koncensionet ” të ndryshuar.*

Gjithashtu në VKM Nr. 945, datë 09.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit” në pikën II, përcaktohet qartë se “...Ministria e Mjedisit harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, nxitjen dhe promovimin e burimeve të rinovueshme, mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, si dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore...”, dhe më tej në pikën III, thuhet se “...Ministria e Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës: Sektorin e mjedisit, përfshirë politikat, standardet dhe monitorimin e mbetjeve urbane, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit, vlerësimin e ndikimit në mjedis...”

Pra, sipas ligjit dhe VKM që sapo u cituan, **Ministri i Mjedisit, kishte dhe ka përgjegjësinë që të angazhohej në çështjet e mjedisit .**

Në këtë pjesë të raportit, nuk do të komentojmë asnjë veprim tjetër të Autoritetit Kontraktor , pra të Ministrisë së Mjedisit , jo vetëm për arsyen që tanimë kjo çështje i takon hetimit dhe gjykimit nga ana e organeve të drejtësisë, por edhe sepse si forcë politike kemi premtuar publikisht, dhe kemi rast të rikonfirmojmë, që nuk i japim mbrojtje askujt, për një akuzë penale. **Kjo është dhe duhet të jetë një përballje që kushdo do duhet ta zhvillojë vetë me drejtësinë .**

Nuk bëjmë avokatinë e askujt të ekspozuar ndaj një akuze penale, por padyshim që kemi detyrë të bëjmë diferencën mes asaj që është përgjegjësi individuale, e ndryshme nga përgjegjësia kolektive, e cila në fakt nuk është kurrë dhe asnjëherë penale .

**Përgjegjësia penale është individuale** dhe këtë legjilacioni penal e shpreh saktësisht në disa nene të tij, neni 1 “ Ligji penal dhe ndarja e veprave penale”, neni 2 “Mosdënimi pa ligj”, neni 3 “ Veprimi në kohë i ligjit penal” , neni 6, 7, 8, 9 ,10,11 për zbatimin e ligjit penal, neni 12 “Moshë për përgjegjësi penale” etj të Kodit Penal.

Kuptimi drejt dhe si duhet i këtyre dispozitave, vlen jo vetëm për dikë që ka formimin e juristit, por duhet të vlejë mbi të gjitha, për një ligjvënës që presupozohet të ketë ose të fitojë një kulturë minimale juridike, në bazë të së cilës të qëndrojë respekti, përpjekja dhe detyrimi për ta lexuar dhe kuptuar si duhet ligjin.

Institucionet po ashtu, presupozohet që duhet të sillen në bazë të ligjit dhe nëse kjo nuk rezulton e tillë, na takon ne ligjvënësve ta identifikojmë dhe të marrim masat për ta korrigjuar situatën .

Në rastin konkret, ne shqyrtuam me vëmendje sjelljen e institucioneve publike dhe konstatuam që Këshilli Bashkiak , Bashkia Elbasan , Prefekti i Qarkut Elbasan, kanë qenë realisht të shqetësuar për situatën mjedisore në Qarkun e Elbasanit dhe nuk ka dhe nuk u soll asnjë e dhënë e tillë që të provonte të kundërtën.

Ligji për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal, por edhe ai për trajtimin e mbetjeve, i jep përgjegjësi të plotë pushtetit lokal , për t’u angazhuar dhe për t’u dhënë qytetarëve shërbimin e pastrimit dhe trajtimit të mbetjeve .

Në kontekstin e detyrimit dhe përgjegjësisë ligjore që shpjeguam më lart, në rastin e Elbasanit, Ministria e Mjedisit në rolin e Autoritetit Kontraktues, të cilës ligji i jep kompetencat për të ndërmarrë një procedurë për dhënie me koncesion /PPP, ligji Nr.125/2013 “Për koncesionet/PPP”, është investuar që **në shtatorin e vitit 2014** për ngritur komisionin e dhënies me koncesion për këtë projekt, një komision i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, dy përfaqësues nga Bashkia e Elbasanit, një përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës dhe ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Ndërkohë që autoriteti kontraktor vijonte procedurën, çfarë ndodhi, si u investua Këshilli i Ministrave në vendimmarrje, çfarë vendimi miratoi Këshilli i Ministrave e natyrisht ministrat të cilët në përgjegjësinë e vet funksionale kuptohet, **nuk e kishin rol kryesor apo atribut zgjidhjen e situatave mjedisore .**

Më datë 31.10.2014, Ministria e Mjedisit, në bazë të nenit 42 të ligjit Nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat në RSH”, referuar rezultateve të Studimit të Fizibilitetit të hartuar nga Autoritetit Kontraktor në zbatim të nenit 19 të ligjit 125/2013, i ka kërkuar miratimin paraprak Ministrisë së Financave.

Autoriteti i Ministrisë të Financave, lidhur me koncesionet/partneritetin publik privat, ushtrohet sipas përcaktimeve në nenet e veçanta të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe konkretisht sipas parashikimeve të **nenit 42** i cili përcakton se “*Projekti që ka nevojë për mbështetje financiare, siç përcaktohet nga studimi i fizibilitetit, kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave, në lidhje me përbalueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, domethënë ndikimet dhe risqet fiskale të menjëhershme dhe urgjente.*

Gjithashtu në të njëjtën datë i është dërguar informacion Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, pra studimi teknik dhe përshkrim financiar me qëllim njohjen nga kjo ministri të teknologjisë së ofruar duke iu referuar fushës së përgjegjësisë së kësaj ministrie.

Legjislacioni për Koncesionin /PPP, përcakton që Ministria e Financave jep miratimin paraprak mbi studimin e fizibilitetit të dërguar nga Autoritetet Kontraktuese, rol i cili referuar fushës së saj të përgjegjësisë shtetërore kufizohet **në dhënien e miratimit paraprak mbi studimin e fizibilitetit, në 3 aspekte:**

(i) përbalueshmëri, (ii) qëndrueshmëri dhe (iii) fizibilitet fiskal, ngushtësisht nga pikëpamja buxhetore e në përputhje me parimet dhe kërkesat e ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Sjellim në vëmendje se asnjë parashikim i mëtejshëm ligjor, si në kuadrin ligjor specifik rregullator “Për koncesionet/PPP” apo ndonjë pjesë tjetër të legjislacionit jo rregullator të fushës, nuk e referon qoftë shprehimisht apo në mënyrë të tërthortë, pjesërisht apo tërësisht Ministrinë e Financave në kryejën e ndonjë vlerësimi tjetër, përveçse asaj të **(i) përbalueshmërisë, (ii) qëndrueshmërisë dhe (iii) fizibilitetit fiskal, analizë e bazuar në studimin e fizibilitetit të hartuar nga Autoriteti Kontraktues.**

Sipas ligjit 125/2013 , Ministria e Financave, shprehet mbi rezultatet e Studimit të Fizibilitetit të hartuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili përmban :

1. përmbledhjen operacionale dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit;
2. analizën e projektit , ku objektivi kryesor i të cilës është të përcaktojë “Vlerën e Parasë (neni 7 i VKM nr 575/2013), pra realizueshmëria ekonomike e projektit, përbalueshmëria , përshtatshmëria financiare dhe një analizë cilësore dhe/ose sasiore risku.
3. analizën teknike
4. analizën ligjore,
5. ndikimin në mjedis

**Sipas nenit 8 të VKM 575/2013** , Autoriteti Kontraktues, vendos se:

“Nëse krahasimi mes *alternativës së prokurimit publik dhe alternativës së koncesion/PPP-së tregon se zgjidhja e dytë ka potencial të ofrojë vlerën më të mirë të parasë, autoriteti kontraktues mund të marrë vendimin për të përgatitur procedurën e dhënies së një kontrate me koncesion/PPP.* Në fund rezultatet e studimit të fizibilitetit të hartuar nga Autoriteti Kontraktues sipas përcaktimeve të pikës të **nenit 9** të VKM 575/2013, të ndryshuar duhet të tregojnë se:

*projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm dhe përmbush kërkesat e politikave të autoritetit kontraktues;*

*projekti është i realizueshëm, në aspektin e realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe tregtare, duke përfshirë edhe përbalueshmërinë dhe përshtatshmërinë financiare;*

*projekti nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor;*

*alternativa përmes së cilës është parashikuar të përfundojë projekti, nëpërmjet dhënies së një kontrate me koncesion/PPP, është më e dobishme në krahasim me alternativën e dhënies së një kontrate prokurimi publik.*

Projekti i cili përmbush të gjitha kushtet si më sipër, më tej paraqitet për miratim në ministrinë përgjegjëse për financat, e cila e vlerëson dhe miraton paraprakisht projektin e koncesionit/(PPP), nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Në vijim të ushtrimit dhe përmbushjes së detyrave sipas fushës së përgjegjësisë së tyre, kanë vijuar komunikimet me shkresa zyrtare **në datat 18.11.2014, 20.11.2014 deri më datë 10.12.2014**, midis Autoritetit Kontraktues dhe Ministrisë së Financave e cila në këtë kontekst, pra në përputhje me parashikimet e nenit 42 të ligjit 125/2013, **ka dhënë miratim paraprak me shkresën nr.17042/1 prot, datë 10.12.2014, mbi studimin e fizibilitetit të hartuar nga Autoriteti Kontraktor**, përsa i takon qëndrueshmërisë dhe fizibilitetit fiskal të projektit koncesionar/PPP, duke vlerësuar ndikimin e risqeve potenciale të menjëhershme dhe urgjente që shoqërojnë projektin në kuadrin fiskal vjetor dhe atë afatmesëm.

Në këtë komision, nga pyetjet dhe përgjigjet e dhëna nga dëshmitarë të ndryshëm, pjesë të seancave dëgjimore, evidentohet se një nga vendimet që ka marrë më shumë vëmendje dhe diskutime është **vendimi nr.907, datë 17.12.2014** i Këshillit të Ministrave, **“Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë”**.

Vendimi i mësipërm ka si bazë ligjore nenet 27 dhe 41 të ligjit Nr.125/2013. Këto dy nene përbëjnë përkatësisht autorizimin ligjor për nxjerrjen e vendimit të Këshillit të Ministrave. Bazuar në pikën 5, të nenit 27, të ligjit, përcaktohet se *marrëveshje dhe/ose kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara quhen në veçanti ato të cilat janë të lidhura për të siguruar financimin e nevojshëm për zbatimin e kontratës.*

Gjithashtu, në nenin 41 të ligjit, saktësohet se *autoriteti kontraktues mund të hyjë në një angazhim detyrues, në emër të shtetit, që do të ketë efektin e sigurimit të garancive të përshtatshme në favor të koncesionarit/partneritetit privat, me të cilin do të mbrohet kundër pasojave financiare të legjislacionit, i cili hyn në fuqi pas fillimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, që u nënshtrohet kufizimeve të mëposhtme:*

- a) *Pasojat financiare duhet të përshkruhen në mënyrë të qartë dhe të saktë;*
- b) *Angazhimi përfundon me përfundimin e marrëveshjes së koncesionit;*
- c) *Duhet të përshkruhet natyra e legjislacionit.*

**Një angazhim i tillë detyrues miratohet më vendim të Këshillit të Ministrave, me kërkesën e autoritetit kontraktues.**

Projekti që ka nevojë për mbështetje financiare, siç përcaktohet nga studimi i fizibilitetit, kërkon një miratim nga Ministria e Financave, në lidhje me përbalueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, domethënë ndikimet dhe risqet fiskale të menjëhershme dhe urgjente.

Në hartimin e projektaktit ka kontribuar grupi i punës, me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe nga Bashkia Elbasan.

Duke qenë se Ministria e Mjedisit e ka konsideruar këtë akt, si akt me karakter individual, nuk e ka konsideruar të nevojshme për ta dërguar projektvendimin për mendim në Ministrinë e Drejtësisë (shih shkronjën “c” të nenit 28 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ku përcaktohet se “...vendimi me karakter individual, është akti nënligjor i Këshillit të Ministrave, që rregullon një marrëdhënie konkrete, ose që u drejtohet një ose disa subjekteve, individualisht të përcaktuara, të së drejtës...”, dhe pika 2 e nenit 24 që parashikon se “...Në çdo rast projektaktet, përveç atyre me karakter individual, i dërgohen për mendim Ministrisë së Drejtësisë, i cili shprehet për ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së tyre...”).

Bazuar në nënin 9 të ligjit 9000/2003, në të cilën përcaktohen kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe më tej në nenet 13, 15 dhe 16 të ligjit, saktësohet se në mbledhjet e Këshillit të Ministrave shqyrtohen aktet e paraqitura nga ministrinë propozuese, kompetencë të cilën Këshillit të Ministrave ia njeh Kushtetuta dhe ligji.

Në këtë kuptim paraprakisht vlerësohet nëse dokumenti përmbush kriteret ligjore, siç janë baza ligjore apo autorizimi ligjor dhe më pas kryhet verifikimi i elementëve formalë që ka akti, si relacioni apo teknika legjislative e përdorur.

Gjatë zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, drejtuesi i saj, fton të gjithë anëtarët që të shprehen duke dhënë mendimin e tyre në lidhje me aktin e marrë në shqyrtim. Pas shfaqjes së mendimit nga të gjithë anëtarët, procedohet me votimin e aktit.

**Sikurse u përmend edhe nga Sekretari i Përgjithshëm Z.Agaçi në dëshminë e tij, ky akt është miratuar me unanimitet nga të gjithë anëtarët e pranishëm.**

Sikurse përmendëm, procedurat koncesionare janë kompetencë e Autoritetit Kontraktor, në bazë të neneve 3, 16, 17, 18 dhe 19 të ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat në RSH”.

Në zbatim edhe të neneve të mësipërme, Autoriteti Kontraktor pasi ka ndjekur të gjitha hapat e përshkruar më lart, ka vazhduar me lidhjen e kontratës.

**Kujtojmë që kontrata sipas pikës 30.8 të saj kishte hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët dhe konkretisht në datën 16.12.2014.**

÷Me shkresën Nr.10843, datë 11.11.2014, Ministria e Mjedisit iu është drejtuar me shkresë 5 institucioneve dhe konkretisht, Ministrisë së Drejtësisë, Financës, Energjisë dhe Industrisë, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, me anë të së cilës kërkonte mendim për projektvendimin “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues përkatësisht Ministria e Mjedisit, për dhënien me koncesion/ppp të ndërtimit dhe administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan për prodhimin e energjisë elektrike në procedurën përzgjedhëse me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës që i jepet shoqërisë Alb-Tek sh.p.k.”.

**Ky projektvendim** që për muaj e muaj u bë refren nga Partia Demokratike dhe opozita, antarët e saj në Komisionin Hetimor, se Këshilli i Ministrave kishte miratuar një akt të paligjshëm, pasi APP kishte kthyer përgjigje negative, **u hodh poshtë nga dokumentacioni i administruar pranë Komisionit Hetimor dhe nga dëshimitë në veçanti të z. Cani, z. Ahmetaj, z. Agaçi, znj. Kashta**



etj., që provuan se ky projektvendim nuk është miratuar asnjëherë nga Këshilli i Ministrave.

**Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar kontratë per dhënien e koncesionit sa I takon Elbasanit, sepse kontrata është lidhur ndërmjet Ministrit të Mjedisit dhe koncesionarit, shoqërisë “Albtek” shpk.**

Procedura e negocimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktor, ka qenë ajo e negocimit pa shpallje paraprake ; nëse ka ndonjë ligj që njeh një procedurë të tillë sigurisht që ka një ligj që e njeh një procedurë të tillë dhe ky është ligji Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” I ndryshuar.

**A duhet të ishte partneritet publik privat apo jo ?**

**Po.** Po t’i referohemi legjislacionit në fuqi, nenit 4 të ligjit 125/2013 “Fusha e zbatimit të koncesioneve/partneriteteve publike private”, parashikon qartë se “Koncesionet/partneritetet publike private mund të jepen për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve për sektorët dhe qëllimet ku përfshihet edhe trajtimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve”, sikundër kjo parashikohet edhe nenin 65 “Nxitja e investimeve private dhe e partneritetit publik privat “ të ligjit Nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

**A duhet të ishte prokurim publik? Jo.**

Po t’i referohemi ligjit 125/2013 dhe VKM 575/2013, Studimit të Fizibilitetit që hartohet nga Autoritet Kontraktor, është treguar se:

- a)projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm dhe përmbush kërkesat dhe politikat e autoritetit kontraktues,
- b)është i realizueshëm, në aspektin e realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe tregtare,
- c)projekti nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor
- d)alternativa përmes së cilës është parashikuar të përfundojë projekti, nëpërmjet dhënies së një kontrate me koncesion/PPP, është më e dobishme në krahasim me alternativën e dhënies së një kontrate prokurimi publik.

**VKM Nr.907** “Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë”, është dhënë më datë 17.12.2014; nuk është e vërtetë sikundër e pohoi në dëshminë e tij Sekretari I Përgjithshëm I Këshillit të Ministrave, z. Ëngjëll Agaçi se janë miratuar 17 vendime në një ditë apo se janë miratuar enkas 17 procedura në një mbledhje të jashtëzakonshme. Në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit të Ministrave janë miratuar mbi 20 akte të ndryshme por vetëm një ishte akti që kishte lidhje me financimin e kontratës koncesionare për trajtimin e impiantit të mbetjeve të Elbasanit. Kjo ishte e pavërteta e radhës që u pranua edhe nga anëtarët e komisionit përfshirë edhe ata të opozitës në fund të procesit hetimor.

Është në traditën e Këshillit të Ministrave , që ky i fundit të mblidhet ditëve të mërkura, ora 11:00, dhe data 17.12.2014 ka qenë një ditë e zakonshme mbledhje e Këshillit të Ministrave , ku janë miratuar 20 akte për të cilat ishte kryer procesi i bashkërendimit, një proces i cili që prej vitit 2010, realizohet sipas sistemit elektronik të akteve, sistem i cili bën të mundur marrjen e mendimeve në kohë reale dhe më parë kohës së mbërritjes të shkresave që përcillen edhe nëpërmjet shërbimit postar.

Dita kur është mbledhur Këshilli I Ministrave për të miratuar VKM Nr.907/ 2014 ka qenë ditë e mërkurë e zakonshme mbledhjeje, cka provon se pohimi që Këshilli I Ministrave të ishte mbledhur posacërisht, në një mbledhje të jashtëzakonshme, dhe vetëm për vendimmarrjen e mësipërme, është I rrëzueshëm katërcipërisht, duke konfirmuar dhe një herë se përgjegjësitë në cdo rast, janë dhe ngelen individuale , nuk ka përgjegjësi të tillë që të implikojë në një të vetme, në një proces vendimmarrje që realizohet me shumicë të thjeshtë të antarëve të qeverisë dhe mbi bazë të shprehjes së lirë të mendimeve nga ana e tyre.

Këshilli i Ministrave bazuar në ligjin 9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe pikën 50 të VKM Nr. 584/2003 lidhur me projektaktet me rëndësi të veçantë, shqyrton propozimin në bazë të disa kriterëve që kanë të bëjnë me urgjencën e propozimit, kërkesën e publikut, plotësimin e objektivave të politikave kombëtare të zhvillimit, mundësisë së zbatimit të shpejtë etj.

Pra duke qënë se Autoriteti Kontraktor kishte përfshirë dhe garantuar që kostot përkatëse të këtij projekti ishin të planifikuara të përballoheshin brenda buxhetit vjetor të Ministrisë së Mjedisit, të miratuara nga Kuvendi; brenda tavaneve të shpenzimeve për periudhën afatmesme, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe pas dhënies së miratimit paraprak nga Ministria e Financave, në lidhje me qëndrueshmërinë, përballueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal të projektit, në zbatimit të nenit 42 të ligjit 125/2015, bazuar në autorizimin ligjor sipas nenit 41 të ligjit 125/2013; u vijua me dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë, nga Këshilli i Ministrave më datë 17.12.2014.

Mandej për zbatimin e kontratës koncesionare kanë vijuar edhe procedura të tjera, ku vecojmë procedurën për nxjerrjen e lejes së ndërtimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Ministria e Mjedisit **më datë 14.01.2015**, I ka dërguar shkresë Agjensisë së Planifikimit të Territorit për çështjen e lejes së ndërtimit .

Leja është dhënë më datë **27.01.2015** dhe zbardhur në muajin **mars 2015**.

Kjo është një tjetër provë e deduktuar prej diferencës kohore të dhënies së përgjigjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës koncesionare në fjalë, e cila tregon se nuk ka pasur asnjë lloj sjellje të paracaktuar, enkas, apo në favor, dukshëm në favor të koncesionarit nga ana e institucioneve qendrore , ministrive dhe autoriteteve të tjera të varësisë, të tilla që të klasifikohen se I kanë shërbyer një vendimmarrjeje të një grupi të organizuar dhe të interesuar për një vendim të përbashkët, në favor të një treti.

Përkundrazi, rezulton e qartë se sjellja e institucioneve ka qenë konform ligjit dhe përgjegjësie përkatëse, në shërbim të një çështjeje që lidhej me një emergjencë mjedisore, në një qark për të cilin ekziston perceptimi i gjerë publik se ka pasur një situatë jashtëzakonisht të rënduar mjedisore e cila kërkonte reagim dhe jo shpërfillje, jo zvarritje burokratike por zgjidhje.

Konform ligjit, u provua të ketë qenë edhe vendimmarrja tjetër e Këshillit të Ministrave në lidhje me këtë kontratë koncesionare, e shprehur në VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”

Roli i Ministrisë së Energjisë në këtë proces përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

#### **Neni 4**

##### **Politikat e sektorit të energjisë elektrike**

1. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për politikën e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike të Shqipërisë, në përputhje me politikën e zhvillimit ekonomik dhe sektorët e tjerë të vendit.

2. Ministria përgjegjëse për energjinë:

c) vlerëson nevojën e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese dhe fuqizimin e rrjeteve, në përputhje me programet afatmesme, duke marrë parasysh:

#### **Neni 49**

##### **Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese**

1. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, të cilat nuk janë objekt koncesioni, ose çdo kapacitet i ri prodhues deri në 2Më, miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese mbi 2 Më, të cilat nuk janë objekt koncesioni, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, miraton rregullat dhe procedurat për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, mbi baza transparente dhe jodiskriminuese, bazuar në:

- a) sigurinë e sistemit të energjisë elektrike, instalimeve dhe pajisjeve të lidhura me to;
- b) mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë publike; c) mbrojtjen e mjedisit;
- ç) përdorimin e truallit dhe vendndodhjen;
- d) efikasitetin e energjisë; dh) natyrën e burimeve parësore të energjisë;
- e) karakteristikat e veçanta të aplikuesit, të tilla si aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare;
- ë) përputhjen me masat e marra për shërbimin publik dhe mbrojtjen e klientëve;
- f) kontributin e kapacitetit prodhues në përmbushjen e objektivit për energjinë që duhet të prodhohet nga burimet e rinovueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- g) kontributin e kapacitetit gjenerues në reduktimin e emetimeve të gazrave të efektit serë;
- gj) shitjen e energjisë elektrike;
- h) vlerën e tarifës që do të paguajë në favor të shtetit përfituesi i autorizimit.

Bazuar në sa më lart, Këshilli i Ministrave, ka miratuar VKM Nr. 822, datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”.

Ky vendim rregullon autorizimet që jep Ministri për çdo impiant prodhimi energjie që nuk janë objekt koncesioni nga ministria e energjisë. Projekti i propozuar është një impiant i përpunimit të mbetjeve urbane me rikuperim të energjisë.

Bazuar në nenin 49 pika 2 të ligjit 43/2015 të Sektorit të Energjisë Elektrike dhe VKM Nr. 822 e sipërcituar, Ministria ka detyrimin ligjor për të përcaktuar një sërë karakteristikash teknike, kriteresh, standardesh, rregulla sigurie, shitjen e energjisë, tarifën që përfiton shteti etj, që duhet të gëzojë çdo impiant energjie që autorizohet për ndërtim dhe operim.

Miratimi I dhënë me shkresën më Nr. 4557/7 Prot, datë 31.10.2016, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë, z. Damian Gjicknuri “Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane, në qytetin e Elbasanit, nga shoqëria “ALBTEK ENERGY” sh.p.k”, është dhënë si pasojë e detyrimit ligjor dhe nuk ka pikë lidhje me “akuzën” se kjo shkresë “ishte një koncesion i fshehur për 25 vite për shitje të energjisë”

Detyrimi për pajisjen e koncesionarit me miratimin në fjalë, vjen jo vetëm si detyrim i ligjit por edhe si detyrim i përcaktuar në kontratën koncesionare tanimë të hyrë në fuqi dhe konkretisht në pjesën “**Dispozita te Përgjithshme/ Përcaktimet**”.

*“Autorizim paraprak” është autorizimi sipas përcaktimit të VKM Nr.1701 datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese, që nuk janë objekt koncesioni” lëshuar nga ministria përgjegjëse për energjinë;*

Theksojmë që **VKM 1701** e cituar në Kontratë, është zëvendësuar në vitin 2015 me **VKM 822** me të njëjtin objekt, duke përbërë bazën ligjore për lëshimin e këtij autorizimi.

Licensa për ndërtimin e burimit energjitik prodhues, është e lidhur vetëm me këtë impiant dhe nuk mund të trajtohet si e ndarë nga ky impiant.

Nuk është po ashtu e mundur transferimi i saj në një subjekt tjetër: licenca është një dhe e pandashme nga impianti .

Theksojmë se nga sa më sipër, nga shpjegimet e dhëna nga dy dëshmitarët, ministrja aktuale e energjisë znj. Belinda Balluku dhe ish ministri Damian Gjicknuri, rezulton se afati prej 25 vjetësh i impiantit , nënkupton vetëm afatin e shfrytëzimit të jetës së burimit prodhues të energjisë.

**Pretendimi se kemi të bëjmë me koncesion të ri është një absurditet apo lajthitje ekstreme, pasi nuk ka asnjë bazë ligjore për t’u konsideruar koncesion, po mbi të gjitha as është vënë ndonjëherë në diskutim qoftë dhe nga gjykata administrative, për konfliktin e krijuar pas kërkesë padisë të koncesionarit ndaj ERE për mosmiratimin e cmimit të shitjes së energjise elektrike të prodhuar për periudhën e operimit deri në vitin 2021.**

Për më tepër në letërkëmbimin mes Koncesionarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës, për fillimin e procesit të dorëzimit dhe mbylljes së kontratës së Koncesionit, datë **26.02.2020** e vijim, në zbatim të kontratës së koncesionit, shprehet qartë transferimi i cdo aseti dhe të drejte të zotëruar nga shoqëria koncesionare, tek AK duke mos pasur asnjë pretendim të mëtejshëm për to.

Nëse ky impiant nuk do ishte pajisur nga ministria me këtë autorizim, Ministria do të ishte në shkelje të legjislacionit në fuqi dhe kontratës së lidhur; mbi të gjitha do bënte të pamundur tregtimin e energjisë së prodhuar, duke privuar impiantin e përpunimit të mbetjeve që në përfundim të afatit të kontratës, I kalon në pronësi Bashkisë Elbasan, nga një e ardhur e rëndësishme që shërben për mbulimin e kostove operative të veprës dhe jo vetëm..

**Me përfundimin e kontratës së koncesionit, të gjitha të drejtat, licencat, asetet etj i kalojnë shtetit dhe në këtë nuk ka asnjë dyshim sepse kontrata koncesionare e përcakton shprehimisht këtë gjë dhe pa asnjë ekuivok .**

ALBTEK është një SPV (subjekt për qëllime të vecanta) i krijuar vetëm për këtë qëllim; ai nuk mund të kryejë aktivitet tjetër dhe në përfundim të periudhës së kontratës, cdo e drejtë i kalon pronarit shtetëror.

Ky detyrim është shprehur qartë sic u tha edhe në kontratën koncesionare ,pikat 5.2; 5.2.1; 5.2.2; si dhe neni 26 i kontratës, ku përcaktohet qartë afati 7 vjecar dhe transferimi i të gjitha kuotave/aksioneve te shteti dhe transferimi i cdo aseti dhe të drejte.

A ka prodhuar energji elektrike I ashtuquajtur i inceneratori I Elbasanit ose jo ?

Në komisionin hetimor është administruar shkresa e OSSHE e datës 23.11.2021, me Nr. 12258/2 Prot, me të cilën konfirmohet se;

*“Në vijim të shkresës tuaj lidhur me kerkesën e komisionit hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve dhe trajtimit të mbetjeve urbane” po ju dërgojmë informacionin e kërkuar si më poshtë ;*

*Për inceneratorin Elbasan, ju bëjmë me dije se shoqëria Albtek Energy ka aplikuar pranë OSSHE për lidhje të burimit gjenerues në rrjetin shpërndarës të OSSHE që në gusht të vitit 2016 .*

*Në prill të vitit 2017, është instaluar në objekt, matësi i energjisë elektrike me dy drejtime .*

*Më datë 06.06.2017 shoqëria ka njoftuar OSSHE se do të kalojë në regjim dhënie energjie në rrjetin e operatorit të shpërndarjes .*

*Deri më datë 08.11.2021, rezulton se ky subjekt ka injektuar në rrjetin shpërndarës sasinë e energjisë prej 6,748.2 MË (Mega Ëat) dhe ka përdorur për nevojat vetjake sasinë e energjisë prej 2,792.6 MË .*

Me këtë të dhënë shkresore si edhe me konstatimin në vend nga ana e Komisionit Hetimor, sa i takon vendosjes së matësit dhe kabinës elektrike, bie poshtë pretendimi se në Elbasan nuk është bërë asnjëherë incenerim gjatë kohës së operimit të kontratës koncensionare, një kontratë që u lidh nga ministri i mjedisit në bazë të përgjegjësisë së qartë që ligji për trajtimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve ia atribuonte .

Vendimmarrja mandej e autoriteteve të tjera shtetërore, përfshirë dhe Këshillin e Ministrav, ka qenë një vendimmarrje e ardhur si rezultat i zhvillimit të një procesi të iniciuar nga organi përgjegjës e që ka finalizuar sikundër u konfirmua dhe nga konstatimi në vend i impiantit të Elbasanit, në zgjidhjen e problemit të depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve për 5 nga 7 bashkitë e Qarkut Elbasan, si bashkia Elbasan, Cërrik, Belsh , Librazhd dhe Gramsh, përvec Përrenjasit dhe Peqinit që ende nuk janë gati për të cuar mbetje tek ky impiant, për një sasi ditore prej 100-104 tonësh, mbetje të cilat I nënshtrohen peshimit, seleksionimit , kompostimit, incenerimit , me zero kosto për shërbim, në eliminimin e pasojave afatgjata të ish dampës së hireve në Elbasan, një sipërfaqe kjo tërësisht e rehabilituar dhe zhdukjen e resë toksike që vijonte prej vitesh mbi Elbasan.

Hetimi parlamentar për Elbasanin, rezultoi në përfundime të cilat tregojnë qartësisht se opozita nuk kishte dhe nuk ka asnjë qasje në provueshmërinë e akuzave për grup të strukturuar kriminal, për korrupsion të kryer në bashkëpunim nga ana e qeverisë, zyrtarëve lokalë , për pastrim të produkteve të veprës penale.

Asgjë e tillë nuk u provua dhe nuk provohet se ekziston përballë fakteve dhe dhënave të qarta e të plota që u analizuan në debatin parlamentar por dhe gjatë marrjes së dëshmime.

Cdo abuzim me ligjin të cilin dyshohet të kenë kryer palët kontraktuese të kontratës koncensionare, nuk është në tagrin e komisionit hetimor parlamentar për ta gjykuar dhe konfirmuar si të vërtetë, sikundër nuk mundet që kjo e dhënë të shndërrohet në një akuzë kolektive për Këshillin e Ministrave dhe Kryeministrin, pasi qartësisht mungojnë ana objektive dhe ajo subjektive e veprave të pretenduara .

Nuk u provua në asnjë rast, asnjë lidhje midis veprimeve të institucioneve të ndryshme dhe pasojës/pasojave të dyshuara të kenë ardhur në hetimin e SPAK për këtë procedurë.

Veprimet e institucioneve apo funksionarëve të ndryshëm, kanë qenë të pavarura nga njëra tjetra, të kryera si detyrim për shkak të ligjit organik apo të lidhura me përgjegjësinë funksionale dhe jo si pasojë e ndonjë bashkëpunimi të vecantë , në formën e një grupi të strukturuar, krijuar apo urdhëruar posacërisht dhe për qëllime fitimi pasuror.

**Akuzat e opozitës në këtë drejtim, janë vecse shpifje, që synojnë të dezinformojnë opinionin publik për të marrë prej tij kredo publike, në rastin që gara e partive politike duhet të bazohet vetëm në oferta prej politikash të ndershme të udhëhequra nga interesi publik ,sikundër nga aktorë që gëzojnë mbështetje dhe kanë integritet reputacion të besueshmërisë.**

#### 1.PËRFUNDIME TË PËRBLLEDHURA

≠ Puna për këtë projekt ka filluar me propozimin e pakërkuar në korrik 2014 dhe kontrata është lidhur në 16 dhjetor 2014, pra rreth 5 muaj më vonë. Ky fakt hedh poshtë çdo alibi nga Partia Demokratike që në shërbim të këtij projekti u vendos gjithë Qeveria.

≠ U vërtetua nga dokumentacioni dhe dëshmitë, se në mbledhjen e datës 17.12.2014 është miratuar vetëm një vendim, konkretisht vendimi Nr.907, datë 17.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë” dhe jo 17 vendime për këtë rast, sikurse padrejtësisht informohet publiku.

≠ U hodh poshtë fakti se Ministri Cani nuk kishte dhënë miratimin për mbështetjen financiare të impiantit të trajtimit të mbetjeve të Elbasanit dhe për këtë arsye u largua nga detyra. Kujtojmë se Z. Cani, pas një sërë komunikimesh me Ministrinë e Mjedisit, me shkresën nr.17042/1 prot, datë 10.12.2014, ka dhënë dakordësinë për mbështetjen financiare të propozuar në studimin e fizibilitetit.

≠ Sa i përket diskutimeve në lidhje me një projektvendim, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, përkatësisht Ministrinë e Mjedisit, për dhënien me koncesion/PPP të ndërtimit dhe administrimit të impiantit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisë elektrike”, bëhet e qartë se ky projektvendim nuk është miratuar asnjëherë nga Këshilli i Ministrave.

≠ Procedurat e ndjekura për miratimin nga Këshilli i Ministrave të vendimit Nr.907, datë 17.12.2014, me anë të cilit është vendosur dhënia e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të ndërtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë”, kanë qenë konform legjislacionit në fuqi dhe në përputhje të plotë me procedurat e parashikuara në ligjin 9000/2003 dhe VKM 584/2003.

≠ Bazuar në nënin 9 të ligjit 9000/2003 në të cilën përcaktohen kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe më tej në nenet 13, 15 dhe 16 të ligjit, saktësohet se VKM 907 datë 17.12.2014 plotësonte të gjithë kriteret ligjor për miratimin e tij nga Këshilli I Ministrave, pasi akti kishte një autorizim ligjor të mirëpërcaktuar në pikën 2, të nenit 41 të ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe ppp në RSH”.

≠ Konform ligjit, u provua të ketë qenë edhe vendimarrja tjetër e Këshillit të Ministrave në lidhje me këtë kontratë koncesionare, e shprehur në Nr.792, datë 09.11.2016, “Për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit për rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane, në qytetin e Elbasanit, shoqërisë “Albtek Energy”, sh.p.k”

Sikurse u sqarua nga dokumentacioni dhe dëshmitarët nuk është koncesion i ri por autorizim i ndërtimit të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike dhe lidhjes me rrjetin. Në fund, bazuar në nënin 26 të kontratës koncesionare, ky autorizim si cdo leje dhe licensë tjetër i transferohet Autoritetit Shtetëror në përfundim të afatit 7-vjeçar të saj.

≠ Nga verifikimet e kryera konstatohet se projektaktet janë përcjellë në Këshillin e Ministrave dhe janë bërë pjesë e rendit të ditës së Këshillit të Ministrave duke përmbushur të gjitha kriteret ligjore dhe formale që parashikon legjislacioni në fuqi, për t’u bërë pjesë e rendit të ditës.

## II.PRAKTIKA KONCENSIONARE FIER

Impianti i trajtimit të mbetjeve urbane Fier

Të dhëna kryesore të kontratës ;

Autoritet kontraktues: Ministria e Mjedisit

Koncesionari; “ Integrated Technology Easte Treatment Fier” shpk

Forma e koncensionit : BOT (Ndërtim-Operim- Transferim)

Data e lidhjes së kontratës : 24.10.2016

Periudha e koncensionit : 6 vjet

Vlera e kontratës ; 28 milionë euro

Vendndodhja: shesh I miratuar me vendim të këshillit bashkiak

Përpjekja për ndërtimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve Fier, ka filluar që në vitin 2015, kohë kur Ministrisë së Mjedisit i është paraqitur me shkresë një propozim i pakërkuar në lidhje me këtë objekt, nga një ofertues privat.

Ndërkohë që Ministria e Mjedisit fillon të investohet në mundësinë e realizimit të një projekti të tillë, emergjenca mjedisore ishte shpallur dhe në Bashkinë Fier .

Si u provuan këto fakte në Komisionin Hetimor ?

Këto fakte u provuan nëpërmjet komunikimeve të ndryshme shkresore midis Bashkisë Fier , Ministrisë së Mjedisit , Ministrisë së Mjedisit dhe autoriteteve të tjera qendrore , Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërive të interesuara për të ofruar ndërtimin e këtij impianti .

A kishte ndalim një autoritet qendror si Ministria e Mjedisit që të diskutonte me privatë për çështjen e menaxhimit të mbetjeve ?

Jo absolutisht , sepse sikundër u shpreh që në krye të këtij raporti, ligji për trajtimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve, i jep të drejtë institucionit qendror, që të nxisë subjekte private në zgjidhjen e problematikave të kësaj çështje .

Kështu që në këtë kuptim, Ministria e Mjedisit, ishte e ligjëruar të investohej për zgjidhjen e një problemi, situata mjedisore në Bashkinë Fier, cka ia ka adresuar dhe vetë kjo e fundit .

Më datë **27.07.2015**, Këshilli Bashkiak Fier, **me vendimin nr.15**, ka vendosur që të autorizojë ekzekutivin e Bashkisë Fier, për hartimin e një plani vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, në përputhje me Planin Kombëtar dhe Rajonal të Mbetjeve . Sipas këtij vendimi, është autorizuar ekzekutivi i Bashkisë Fier, për të negociuar me subjekte shtetërore dhe private , për të zgjedhur një venddepozitim mbetjesh si edhe për të negociuar me qeverinë dhe me partnerë të huaj dhe vendas për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e këtij qëllimi .

Këshilli Bashkiak I Fierit **me vendimin nr. 40 datë 26.10.2015**, ka vendosur që të shpallë emergjencën mjedisore në fushën e menaxhimit të mbetjeve, duke filluar hartimin dhe realizimin e një zgjidhje teknike të nevojshme për përmirësimin e kësaj situatë në një vend të ri depozitimi që ndodhet në njësinë administrative Portëz; janë përmendur emra të dy fshatrave kufitarë të kësaj njësie si venddepozitim, fshati Plyk dhe Mbyet, ndërkohë që nga dëshmia e Kryetarit të Bashkisë Fier, z. Armando Subashi, u saktësua se venddepozitimi fillestar, I takonte si zonë kadastrale fshatit Mbyet të njësisë administrative Portëz.

Impianti, sikurse rezultoi nga hetimi, nuk u ndërtua në njësinë Portëz, por në njësinë administrative Mbrostar , në fshatin Mbrostar .

Gjatë hetimit, janë administruar një sërë dokumentash shkresorë, që tregojnë në mënyrë kronologjike sepse u ndryshua vendi i diskutuar paraprakisht për ndërtimin e këtij impianti, një diskutim ky I cili rezultoi të jetë bërë objekt hetimi e gjykimi gjyqësor edhe nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, sipas vendimit nr.1084 datë 23.12.2020 të saj.

Ky vendim gjyqësor është i formës së prerë dhe cfarë ky vendim pohon si fakte në brendinë e tij, janë të padiskutueshme dhe të detyrueshme për t'u marrë si të vërtetë .

Më datë 24.10.2016, me shkresën Nr.5553/4 Prot të Ministrisë së Mjedisit , Bashkisë Fier i është dërguar një kopje e kontratës së koncensionit të formës BOT, për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe koncensionarit .

**Me vendimin Nr. 89 datë 25.10.2016** të Këshillit Bashkiak Fier, është vendosur fillimi i procedurave të shpronësimit për interes publik për pronat private në fshatin Mbyet me qëllim ndërtimin e impiantit për trajtimin e mbetjeve urbane

Për vazhdimin e procedurave të shpronësimit është ngarkuar ekzekutivi I Bashkisë Fier .

**Më datë 01.11.2016** koncesionari I ka drejtuar një shkresë Bashkisë Fier, me anë të së cilës i bën me dije Këshillit Bashkiak të Bashkisë Fier , Kryetarit të Bashkisë z.Subashi , se në realizimin e projektit në fjalë ka disa problematika të cilat kërkonin marrjen në vëmendje nga ana e Bashkisë Fier .

Kush ishin keto problematika të konstatuara nga ekipi i koncensionarit në vendin ku planifikohej të ndërtohej impianti ?

***Topografia e terrenit të përzgjedhur e bën problematike dhe mjaft jo efikase procesin e kërkuar teknologjik të ndërtimit të impiantit . Largësia nga pikat e lidhjes me energji elektrike është gjithashtu një problematikë që duhet rishikuar me vëmendje . Bazuar në studimet gjeologjike, pjerresitë e terrenit si dhe afërsia me lumin Gjanica, besohet se mund të ketë shkarje të cilat do të vinin në rrezik projektin duke ndikuar mjaft në realizimin e parametrave konstruktivë dhe***



*duke cuar në një situatë të papëlqyeshme mjedisore me të cilën do të ballafaqohemi në realizimin e veprës .*

Fusha e mbetjeve në Fier në ndërkohë, ishte në një gjendje skandaloze.

Në Komisionin Hetimor është administruar një dokument I hartuar nga nëpunës të Bashkisë Fier, Drejtoria e Shërbimeve Publike, ku theksohet *që fusha e depozitimit të mbetjeve urbane në Bashkinë e Fierit ka një sipërfaqe prej 6.2 ha (hektarë) , ka një distancë 4 km nga qendra e qytetit dhe 100 metër nga zona e banuar . Fusha e depozitimit të mbetjeve kufizohet në veri nga kanali kullues i Roskovecit në jug me Vijën e Ngjalës, në lindje kufizohet me Hekurudhën dhe në perëndim me lumin Gjanica . Venddepozitimi I mbetjeve ka një vjetërsi 45 vjecare , është ndërtuar rreth viteve 1970-1975; sasia e mbetjeve të ngurta që grumbullohet nga pikat e grumbullimit është 140 ton në ditë dhe fjala është per Bashkinë Fier përpara Reformës Administrative Territoriale ; Fusha e depozitimit të mbetjeve është tejet e amortizuar si pasojë e përdorimit të gjatë dhe pa asnjë standart teknik apo sanitar ;Koha e gjatë e përdorimit dhe afërsia me qendrën e banuar përbën një domosdoshmëri urgjente për ndërtimin e një fushe të re të grumbullimit të mbetjeve urbane .*

Sasia e depozimit në fushën e venddepozitimit të mbetjeve, së bashku me mbetjet që do të vinin nga ish komunat llogaritej në 180 ton në ditë , cka në fakt e përjashtonte totalisht nga funksioni këtë fushë dhe justifikonte pse Bashkia e Fierit ka qenë e interesuar që ky problem të zgjidhej urgjentisht sepse nuk ishte një problem thjesht për ekzekutivin e bashkisë por problem për komunitetin e një bashkie të madhe, një nga më të mëdhatë në vend.

Më datë 07.11.2016, nga ekzekutivi i bashkisë, Këshillit të Bashkisë Fier, I është paraqitur një relacion me Nr.7508 Prot, me anë të të cilit Këshillit i është kërkuar të ngrejë një komision me qëllim që të identifikonte zonën ku mund të ndërtohej ky impiant .

E rëndësishme është për t'u theksuar që të gjithë antarët e këshillit, përfaqësues të subjekteve të ndryshme politike, të mazhorancës dhe opozitës, kanë qenë dakord për ndërtimin e impiantit dhe I kanë kërkuar ekzekutivit të Bashkisë Fier, që të përgatisë një material me variante të mundshme se ku mund të ndërtohej ky impiant e që këshilli të mund të vendoste .

Grupi I punës I ngritur me këtë rast, ka operuar dhe sipas relacionit me Nr.7657 Prot, datë 11.11.2016, ka ofruar 10 variante, ndër të cilët Këshilli Bashkiak i mbledhur po më datë 11.11.2016, me unanimitet, përzgjedhi variantin nr.4, variant i cili i referohej si vend për ngritjen e impiantit, fshatit Mbrostar, Njësia Administrative Mbrostar.

Diskutimi për kategorinë e tokës në të cilën u vendos të ndërtohej impianti i trajtimit të mbetjeve Fier, u sqarua nëpërmjet dëshmisë së Kryetarit të Bashkisë z. Subashi, i cili solli si provë para komisionit Planin e Përgjithëm Vendor të miratuar me Vendimin Nr .100 dt 06.12.2016 , konfirmuar me shkresën e Prefektit Nr. 1205/1 Prot datë 14.12.2016, miratuar dhe me vendim Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr.5 dt 26.12.2016.

Sipërfaqja e tokës në fjalë, identifikohet si pjesë e infrastrukturës dhe kategoria e tokës ishte ndryshuar , nga tokë “arë” në “ truall” .

Sqarimet për këtë pjesë , e drejtë e kujt ishte ky veprim, i gjejmë të legjitimuara edhe në Vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

Gjykata arsyeton se ndryshimi i kategorisë së tokës ku po ndërtohet objekti, është bërë me anë të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Fier, të miratuar edhe me vendimin Nr .5 dt 26.12.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit .

Gjykata cmon se palët paditëse, shoqatat mjedisore dhe banorë të zonës, nuk kanë identifikuar asnjë dispozitë ligjore me karakter urdhërues të ligjit nr.107/ 2014, ligji “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Ky vendim i gjykatës na vjen në ndihmë për të gjykuar për vlefshmërinë e vendimeve të marra nga Këshilli Bashkiak Fier, vendime të cilat Gjykata Administrative e Apelit i ka gjetur të vlefshme; kjo gjykatë ka gjetur të vlefshme deklaratën mjedisore, të vlefshme lejen e ndërtimit, ka gjetur të vlefshme diskutimin që është bërë për kategorinë e tokës në të cilën është ndërtuar impianti, ka provuar po ashtu edhe faktin që janë kryer dëgjesa publike me banorët.

Ka pasur një material prej **69 faqesh** që perfaqësuesja e Agjensisë Kombëtare të Mjedisit ka paraqitur në këtë gjykatë, të shoqëruar me foto e me procesverbale, që tregojnë se janë bërë takime me komunitetin, takime të përshkruara në mënyrë të hollësishme, sa i takon numrit të pjesëmarrësve, vendit të takimit dhe diskutimeve në to.

Fakti i mësipërm konfirmohet edhe nga raporti I KLSH I vitit 2018, një raport ku KLSH e mbron argumentin pse incinerator dhe jo landfill.

KLSH mbron idenë pse metoda e djegies me incenerim është më e përshtatshme për zgjidhjen e problemit.

***Duke iu referuar praktikës së vendeve më të zhvilluara me standarte dhe kërkesa më të larta në fushën e mjedisit, është lehtësisht e dukshme se shumë vende europiane si Gjermania, Austria, Italia, Franca, këtë metodë e përdorin si një nga mënyrat për trajtimin e mbetjeve. Përsa i përket vendit tonë, diskutimi gjithmonë ka qenë të ndërtojmë landfille apo të ndërtojmë impiante dhe sigurisht ato të jenë me incenerim apo me djegie me rikuperim të energjisë. Cdo metodë ka avantazhet dhe disavantazhet e veta.***

**Pse zgjati ndërtimi i impiantit të Fierit?**

Të gjithë jemi deshmitarë se ka patur protesta nga banorët, protesta të frymëzuara edhe nga përfaqësuesit politikë të opozitës që ndërkohë pas zgjedhjeve të vitit 2017, për shkak të prishjes së koalicionit qeveritar të vitit 2013, u shtuan dhe me përfaqësuesit e partisë politike LSI.

Vecanërisht pas zgjedhjeve të vitit 2017, pjesë e organizimit të këtyre protestave u bënë përfaqësues të PD dhe LSI, fakt ky i provuar nga media audiovizive por dhe materiale fotografike që Komisioni Hetimor administroi gjatë marrjes së dëshmisë së Kryetarit të Bashkisë Fier.

Të gjitha këto situata e vonuan zhvillimin e projektit, por sot mund të themi që ky projekt i cili vijon ende të jetë brenda termave të afatit kontraktor, është një projekt jashtëzakonisht i vlefshëm; Aktualisht, bashkitë e Fierit, Lushnjës, Roskovecit dhe Patosit, në kohë të shkurtër këtij projekti do i bashkohen edhe bashkitë e Divjakës dhe Mallakastrës, i depozitojnë të gjitha mbetjet, rreth 170-180 ton mbetje cdo ditë, në këtë impiant, për ndërtimin e të cilit është shpallur garë rregullisht duke u bërë njoftimet përkatëse në Agjensinë e Prokurimit Publik.

Ish fusha e mbetjeve në Fier është kapsuluar, rehabilituar në masën mbi 70%, duke u mbjellë në të mbi 4000 pemë, akacie dhe ekualipte.

Mbetjet e Bashkisë Fier, përfshirë këtu edhe 9 njësitë administrative të saj, pasi mblidhen me mjete ekologjike, nëpërmjet një stacioni transferimi të ngritur nga vetë Bashkia Fier, me anë të dy mjeteve të tonazhit të lartë, transportohen në impiant, aty ku bëhet depozitimi dhe përpunimi i mbetjeve që vijnë në ndërkohë dhe nga bashki të tjera, si ajo e Lushnjës, Patosit dhe Roskovecit. Pozicioni gjeografik i vendndodhjes së impiantit është i përshtatshëm që edhe bashki të tjera vec asaj të Divjakës dhe Mallakastrës që janë pjesë e Qarkut Fier, si bashkia Dimal, Kucovë, Berat

psh, të mund ta konsiderojnë këtë impiant si një zgjidhje optimale për trajtimin e mbetjeve urbane në territorin e tyre, sigurisht duke vlerësuar më parë të gjitha kostot.

**Parimi “Kush ndot, paguan”**, është një parim të cilin duhet ta kuptojmë dhe vlerësojmë drejt, nëse vërtet dëshirojmë një mjedis të pastër për vete dhe brezat që do të vijnë.

Proceset e trajtimit dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve, janë procese komplekse që kërkojnë njohuri të duhura shkencore dhe jo vetëm, përditësim të tyre por dhe financa të mira, të qëndrueshme dhe të konsoliduara.

Sa më lart, do të thotë që administrimi i mëtejshëm i impianteve nga ana e bashkive do të jetë sa një sfidë, aq edhe një mundësi e mirë për të krijuar të ardhura nëpërmjet diferencimit të mbetjeve, kostifikimit të tyre, prodhimit të energjisë etj.

Nga dëshmitë e Kryetarëve të Bashkive Fier dhe Elbasan, rezultoi e qartë se institucionet që ato drejtojnë, kanë hyrë tanimë në rrugën e marrjes përsipër të këtyre përgjegjësive konkretisht, dhe kanë marrë paraprakisht cdo masë të nevojshme për të siguruar mirëadministrimin, në funksion të një zgjidhje me standarte dhe që I përgjigjet nevojës së të gjithëve për mjedis të pastër dhe higjën të përshtatshme.

#### PËRFUNDIME TË PËRMBLEDHURA :

≠Në procedurën e ndjekur nga Bashkia Fier, nuk ka pasur shkelje të ligjit përsa i përket ushtrimit të kompetencave nga organet e veta, Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë. Të gjitha vendimet për përcaktimin e vendit të ndërtimit të impiantit, janë marrë hap pas hapi nga Këshilli i Bashkisë, shumica madje në unanimitet.

≠Nga ky hetim rezultoi se Kryetari i Bashkisë nuk ka disponuar për këtë çështje, pa marrë miratimin e këshillit .

≠Nga opozita është ngritur pretendimi se ndryshimi i vendit të ndërtimit të këtij impianti, është bërë pa vendim këshilli bashkiak, çka rezultoi e pavërtetë nga hetimi i kryer nga ky komision.

≠Gjithashtu i pavërtetë rezultoi edhe pretendimi tjetër i opozites se ndryshimi i vendit nga një pronë shtet në një pronë private, i ka shkaktuar shtetit një dëm ekonomik në vlerën e rreth 46 milion lekëve.

Nga hetimi rezultoi të provuar, se në asnjë nga vendimet e këshillit bashkiak nuk ka qenë parashikuar ndërtimi i këtij impianti në tokë shtet.

≠Sipërfaqet e shprehura në fillim, në Njësinë Administrative Portëz, në ZK 3000 fshati Plyk, apo edhe saktësimi në ZK 2637 në fshatin Mbyet, nuk rezultuan që të ishin “toka shtet”.

Ato ishin toka bujqësore të ndara me ligjin 7501 fermerëve të këtyre fshatrave, të cilët në gjithë këto vite kishin kultivuar kultura bujqësore dhe pemë drufrutore, të cilat do i nënshtroheshin procesit të shpronësimit në rast se impianti do të ndërtohej aty dhe vlera e shpronësimit do të kishte qenë po ajo ose më e lartë se vlera e shpronësimit të kryer për pronën ku u ngrit impianti. Mbrostar.

≠Po kështu, mund të themi se pavarësisht pretendimeve të opozitës, Bashkia Fier rezulton të jetë bërë pronare e sipërfaqes së tokës së shpronësuar me VKM 951 dt 28.12.2016, një sipërfaqe prej 111.564 m<sup>2</sup> dhe mbi këtë bazë ajo ka shtuar asetet e veta, nuk i ka pakësuar ato.

Është krejt e qartë se nuk mund të pretendosh dëm ekonomik apo financiar, kur një ent publik apo aq më shumë një bashki, nëpërmjet një shume të caktuar monetare, shton asetet e veta me pasuri të paluajtshme, sic është kjo sipërfaqe toke në rastin konkret.

≠Të gjitha problematikat e ngritura sot nga aktorë të ndryshëm politikë ose jo, lidhur me parregullsi të pretenduara gjatë këtij procesi, kanë qënë objekt i shqyrtimit gjyqësor nga gjykata administrative. Në gjykimin e zhvilluar është pretenduar konstatimi i pavlefshmërisë absolute të deklaratës mjedisore nr:18 dt08.05.2017 si dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute të lejes së ndërtimit nr.15 dt16.10.2017 te K.K.T.

Në vendimin e tyre, gjykatat kanë arsyetuar se përpara nxjerrjes së lejes mjedisore dhe lejes së ndërtimit, nga ana e autoritetit kontraktor-Ministria e Mjedisit, janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme, duke përfshirë dhe dëgjuesat publike me banorët e zonës. Ndërkohë për sa i përket lejes së ndërtimit, gjykatat argumentojnë që ajo është nxjerrë në përputhje midis të tjerash edhe me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Fier, i cili është miratuar nga Këshilli Bashkiak në dt.06.12.2016 dhe nga K.K.T në datë 29.12.2016. Sipas këtij plani, ndërtimi i impiantit është parashikuar pikërisht në zonën ku është ndërtuar sot.

≠Diskutimi pse shpronësimi është bërë mbi kategorinë tokë “truall” dhe jo tokë “arë” gjen përgjigje në vendimin e gjykatës së Apelit Administrativ për të cilën u shprehëm më lart.

Sipërfaqja e tokës mbi të cilën është ndërtuar impianti, ka ndryshuar kategorinë tokë “arë” në tokë “truall”, po nëpërmjet Planit të Përgjithshëm Vendor.

A mund të vëmë në diskutim këtë vendim gjyqësor të formës së prerë, duke e injoruar, duke e mosnjohur, apo duke bërë sikur nuk ekziston, thjesht dhe vetëm për interesa politike apo për shkak të një agjende të paracaktuar?

### **Sigurisht që jo!**

Ky vendim është i formës së prerë dhe si i tillë, zbatimi i tij nuk mund të vihet në diskutim . Është e vërtetë që në 2017-2018, ky vendim nuk ka ekzistuar pasi ka marrë formë të prerë në vitin 2020, por konstatimi dhe sanksionimi i fakteve në vitin 2020, nga gjykata, i jep përgjigje dhe pretendimeve të opozitës në këtë komision.

Neni 3 i ligjit nr.8891 dt.2.5.2002 “Per Organizimin dhe Funksonimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit” në pikën 4 të tij parashikon se: **“Komisioni nuk mund të ngrëjë akuza penale dhe as të ushtrijë atributet e gjykatave.”**

Pra është e qartë që përballë një vendimi gjyqësor të formës së prerë, të gjykatës së Apelit, komisioni por edhe Kuvendi, nuk mund të marrin atributet e një gjykate më të lartë, duke mos njohur apo ndryshuar fakte, prova apo konkluzione të pranuar dhe sanksionuara nga një vendim gjyqësor i formës së prerë.

Në nenin 4, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionohet se: **” E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”**, ndërsa në nenin 7 të Kushtetutës parashikohet se: **”Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë, bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.”** Ndërsa në nenin 142 pika 3, sanksionohet se **“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”**.

Pra nga pikëpamja kushtetuese , është e qartë se vendimi gjyqësor i formës së prerë, nuk mund të mos zbatohet nga komisioni në përgatitjen dhe miratimin e raportit apo nga Kuvendi i Shqipërisë në miratimin e tij në seancë plenare.

Nga gjithë sa më lart, as VKM Nr.951, datë 28.12.2016, nuk mund të vihet në diskutim, pasi gjykata duke argumentuar ligjshmërinë e kësaj VKM-je ne ndryshimin e kategorisë së tokës, ka gjetur të vlefshme edhe lejen e ndërtimit të dhënë nga KKT me vendimin Nr15 dt.16.10.2017.

### **III.PRAKTIKA KONCENSIONARE TIRANË**

#### **Impianti i trajtimit të mbetjeve urbane Tiranë**

##### **Të dhëna kryesore të kontratës ;**

Autoritet kontraktues: Ministria e Mjedisit

Koncensionari; “ Integrated Energy BV SPV” shpk

Kontratë koncensiononi e formës BOT (ndërtim, operim dhe transferim I të drejtës së pronësisë dhe operimit në përfundim të kontratës)

Data e lidhjes së kontratës : 31.08.2017

Periodha e koncensionit : 30vjet

Vlera e kontratës ; 128 milionë euro

Vendndodhja: Sharrë

Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve ka qënë dhe ngelet një sfidë për shtetin shqiptar, por diferenca nga viti 2013 e këtej, është që asokohe nuk bëhej thuajse asgjë, ndërsa sot ka një hov cilësor në drejtim të përgatitjes dhe ndjekjes së atyre rrugëve të rëndësishme që sigurojnë trajtimin adekuat të të gjitha mbetjeve që krijohen në territorin e Republikës së Shqipërisë .

Dokumenti i politikave strategjike dhe Plani Kombëtar i menaxhimit të integruar të mbetjeve 2020-2035, orienton për një politikë kombëtare të mbështetur në 4 shtylla;

- planifikim
- edukim
- burime
- legjisllacion

Të planifikosh do të thotë të përcaktosh ku do të ndodhë konkretisht trajtimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe aktualisht Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, parashikon që trajtimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve të bëhet në 10 rajone të Shqipërisë .

Pra ndarja është rajonale sipas planit që ka bërë institucioni qendror .

Edukimi nuk është një sfidë të cilën e kemi mbërritur edhe për këtë jemi të gjithë të ndërgjegjshëm; kultura qytetare në drejtim të krijimit të sa më pak mbetjeve apo të diferencimit të mbetjeve që në burim, është një kulturë e munguar në Shqipëri dhe këtë nuk ka asgjë që e kundërshton sepse fakti është evident ; në fund të ditës ne sillemi si cdo qytetar I zakonshëm I këtij vendi dhe e dimë shumë mirë sa mbetje krijojmë çdo ditë në shtëpitë tona.

**Referuar të dhënave të INSTAT, rezulton që çdo person krijon 1.4 kg mbetje çdo ditë dhe po të shumëzosh këtë të dhënë, me numrin e qytetarëve që banojnë e jetojnë në vendin tonë, atëherë merret me mend sesa e madhe është sasia e mbetjeve që krijohet çdo ditë dhe se çfarë angazhimi serioz kërkohet që këto mbetje të menaxhohen në mënyrën e duhur .**

Burimet janë kapacitete njerëzore/intelektuale dhe financiare .

Procesi i menaxhimit të mbetjeve është një proces që kushton; në të gjithë botën kushton; nuk është një proces i lehtë për t'u bërë dhe për t'u ndërmarrë ashtu siç duhet, se po të hidhje plehrat, siç ndodhte deri në vitin 2013, 50% të mbetjeve në kosh dhe 50% lumenjve, deteve, rrugëve etj etj sigurisht që kjo nuk "kushtonte" në ndonjë buxhet, por me siguri ka kushtuar jetë njerëzore, vuajtje të pafundme shëndeti dhe ekonomi familjare.

**Kapacitetet njerëzore janë gjithashtu të rëndësishme, dhe fjala është për kapacitete profesionale në fushën e mjedisit, kapacitete që I munguan dëgjuesës së një komisioni hetimor të ngritur për vendimmarrje të lidhura me mjedisin; publiku që na ndoqi, pa në këtë komision të zgjedhur "të ethshëm" për të bërë gjyqtarin, prokurorin, policin, por nuk pati mundësinë të dëgjonte asnjë ekspert mjedisor, sepse qëllimi i ngritjes së këtij komisioni, nuk ishte ai për të kuptuar përmes fakteve dhe të dhënave, se cila duhet të ishte zgjidhja më e përshtatshme mjedisore, a janë një zgjidhje impiantet me rikuperim të energjisë, por ngjizja e një gënjeshtre që duhej të zmadhohej dita ditës dhe përtej vëmendjes ndaj zhvillimeve degraduese brenda një partie politike që përfaqëson dhe opozitën më të madhe numerike në vend.**

Fatmirësisht, qytetarët, ata të Elbasanit, Fierit dhe Tiranës, ndonëse nuk dëgjuan ekspertë mjedisorë, janë dëshmitarë okularë të asaj se çfarë ishin qytetet e tyre para dhe pas 2013-s, në kontekstin e venddepozitimeve të mbetjeve urbane, dhe fuqia provuese e këtyre dëshmimeve, është e pacmuar në raport me përgjegjësitë e qeverisjes aktuale në kohën e ardhjes në pushtet.

### **Të rikthehemi te legjislacioni**

Në këtë pikë është bërë progres sepse edhe pse në rastet që ne jemi duke diskutuar, është vepruar kryesisht mbi një legjislacion me të cilin ka vepruar edhe qeverisja juaj, rrugës ky legjislacion është përmirësuar; ndoshta kjo nuk është vetëm meritë e qeverisjes sonë, por dhe fakti që vetë BE ka orientuar direktiva të ndryshme në fushë dhe për këtë arsye është dashur që legjislacioni të përditësohet.

Kështu një ndër nismat më të rëndësishme ligjore, është ajo e ndërmarrë më 06.11. 2018, projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat".

Synimi i projekt aktit ishte të përmirësonte kuadrin ligjor, mënyrën e zbatimit të procedurave për dhënien e koncesioneve/PPP dhe të rriste kontrollin mbi angazhimet fiskale të marra përsipër nga Autoritetet Kontraktore nëpërmjet kontratave të koncesionit/PPP, me qëllim minimizimin e impaktit fiskal në buxhetin e shtetit, bazuar edhe në rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare si; FMN, Banka Botërore, SIGMA-OECD, .

Këto ndryshime vinin në koherencë dhe harmoni të plotë me ndryshimet e bëra në ligjin organik Nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ku përcaktohet se:

*"...Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve, individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të*

ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore. Kuvendi, në ligjin vjetor të buxhetit, miraton tavanin e vlerës totale të kontratave në përqindje të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi gjatë vitit buxhetor korrent”.

**Iniciativa për ndryshimin e ligjit 125/2013 përfshinte :**

a) Heqja e Propozimeve të Pakërkuara në një sërë sektorësh përfshirë atë të trajtimit të mbetjeve.

Ky ndryshim vinte në harmoni edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe direktivën 2014/23 UE “Për dhënien e kontratave të koncesionit”.

b) Heqja e bonusit për propozimet e pakërkuara.

Me qëllim rritjen e transparencës dhe trajtimit të barabartë për të gjithë operatorët në procedurën konkurruese u hoq mekanizmi i shpërblimit me pikë bonus, i operatorëve të cilët paraqesnin propozime të pakërkuar. Pra me anë të këtyre ndryshimeve u përcaktua se pas datës 1 korrik 2019 nuk do të kishte më sistem të shpërblimit me pikë bonus dhe për të nxitur sektorin privat u propozua zëvendësimi i sistemit me pikë bonus me atë të kompensimit në vlerë monetare të propozuesit të pakërkuar, në rast se ky i fundit nuk shpallet fitues. Në çdo rast, vlera e kompensimit nuk mund të ishte më e lartë se 1% e vlerës së investimit. Mekanizmi i propozuar i kompensimit nuk çënon konkurrencën dhe nuk avantazhon propozuesin e pakërkuar.

c) Forcimin e rolit të ministrisë përgjegjëse për financat.

*Qëllimi ishte përcaktimi i qartë i rolit dhe përgjegjësi të ministrisë përgjegjëse për financat, në lidhje me vlerësimin, miratimin e të gjithë projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat dhe ecurinë e kontratave të koncesionit/PPP nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.*

*Duke qenë se projektet e koncesionit/PPP janë projekte komplekse, afatgjata që implikojnë një sërë risqesh, si dhe detyrimesh kontingjente të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, është e nevojshme dhe e domosdoshme që të gjitha këto projekte si ato me dhe pa mbështetje financiare të paraqiten paraprakisht në ministrinë përgjegjëse për financat për vlerësim dhe miratim në këndvështrimin e implikimeve fiskale dhe buxhetore.*

Një parashikim tjetër që u vlerësua si shumë i rëndësishëm ishte që përpara nënshkrimit të kontratës përfundimtare të koncesionit/PPP, ajo duhet të paraqitet sërish për vlerësim pranë ministrisë përgjegjëse për financat, me qëllim për të eliminuar çdo implikim të paparashikuar të buxhetit të shtetit si rrjedhojë e angazhimeve financiare të pakontrolluara nga ana e autoriteteve kontraktuese dhe me qëllim që ministria përgjegjëse për financat të jetë në dijeni të të gjithë ecurisë së projekteve dhe kontratave të koncesionit/PPP, duke vendosur edhe një rregull të ri, ai i monitorimit të e performancës së tyre, për të analizuar dhe minimizuar risqet e tyre fiskale dhe buxhetore.

d) Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP.

Me qëllim rritjen e cilësisë së studimeve të fizibilitetit mbi projektet e koncesionit/PPP, u parashikua në projektligj dhe krijimi i Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të

**Koncesionit/PPP**, si një organ kolegjal me objekt kryesor të veprimtarisë përzgjedhjen e projekteve të Koncesionit/PPP të cilët do të asistohen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimeve fizibilitetit dhe/ose oponencën e tyre.

Lidhur me kontratën koncensionare të Tiranës, në Komisionin Hetimor është administruar një përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me të cilën provohet që landfilli i Sharrës, i cili mbulonte vetëm Bashkinë e Tiranës, e theksoj vetëm Bashkinë e Tiranë, jo qarkun e Tiranës, i ndërtuar në periudhën 2006 – 2008 ishte planifikuar për të operuar deri në vitin 2015.

Ky landfill administrohej nga Bashkia Tiranë.

E dhëna që ky landfill ishte ndërtuar për të operuar deri në vitin 2015, justifikon edhe arsyen pse në vitin 2015, Bashkia Tiranë, që është autoriteti përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve të qytetit të Tiranës dhe jo vetëm të qytetit, por dhe ish komunave që sot i janë bashkuar si njësi administrative, në pajtim kjo me Planifikimin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, më datë 23 Dhjetor 2015 i drejtohet Ministrit të Mjedisit, ministria që e ka në fushën e vet të veprimit dhe e ka përgjegjësi, menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë, që ta asistojë për përfshirjen e sektorit privat në procesin e menaxhimit të mbetjeve në qytetin e Tiranës, kjo sipas studimeve të IFC nëpërmjet PPP-ve në përputhje me strategjinë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe për hir të se vertetës, kur Bashkinë e Tiranës e drejtonte kryetari i PD-së, z. Lulzim Basha, ka pasur studime të ngjashme që tregonin që Bashkia nuk kishte kapacitetet intelektuale dhe as kapacitetet financiare që ta merrte përsipër pastrimin e mbetjeve në qytetin e Tiranës, por nevojitej një PPP. A mori kjo shkresë përgjigje të menjëhershme? A u zgjidh të nesërmen historia e Tiranës?

Jo nuk është zgjidhur që të nesërmen, se në fakt nga komunikimet shkresore të administruara nga Komisioni Hetimor, rezulton që më datë 23.06.2016, pra një vit më pas, Ministrisë së Mjedisit i është paraqitur një propozim i pakërkuar për Tiranën, nga një bashkim operatorësh.

Sjellja e operatorëve privatë, si dhe ku i ndërtojnë ata shoqëritë, nuk është objekt i këtij hetimi; nuk mund të jetë objekt i një hetimi parlamentar, pasi parlamenti ka të drejtën dhe detyrimin të hetojë sjelljen e aktorëve shtetërorë në çdo rast dhe për qëllime të interesit publik.

Nëse ata bëjnë ose kanë bërë shkelje që vijnë në mashtrim të ligjit apo në shmangie nga zbatimi i tij, padyshim që organet e drejtësisë kanë detyrimin që t'i ndjekin dhe t'i sanksionojnë deri në fund.

Bashkia Tiranë në qershor të vitit 2016, pasi Ministria e Mjedisit e njofton që ka një propozim të pakërkuar, i bën me dije situatën në venddepozitimin e Sharrës;

Për të gjithë publikun mbetën akoma në kujtesë emisionet televizive ku shfaqej mali shkumbues i Sharrës dhe historia e njerëzve që kanë humbur jetën për shkak se shkonin aty për të mbledhur mbetje nga ato që riciklohen, seleksionohen etj

Çfarë rezultonte në Sharrë në vitin 2015, atëherë kur Sharra e mbaroi funksionimin dhe patjetër që lipsej një zgjidhje?

Në Sharrë, vetëm për vitin 2015, sasia totale e mbetjeve të depozituara nga Bashkia Tiranë, që do të thotë atje nuk depozitonte as Kamza, as Vora, as Kavaja, as Durrësi por vetëm Tirana, ishte **200, 275.2 ton mbetje**: ndërkohë që Tirana sipas census të 01.01. 2016, kishte 780.531 banorë.



Sikur të bëni një veprim të thjeshtë aritmetikor, sigurisht do ta kuptoni sesa e lartë ishte sasia e mbetjeve të krijuara nga çdo qytetar që jetonte në qarkun e Tiranës , një qark me **sipërfaqe prej 1586 km<sup>2</sup>** e ku sipas censusit të vitit 2011, popullsia e këtij qarku ishte **749 365 banorë**.

Menjëherë pas këtij komunikimi, Autoriteti Kontraktor, Ministria e Mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për koncesionet, pranoi dhe filloi shqyrtimin e propozimit të pakërkuar , duke bërë një vlerësim paraprak të tij, (nga pikëpamja formale, ligjore , teknike) duke e konsideruar të pranuar këtë propozimin në përputhje me ligjin dhe domosdoshmërinë për realizimin e këtij projekti, për të vijuar më pas me veprimet për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat .

Autoriteti Kontraktor , në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka ndërmarrë hapat ligjorë për kryerjen e veprimeve për dhëniem me koncesion , duke vijuar me ngritjen e Komisionit të dhënies me koncesion i cili në zbatim të nenit 18 të Ligjit 125/2013

a) harton studimin e fizibilitetit

b) përcakton procedurën e zbatueshme

c) harton dokumentacionin e tenderit

d) shqyrton dhe vlerëson ofertat e pranuar;

e) formulon propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit si dhe kryen të gjitha aktivitetet e tjera që kërkohen për zbatimin e procedurës së koncesionit /partneritetit publik privat, në përputhje me rregulloret në fuqi.

Theksojmë edhe një herë që neni 4 i ligjit 125/2013, parashikon qartë se *Koncesionet/partneritetet publike private mund të jepen për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve për sektorët dhe qëllimet ku përfshihet edhe trajtimi dhe menaxhimi i integruar të mbetjeve*, sikundër kjo parashikohet edhe në nenin 65 “*Nxitja e investimeve private dhe e partneritetit publik privat*” të ligjit Nr. 10463, datë 22.9.2011, “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*”, të ndryshuar.

Ngritja e komisionit nga Autoriteti Kontraktor, ka përfunduar në shtator të vitit 2016 me përbërje, përfaqësues nga Ministria e Mjedisit , Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve , Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës.

Komisioni ka vijuar me disa mbledhje dhe diskutime që gjenden të dokumentuara në proshverbalet përkatëse, ka përmbushur formalisht të gjitha detyrimet që i ngarkon ligji , ka kryer veprimet për dhënien me koncesion/ppp , duke filluar me hartimin e studimit të fizibilitetit i cili përmban:

1) Analizë teknike

2) Analizë ekonomiko –financiare ku përfshihet modeli financiar objektiv kryesor i të cilës është të përcaktojë “*Vlerën e Parasë*” duke konfirmuar leverdishmërinë, qëndrueshmërinë si dhe të ofrojë vlerën më të mirë të parasë.

3) Analizë ligjore

4) Ndikimin në mjedis, sipas parashikimeve ligjore e deri në sigurimin e dokumentacionit të kërkuar për lidhjen e kontratës koncesionare .

Ndërkohë Këshilli i Ministrave, ka marrë 2 vendime në lidhje me këtë procedurë ; **vendimi i parë** është ai që ka të bëjë me miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet

shoqërisë për dhënie me koncension për ndërtim landfilli , inceneratori dhe rehabilitim të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë (VKM Nr.855 datë 07.12.2016) .

Nga titulli i këtij vendimi del e qartë që do të bëhej rehabilitimi I Sharrës e mandej do të vazhdohej me ndërtimin e landfilleve dhe agregatëve të incenerimit.

Debati a duhet apo nuk duhet incenerimi, a e kishte parashikuar shteti shqiptar në ndonjë akt ligjor, apo jo incenerimin dhe çfarë është incenerimi , është një debat I stisur me dashje nga ana e kërkuesve të ngritjes së këtij komisioni hetimor, opozita pasi që në ligjin e vitit 2011, ligjin për trajtimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve , të miratuar në kohën kur në qeverisje ishte PD, në nenin 3 të tij, gjen një përkufizim të plotë të incenerimit, si një nga metodat për trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë .

Pse është dhënë bonus duke u miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në rastin e kësaj procedure ?

Dhënia e bonusit është një procedurë e parashikuar nga ligji 125/2013 .

Pikërisht neni 25 i tij parashikon se ***në rast se një propozim i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm pas një vlerësimi paraprak të bërë nga autoriteti kontraktues, propozuesit i jepet një bonus për rezultatet teknik/dhe ose financiar***, çka do të thotë se sjellja e organeve shtetërore ka qenë legjitime dhe konform parashikimeve ligjore në fuqi.

Vendimi I dytë, që ka marrë Këshilli I Ministrave, në lidhje me këtë procedurë koncensionare, ka qenë **VKM Nr.811 datë 26.12.2018** ,”Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme prona private që preken nga realizimi i projektit për ndërtimin e landfillit , inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike Tiranë”.

Shpronësimi është bërë nga qeveria , nuk është bërë nga Bashkia Tiranë , në kuptimin që vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 284.995.840 lekësh, sipas këtij vendimi, i është alokuar Bashkisë Tiranë që të vazhdonte procedurën e shpronësimit. Përballimi i të gjithë shpenzimeve në këtë rast, është bërë nga llogaria “Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit” miratuar rregullisht për vitin 2018 .

Të njëten përgjigje që e gjejmë në këtë dokument zyrtar, vendim të Këshillit të Ministrave, e gjejmë dhe në përgjigjen e sjellë nga Kryetari i Bashkisë Tiranë .

Shpronësimi lidhur me kontratën koncensionare të Sharrës, është vendosur nga Këshilli i Ministrave, është suportuar me mbështetje buxhetore nga buxheti i shtetit gjë e cila në vetvete shpreh angazhimin e Qeverisë në dhënie rrugëzgjdhje problemit madhor të trajtimit të mbetjeve në kryeqytetin e vendit, në Tiranën e pothuaj një milion banorëve, në Tiranën ku konsumi presupozohet të rritet dita ditës e ku Sharra e cila kishte 25 vjet që i shërbente grumbullimit të mbetjeve në Tiranë, imagjinoni në 25 vjet sesa është rritur Tirana, kishte mbaruar funksionin e vet që prej 3 vjetësh!!

Lidhur me statusin juridik të tokës ku sot ngrihet impianti i trajtimit të mbetjeve të Tiranës , vlen të thuhet se sipërfaqja totale e saj është 120 ha; 60.1 % është pronë shtet dhe 39.9% është pronë private e shpronësuar sipas vendimit të mësipërm.

Sipërfaqja në të cilën zbatohet ky projekt është një sipërfaqe e madhe e domosdoshme , e cila është konceptuar për të kryer të gjithë aktivitetet sipas kësaj kontrate koncesionare.

Ky projekt përfshin ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave kryesore dhe plotësuese si: kapsulimi i venddepozitimit ekzistues, impianti i përpunimit të ujërave të ndotura, impianti i diferencimit të mbetjeve të integruara, venddepozitimi i mbetjeve të ngurta urbane, impianti i përpunimit të mbetjeve, nënstacioni elektrik, venddepozitimi i hireve, venddepozitimi i mbetjeve inerte.

Shpronësimi është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 37 “Marrëdhëniet e pronësisë” të ligjit 125/2015 ku përcaktohet se: *“1. Në rast se një kontratë koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e pasurisë në pronësi të një personi, që nuk është i përfshirë në procedurën për dhënie të kontratës, marrëdhëniet e pronësisë që shoqërojnë një pasuri të tillë duhet të zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar....”* si dhe në përputhje edhe me parashikimet kontraktuale

Bashkia e Tiranës, në rolin e përfituesit të këtij projekti, është mbështetur nga qeverisja qendrore për të ushtruar dhe përmbushur funksionet e saj. Sigurisht që vlen të theksojmë që prona e përfituar nga procesi i shpronësimit është pronë shtet dhe është aset publik.

Sipërfaqja e shpronësuar nga shteti nuk është një sipërfaqe e vogël sepse ish fusha e Sharrës e njehësuar me venddepozitimin mbetjeve, nuk mund të mbetet në përmasat e dikurshme, të para 25 viteve; sipërfaqja shtesë është 478.800 m<sup>2</sup> dhe për këtë sipërfaqe është miratuar kjo vlerë shpronësimi .

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, në nenin 54 parashikon kompetencat dhe detyrat e këshillit bashkiak.

**Pretendimi i përfaqësuesve të opozitës se duhej miratim për një procedurë koncesionare që po zhvillohej, nga këshilli bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore, është i pabazuar në ligj, pasi procedura rregullohet sipas ligjit përkatës për koncesionet dhe partneritetin publik privat.**

Pretendimi i opozitës në komision hetimor, në lidhje me marrjen e miratimit nga Këshilli Bashkiak Tiranë, përsa i përket angazhimit financiar për këtë procedurë koncesionare, bëhet duke ngatërruar qëllimisht kompetencat dhe detyrat e këshillit në lidhje me miratimin e buxhetit, të parashikuara në shkronjën “dh” të nenit 54 të ligjit, ku thuhet shprehimisht se *“këshilli bashkiak miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë”*.

Pra nga leximi i kësaj dispozite, nuk del në asnjë rast parashikimi dhe detyrimi ligjor në lidhje me marrjen paraprakisht të miratimit të këshillit bashkiak, pasi ky i fundit shprehet në lidhje me miratimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ndryshimet që pëson ky buxhet gjatë vitit buxhetor.

Siç del qartë për sa më sipër, dhënia e miratimit në parim për një procedurë në proces, nuk është kompetencë apo detyrë e këshillit bashkiak.

Shprehja parimisht dakord sipas shkresës së datës 27.03.2017, nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, përsa i përket rolit të kësaj bashkie, nuk ka të bëjë me miratimin e buxhetit apo ndryshimeve të tij, por me dakortësinë me termat në të cilat propozohej zgjidhja e çështjes së trajtimit të mbetjeve brenda territorit administrativ të Bashkisë Tiranë.

Në vijim të këtij projekti, kompetencat e Kryetarit të Bashkisë përcaktohen qartë në pikën 12 të nenit 21 të Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar ku citohet se “ *Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.*”.

Gjithashtu në pikën 1 të nenit 5 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar është parashikuar se “*Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë*” Në gërmën “gj” të nenit 64 “*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*” të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, është parashikuar se “*Kryetari i Bashkisë ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët*”. Ai ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës

Sipas kësaj dispozite ligjore, çdo kompetencë që nuk përfshihet në kompetencën e këshillit bashkiak, është kompetencë dhe detyrë e kryetarit të bashkisë si organi ekzekutiv i njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në Komisionin Hetimor, nga ish Ministri i Financave, z. Arben Ahmetaj u shpjegua qartë edhe autoriteti i Ministrisë të Financave, lidhur me koncesionet/partneritetin publik privat, i cili ushtrohet sipas përcaktimeve në nenet e veçanta të Ligjit Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar .

Ministria e Financave jep miratimin paraprak mbi të dhënat dhe analizën ekonomiko-financiare, referuar fushës së tij të përgjegjësisë shtetërore në përputhje me parimet dhe kërkesat e ligjit Nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

**Dhënia e miratimit paraprak kufizohet në 3 aspekte: (i) përballueshmëri, (ii) qëndrueshmëri dhe (iii) fizibilitet fiskal.**

Në këtë kontekst, Ministria e Financave vlerëson qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal të projektit koncesionar/PPP sipas studimit të fizibilitetit të hartuar nga Autoriteti Kontraktor, duke vlerësuar ndikimin e risqeve potenciale të menjëhershme dhe urgjente që shoqërojnë projektin cka nënkupton se Ministria e Financave limitohet në kryerjen e kontrollit lidhur me faktin që shumat e përgjithshme të pagesave vjetore neto që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP) të mos tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.

Në lidhje me përballueshmërinë e një projekti, që kërkon mbështetje financiare Ministria e Financave kontrollon nëse kostot përkatëse të projektit janë të planifikuara, nëse përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuar nga Kuvendi, si dhe brenda tavaneve të shpenzimeve për periudhën afatmesme, të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Pretendimi se ka pasur pamundësi për vendimmarrjen nga ana e Këshillit Bashkiak Tiranë, pasi që duhej miratimi me 3/5 e antarëve të tij, po ashtu nuk gjen mbështetje ligjore.

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, në nenin 55 të tij, e ka të mirëpërcaktuar se kur kërkohet miratimi nga 3/5 e antarëve të këshillit. **Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të antarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54 të këtij ligji dhe rasti është ai i tjetërsimit dhe dhënies në përdorim të pronave në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe në asnjë rast tjetër.**

Përgjigjja që rezulton në shkresën nr. 8275/1, datë 27.03.2017, është korrekte për atë kohë sa nuk kemi të bëjmë me miratim buxheti, ndryshime të tij, apo marrjen marrjen përsipër të një angazhimi 30 vjeçar, theksojmë në atë moment.

Këshilli bashkiak nuk mund të japë as dakordësi dhe as pëlqim jashtë kompetencave të tij të parashikuara nga ligji, për një procedurë koncensionare që po zhvillohej nga një autoritet kontraktor.

Në momentin e parashikimeve buxhetore, këshilli bashkiak ka ushtruar kompetencat e tij dhe ka ngarkuar kryetarin e bashkisë për të nënshkruar aktet dhe angazhimet përkatëse në vijim të kësaj procedure.

Angazhimi financiar nga Bashkia Tiranë apo nga bashkitë e tjera të Qarkut Tiranë, sipas parashikimeve edhe të vetë kontratës koncensionare, është marrë përsipër vetëm në momentin që këto njësi kanë nënshkruar në formën e angazhimit, sipas aneksit nr. IX të kontratës.

Përpara marrjes përsipër të formës së angazhimit nga Bashkia Tiranë, në momentin kur kësaj njësie vendore i është përcjellë edhe kontrata koncensionare e nënshkruar midis Ministrisë së Mjedisit dhe koncensionarit, Bashkia Tiranë ka kryer të gjitha procedurat përkatëse në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Bashkia Tiranë ka nënshkruar formën e angazhimit mbi detyrimet e njësisë vendore të qarkut Tiranë (aneksi IX), në vitin 2018, pas marrjes së miratimit nga Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 106, datë 28.09.2017, ku me ndryshimet përkatëse në programin buxhetor, ka ngarkuar Kryetarin e Bashkisë Tiranë për zbatimin e detyrimeve dhe angazhimeve të parashikuara në këtë vendim dhe nënshkrimin e akteve të nevojshme në zbatim të tij.

Po kështu, me vendimin Nr. 132, datë 21.12.2017 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2018”, janë bërë parashikimet e nevojshme buxhetore në zbatim të kontratës koncensionare.

Bashkia Tiranë ka kryer komunikimin shkresor me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me angazhimin financiar të bashkisë Tiranë dhe sigurimin e mbështetjes financiare, nga qeverisja qendrore me qëllim kryerjen dhe përmbushjen e funksioneve të saj, sipas parashikimeve kontraktuale.

Pra nga sa më sipër rezulton se procedurat administrative të ndërmarra nga bashkia Tiranë janë kryer konform legjislacionit në fuqi, brenda kompetencave që parashikon legjislacioni bazuar në zgjidhjen e propozuar për menaxhimin e mbetjeve për territorin e Bashkisë Tiranë, për të vijuar më pas po në përputhje me ligjin me disponueshmëri financiare sipas objektivave afatmesëm të buxhetit të miratuar rregullisht nga Këshilli Bashkiak.

Sakaq procedura koncesionare është miratuar, pasi që më parë Bashkia Tiranë nëpërmjet Kryetarit të Bashkisë, z. Erion Veliaj, ka shprehur dakortësinë me termat në të cilat propozohet zgjidhja e çështjes së trajtimit të mbetjeve në Tiranë, ka treguar disponueshmëri financiare sipas objektivave afatmesëm të buxhetit të miratuar rregullisht nga Këshilli Bashkiak, dakortësi kjo e pasuar dhe e sqaruar saktësisht në Komisionin Hetimor, nga ish Ministri i Financave, z. Arben Ahmetaj.

Ndërkohë sjellim edhe njëherë në vëmendje ligjin mbi bazën e të cilit funksionon Këshilli i Ministrave, që është po ashtu një ligj i vitit 2003, me të cilin kanë vepruar singjashëm të gjitha qeveritë, të majta dhe të djathta.

Procedura e konsultimit midis ministrave, e njohur si “Bashkërendimi i akteve” është një procedurë rutinë pune, nuk është një procedurë e cila të amplifikohet sikur është zhvilluar enkas nga kjo qeveri:

Pa dyshim është një punë që e detyron ligji: përfaqësuesit, kabinetet në institucione të ndryshme qëndrore, përfshihen në procesin e konsultimit të vendimmarrjeve që duhet të bëjë Këshilli i Ministrave, pikërisht në bazë të ligjit organik të këtij të fundit.

A mund penalizohet dikush për mendimet ?!

Përgjigjen e kësaj pyetje e ka dhënë ligji themeltar, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, që ka të garantuar në përmbajtjen e saj “lirinë e shprehjes” (shih nenin 22 të saj).

Si merren vendimet në mbledhjet e Këshillit të Ministrave ?

**Anëtarët e Këshillit të Ministrave, duhet t’i respektojnë vendimet e marra në mbledhjet e qeverisë .**

**Ata duhet të mënjanojnë në menyrë të veçantë çdo shprehje mospajtimi, të mbrojnë ose të përkrahin vendimet e lartpërmendura, pavarësisht nga fakti nëse kanë marrë pjesë ose jo në mbledhje, kanë votuar pro ose kundër .**

Këshilli i Ministrave është organ kushtetues, kolegjal për nga natyra e funksionimit, dhe i tillë që duhet të shfaqet unitar në vendimmarrjen e vet, pavarësisht debateve dhe vlerësimeve të ndryshme që eventualisht mund të ruajnë anëtarët e kabinetit për vendime ose çështje të ndryshme .

**Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten konfidenciale, sanksionon ligji organik i Këshillit të Ministrave.**

Ky adresim në të tilla parashikime ligjore, vlen për të rrëzuar çdo pretendim të opozitës për qenie në konflikt interesi të antarëve përfaqësues të mazhorancës në Komisionin hetimor e që kanë mbajtur detyrën e ministrave në qeveritë paraardhëse, sikundër njëherazi tregon se nuk ka pasur asnjë urdhër, të shprehur apo të nënkuptuar si të tillë, i cili të impononte një vendimmarrje të caktuar dhe dakortësi nga ana e të gjithëve.

Ajo që është edhe më e rëndësishmja për t’u theksuar është që kontrata e inceneratorit të Tiranës nuk është PPP, por është Koncesion i pastër, e cila nuk kërkon mbështetje financiare .

Tirana është një koncesion i formës “ Pay for Use, një kontratë me tarifë shërbimi, prej 29 euro. **Impianti Tiranës, nuk ka kërkuar mbështetje financiare, në kontekst të nenit 42 te ligjit 125/2013, por është një investim tërësisht privat 128 mln euro, ku asetit në fund të 30 viteve, do i transferohet Bashkisë së Tiranës.**

Ky shpjegim u bë në Komisionin Hetimor edhe nga ish Ministri i Financave Z. Arben Ahmetaj

Në Sharrë do të ndodhë dhe incenerimi I mbetjeve të papërdorshme dhe kujtojmë se jemi brenda afatave të zërave të kontratës.

Vlera e investimit është vlera e investuar nga koncensionari ; ajo nuk mund të njësohet me tarifën e shërbimit për ton mbetje urbane.

Për çdo ton mbetje urbane që dërgohet në Sharrë nga Bashkia Tiranë, por edhe bashkitë Durrës e Kavajë, paguhet tarifa prej 29 Euro për ton .

A është kjo një tarifë disproporcionale krahasur me tarifa shërbimi të ngjashëm?

Në Komisionin Hetimor, nga të dhëna të ndryshme statistikore që u administruan, konstatohet lehtësisht se kjo është një tarifë e përafërt për shërbime të trajtimit të mbetjeve urbane kudo në Europë e ku funksionojnë impiante të tilla .

Për provueshmërinë në këtë rast, na ka ndihmuar edhe administrimi I një informacioni nga ana e Bashkisë Tiranë, për kohën kur kjo bashki drejtohej nga kryeopozitari Basha, lidhur me një studim të Bankës Botërore, i cili propozonte tarifën prej 37 euro për ton mbetje dhe bëhej fjalë vetëm për landill dhe dicka më komplekse se kaq .

Komisioni hetimor ka administruar si provë edhe një listë të të dhënave të tarifës për ton mbetje si dhe të sasive të mbetjeve urbane që krijohen në vit, në vende të ndryshme të Europës.

Për të provuar shkelje të ndryshme të ligjit në procedurat koncensionare, në të tre këto raste, u kërkua të sillen si provë dhe raportet e kontroleve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KLSH është sigurisht një institucion i rëndësishëm kushtetues e si I tillë duhet të jetë I pavaruar , pavarësisht faktit që ish Kryetari I Kontrollit të Lartë të Shtetit, nënshkrues i këtyre raporteve, ishte një ministër në kohën kur qeveriste PD dhe sot është deputet I këtij subjekti politik, por aktet e këtij organi nuk kanë fuqinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Ato janë akte administrative dhe si të tilla janë të kontestueshme në rrugë administrative dhe në rrugë gjyqësore, cka për një hetim parlamentar do të thotë se faktet ose konkluzionet që nxirren në to, nuk mund të merren si definitive apo si provë e pakundërshtueshme.

Mospërmbushjet e detyrimeve kontraktore edhe në rastin e këtyre kontratave koncensionare trajtohen civilisht derisa nuk provohet dhe nuk u provua në këtë komision hetimor, që ato përbëjnë vepër penale psh. vonesat e referuara si mospërmbushje të disa zërave të kontratës.

Është detyrim I Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka qenë dhe ngelet detyrim I tij, që nëse gjatë auditimit të kontratave koncesionare në fjalë, ka ndeshur shkelje, mospërmbushje kontraktore e që përbëjnë vepër penale, t'i kallëzonte në organin e prokurorisë, gjë e cila nuk u provua të ketë ndodhur gjatë zhvillimit të Komisionit Hetimor.

Një moment tjetër që u kërkua të hetohej në Komisionin Hetimor ishte dhe fakti i mbylljes së Porto Romanos, për t'u shndërruar në një EkoPark si dhe trajtimi i mbetjeve të Bashkisë Durrës në impiantin e Tiranës.

Mbyllja e Porto Romanos është reflektuar si një vendim i duhur në publik, por dhe në rrethet akademike.

Në Komisionin Hetimor, u soll si provë e këtij fakti, një shkrim i z.Seit Shallari , Docent dhe Përgjegjës i Departamentit të Agro-Mjedisit dhe Ekologjisë në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

*Ndotja në Porto Romano nga mbetjet , rrjedhjet toksike drejt nëntokës dhe detit si dhe gazrat me përmbajtje të substancave toksike kancerogjene që përfundojnë në mushkritë e studentëve aty afër dhe banorëve, duket sikur po ia lënë vendin rehabilitimit, pas dekadash në qytetin ku kalon fluksi më i madh i turistëve gjatë stinës së verës . Është lajm shumë i mire që u mbyll Porto Romano ,*

*është lajm shumë i mirë që Sharra mund t'i shërbejë edhe trajtimit të mbetjeve që ka Durrësi e është vetëm 40 km larg prej tij.*

Durrësi dhe Vlora përvec që janë dy bashki të mëdha, të kategorisë së parë, por janë dhe dy bashki turistike, që përballojnë një fluks turistësh që në sezon shkon deri në një milionë, një milionë e gjysëm vetë.

Pa diskutim një shifër shumë e lartë, që flet për një konsum tejet të shtuar, por po aq dhe për volum të shtuar mbetjesh për t'u menaxhuar.

Në vijim të këtyre argumenteve, rikthehemi dhe njëherë në përmbajtjen e shkresës Nr.1831 Prot datë 19.11.2021 e Institutit të Statistikave që ky komision administroi si provë.

Sipas shkresës në fjalë, ***deri në vitin 2013 të dhënat e mbledhura dhe statistikat e publikuara ishin të pakta dhe përgjithësisht të referuara në rekorde administrative, raportuar këto nga burimet administrative të kohës. Lidhur me sasinë mesatare të mbetjeve të gjeneruara gjithsej, të raportuara për periudhën 2004-2012, janë gjeneruar rreth 745 249 tonë për periudhën referencë.***

***Nga viti 2013 e në vazhdim, nën drejtimin metodologjik të asistencave teknike, të udhëhequra nga Bashkimi Europian, por duke u mbështetur dhe në eksperiencat më të mira ndërkombëtare, të dhënat mbi gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane, pësuan përmirësim rrënjësor në strukturë, sasi dhe metodologji sa i përket mbledhjes, llogaritjes dhe publikimit të tyre.***

***..lidhur me sasinë mesatare të mbetjeve të gjeneruara gjithsej, të raportuara për periudhën 2013-2020, janë gjeneruar rreth 1.606 639 tonë për periudhën referencë.***

Nëse këto të dhëna, nuk janë shifra që flasin dhe tregojnë që dikush duhet të lëvizte nga vendi e duhej t'i përgjigjej me metoda moderne, trajtimit të mbetjeve, kjo pritej vetëm nga "inkuizitorët e rinj", kërkuesit e këtij Komisioni Hetimor.

Në zbatim të detyrimeve të këtij Komisioni Hetimor, ne kemi qenë të vëmendshëm edhe në drejtim të njohjes së praktikës europiane të menaxhimit të mbetjeve, sikundër disa herë e përdorëm si referencë, ndërkohë që opozita e përdor si provë të akuzave të saj publike.

Referuar publikimeve shkencore, rezulton se sot në nivel global, gjenerohen mbi 2 miliardë tonë mbetje urbane në vit.

Shekuj më parë, një mendje universale deklaronte se "ajo që për ne sot quhet mbetje, nesër do jetë lëndë e parë".

Përvoja europiane tashmë e ka vërtetuar këtë pohim, ndaj prioritet i BE-së është ekonomia qarkulluese, që ka për synim reduktimin e mbetjeve dhe riciklimin.

Në modelin e ekonomisë qarkulluese prodhimi i energjisë nga djegia e mbetjeve radhitet në vendin e katërt.

Prioritet është: 1) Parandalimi i gjenerimit të mbetjeve; 2) Ripërdorimi; 3) Riciklimi dhe pastaj djegia (incenerimi).

Kuadri ligjor i BE rregullohet e ndryshon në funksion të këtyre prioriteteve, duke kufizuar djegien vetëm për ato mbetje, të cilat nuk kanë vlerë riciklimi dhe ripërdorimi.

Në nivelin e BE-së përqsjet e shteteve anëtare në menaxhimin e mbetjeve janë të ngjashme, përsa i takon riciklimit, por jo djegies.



Danimarka është kampione e djegies, riciklon rreth 50%, rreth 1% e dërgon në landfill, pjesa tjetër digjet.

Në BE përgjatë viteve 1995 – 2019, është zvogëluar depozitimi i mbetjeve në landfille, nga 121 milionë tonë, në 53 milionë tonë. Sasia e mbetjeve të ricikluara dhe kompostuara nga 37 milionë tonë në 1995, u rrit në 107 milionë tonë në 2019. Djegia në këtë periudhë kohore u rrit nga 30 milionë tonë në 60 milionë tonë.

Sot në BE janë në punë rreth 500 inceneratorë.

Cila mënyrë e menaxhimit është më e mira ?

Riciklimi, djegia apo depozitimi (landfill)?

Praktika ka treguar se menaxhimi i mbetjeve nuk është si recetat në gatim. Një model që funksionon në një vend, nuk ecën diku tjetër.

Kombinimi në masën e duhur i formave të menaxhimit, duke patur parasysh kriteret mjedisore, ekonomike, të tregut, të shëndetit të njeriut, si dhe ato të zhvillimit të qendrueshëm, do çonte në zgjidhje optimale.

Menaxhimi më i mirë është kombinimi i të gjithë mënyrave, ku prioritet duhet të ketë reduktimi, ripërdorimi e riciklimi i mbetjeve.

Në Shqipëri, deri para pak vitesh, mbetjet menaxhoheshin në mënyrën më të keqe. Tirana dhe thuajse të gjitha qytetet mbuloheshin nga retë toksike të tymrave, si rrjedhojë e djegies spontane të mbetjeve.

Vendet e pasura, me sipërfaqe toke të kufizuara, si Holanda dhe Danimarka i kanë dhënë përparësi riciklimit dhe djegies. Këto vende thuajse po eliminojnë landfillet.

Si anë pozitive të inceneratorëve përmenden reduktimi i vëllimit të mbetjeve deri në 90%, djegia plotësisht e një pjese të lëndëve toksike, prodhimi i energjisë dhe avullit, si dhe mundësia për të rikuperuar metalet.

**Mbetjet nuk janë vetëm problem i qeverisë, por edhe i qytetarit, edukimit të tij, prandaj kjo çështje sigurisht që do të përbëjë debat, do të kërkojë angazhim edhe më shumë, vëmendje, përditësim të njohurive, kërkesë llogarie, përgjegjësi të shtuar në administrimin si duhet, ligj dhe standartizim të procedurave përkatëse, për të optimizuar përfitimet dhe ulur kostot, për të siguruar një cilësi më të mirë të mjedisit si dhe rrjedhimisht dhe të jetës dhe shëndetit tonë.**

**Shuma prej 430 milion euro, e supozuar si abuzim nga Partia Demokratike, nuk ekziston.**

Si nga dokumentacioni i administruar në Komisionin Hetimor por dhe nga dëshmitë e Kryeministrit, Zv.Kryeministrit Ahmetaj dhe Ministres Balluku, u provua se shifra prej **430 milion euro** është një shifër e pavertetë, e cila pati dhe ka si qëllim të vetëm, keqinformimin e publikut dhe nxitjen e tij për të menduar se kjo shumë është vjedhur nga një grup i strukturuar kriminal.

Shuma e paguar nga Buxheti i Shtetit në total është rreth 55 milionë euro, e faktuar kjo nga autorizimet përkatëse nxjerrë nga Thesari i Shtetit. Në këtë shumë përfshihet:

Pagesa e plotë për impiantin e trajtimit të mbetjeve për Qarkun e Elbasanit në një total prej 21,6 milion euro pa TVSH (vepër e ndërtuar dhe në funksion të gjitha impiantet dhe prodhon energji elektrike);

Një pjesë e pagesës për impiantin e trajtimit të mbetjeve në Fier që ka vlerë totale prej 28 milion euro pa TVSH (vepër e ndërtuar dhe në funksion të gjitha impiantet me përjashtim të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike) për të cilën ende nuk janë paguar rreth 5 milionë euro;

Nëse pagesa e plotë e kryer nga viti 2014 deri më tani nga Buxheti i Shtetit , për ndërtimin e dy veprave është në total rreth 55 milionë euro, atëherë si ka mundësi që Partia Demokratike flet për një shumë stratosferike prej 430 milionë euro?!

Në komision nuk u soll asnjë provë dokumentare që të faktojë këtë gjë.

Opozita në Komisionin Hetimor, pohoi se kjo shifër është e parashikuar në kontratën e koncesionit të Tiranës (duke ju referuar tabelës përmbledhëse të punimeve).

Pra sipas logjikës së tyre, shuma që do të paguajnë Bashkitë e Qarkut Tiranë, në 30 vitet e ardhshme për pagesën e tarifës së shërbimit prej 29 euro deri në vitin 2047 shuma totale që ato do paguajnë ,do të jetë rreth 300 milion euro. Kësaj shume i shtojnë edhe investimin që do kryejë investitori privat prej rreth 130 milionë euro duke shkuar në këtë mënyrë në shumën prej 430 milionë euro!!.

**Kjo mënyrë e bërjes së llogarive, në rastin më të mirë është paaftësi për të cilën kjo forcë politike shquhet, dhe në rastin më të keq është dashakeqësi. Megjithatë mendojmë se kjo e dyta prevalon mbi të parën kjo pasi:**

**Kontrata e koncesionit është 30 vjeçare dhe shuma totale prej 300 milionë euro, do të paguhet nga Bashkitë deri në vitin 2047, fakt ky që Partia Demokratike me qëllim nuk ia thotë opinionit publik;**

Në shumën 430 milionë euro, janë futur edhe shpenzimet e ndërtimit prej rreth 130 milion euro që do të kryejë subjekti privat (kujtojmë që investimi kryhet nga privati dhe jo nga buxheti i shtetit). **Nga gjithë sa sqaruar më sipër, kuptohet qartë se opinionin publik është disinformuar në mënyrë të përsëritur nëpërmjet deformimit të shifrave dhe fakteve si dhe atribuitit të disa akuzave penale, funksionarëve të ndryshëm shtetërorë , me qëllimin e qartë për të fituar kredo politike.**

Në lidhje me përcaktimin e tarifave të dherave nga Këshilli Bashkiak i Tiranës, sipas pretendimeve dhe akuzave të ngritura nga përfaqësuesit e opozitës në Komisionin Hetimor, sqarojmë se kjo çështje është jashtë kompetencave të këshillit bashkiak, bazuar kjo në parashikimet e nenit 54 të ligjit nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 68 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Neni 35 i ligjit nr. 139/2015, parashikon të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore.

Konkretisht në pikën 5, shkronja “a” të këtij neni përcaktohet se ... Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për: a) shërbimet publike që ato ofrojnë.

Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 3, përcakton se “Tarifë vendore” është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

Po kështu në nenin 14 të këtij ligji përcaktohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë.

Në rastin e kontratës koncensionare, nuk kemi të bëjmë me një tarifë që miratohet nga këshilli bashkiak, pasi Bashkia Tiranë nuk është subjekti që ofron një shërbim apo një të drejtë ndaj qytetarëve të saj, por sipas kontratës koncensionare, Bashkia, është një subjekt si cdo subjekt tjetër, që mund të depozitojë mbetjet e ngurta pranë koncensionarit.

E drejta e koncensionarit për depozitim e mbetjeve është një parashikim i vetë kontratës koncensionare.

Për sa më sipër, Bashkia Tiranë dhe Këshilli Bashkiak, sipas parashikimeve ligjore, nuk kanë asnjë kompetencë të tillë që të vendosin tarifë për një shërbim që nuk ofrohet nga Bashkia Tiranë.

Në Komisionin hetimor u debatua dhe sa i takon zbatimit të kontratës koncensionare të Tiranës, diskutim në lidhje me të cilin nga dëshmitë e marra dhe dokumentacioni i administruar, rezulton sa më poshtë :

1. NJZP (njësia e zbatimit të projektit)

Është ngritur NJZP me një përbërje me perfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Përzgjedhja e supervizorit.

- Sipas kontratës Koncensionare procedura për përzgjedhjen e supervizorit kryhet nga Koncensionari.

- Në datën 19.02.2018, NjZP, sipas dokumentacionit dhe kriterëve të përcaktuara, ka miratuar një nga tre propozimet e paraqitura nga Koncensionari. v Vendimmarrja e NjZP i është përcjellë zyrtarisht Koncensionarit, më datë 28.2.2018. Kompania e perzgjedhur është AVE CONSULTING.

3. Nënkontraktorët

Ne nenin 6, “Marrëveshjet e fazës parandërtimore dhe ndërtimore nën përgjegjësinë e koncensionarit”, parashikohet se “brenda 3 muajve nga data kur koncensionari ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme, koncensionari është i detyruar të njoftjë AK për lidhjen e kontratave me nënkontraktorët përkatës”. Gjithçka që është parashikuar në kontratë është përmbushur .

4. Mbështetja financiare

Plani i angazhimit financiar për sasinë minimale të mbetjeve të trajtuara në Sharrë shpreh dhe mbështetjen e Qeverisë shqiptare për Bashkinë e Tiranës.

Procedura

➤ Bashkia Tiranë cdo vit i dërgon një shkresë MFE dhe për dijeni MIE “informacion/kërkesë mbi detyrimet kontraktuale të kontratës”.

➤ Kjo kërkesë e administruar nga MFE përfshihet në VKM për miratimin e tavaneve buxhetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

➤ Me ligjin e buxhetit, miratohen tavanet buxhetore përfundimtare të vitit pasardhës.

➤ Me hyrjen në fuqi të ligjit për buxhetin, MIE merr miratimin e detajimit nga MFE dhe njofton Bashkinë e Tiranës se fondet janë aktive në Thesar.

➤ Në vijim është Bashkia e Tiranës e cila kryen ndjekjen dhe pagesat për sasinë e mbetjeve të depozituara në lidhje me këtë kontratë.

Fondet në dispozicion për mbështetje të Bashkisë Tiranë, sipas viteve, paraqiten si më poshtë:

2018                    753 milionë lekë

2019	500 milionë lekë
2020	700 milionë lekë
2021	600 milionë lekë
2022	200 milionë lekë
Total	2.803 miliard lekë

### PËRFUNDIME TË PËRMBLEDHURA

≠ Sipas raportit të përpiluar në vitin 2012, jetëgjatësia e fushës së Sharrës ishte parashikuar deri në vitin 2015 .Tirana u shpall në emergjencë mjedisore pikërisht në këtë vit.

≠ Procedura koncesionare e ndjekur, është në përputhje me legjislacionin në fuqi për koncesionet .

≠ Impianti i Tiranës është një investim tërësisht privat dhe është një kontratë koncesionare , që nuk kërkon mbështetje financiare por i referohet modelit financiar që quhet “ Pay for Use”. I gjithë investimi kryhet nga koncesionari i cili e operon dhe në fund të 30 viteve transferon asetin publik tek Bashkia Tiranë.

≠ Qeverisja qëndrore ka mbështetur në formën e transfertave , Bashkinë e Tiranës në procesin e menaxhimit të mbetjeve, me qëllim përmbushjen dhe ushtrimin e procesin e menaxhimit të mbetjeve.

≠ Sipas kontratës koncesionare, procedura për përzgjedhjen e supervisorit kryhet nga koncesionari, pasi edhe pagesa e supervisorit nuk bëhet nga buxheti i shtetit por nga koncesionari. NjZP i përcillen tre propozime për kompani të ndryshme. NjZP miraton një nga tre propozimet e paraqitura nga Koncesionari (sipas p përcaktimeve në kontratë) dhe më tej vendimmarrja e NjZP i është përcjellë zyrtarisht Koncesionarit.

≠ Nuk ka pasur ndryshim kuotash të kësaj kontrate, ka pasur vetëm ndryshim të emrit dhe kompania zotëruese nuk ka ndryshuar. Kompania holandeze është e njëjtë, me të njëjtat të dhëna, me nipt, me adresë dhe gjithçka tjetër.

≠ Në lidhje me mbetjet e Durrësit nuk është amenduar kontrata koncesionare e Tiranës. Sipas përcaktimeve në kontratën e Tiranës, në pikën 2.2.3 përcaktohet se, ***“me qëllim rritjen e rentabilitetit/maksimalizimit të investimeve të koncesionarit, ky i fundit ka të drejtë të marrë dhe të furnizohet me mbetje edhe nga njësi vendore të qarqeve të tjera ose persona të tretë privat ose publik, për aq sa kjo nuk çënon përmbushjen e detyrimeve dhe sasisë së mbetjeve urbane që koncesionari ka sipas kësaj kontrate”***.

Në kushtet e një emergjencë mjedisore në Bashkinë Durrës, është marrë një vendim i analizuar dhe i mbështetur në studime dhe analiza të zonës Tiranë-Durrës, për të përfshirë edhe këtë bashki. Është në kompetencën e Njësisë Vendore të vendosë mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane për qytetin, dhe në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak të Durrësit u dakordësua kostoja për trajtimin e mbetjeve.

≠ Leja e ndërtimit është shqyrtuar në Këshillin Kombëtar të Territorit më 17.5.2019, është miratuar me kusht për shkak të plotësimit të dokumentacionit nga koncesionari. Pas plotësimit të dokumentacionit, leja e ndërtimit është zbardhur në 24.11.2020 për objektin “Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimin e vendepozitimeve ekzistuese me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”.

≠Aktualisht, projekti është fazën e ndërtimit dhe të operimit, pasi duhet pasur parasysh që Tirana është e përbërë nga impiantet për prodhimin e energjisë nga mbetjet e paripërdorshme, nga landfilli i mbetjeve urbane, nga landfilli i inerteve, nga landfilli i hireve, impianti i trajtimit të ujërave të ndotura, impianti i diferencimit për riciklim dhe e gjithë infrastruktura mbështetëse.

≠Landfilli i mbetjeve inerte është pjesë e kontratës, i cili është i përfshirë edhe në planimetrinë të miratuar në KKT. Kontrata nuk ka të përcaktuar tarifë për mbetjet inerte.

Sipas VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, tarifimi i mbetjeve inerte është kompetence e operatorit/bashkisë, kur landfillimi i mbetjeve kryhet nga vetë Bashkia dhe vendndodhja e landfillit të mbetjeve inerte është kompetencë e bashkisë/ministrisë.

≠ Landfilli i mbetjeve inerte, është pjesë e kontratës së inceneratorit të Tiranës, pra një nga veprat e këtij projekti , në të cilin depozitohen mbetjejet inerte të bashkive që mbledhen dhe transportohen nga operatorët ekonomikë privatë apo publikë , cka nënkupton që përcaktimi i tarifës për këto mbetje, është një marrëdhënie kontraktuale midis koncesionarit dhe operatorit ekonomik .

≠Tarifa 29 euro për ton mbetje është çmim mesatar i ponderuar, i cili është vendosur si i tillë pas një analize në studimin e fizibilitetit që i paraprin kontratës. Çmime mesatare të ponderuara janë një nga instrumentet financiarë që përdoren për t’i dhënë një kurbë sa më të zbutur një koncesioni, dhe për të mos e goditur më vonë gjatë momentit kur do të nisë incenerimi.

≠Impianti I prodhimit të energjisë elektrike është pjesë e rëndësishme e përpunimit të mbetjeve dhe është vetëm një nga proceset të cilat kryhen. Pra nga mbledhja e mbetjeve tek ndarja e tyre, tek trajtimi, tek landfille të cilat kapsulojnë sot mbetjet në impiantin e Tiranës. Mbetjet sot kapsulohen dhe një pjesë e tyre do të digjet kur incineratori të vendoset në punë. Pjesa tjetër që janë për riciklim dërgohen për riciklim dhe ndërkohë pjesa e mbetjeve biologjike shkon dhe vendoset në landfill.

≠Komisioni ka verifikuar që nuk bëhet fjalë thjeshtë për incinerator, por për impiante të përpunimit të mbetjeve urbane.

**Fjala “incinerator”, është përdorur qëllimisht nga opozita ,për të zvogëluar tërësinë e funksioneve të këtyre impianteve si dhe për të justifikuar akuzat e prodhuara në publik.**

≠Këto janë impiante të përpunimit të mbetjeve të cilët funksionojnë në bazë të piramidës dhe në bazë të përputhshmërisë së plotë me të gjitha direktivat e Bashkimit Evropian. I gjithë procesi nis nga kolektimi i mbetjeve, tek ndarja e tyre, seleksionimi i tyre, tek nxjerrja në proces të riciklimit të mbetjeve që janë të riciklueshme dhe deri tek shkatërrimi i mbetjeve biologjike përmes incenerimit dhe prodhimit të energjisë. Kështu që impiantet e trajtimit të mbetjeve janë impiante komplekse dhe të integruara që nuk janë vetëm inceneratorë. Kryejnë të gjitha këto procese që edhe Bashkimi Evropian i ka të rëndësishme.

## **6.KONKLUZIONE**

### **SUGJERIME**

Ky hetim ishte kompleks në vetvete, ndërkohë që mënyra e zhvillimit të tij, tregoi qartësisht nevojën që kemi, për të riparë ligjin Nr.8891 datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin

e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, një ligj i cili nuk i qëndron më kohës, nuk lidhet absolutisht me Reformën në Drejtësi, e cila një ndër synimet kryesore që pati, ishte pikërisht largimi i politikës nga drejtësia jo në kuptimin formal por në atë substancial mbi të gjitha.

Ligji sikundër lexohet sot, nuk garanton mosshkeljen e parimit të rëndësishëm kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe ky është cedimi më i rëndë e që natyrisht nuk duhet lejuar më të ndodhë nga ligjvënësi, të cilit i propozojmë rishikimin tërësor të ligjit , sigurisht duke iu përmbajtur Kushtetutës, nenit 77.2 të saj, duke riafirmuar të drejtën e opozitës për të ngritur komisione parlamentare hetimore, për objektin e veprimtarisë së të cilëve, për qënien e tyre në përputhje me parimet e rëndësishme kushtetuese, të na sigurojë vetë mekanizmi që vendos ligji në ndërtimin dhe veprimin e këtyre komisioneve, dhe jo numrat në Kuvend që janë e do ngelen gjithmonë vendimmarrje politike të atij momenti e që nuk mundet si të tilla të garantojnë në mënyrë absolute, edhe respektimin e parimeve të rëndësishme në funksionimin e tre pushteteve mes njëri tjetrit.

Këtij raporti i kemi bashkëngjitur dhe gjithë dokumentacionin e administruar në Komisionin Hetimor, një dokumentacion i cili në gjykimin tonë, mund t’i shërbejë shumë mirë edhe hetimit të organit të ndjekjes penale në lidhje me çështjet në fjalë.

Kjo është arsyeja që vec sugjerimit për rishikimin brenda kësaj legjislatore të ligjit organik të komisioneve hetimore, ne sugjerojmë që konform nenit 77.2 të Kushtetutës ku parashikohet se “ ..Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t’i njoftohen prokurorisë e cila vlerëson sipas procedurës ligjore”, dërgimin e këtij Raporti dhe dokumentacionit bashkëlidhur , Prokurorisë së Posacme, duke besuar që në sjelljen tonë i jemi përmbajtur sa duhet ,respektimit të parimeve të rëndësishme kushtetuese të cituara mëse njëherë në këtë raport.

## **7.MENDIM I PAKICËS PARLAMENTARE**

### **PËRMBAJTJA**

#### **HYRJE**

#### **I. METODA E INCENERIMIT**

##### **A. IMPAKTI NË MJEDIS**

##### **B. RAPORTI ME TË DREJTËN E BE-SË**

#### **II. PRONËSIA E KOMPANIVE**

#### **III. FOLLOW THE MONEY**

#### **IV. IMPIANTI I TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE ELBASAN**

##### **A. PROCEDURAT**

##### **B. ZBATIMI I KONTRATËS**

#### **V. IMPIANTI I TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE FIER**

##### **A. PROCEDURAT**

##### **B. ZBATIMI I KONTRATËS**

#### **VI. IMPIANTI I TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TIRANË**

##### **A. PROCEDURAT**

##### **B. ZBATIMI I KONTRATËS**

#### **VII. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

## HYRJE

1. Në datën 28.10.2021, Kuvendi i Shqipërisë, me kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, miratoi vendimin nr. 81/2021 “Për Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Kontrollin e Ligshmërisë së Veprimeve të Organeve Publike në Procedurat për Ndërtimin dhe Administrimin e Impianteve të Trajtimit të Mbetjeve Urbane”.

2. Sipas vendimit nr. 81/2021, Komisioni Hetimor Parlamentar kishte për objekt:

1. Kontrolli i zbatimit të ligjeve nga ana e organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane.
2. Verifikimi i pasojave ekonomike në buxhetin e shtetit shqiptar, si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të organeve publike.
3. Verifikimi i efekteve mjedisore dhe pasojave mbi konkurrencën dhe tregun e lirë.
4. Vlerësimi i nevojës për marrjen e masave ligjore për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe parimit të mosdiskriminimit.
5. Vlerësimi i nevojës për marrjen e masave të përshtatshme ligjore për mbrojtjen e mjedisit.
6. Rekomandime për marrjen e masave të përshtatshme duke ndërgjegjësuar hallkat e administratës shtetërore mbi aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e mjedisit.
7. Vlerësimi i nevojës për përafrimin e legjislacionit për koncesionet dhe mjedisor, me direktivat dhe praktikatat më të mira të BE-së.

3. Komisioni do të ushtrontë veprimtarinë për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi. Duke qenë se afati 3-mujor përkonte me përfundimin e sesionit parlamentar, përkatësisht periudha 20.12.2021 – 17.01.2022, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin vendosi që afati i Komisionit Hetimor të shtyhej deri në datën 25.02.2022.

4. Me vendimin nr. 81/2021, Kuvendi miratoi përbërjen e Komisionit me 15 anëtarë të përhershëm, 8 përfaqësues të Partisë Socialiste dhe 7 përfaqësues të Partisë Demokratike, dhe 4 anëtarë zëvendësues, 2 përfaqësues të Partisë Socialiste dhe 2 përfaqësues të Partisë Demokratike. Përbërja e Komisionit ishte si më poshtë:

- |                     |                       |
|---------------------|-----------------------|
| 1. Jorida TABAKU    | Kryetare (PD)         |
| 2. Ermonela FELAJ   | Zëvendëskryetare (PS) |
| 3. Arben PËLLUMBI   | Anëtar (PS)           |
| 4. Eduard SHALSI    | Anëtar (PS)           |
| 5. Etjen XHAFAJ     | Anëtar (PS)           |
| 6. Anila DENAJ      | Anëtare (PS)          |
| 7. Fadil NASUFI     | Anëtar (PS)           |
| 8. Antoneta DHIMA   | Anëtare (PS)          |
| 9. Besion AJAZI     | Anëtar (PS)           |
| 10. Edmond SPAHO    | Anëtar (PD)           |
| 11. Helidon BUSHATI | Anëtar (PD)           |

12. Dhurata ÇUPI	Anëtare (PD)
13. Belind KELLICI	Anëtar (PD)
14. Luciano BOCI	Anëtar (PD)
15. Lefter GËSHTENJA	Anëtar (PD)

1. Jurgis CYRBJA	Anëtar zëvendësues (PS)
2. Denis DELIU	Anëtar zëvendësues (PS)
3. Luan BACI	Anëtar zëvendësues (PD)
4. Ina ZHUPA	Anëtare zëvendësuese (PD)

5. Sa i përket përbërjes, kryetarja e Komisionit Hetimor, znj. Jorida Tabaku evidentoi faktin se deputetja e PS-së, e cila ushtronte detyrën e zëvendëskryetares së Komisionit, ishte në kushtet e konfliktit të interesit sipas nenit 13 të Kodit të Sjelljes së Deputetëve, miratuar me vendimin nr. 61/2018 të Kuvendit të Shqipërisë, pasi në cilësinë e saj si ministër shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin, ka qenë e përfshirë në procedurat koncesionare, objekt hetimi. Megjithatë, deputetja Felaj vazhdoi të ishte pjesë e Komisionit dhe vendimmarrjes së tij.

6. Gjatë periudhës së veprimtarisë së tij, Komisioni Hetimor zgjodhi sekretaren e tij, znj. Antoneta Dhima, miratoi Rregulloren e Brendshme, Planin Paraprak të Hetimeve dhe mbledhi dokumentet dhe provat e nevojshme, sipas kërkesave të anëtarëve të Komisionit. Në datën 07.02.2022, Komisioni miratoi Planin e Hetimit dhe listën e dëshmitarëve. Nga data 14 Shkurt deri në 23 Shkurt 2022, Komisioni zhvilloi seancat dëgjimore me dëshmitarët.

7. Anëtarët, përfaqësues të Partisë Socialiste, refuzuan të dëgjonin dëshminë e gazetarit Artan Rama, me pretendimin se në kushtet kur ndaj tij kishte një padi civile për shpifje, ishte në papajtueshmëri për të dëshmuar. Po ashtu, nuk u morën dëshmitë e anëtarëve të komisionit të koncesionit të Elbasanit, pasi ata paraqitën një shkresë nga Prokuroria Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në të cilën iu kërkohej ruajtja e sekretit hetimor si persona nën hetim. Deputeti i PS-së, Alqi Bllako refuzoi të dëshmonte përpara Komisionit, me pretendimin se ishte thirrur për të dëshmuar nga SPAK dhe i ishte kërkuar ruajtja e sekretit hetimor. Të njëjtin arsyetim e shprehu dhe kryetarja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për inceneratorin e Tiranës, Valbona Ballgjini dhe gjithashtu edhe anëtari i Komisionit të Koncesionit të Inceneratorit të Fierit Florian Muçaj, Ndërkohë, kryetarja në detyrë e Bashkisë Durrës, Emirjana Sako u largua nga Komisioni pa ndonjë arsye, në mënyrë demonstrative, duke refuzuar të dëshmonte.

8. Komisioni zhvilloi 18 (tetëmbëdhjetë) mbledhje dhe në përfundim miratoi Raportin Përfundimtar, i cili i paraqitet Kuvendit (seancës plenare) për miratim.

9. Komisioni, gjatë të gjithë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ka zbatuar me përpikëri ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, Kodin e Procedurës Penale, Rregulloren e Kuvendit dhe Rregulloren e tij të brendshme, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion për mbledhjen e provave, informacioneve



dhe dëshmime të nevojshme për përmbushjen e planit të miratuar të hetimit dhe realizimin e qëllimit dhe objektit të komisionit hetimor.

## I. METODA E INCENERIMIT

### A. IMPAKTI NË MJEDIS

**10.** Deri në vitin 2011 menaxhimi i mbetjeve urbane në Shqipëri barazohej padrejtësisht me “pastrimin”, bazuar në Ligjin Nr.8094, datë 21.3.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”. Në vitin 2011 Shqipëria e vendosi trajtimin e këtij problemi mbi baza të drejta ligjore, dhe filloi zgjidhjen e tij kur Parlamenti aprovoi Ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, dhe kur Qeveria nxori VKM nr. 175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”. Këta hapa ishin të përafuara plotësisht me politikat sektoriale të BE-së për mbetjet, përkatësisht me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, datë 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”, thelbi i së cilës është respektimi i “hierarkisë së mbetjeve” (1. parandalimi; 2. ripërdorimi; 3. riciklimi; 4. rikuperimi; dhe 5. trajtimi përfundimtar/asgjësimi). Si pasojë, në Progres Raportin e BE për Shqipërinë 2013, jepej vlerësimi se “në sektorin e rregullimit ligjor të menaxhimit të mbetjeve Shqipëria ka arritur nivelin më të lartë të harmonizimit me pothuaj 100% përputhshmëri”. Pra, ndërkohë që rruga politike sektoriale ishte plotësisht e drejtë, mjaftonte vetëm shtimi i investimeve në të gjithë hallkat e hierarkisë dhe problemi do të fillonte të zgjidhej në mënyrë graduale por të qëndrueshme.

**11.** Situata filloi të ndryshojë menjëherë në fund të vitit 2013, që kur në pushtet erdhi shumica e udhëhequr nga PS. Qeveria e re vendosi të investonte vetëm në hallkën më të ulët të hierarkisë së mbetjeve, atë të “rekuperimit me anë të incenerimit”. Nëse ky do të kishte qenë thjesht një çështje e ndryshimit të politikave publike për mbetjet, duke e përmbysur hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve dhe rrjedhimisht duke përmbysur edhe përparësitë në investime, do të kishte mjaftuar që Qeveria të ndryshonte Ligjin dhe Strategjinë, dhe kështu të kishte bazën ligjore që të fillonte procedurat e rregullta të bashkëpunimit të sektorit publik me atë privat. Por kjo nuk ndodhi: as Ligji dhe as Strategjia nuk ndryshuan. Kjo është prova që Qeveria kishte vetëm qëllimin që të përshkonte një rrugë të shkurtër, e cila ende sot rezulton e paqartë nga ana ligjore, por e cila i mundësoi asaj të shpenzonte mjete financiare publike me procedura të shpejta dhe pa negociim apo shpallje. Qeveria vendosi të përdorte organizmin e quajtur Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, të cilit Ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” në nenin 15 i jep vetëm kompetencën që “të bashkërendojë detyrat e ministrive për menaxhim të integruar mjedisor të mbetjeve” si organizëm ndërministror, në nivel zëvendësministrash. Pa ndërmarrë ndryshimin e Ligjit, Qeveria në 25 tetor 2013 aprovoi një VKM vetëm për t’i dhënë këtij Komiteti një kompetencë shtesë që Ligji nuk ia kishte dhënë: kompetencën që të mund “të shpallte fillimin dhe përfundimin e emergjencës mjedisore në vend”. Këtu fillon gjithçka.

**12.** Pak muaj më pas, më 5 shkurt 2014, mbledhet Komiteti i Emergjencës mirëpo në mbledhjen e tij nuk u arrit kuorumi i nevojshëm prej 11 anëtarësh. Sipas një dokumenti të zbardhur

ky Komitet kishte vetëm 5 anëtarë nga të cilët kanë firmosur vetëm 3 të tillë për rrjedhojë dokumenti që qeveria dhe mazhoranca pretendon se ka bazuar gjithë shpalljen e gjendjes së emergjencës rezulton të mos ketë asnjë vlerë pasi nuk është arritur kuorumi i duhur. Për rrjedhojë emergjenca e pretenduar se ka dalë nga vendimi i këtij Komiteti Strategjik është inegzistent dhe nul juridikisht. Për rrjedhojë përdorimi i kësaj alibie ishte shkaku që solli shpalljen e “emergjencës mjedisore” nga Këshilli Bashkiak i Elbasanit dhe dhënia e kontratës “me negociim pa shpallje paraprake” ndaj kompanisë Albtek Energy.

**13.** Koordinimi perfekt kohor i vendimit të Qeverisë 25 tetor 2013, me vendimin e Komitetit dt 5 shkurt 2014, dhe më tej me vendimin e sipërcituar të Këshillit Bashkiak të Elbasanit, ngrenë dyshimin se cdo gjë ka funksionuar si një plan pune i parapërgatitur, qëllimi i të cilit nuk ishte zbatimi i Ligjit për Mbetjet apo i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, por vetëm dhënia e kontratës pa negociim. Orientimi i investimeve vetëm drejt hallkës së parafundit dhe të fundit të hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve, përkatësisht “rekuperim i energjisë nëpërmjet djegies” dhe “landfillim”, në kushtet e mungesës totale së procesit të ndarjes së mbetjeve në burim dhe kur kuotat për riciklimin e mbetjeve, të premtuara në strategjinë kombëtare, nuk ishin realizuar, kjo vendimmarrje pra, dëmtoi rëndë në mënyrë të pakthyeshme menaxhimin e integruar të mbetjeve në RSH, gjë që provohet edhe nga ndryshimi rrënjësor i vlerësimit nga Raportet e Progresit, të hartuara nga BE për Shqipërinë pas vitit 2017 kur u realizua incineratori i Elbasanit dhe kur u qartësuan objektivat për ndërtimin e inceneratorëve të tjerë në Fier dhe Tiranë. Kështu, në Raportin e Progresit 2018, thuhet se “...ndërtimi i inceneratorit në Elbasan, i cili filloi të funksionojë vitin e kaluar, dhe planet për investime të mëtejshme në incineratorë paraqesin shqetësime në lidhje me pajtueshmërinë me parimet e BE duke konsideruar se depozitimi dhe djegia janë opsionet më pak të preferuara për menaxhimin e mbetjeve.”. Sic shihet, vendimi i sipërcituar i Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, është përdorur si truk nga ana e Qeverisë për të iniciuar procedura ekstra-ligjore, me alibinë e “emergjencës mjedisore”, dhe po ashtu ka shkaktuar efekte zinxhir të përkeqësimit të pozitës së Shqipërisë në procesin e përafrimit më BE-në. Në të gjitha Raportet e Progresit që prej vitit 2018 shprehet i njëjti shqetësim lidhur me mospajtueshmërinë e incinerimit për përputhshmërinë me Acquis Communautaire.

**14.** Është paradoksal nga ana tjetër, fakti që vendimi i cili që konsiderohet nga Kryeministri si “baza ligjore fillesë e gjithçkaje”, duket se në fakt është i pavlefshëm ligjërisht, për disa arsye.

- Së pari, sipas Ligjit, Komiteti në fjalë kishte vetëm funksion koordinimi dhe jo funksion vendimmarrës. Gjithsesi, kjo mungesë kompetence ligjore e Komitetit të sipërcituar duket se ka qenë arsyeja se pse 2 anëtarët juristë të Komitetit, përkatësisht zv/ministrat Ylli Manjani (zv ministër i Infrastrukturës) dhe Arben Isaraj (zv ministër i Drejtësisë), nuk e kanë nënshkruar Vendimin për shpalljen e emergjencës së mbetjeve, si dhe as Relacionin shoqërues për Qeverinë. Po ashtu, edhe pse u kërkua nga Komisioni Hetimor Parlamentar mbi Inceneratorët, ky relacion/raport nuk iu vu atij në dispozicion, duke hedhur kështu dyshime të arsyeshme mbi integritetin ligjor dhe saktësinë teknike të Raportit.
- Së dyti, detyra për shpalljen e emergjencës i përket Këshillit të Minsitrave. Në Ligjin Nr. 8756, datë 26.3.2001 PËR EMERGJENCAT CIVILE, i cili ka qenë në fuqi në atë kohë, përcaktohet se: 1. “Emergjencë civile” kuptohet një situatë e shkaktuar nga faktorë

natyrorë, ekologjike, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin; 2. "Emergjencë civile kombëtare" kuptohet një situatë kritike urgjente e një natyre të përkohshme, që dëmton seriozisht jetën, shëndetin dhe sigurinë e shtetasve të Republikës së Shqipërisë, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë e natyrë të tillë që kalon mundësinë ose autoritetin e organeve të qeverisjes vendore për ta përballuar atë, ose kërcënon seriozisht mundësinë e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të ruajtur sovranitetin, sigurinë dhe integritetin territorial të vendit.

- Së treti, mbajtja në fuqi e të ashtuquajturës “gjendje e emergjencës mjedisore për mbetjet” nuk është e bazuar në ligj. Ligji PËR EMERGJENCAT CIVILE, përcakton kohëzgjatje maksimale 30 ditore për mbajtjen në fuqi të gjendjes së emergjencës. Është Këshilli i Ministrave i cili vendos për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit për parashikimin, parandalimin, operacionet e ndërhyrjes ose riaftësimin e pasojave të situatave të emergjencës civile. Në rast të nevojës për shtyrje përtej 30 ditëve, duhet informuar Parlamenti dhe Presidenti i Republikës. Nuk mundet Këshilli i Ministrave t’i delegojë një detyrë të vetën ligjore, një organizmi tjetër, aq më pak jo-kushtetues.
- Së fundmi, nuk ekziston asnjë referencë ligjore apo rregullatorë se çfarë quhet “emergjencë mjedisore për mbetjet” apo “emergjencë mjedisore” apo “emergjencë ekologjike”, dhe se kur është e domosdoshme që faktorët “ekologjike” (sic përcaktohet në Ligjin mbi Emergjencat civile) mund të bëhen shkak për shpallje të gjendjes së emergjencës në shkallë kombëtare. Nuk ka në Ligj apo në ndonjë VKM apo Rregullore asnjë standard teknik, tregues/indikator sasior, metodikë vlerësimi, që të dëshmojë që vendimi për shpallje të tillë të emergjencës është objektiv dhe i bazuar në ligj, dhe nuk është një vendim voluntarist dhe subjektiv.

**15.** Mbetet pra për t’u sqaruar ligjërisht fakti nëse Qeveria mundet që nëpërmjet një VKM-je të kapërcejë përcaktimet ligjore mbi një organizëm koordinimi, duke i akorduar kompetenca shtesë vendimarrjeje. Mbetet po ashtu për t’u sqaruar ligjërisht, se si mundet që një seri veprimesh juridike dhe ekonomike në nivel kombëtar dhe lokal, të cilat kanë anashkaluar për vite me rradhë procedurat ligjore të prokurimit publik apo të dhënies së koncesioneve, dhe kanë angazhuar mjete të rëndësishme financiare publike, janë ndërmarrë duke u bazuar tek ky vendim i Komitetit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve i marrë jashtë kompetencave të veta ligjore.

**16.** Për të kuptuar arsyet se pse trajtimi prioritar i hallkës së incinerimit është sabotim i procesit të menaxhimit të mbetjeve, dhe dëmtim i financave publike dhe personale të qytetarëve, duhet të shpjegojmë shkurt konceptin e “hierarkisë së trajtimit (menaxhimit) të mbetjeve” dhe hallkat përkatëse. Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve, e përcaktuar si detyrim në të gjitha dokumentet ligjore të BE dhe të Shqipërisë, është: 1. parandalimi; 2. ripërdorimi; 3. riciklimi; 4. rikuperimi; dhe 5. trajtimi përfundimtar/asgjësimi. Kjo e detyron Qeverinë që të ndërmarrë politika dhe investime sipas prioriteteve që përcakton kjo hierarki, përkatësisht nga niveli 1 si më i larti e deri tek niveli 5 si më i ulti.

**17. Parandalimi.** Politikat dhe investimet do të duhet të synojnë që fillimisht të parandalohet gjenerimi i mbetjeve. Ky është prioritet absolut. Kjo bëhet nëpërmjet incentivave, apo taksave, dhe përgjithësisht ka një kosto ekonomike buxhetore afatshkurtër e afatmesëm, por që siguron një përfitim ekonomik dhe mjedisor afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Këtu qëndron sabotimi i parë (nr 1) që angazhimi me incineratorët i kanë bërë menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane në Shqipëri. Qeveria nuk ndërmerr hapa për reduktimin (parandalimin) e mbetjeve sepse ka detyruar Bashkitë që të nënshkruajnë kontrata me incineratorët, ku Bashkitë janë të detyruara të cojnë për djegie sasi të mëdha të mbetjeve. Nëse Bashkitë cojnë sasi më të vogla, incineratorët paguhet për mospërbushje të kontratës. Kjo bën që Qeveria mos të dëshmojë asnjë interes që të ndërmarrë politika të reduktimit/parandalimit të krijimit të mbetjeve. Nisma e Qeverisë për të hequr nga qarkullimi qeset plastike me spesor të hollë, u anulua që në fillimet e saj. E vetmja politikë e parandalimit e zbatuar është ajo e taksës mbi çdo qese plastike që marrin qytetarët në supermarketet. Edhe kjo masë ka dështuar. Në këtë mënyrë, angazhimi me incineratorët ka dëmtuar dhe sabotuar menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane dhe ka larguar Shqipërinë nga përmbushja e përputhshmërisë me BE-në.

**18. Ripërdorimi dhe Riciklimi.** Më pas, nga mbetjet që nuk arrijnë të parandalohen dhe rrjedhimisht gjenerohen, pjesa më e madhe e tyre duhet të synohet që të ripërdoren ose të riciklohen. Sipas Ligjit, riciklimi duhet të bëhet nëpërmjet “ndarjes së mbetjeve në burim”, pra nëpërmjet ndarjes që qytetarët dhe bizneset duhet të kenë mundësinë ta bëjnë përpara se mbetjet të grumbullohen nga Bashkia dhe sigurisht përpara se mbetjet të përfundojnë të përziera në impiantin e incinerimit apo të landfillimit (venddepozitimit si psh Sharra). Nëse mbetjetohen të pandara në incinerator apo në landfill, sic ndodh me mbetjet në çdo Bashki të Shqipërisë, ato nuk riciklohen dot më. Këtu qëndron sabotimi i dytë (nr 2) që veprimet e Qeverisë dhe disa Bashkive i kanë bërë menaxhimit të integruar të mbetjeve: nuk kanë krijuar mundësinë që qytetarët të bëjnë “riciklimin nëpërmjet ndarjes në burim”. Ndarja e mbetjeve në burim e con një pjesë të volumit dhe peshës së mbetjeve urbane drejtpërdrejt drejt bizneseve të riciklimit, dhe vetëm më një kosto fare minimale të ndarjes së materialeve nga njëra-tjetra. Ndarja në burim kursen buxhet publik dhe qytetar në dy mënyra. Mënyra e parë është nëpërmjet uljes së peshës/vëllimit të mbetjeve që Bashkitë cojnë në incinerator apo landfill. Sa më pak mbetje të cohen në incinerator apo landfill, aq më pak paguhet. Mënyra e dytë është kursimi për qytetarin. Duke çuar një pjesë të mbetjeve direkt tek bizneset e riciklimit, kjo gjeneron të ardhura për Bashkinë, dhe kjo krijon mundësinë që të ulet taksa përkatëse që paguan çdo familje. Njëkohësisht kjo krijon një reagim pozitiv tek qytetarët, duke çuar në rritjen e sasisë së mbetjeve që ndahen në burim dhe që riciklohen, duke krijuar një rreth vicioz pozitiv për uljen e kostos publike në tërësi për menaxhimin e mbetjeve.

**19.** Në përfundim, braktisja, nga ana e Qeverisë, e politikave për parandalimin dhe riciklimin e mbetjeve dhe për të mos e mbështetur ndarjen e tyre në burim, ka shkatërruar, njëherë e përgjithmonë, industrinë e riciklimit në vend. Kësisoj, një pjesë e impianteve të kësaj industrie, kaq të dobishme për mjedisin, në kushtet e thellimit të krizës mjedisore globale, kanë falimentuar.

**20. Rikuperimi.** Nëse mbetjet e cohen të pandara (*të padiferencuara*) në incinerator, siç ndodh në Shqipëri, këtu hyn në fuqi hallka e parafundit e hierarkisë, pra “rikuperimi”. Rikuperimi nënkupton që “nga mbetjet që nuk janë ripërdorur dhe as ricikluar, të përpiqemi të marrim (të rikuperojmë) çfarë të mundemi”. Rikuperimi nuk është i barazvlershëm as në kosto ekonomike dhe as në përfitim mjedisor me riciklimin. Procesi i rikuperimit ka kosto më të lartë ekonomike sesa procesi i riciklimit, dhe ka edhe efikasitet mjedisor shumë herë më të ulët se ai, sepse shumë materjale nuk rikuperohen dot më. Këtu qëndron edhe sabotimi dhe abuzimi i tretë (nr 3) që veprimet e Qeverisë dhe disa Bashkive bëjnë: përpara Komisionit Hetimor për Incineratorët dëshmitarët deklaruan që “riciklimi” bëhet në incinerator ose landfill, ndërkohë që kjo nuk është e saktë. Procesi që kryhet në incinerator është vetëm “rikuperim” dhe jo riciklim: riciklimi nuk bëhet as në incinerator as në landfill. Në hallkën e “rikuperimit” rikuperohet material dhe energji, pikërisht në këtë rend prioriteti ekonomik dhe mjedisor.

**21. Rikuperimi i materialit bëhet duke nxjerrë nga mbetjet ato pak materjale që nuk janë ricikluar.** Kur bëhet manualisht, eficienta e rikuperimit të materialit është shumë e ulët, dhe procesi kryhet thjesht formalisht, sepse shumica e materialit nuk rikuperohet dot. Procesi automatik i rikuperimit është më i kushtueshëm sepse nënkupton tharjen dhe copëzimin e mbetjeve dhe më tej ndarjen nëpërmjet proceseve speciale teknike: kjo nuk realizohet në Shqipëri në asnjë venddepozitim. Materiali që mund të rikuperohet në nivel disi më të lartë, janë metalet (alumin, hekur, bakër). Letra nuk rikuperohet dot, sepse për shkak të mosndarjes në burim ajo mbërrin e ndotur me mbetje të lagëta. Edhe një pjesë e mirë e materialit plastik nuk rikuperohet dot për të njëjtën arsye. Meqenëse incineratori e bazon rikuperimin e energjisë tek fuqia kalorifike e materialit, dhe meqë plastika është i vetmi material me fuqi kalorifike të lartë i mbetjeve, procesi i intereson që plastikën mos ta rikuperojë si material por ta djegë duke rikuperuar si energji. Sa më shumë material plastik të djegë incineratori, aq më pak energji duhet të fusë si input për procesin e djegies (naftë, ose energji elektrike). Kjo sjell dy pasoja negative. Së pari, ul eficientën mjedisore dhe ekonomike të incineratorit. Së dyti, djegia e plastikës rrit rrezikun e ndotjes me dioksina dhe furane, të cilët janë ndotësit kancerogjenë më problematikë të prodhuar nga njeriu.

**22. Ndërsa energjia rikuperohet nëpërmjet djegies (incinerimit) së mbetjeve të cilat as janë ripërdorur, as janë ricikluar, dhe as janë rikuperuar dot, duke prodhuar energji elektrike.** Eficienta e prodhimit të energjisë elektrike nga incineratorët konsiderohet e ulët. Incinerimi i mbetjeve nuk nënkupton zhdukje të mbetjeve: substanca ndotëse dalin nga oxhaku i incineratorit në formën e pluhurave, ndërkohë që substancat që rezultojnë nga djegia janë edhe hirit toksike të cilat kanë nevojë të trajtohen me kujdes duke kaluar në hallkën e fundit që është “trajtimi përfundimtar/asgjësimi”, dhe posaçërisht tek “landfillimi” ose depozitimi. Gjatë procesit të incinerimit, emetohen këta ndotës në ajër: grimca të ngurta pezull, monoksid karboni, acid klorhidrik, dioksid sulfuri, dioksina, furane, hidrokarbure policiklike, metale të rënda si kadmium, plumb dhe merkur, etj. Këta janë ndotës problematikë deri në vdekjeprurës.

**23. Trajtimi përfundimtar/asgjësimi.** Hallka e fundit e hierarkisë së mbetjeve është “trajtimi përfundimtar/asgjësimi”. Kjo hallkë nënkupton dy procese, të lidhura ose të ndara nga

njëri-tjetri: 1) “djegien pa rikuperim energjie” e cila në Shqipëri nuk realizohet, sepse incineratorët në Shqipëri do të djegin duke prodhuar energji, dhe 2) “depozitimin” i cili në Shqipëri njihet si “landfillimi”. Landfillimi nënkupton depozitim në një hapësirë (gropë ose qelizë) të madhe e cila është shtruar në të gjithë sipërfaqen e poshtme me materjale izoluese që mbron tokën nga ndotja. Kur vëllimi i kësaj hapësire ezaurohet, atëherë ajo mbulohet me materjale izoluese, garantohet nxjerrja e vazhdueshme e gazit metan nga brendësia nëpërmjet puseve, dhe mbulohet me dhe’, dhe mund të rregullohet estetikisht duke e mbjellë me pemë të ulëta.

**24.** Këtu qëndron edhe abuzimi i katërt (nr 4) nga ana e Qeverisë dhe Bashkive. Kështu, për rastin e Tiranës dëshmitarët kanë bërë deklaram se “në Tiranë bëhet tashmë një proces i ndryshëm nga ai i mëparshmi, sepse tashmë kemi landfillim dhe jo thjesht depozitim”, ndërkohë që kjo është e njëjta gjë. Landfillimi dhe depozitimi janë sinonime. Kjo është lojë termash, që synon të mbulojë të vërtetën. E vërteta është se në Sharrë mbetjet që prej vitit 2009 depozitoheshin në “landfill” të sanitarizuar, pra landfill të rregullt. Edhe aktualisht mbetjet sërish depozitohen në të njëjtën mënyrë, pra në landfill. Operatori pretendon se kur të vihet në punë incineratori mbetjet do të rinxirren nga qelizat (sektorët) e landfillit dhe do të digjen. Në realitet ky proces i dyzuar është shumë i vështirë teknikisht për t’u realizuar, dhe pa asnjë sens ekonomik, dhe rrjedhimisht ka dyshime të forta se mund të mos realizohet. E vetmja ndërhyrje që është bërë në Sharrë është ndërhyrja estetike e mbjelljes së pemëve mbi qelizat e ezauruara dhe të mbyllura të venddepozitimit të Sharrës.

**25.** Në hallkën “trajtimi përfundimtar/asgjësimi” qëndron edhe abuzimi i pestë (nr 5) që bëhet me trajtimin e mbetjeve. Ky ka të bëjë me faktin se në Shqipëri nuk ka ende një venddepozitim të mbetjeve të rrezikshme ku të mund të depozitohet hiri toksik që rezulton nga incinerimi. Pasi mbetjet e ngurta urbane incinerohen, prodhohen dy lloj mbetjesh (ose hi): 1. Skorjet nga djegia (ose hiri i rëndë), të cilat në varësi të përbërjes merceologjike të mbetjeve që incinerohen, dhe në varësi të teknologjisë së incineratorëve, janë rreth 10-12% i vëllimit dhe 15-20% e peshës së mbetjeve të djegura. Skorjet mund të depozitohen në landfille të zakonshme, por me ambalazh special. 2. Hiri që rezulton nga trajtimi dhe kapja e tymrave të oxhakut (ose hiri i lehtë), i cili përbën rreth 5% të peshës së mbetjeve të djegura. Ky hi konsiderohet si “mbetje speciale shumë toksike” dhe duhet patjetër të depozitohet në “landfill të mbetjeve të rrezikshme”. oksik dhe kalsifikohet zyrtarisht si “mbetje e rrezikshme”. Këto dy lloj hiresh që rezultojnë nga incinerimi nuk duhen përzier por duhen trajtuar në mënyrë të veçantë.

**26.** Në kushtet kur në Shqipëri nuk ka një landfill publik të mbetjeve të rrezikshme, këto mbetje duhet të depozitohen jashtë vendit. Mbetjet për t’u verifikuar nëse incineratori i Elbasanit ka bërë depozitim të këtyre mbetjeve të rrezikshme në landfille speciale jashtë vendit, apo ka përdorur landfillin e zakonshëm që ka brenda hapësirës së vet për të depozituar edhe këto mbetje të rrezikshme. Në fund të procesit të incinerimit emetohen këta ndotës në ajër: grimca të ngurta pezull, monoksid karboni, acid klorhidrik, dioksid squfuri, dioksina, furane, hidrokarbure policiklike, metale të rënda si kadmium, plumb dhe mërkur, etj. Këta janë ndotës problematikë deri në vdekjprurës, dhe për rrjedhim, Leja mjedisore për ushtrim të aktivitetit të incinerimit për

këta subjekte duhet të jepet pas një procedure mjaft të kujdesshme verifikimi dhe certifikimi të teknologjisë. Ky aktivitet ka risk të lartë të ndotjes.

**27.** Në perspektivën e vendimmarrjes strategjike, administrimi i mbetjeve urbane, përmes një opsioni të vetëm, jo proporcional, “incinerimit”, në kushtet e mungesës së ndarjes së mbetjeve në burim dhe në kushtet kur riciklimi aplikohet në nivele tepër të ulëta të një informaliteti të lartë, me pasoja jashtëzakonisht negative për ekonominë qarkulluese të vendit, një praktikë e cila bie ndesh me dokumentet strategjike të sektorit të mbetjeve, ky administrim rezulton i papërqasur me prioritetet e BE-së. Kjo qasje do të duhej të ishte trajtuar me një studim “Vlerësim Strategjik Mjedisor” (Strategic Impact Assessment), sepse është një proces planifikues. Kjo qasje do të duhej të ishte diskutuar me të gjithë aktorët e interesit dhe me publikun, bazuar në Konventën e Aarhus dhe në të gjithë dokumentat që garantojnë të drejtën e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe jo të kufizohej vetëm në një rreth të ngushtë burokratësh e biznesmenësh, çka, sipas hetimit, rezultuan të ishin të vetmit përfitues të parave publike.

**28.** Opsioni “incinerator” është opsioni më i shtrenjtë që në fazën e ndërtimit. Ky vendim është justifikuar me argumentin se në strategjitë e BE-së preferohet incinerimi (djegia) ndaj landfillimit (depozitimit). Kjo është e vërtetë për shumë vende të BE-së, por nuk mund të jetë e vërtetë për Shqipërinë. Shqipëria ka mjaftueshëm zona të përshtatshme nga pikëpamja litologjike (e përbërjes së shkëmbinjve) dhe strukturore (mënyra e vendosjes së shtresave shkëmbore ndaj njëra tjetrës), si dhe që janë larg qendrave të mëdha të banuara, për të mundur të krijojë një rrjet efikas të landfillleve. E kombinuar kjo lëvizje dhe me një nxitje të procesit të ndarjes së mbetjeve në burim nga qytetarët, nëpërmjet incentivave ekonomike por edhe masave ndëshkuese për shkeljet, do ta bënte opsionin “landfill” më të leverdishmin nga pikëpamja ekonomike dhe më efikasin edhe nga pikëpamja mjedisore dhe e zhvillimit të qëndrueshëm.

**29.** Opsioni “incinerator” është i shtrenjtë në ndërtim, por është edhe më i shtrenjtë në operim. Kostoja e djegies së mbetjeve në incinerator normalisht, si në cdo vend të botës, do të duhej të përballohet nga qytetari dhe komunitetet përkatëse. Në Shqipëri kjo është kamufluar me idenë që “kosto për qytetarin është zero”, ndërkohë që Qeveria i paguan dhe do t’i paguajë incineratorët me fonde publike, në mos për ndërtimin, të paktën për operimin. Kjo është e njëjta gjë: një çmim artificialisht i lartë për cdo ton mbetje që incinerohet, do të arrijë të mbulojë pa asnjë problem për operatorët privatë “të partneritetit” edhe koston e ndërtimit të një incineratori, për të cilin nuk është vendosur asnjë kusht teknik paraprak për cilësinë e teknologjisë. Nga ana tjetër, ky subvencionim nga ana e Qeverisë për cdo ton mbetje që incinerohet, nuk mund të vazhdojë përgjithmonë. Herët a vonë, komunitetet lokale do të detyrohen të përballen me kostot e incinerimit sipas kontratave që kanë nënshkruar. Kjo nuk është konsultuar me këto komunitete, kështu që ato do të gjenden para faktit të kryer.

**30.** Për më tepër, gjatë kësaj kohe këto komunitete nuk janë nxitur të riciklojnë nëpërmjet ndarjes së mbetjeve në burim. Nëse do të ishin nxitur, kjo do të conte të paktën në një ulje të sasisë së mbetjeve që do të duhej të çoheshin në incinerator. Kur këto komunitete të gjenden në kushtet kur do të duhet të paguajnë vetë kostot e incinerimit, do të gjenden përpara dy opsioneve: ose të

rrisin taksën vjetore të trajtimit të mbetjeve për cdo familje, ose të kthehen sërish tek abuzimi mjedisor duke i depozituar në mënyrë kriminale mbetjet në zona të paautorizuara. Prandaj trajtimi i mbetjeve vetëm me incineratorë, është konsideruar për Shqipërinë si një “bombë me sahat: ekonomike, sociale, dhe mjedisore”.

**31.** Së fundi, në procese të tilla delikate nga pikëpamja mjedisore, një Qeveri, në kushtet kur mungonte ekspertiza e deriatëhershme lidhur me incenerimin e mbetjeve, duhej të kujdesej veçanërisht për interesin publik, dhe të vendoste kriteret rigoroze, të cilat në “Politikat e Mjedisit” njihen si “standartet e procesit”. Një nga standartet më të suksesshme kur bëhet fjalë për sektorë problematikë dhe për sektorë me risk ndotjeje, është standardi BAT-EE. Standardi “best available technology & economically efficient” mund të ishte aplikuar edhe nga Qeveria shqiptare në rastin e incineratorëve. Ky standard do të kishte detyruar operatorët investitorë që të garantonin instalimin në Shqipëri të incineratorëve me “teknologjinë më të mirë të arritshme, dhe ekonomikisht eficientë”, të certifikuar nga ISO. Nëse kjo do të ishte bërë, të paktën do të ishte shmangur debati mbi ndotjen e rëndë të shkaktuar nga këto impiante të rëndësishme për sa i përket impaktit në mjedis. Mosadoptimi i këtij standardi rrezikon instalimin në Shqipëri të impianteve me teknologji të prapambetur apo të pacertifikuar.

## B. RAPORTI ME TË DREJTËN E BE-SË

**32.** Qeveria Shqiptare është angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe në këtë drejtim, Ministria e Mjedisit ka punuar për përputhjen e instrumenteve kryesore të legjislacionit të BE në instrumente ligjore shqiptare. Legjislacioni kryesor nga Bashkimi Europian që ka të bëjë me mbetjet është Direktiva Kuadër e Mbetjeve, nr. 2008/98/KE mbi mbetjet adaptuar në Nëntor të Vitit 2008, e cila parashikon: “[...] një qasje të re mbi administrimin e mbetjeve, bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin si dhe duke synuar kufizimin e prodhimit të mbetjeve si dhe nxitjen e përdorimit të mbetjeve si burim nga riciklimi dhe rikuperimi. [...]”

**33.** Direktiva krijon një hierarki mbi mbetjet dhe shtron pyetje mbi procesin e transferimit të përshtatjes së legjislacionit. Ajo ka për qëllim të përmirësojë parandalimin e ndotjes duke paraqitur programe parandalimi të mbetjeve si një instrument politik për shtetet anëtare. Riciklimi dhe përpunimi i mbetjeve po promovohet me objektiva, si kriteret e mbledhjes së vecuar dhe efikasiteti i energjisë së rinovueshme. Kjo direktivë parashikon një hierarki të metodologjisë së trajtimit të mbetjeve duke filluar me parandalimin, minimizimin, ripërdorimin, riciklimin, dhe në fund të kësaj hierarkie është rigjenerimi i energjisë dhe hedhja.

**34.** Përsa më sipër, kjo direktivë, mbetet e fokusuar në parandalimin e prodhimit të mbetjeve duke vendosur edhe objektiva dhe tregues të synuar të cilat do të ndihmojnë vendet e BE-së për tu zhvendosur drejt një shoqërie ricikluese dhe jo djegëse dhe groposje të mbetjeve.

**35.** Sipas raporteve të BE, ka përfitime shumë më të mëdha nga riciklimi në përgjithësi në krahasim me metodën e incenerimit si psh: (i) zvogëlon nevojën për hapsira të landfill-it; (ii)



kursen taksat; (iii) kursen harxhimit e energjisë me 2/3; (iv) zvogëlon ndotjen; (v) mbron burimet tona të pamjaftueshme; (vi) e bën botën një vend më të pastër për të jetuar. Reciklimi sipas BE kontribuon në togun e madh të mbetjeve duke i ndarë ato që në banesë, njësi shitje dhe shërbim ambulant.

**36.** Në vijim, dispozitat paraprake të Direktivës sipërcituar theksojnë se incenerimi është metoda e djegjes së mbetjeve me anë të oksigjenit të ajrit. Në administrimin modern të mbetjeve kjo metodë përdoret për materialet jo të riciklueshme dhe jo të ripërdorshme. Për shkak të hirit të lartë të prodhuar dhe kostot e larta të këtij procesi, vendet e BE e përdorin metodën e incenerimit vetëm pasi kanë ritur kapacitetet e tyre recikluese dhe ndarjen e mbetjeve urbane në burim.

**37.** Referuar sa më sipër, në vecanti hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve urbane të Direktivës 2008/98/KE e pasqyruar kjo edhe në Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve edhe në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, zgjedhja e impiantit të përpunimit të mbetjeve duhet të jetë alternativa e para-fundit dhe e fundit për tu përzgjedhur. Është e paqartë se si qeveria, në mungesë të një studimi të mirëfillt mjedisor ka justifikuar faktin se pse janë kapërcyer tre hapat e parë të parashikuar nga Direktiva sipërcituar SKMM dhe PKMM, si dhe arsyet pse ndërtimi i një impianti për përpunimin e mbetjeve përmes djegjes është zgjedhja më e mirë ekonomike. Edhe në kontekstin financiar, metoda më kosto-eficente e propozuar nga BE është ajo e landfill-it e shoqëruar me reciklim por edhe kjo metodë nuk është zgjedhur nga qeveria Shqipëtare duke shkelur kështu qasjen e Direktivës së Be por edhe të vetë dokuemtave Strategjisë të Shqipërisë për menaxhimin e mbetjeve.

**38.** Edhe po ti referohemi raportit të KLSH-së, në vecanti analiza kosto-përfitim, konkludojmë se kjo metodë ndiqet gjerësisht nga vendet e BE dhe vendet e tjera të zhvilluara. Kjo metodë përveçse respekton të gjitha normat sociale dhe mjedisore do t'i sillte investitorit rreth 32 milion euro përfitime dhe të ardhura në 20 vite. Në këtë vlerë llogaritet vlera që do të përfitohej nga shitja e materialeve të riciklueshme por edhe reduktimi i kostove nga shmangia e dëmeve sociale e mjedisore.

## II. PRONËSIA E KOMPANIVE

**39.** Zanafilla e aferës së inceneratorëve do të ngjante e pakuptueshme nëse në këtë pjesë të parë të analizës nuk do të ndaleshim tek kush ishin tre kompanitë që iniciuan tre projektet në Elbasan, Fier dhe Tiranë, dhe mbi të gjitha kush ishin pronarët e këtyre tre kompanive. Faktet, dokumentet, dëshmitë tregojnë se në fakt janë gjithmonë të njëjtin njerëz, të njëjtat mekanizma, të njëjta lidhje korruptive dhe praktika të paligjshme. Formalisht, pronarët e inceneratorëve janë tre: Mirel Mërtiri, Klodian Zoto dhe Stela Gugallja. Por, e vërteta është se kryeparonari i inceneratorëve është vetëm shtetasi Mirel Mërtiri, ndërsa shtetasi Klodian Zoto është vartësi i tij, dhe shtetasja Stela Gugallja, është bashkëjetuesja e tij. Megjithëse pra, ky shtetas herë përpiqet të fshihet pas një kompanie holandeze, herë pas dy kompanive italiane, e herë pas një kompanie malteze, ai është gjithmonë i njëjti dhe shfaqet kudo sa herë që flitet për destinin e miliona eurove të përfituara nga afëra e inceneratorëve.

**40.** Mirel Mërtiri, një person me lidhje të forta politike, në bashkëpunim me ish bashkëpunëtorë të tij që më vonë u shndërruan në aksionerë të disa kompanive duket se ideoi një skemë të madhe fitimprurëse për bizneset dhe aleatët e tij politikë në kurriz të taksave të shqiptarëve. Pikërisht nga kjo treshe e suksesshme që herë rezultojnë të përfshirë në ortakëri e herë të tjera në administrim duket se lindi “ideja brilante” për t’i propozuar ministrit të Mjedisit, Lefter Koka ndërtimin e tre inceneratorëve. Pikërisht kjo ide tyre jo vetëm u gjet “shumë interesante” për interesin publik, por të gjitha institucionet qendrore dhe vendore u vunë në dispozicion të tij, për të implementuar “gjetjen e shekullit”. Ndonëse kjo gjetje rezultoi të jetë në kundërshtim të plotë me Direktivat e BE-së dhe padyshim e parë me skepticizëm në shumë vende që e kishin refuzuar me vendosmëri për shkak të pasojave që prodhonte në mjedis dhe shëndetin e njerëzve. Kushdo tashmë mund të ketë ngritur pyetjen se si ka mundësi që gjithë shteti vihet në funksion të tre persoaneve. Dhe në fakt kjo është një pyetje e drejtë sepse kur lexon aktet,

dokumentet dhe dëshmitë, shikon se si funksionarë publikë që kishin refuzuar me vendosmëri projektin, papritur “reflektojnë” dhe e miratojnë.

**41.** Përgjigja e Komisionit Hetimor, Prokurorisë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, medias dhe qytetarëve, duhet kërkuar në fakt të lidhjet e këtyre personave që aktualisht janë të akuzuar dhe ndaj tyre ka një masë sigurie personale me persona që mbajnë funksione të larta qeveritare, njëri prej të cilave rezulton të jetë deputeti, ish-ministri i Ekonomisë, ish-ministri i Financave, ministrit i Shtetit për Rindërtimin dhe zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj. Faktet që do të paraqesim në vijim dëshmojnë për njohjen e vjetër dhe marrëdhënien e konsoliduar të shtetasve nën hetim Mirel Mërtiri dhe Klodian Zoto me Ministrin e Kallëzuar në SPAK, çka në fakt edhe publikisht nuk është mohuar asnjëherë nga ministri Ahmetaj. Një lidhje tjetër dhe njohje e vjetër e personave të dyshuar dhe në arrati Zoto dhe Mërtiri, por vecanërisht e shtetasit Klodian Zoto është edhe ish-ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, deputeti dhe sekretari i përgjithshëm i Partisë Socialiste, Damian Gjikhuri.

**42.** Dyshja Ahmetaj – Gjikhuri duken pra, të jenë mrekullibërësit e transformimit të Mërtirit dhe Zotos në biznesmenët më të mëdhenj dhe të fuqishëm në vend. Dhe kjo jo për zemërgjërësi apo bujari, por për shkak të interesave të pastra korruptive dhe financiare që i lidhin këta shtetas me njëri-tjetrin. Mundësitë e Komisionit Hetimor për t’i shkuar më tej kësaj të vërtete të madhe, ishin të kufizuara dhe u penguan vecanërisht nga avokatët e aferës së inceneratorëve në Komision, institucione publike dhe bankat e nivelit të dytë. Megjithatë, një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i Prokurorisë Speciale, organit të akuzës, SPAK mund të zbardhë të plotë interesat që i lidhin fort me njëri-tjetrin Mirel Mërtirin, Klodian Zoton, Arben Ahmetaj dhe Damian Gjikhurin dhe të gjithë anëtarët e kabinetit qeveritar që qartësisht kanë vendosur në dispozicion qeverinë dhe institucionet shtetërore për të kryer abuzime me paratë e buxhetit të shtetit.

**43.** Një ndihmë vecanërisht e madhe mund t’i vijë SPAK-ut nëse do të fokusohet te hetimi i udhëtimeve të përbashkëta që kanë realizuar shtetasit nën hetimi me Ministrat e Kallëzuar nga PD, vendeve ku kanë qëndruar, llogarive Bankare që kanë hapur dhe ku kanë përfunduar paratë e këtyre llogarive, aktivitetet që kanë kryer. Ndjekja e intenerarëve të udhëtimit së bashku me paratë e transferuara do të ishte në dobi të këtij hetimi nga SPAK për të hedhur dritë mbi këtë aferë. Për aq sa ka mundur, Komisioni do të përpiqet të hedhë dritë mbi këto lidhje nëpërmjet analizës në vijim të pronësisë së kompanive të inceneratorëve.

#### A. INCENERATORI I ELBASANIT

**44.** Në 04.07.2014, Qazim Sejдини, Kryetar i Bashkisë Elbasan, i dërgon Lefter Kokës, Ministër i Mjedisit, shkresën “Kërkesë emergjente për zgjidhje koncesionare/ppp” duke bërë fakt të kryer procedimin me Koncesion/PPP dhe jo procedurë prokurimi, madje duke dhënë edhe karakteristika të impjantit.

**45.** Brenda 5 ditësh, në datë 10.07.2014, themelohet shoqëria Albtek Energy sh.p.k, me NIPT L41914013H, me administrator dhe zotërues shtetasen Stela Gugallja, me kapital themeltar

100.000 lekë dhe me objekt të veprimtarisë “Ndërtim i impianteve të trajtimit të mbetjeve me djegie (Inceneritor). Ndërtim, konstruksion dhe punime restaurimi, të objekteve civile, industriale, tregtare, turistike, shëndetësore, kulturore, sportive, vepra kullimi dhe vaditje, infrastrukture, shërbime komunale, projektim i objekteve të treguara me sipër. Instalimi i linjave dhe kabinave elektrike të Tensionit të Ulet”. Më datë 16.04.2015, u shtua objekti i aktivitetit me: “Zhvillimin e veprimtarisë minerare me punime sipërfaqësore dhe nëntokësore” dhe më datë 20.08.2015, u shtua objekti i aktivitetit me: “Transport e punë me lëndë plasëse”. Adresa e ushtrimit të aktivitetit Njesia Bashkiake nr.5, Rruga "Ibrahim Rugova", Sky Toëer, kati 13, zyra 13/2 (e njëjta adresë fizike me Inceneratorin e Fierit), e cila u ndryshua në Impianti i perpunimit te mbetjeve urbane, Nenstacioni Elektrik, FusheMbret, Zona Kadastrale 8526, Nr pasurie 407/23 dhe Zona Kadastrale 2124, Nr pasurie 600/8.

**46.** Sipas të dhënave të bilanceve të shoqërisë, Albtek Energy sh.p.k ka pasur xhiro vjetore dhe fitim para tatimit si më poshtë:

Në vitin 2015 ka pasur xhiro vjetore 763.986.844 lekë dhe fitim para tatimit – 123.487 lekë

Në vitin 2016 ka pasur xhiro vjetore 527.996.498 lekë dhe fitim para tatimit 54.962.825 lekë

Në vitin 2017 ka pasur xhiro vjetore 1.305.218.064 lekë dhe fitim para tatimit 99.740.008 lekë

Në vitin 2018 ka pasur xhiro vjetore 507.466.137 lekë dhe fitim para tatimit 61.518.534 lekë

Në vitin 2019 ka pasur xhiro vjetore 489.094.746 lekë dhe fitim para tatimit 34.849.520 lekë

Në vitin 2020 ka pasur xhiro vjetore 490.903.360 lekë dhe fitim para tatimit 48.773.268 lekë

**47.** Një muaj nga themelimi, në datën 11.08.2014, shoqëria Albtek Energy sh.p.k, me zero përvojë në fushën e trajtimit apo incenerimit të mbetjeve dhe me kapital 100.000 lekë, i paraqet Ministrisë së Mjedisit “Kërkesë për shprehje interesi për koncesion/ppp”, shoqëruar me një projekt paraprak prej 4 fletësh, hartuar në datë 26.06.2014 nga shoqëria Integrated Technology Services sh.p.k, në zotërim 100% nga shtetasi Klodian Zoto, vetëm një javë para kërkesës emergjente për zgjidhje koncesionare/ppp të Bashkisë Elbasan, drejtuar Ministrisë së Mjedisit.

**48.** Në kërkesën për shprehje interesi për koncesion/ppp, shoqëria me kapital themeltar 100.000 lekë, angazhohej për investim 22 milionë euro dhe për ndërtim impianti që do të përballonte 120 – 140 ton mbetje në ditë.

**49.** Në datën 27.10.2014, shoqëria Albtek Energy sh.p.k i paraqet Ministrisë së Mjedisit studimin teknik i impiantit, përgatur nga Ernesto Granelli (del edhe tek Inceneratori i Fierit dhe Tiranës), të dhënat e të cilit do të përdoren më pas pa asnjë ndryshim në Dokumentat Standarte të Tenderit nga Ministria e Mjedisit dhe projektin (përmbledhje) tekniko – financiar hartuar nga shoqëria Integrated Technology Services sh.p.k, në zotërim 100% nga shtetasi Klodian Zoto.

**50.** Në nëntor 2014, me kërkesë të shoqërisë Albtek Energy sh.p.k, hartohet Raporti Paraprak i Vlerësimit në Mjedis, hartuar nga ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS sh.p.k, me NIPT K81317002P, me administrator dhe pronar shtetasen Elidiana Shehu. Po e njëjta shoqëri, në dhjetor 2014, harton edhe studimin e fizibilitetit. Me date 26.06.2020, me anë të Urdhrit Nr.421 Prot, lëshuar nga përmbarues privat drejtuar QKB, u

urdherua vendosja e masës se sekuestros ne kuotat e palës debitore në subjektin Albtek Energy sh.p.k kërkuar nga shoqëria EMC Studio sh.p.k. Edhe pse kjo e fundit ka hartuar për llogari të shoqërisë koncesionare Raportin Paraprak të Vlerësimit në Mjedis dhe studimin e fizibilitetit nuk është pagaur nga shoqëria Albtek Energy sh.p.k sepse ajo nuk dispononte asete apo kapitale financiare. Më datë 02.07.2020, me anë të Urdhrit Nr.375 Regj, Nr.449 Prot "Urdhër për heqjen e sekuestros konservative", u urdherua heqja e masës së sekuestros konservative nga aktivet e pales debitore.

**51.** Në datën 27.11.2014, shoqëria Albtek Energy sh.p.k., lidh “Kontratë me çelësa në dorë” me shoqërinë Energy Recuperator spa, e cila parashikon se, objekti do të ndërtohet në Elbasan, sipërmarrësi do të ndërtojë impiantit e inceneratorit dhe se çmimi i ndërtimit të impiantit është 15 milionë euro, që sipas librave të shitjes së shoqërisë koncesionare, rezulton të jetë zhdoganuar në vlerën 7 milionë euro. Kontrata për ndërtimin e impiantit lidhet nga shoqëria Albtek Energy sh.p.k, pa u shpallur fituese dhe nënshkruar kontratën koncesionare me Ministrinë e Mjedisit, duke pasur siguri për lidhjen e kontratës, siguri e cila faktohet nga angazhimi kontraktualisht me të tretë në funksion të projektit përpara lidhjes së kontratës. Qartazi shoqëria Albtek Energy sh.p.k nuk ka asnjë përvojë në fushën objekt koncesioni dhe i ka paraqitur Autoritetit Kontraktor si kontrata të ngjashme ato të shoqërisë Energy Recuperator spa, të cilat janë të papërkthyer dhe të panoterizuara.

**52.** Energy Recuperator sh.p.k, me NIPT L61703006L, është degë e shoqërisë së huaj Energy Recuperator spa, regjistruar në shqipëri në datën 03.05.2016 dhe përfaqësuar nga shtetasit Ernesto Granelli (hartues në 27.10.2014 i studimit teknik të impiantit) dhe Mario Granelli, shoqëri të cilën e gjejmë edhe tek Inceneratori i Fierit dhe Tiranës. Kjo shoqëri ka si objekt të veprimtarisë “Ndertimin, instalimin, shitjen dhe perfaqesimin e produkteve dhe te impianteve elektrike dhe elektronike dhe gjithsesi te sistemeve te nderlidhura, te integruara dhe te rendesishme dhe/ose te nderveprimimit; Projektimi, instalimi, mirembajtja dhe asistenca per impiantet industriale dhe civile te kondicionimit, ngrohjes, prodhimit dhe kursimit te energjise; Tregtimin ne te gjitha format e tregtimit me shumice dhe me pakice si edhe blerja e perfaqesive te shoqerive italiane apo te huaja, te te gjitha prodduketve, makinerive dhe pajisjeve qe kane lidhje me kete sektor; prodhimi i energjise, ne te gjitha format e saja, tregtimi, shitja, shperndarja, transmetimit te energjise apo transmetues te energjise te cfaredo lloj natyre; menaxhimi edhe per llogari te paleve te treta ose ne menaxhimin e nje pale te trete te objekteve te prodhimit apo rckuperimit te energjise, te bashkeprodhimit, te dyja mundesuar nga burime konvencionale dhe nga burimet e ripërteritshme dhe te perziera. Shoqeria mund te marre dhe te pranoje agjenci, komisione, perfaqesime, me ose pa depozite, dhe mandate, te bleje, te perdore dhe transferoje patenta dhe vepra te tjera te inteligjences (gjentut) njerezore, te kryer kerkime te tregut dhe perpunimin e te dhenave nga llogari te vet dhe per palet e treta, te jape dhe te marre licencat e shfrytezimit tregetar, si dhe permbushjen e te gjitha operacioneve komerciale (duke perfshire importin dhe eksportin), financiare, te pasurive te luajtshme dhe pasurive te paluajtshme, te nevojshme apo te dobishme per permbushjen e objektit (qellimit) te shoqerise. Ne menyre strumentale per arritjen e qellimit te objektit te shoqerise dhe ne cdo rast ne rruge jo prevalente, shoqeria mund: te kryeje te gjitha operacionet e pasurive te luajtshme, te pasurive te patundshme, tregetare, industriale dhe financiare qe konsiderohen te

dobishme nga Keshilli i Administrimit per arritjen dhe permbushjen e shoqerise, duke perfshire edhe leshimin e garancive re”.Adresa e ushtrimit të aktivitetit “Njesia Nr. 4, Rruag 5 Maji, Kompleksi Concorde Center, Kulla III, SHkalla II, Kati 5, Ambjenti 29”, e cila është e njëjta adresë me shoqërinë E.R One Albania shpk.

**53.** Shoqëria E.R One Albania shpk, me NIPT L61629037G, themeluar në 29.04.2016, me administrator Mirel Mërtiri, dhe pronarë Stela Gugallja (40%) dhe Energy Recuperator - Ernesto Granelli (60%), me objekt aktiviteti “Import eksport te materialeve te ndryshem qe kane lidhje me objektin e veprimtarise. Import eksport e tregtim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem industrial te perdorimit te gjere, telekomunikacion, aktivitete komisionimi, tregti te pergjithshme, sherbime konsulence instalime dhe ngritje terminalesh, ndertime dhe punime civile te ndryshme. Ndertim Hidrocentrale dhe Termocentrale te kapaciteteve te ndryshme. Prodhim, montim dhe tregti me shumice dhe pakice i paneleve per prodhimin e energjise diellore, dhe aksesoreve te tyre brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Trajtim i mbetjeve te ndryshme, organike dhe te ngurta. Instalimi i linjave dhe kabinave elektrike te Tensionit te Ulet. Zhvillimin e veprimtarise minerare me punime siperfaqesore dhe nentokesore. Transport e pune me lende plasese.Perpunim, trajtim, menaxhim dhe transport te mbetjeve. Ndertimi, instalimi, shitja dhe prezantimi i produkteve dhe impianteve elektrike dhe elektronike apo te sistemeve lidhese te integruar apo perberes. Ndertimi instalimi, mirembajtja, dhe asistenca e impianteve industriale dhe civile te kondicionimit ngrohjes per prodhimin dhe kursimin e energjise. Tregtimi brenda dhe jashte vendit i te gjitha produkteve, makinerive dhe pajisjeve te tjera te kesaj fushe. Prodhimi i energjise ne te gjithë format e saj. Distribuimi, tregtimi i transportimi i energjise, transportuesve te energjise te te gjithë natyrave”, me adresë fizike Njesia nr. 4, Rruga 5 Maji, Kompleksi Concord Center, Kulla III, Shkalla II, Kati 5, Apartamenti 29, e njëjta adresë me shoqërinë Energy Recuperator.

**54.** Bazuar në procesverbalin mbi fillimin e punimeve, procesverbalin mbi piketimin e objektit dhe akt dorëzimin e sheshit të ndërtimit, të datës 05.03.2015, shtetasi Klodian Zoto, firmos në cilësinë e sipërmarrësit dhe shoqëria Albtek Energy sh.p.k në cilësinë e investitorit.

**55.** Sipas Dokumentave Standarte të Procedurës Koncesionare, shoqëria që të kualifikohet fituese duhet të sigurojë ofertën në masën 10% të vlerës së investimit si dhe të sigurojë garanci për financim nga banka. Lidhur me sigurimin e ofertës në masën 10%, shoqëria Albtek Energy sh.p.k nuk e ka përmbushur bazuar në Formularin e Sigurimit të Ofertës, datë 15.12.2014 (një ditë para përfitimit të kontratës koncesionare), ku oferta është siguruar në masën 450.000 mijë euro dhe jo 2.16 milionë euro (10%) si dhe lidhur me garancinë për financimin nga banka, Veneto Bank (Gruppo Veneto) i përgjigjet se lidhur me kërkesën për financim, mbetet në pritje të përfundimeve të negociatave me autoritetin kontraktor si dhe të aspekteve kontraktore, me qëllim përcaktimin e ndëryrjes së saj eventuale, pra banka nuk ka dhënë garanci të plotë për financimin e projektit, ndërkohë ditën e firmosjes së kontratës, datë 16.12.2014, kthen përgjigje se mer në konsideratë financimin.

**56.** Më datë 29.06.2015 (6 muaj pas përfitimit të kontratës koncesionare), asambleja e përgjithshme e shoqërisë ka vendosur marrjen e kredisë pranë Bankës Credins duke caktuar si

përfaqësuese të shoqërisë Stela Gugallja për të kryer veprimet në lidhje me marrjen e kredisë. Me anë të marrëveshjes siguroese Nr.8975 Rep. Nr.2686 Kol., datë 17.09.2015, shoqëria Albtek Energy sh.p.k do të vendosë si garanci në favor të Bankës Credins sha për kthimin e kredisë (i) 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë ALBTEK ENERGY Sh.p.k (ii) Kontratë konçesioni e formës BOT për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan, nr. 11026/7 Prot, datë 16.12.2014 dhe (iii) Kontratë furnizimi me “çelësa në dorë” nr. 14-E-009, datë 18.06.2015, me objekt furnizim me çelësa në dorë të impiantit të përpunimit termik të mbetjeve urbane me fuqi për prodhim të energjisë elektrike 2.85 MV në Elbasan, sipas faturave që do i bashkëlidhen kësaj kontrate.

**57.** Më 27.05.2015, Bashkia Elbasan i kërkon shoqërisë A.L.T.E.A. & GEOSTUDIO 2000 sh.p.k, NIPT J62026003M, në pronësi të shtetasit Skender Allkja, të realizojë projektin e zhvendosjes së mbetjeve të ngurta dhe rishikimin e studimit. Më datë 29.06.2015, Bashkia Elbasan i dërgon kërkesë zyrtare Ministrisë së Mjedisit për realizimin e projektit të zhvendosjes së mbetjeve, sistemin e bonifikimit e lanfillit ekzistues, ku Bashkia Elbasan pranon bashëpunimin me A.L.T.E.A. & GEOSTUDIO 2000. Në qershor 2015, kjo shoqëri harton edhe Relacionin Teknik dhe Raportin mbi kushtet gjeologjike dhe inxhinjerike. Për të gjitha projektet e sipërcituara, nuk ka asnjë procedurë prokurimi nga Bashkia Elbasan, ndërkohë nga librat e blerjes së shoqërisë Albtek Energy sh.p.k, rezulton se kjo shoqëri në vitin 2015 ka përfituar pagesa në vlerën 2.558.700 lekë.

**58.** Më datë 31.01.2019, me vendim të asamblesë së ortakeve, u rrit kapitali i shoqërisë më shumë 6.500.000 lekë. Si rezultat, kapitali i shoqërisë bëhet 6.600.000 lekë.

**59.** Shoqëria Albtek Energy sh.p.k ka lidhur kontrata nënkontraktimi me shoqëritë Consulting SE Partners sh.p.k, Zoto Consulting sh.p.k dhe Integrated Technology Services sh.p.k.

**60.** Shoqëria Consulting SE Partners sh.p.k, me NIPT L72206029G, themeluar në 23.10.2017, me kapital themeltar 100.000 lekë, me administrator shtetasen Stela Gugallja dhe zotërues shtetasen Stela Gugallja (80%) dhe shtetasin Erton Kaleshi (20%), me objekt aktiviteti “Keshillim dhenie rreth tatimeve e taksave, ofrim sherbimesh te specializuara financiare dhe kontabile, ofrim sherbimesh te specializuara tatimore, ekspertize ne ngritje, organizim dhe administrim sistemesh tatimore, te gjitha aktivitetet tregtare qe nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar. Vleresim i pasurive te paluajtshme. Aktivitet me patundshmeri qe nuk eshte i kufizuar me vleresimin e pasurive te patundshme dhe te tundshme dhe pasuri te tjera, mallra, sherbime, konsulence, studime dhe konsulence per hyrje ne treg”. Më datë 30.01.2019, me ane të kontratës së shitjes së kuotave, Erton Kaleshi shet 20% të kuotave në favor të blereses Julia Demneri, kundrejt cmimit 20.000 lekë.

**61.** Sipas të dhënave të bilanceve të shoqërisë, shoqëria Consulting SE Partners sh.p.k ka pasur xhiro vjetore dhe fitim para tatimit si më poshtë:

Në vitin 2017 ka pasur xhiro vjetore 3.416.670 lekë dhe fitim para tatimit 1.468.361 lekë

Në vitin 2018 ka pasur xhiro vjetore 28.016.682 lekë dhe fitim para tatimit 13.327.297 lekë

Në vitin 2019 ka pasur xhiro vjetore 29.766.683 lekë dhe fitim para tatimit 10.512.089 lekë

Në vitin 2020 ka pasur xhiro vjetore 25.116.679 lekë dhe fitim para tatimit 5.108.762 lekë

**62.** Shtetasi Erton Kaleshi, ka qënë ortak i shoqërisë për periudhën 23.10.2017 deri në 30.01.2019, kjo pasi në 01.02.2019 emërohet Këshilltar i Ministrit Arben Ahmetaj dhe më vonë Këshilltar i Ministres Anila Denaj në Ministrinë e Financave.

**63.** Shoqëria ZOTO Consulting sh.p.k, me NIPT L72115013Q, themeluar në 15.09.2017, me kapital themeltar 1.000.000 lekë, me administrator shtetasen Denisa Tollkuçi dhe zotërues shtetasin Klodian Zoto (90%) dhe shtetasin Denisa Tollkuçi (10%), me objekt aktiviteti “Konsulence ne fushen e drejtesise dhe ligjit duke perfshire pa u kufizuar ne konsulence juridike, gjeresisht ne fushen e te drejtes tregtare, te drejtes civile, administrative, penale, publike, te punes, financiare dhe bankare, familjares, kontratave dhe detyrimeve dhe te drejtes nderkombetare publike dhe private. Konsulence ligjore ne fushen e taksave, qeverisjes se korporatave, bashkimit dhe perthithjes se shoqerive tregtare, prokurimeve publike, koncesioneve dhe privatizimeve, pronesise intelektuale dhe te drejtave te autorit, negociim tregtar dhe kontrata si dhe konsulence ne te gjitha fushat e tjera te se drejtes ne pergjithesi. Sherbime avokatie dhe perfaqesimi ne gjykata te te gjitha shkalleve si dhe ne gjykatat e arbitrazhit ne Shqiperi dhe jashte saj. Sherbime ndermjetesimi dhe zgjidhje konfliktesh, lobing dhe advokaci. Sherbim perfaqesimi ndaj shoqerive tregtare, individeve dhe tregtareve, qofshin keta vendas apo te huaj. Konsulence financiare, bankare dhe tregtare, konsulence ne fushen e investimeve, zhvillimit te pasurive te paluajtshme dhe tregjeve financiare, bursave ne vend dhe jashte saj, konsulence ne fushen e telekomunikacioneve dhe 2 teknologjive, konsulence ne fushen e turizmit dhe ndertimit si dhe konsulence ne te gjitha fushat e tjera te tregtise, industrise etj. Aktivitete ne fushen e investimeve per fusha te ndryshme, aktivitete komisioni dhe brokeri, aktivitete konsulence ne fushen e ndertimit dhe operimit te pasurive te paluajtshme. Aktivitet agjensie dhe agjenti. Te kryej cdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, dheniemarrje me qira, te vendose pengje dhe barre hipotekore, aktivitete keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesor te citura me siper, te kryeje aktivitete publikimi dhe reklamimi”.

**64.** Sipas të dhënave të bilanceve të shoqërisë, shoqëria ZOTO Consulting sh.p.k ka pasur xhiro vjetore dhe fitim para tatimit si më poshtë:

Në vitin 2017 ka pasur xhiro vjetore 4.000.000 lekë dhe fitim para tatimit 1.679.199 lekë

Në vitin 2018 ka pasur xhiro vjetore 26.500.000 lekë dhe fitim para tatimit 5.372.649 lekë

Në vitin 2019 ka pasur xhiro vjetore 27.166.667 lekë dhe fitim para tatimit 8.741.640 lekë

Në vitin 2020 ka pasur xhiro vjetore 18.416.668 lekë dhe fitim para tatimit – 868.044 lekë

**65.** Shoqëria Zoto Consulting në pronësi të Klodian Zotos dhe Consulting SE Partners sh.p.k në pronësi të Stela Gugallja janë nënkontraktorë tek të tre Inceneratorët.

**66.** Personat e përfshirë tek inceneratori i Elbasanit:



Stela Gugallja  
Klodian Zoto  
Ernesto Granelli  
Erton Kaleshi  
Denisa Tollkuçi  
Elidiana Shehu  
Skender Allkja

## B. INCENERATORI I FIERIT

**67.** Pas dorëzimit në Ministrinë e Mjedisit të propozimit të pakërkuar, nëpërmjet VKM nr. 341, datë 04.05.2016, Qeveria miraton bonusin prej 10% të pikëve shoqërisë Building Construction & Green Energy shpk, për rezultatin teknik e financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të ndërtimit e administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë.

**68.** Building Construction & Green Energy shpk është themeluar në 25.11.2015, me kapital themeltar 50.000.000 lekë, me administrator shtetasin Aris Goxha dhe zotërues shoqëritë (i) EcoAlb FR shpk (50%), (ii) Devolli Group shpk (30%) dhe (iii) Building Construction shpk (20%); ka si objekt të veprimtarisë “Veprimtari në fushën e ndërtimit të hidrocentraleve dhe termocentrale të kapaciteteve të ndryshme. Prodhim, montim dhe tregtim me shumicë e pakice të paneleve për prodhim të energjisë diellore dhe aksesoreve të tyre brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Trajtim i mbetjeve të ndryshme organike, etj. Ndërtim i impianteve të trajtimit të mbetjeve me djegie (Incenerator) dhe landfille për perpunimin e mbetjeve urbane dhe të rrezikshme. Projektim, ndërtim, konstruksion dhe punime restaurimi të objekteve civile dhe vaditje, infrastrukture, shërbime komunale etj. Import-Eksport”.

**69.** EcoAlb FR shpk, me NIPT L52228039G, është themeluar në 27.10.2015, me kapital themeltar 100.000 lekë, me administrator dhe pronar shtetasen Sevi Zani (24 vjeç në momentin e themelimit të shoqërisë), punonjëse e shoqërisë Integrated Technology Services sh.p.k në pronësi të Klodian Zotos, pranuar nga Arenc Myrtezani në dëshminë e dhënë në Komision Hetimor; me objekt të veprimtarisë “Ndërtim Hidrocentrale dhe Termocentrale të kapaciteteve të ndryshme. Prodhim, montim dhe tregti me shumicë dhe pakice të paneleve për prodhim të energjisë diellore, dhe aksesoreve të tyre brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Trajtim i mbetjeve të ndryshme, organike dhe të ndryshme. Ndërtim i impianteve të trajtimit të mbetjeve me djegie (Incenerator), dhe landfille për perpunim të mbetjeve urbane dhe të rrezikshme. Ndërtim, konstruksion dhe punime restaurimi, të objekteve civile, industriale, tregtare turistike, shëndetësore, kulturore, sportive, vepra kullimi dhe vaditje, infrastrukture, shërbime komunale, projektim i objekteve të treguara me siper. Instalimi i linjave dhe kabinave elektrike të Tensionit të Ulet. Ndërtime civile, instalime sistemesh dhe pajisjeve matese ëireless”. Adresa e ushtrimit të aktivitetit Njesia nr.5, Bulevardi Bajram Curri, Pallatet Agimi, shkalla Nr.4, kati 3, ap. Nr. 68.

**70.** Në 28.10.2015, një ditë pas themelimit, ortakut i vetëm shtetasja Sevi Zani, vendos të marrë pjesë në themelimin e shoqërisë Building Construction & Green Energy shpk (përfituesja e bonusit të Inceneratorit të Fierit), duke zotëruar 50% të kuotave (ndërkohë që shoqëria e bonusit themelohet një muaj pas këtij vendimi).

**71.** Në datën 25.01.2016, Sevi Zani shet 100% të kuotave në favor të shoqërisë Integrated Technology Services sh.p.k, në pronësi të shtetasit Klodian Zoto, i cili tashmë është edhe administrator i shoqërisë. Pas zotërimit të EcoAlb FR nga Klodian Zoto, e cila zotëron 50% të shoqërisë Building Construction & Green Energy shpk, kjo e fundit përfiton bonusim prej 10% të pikëve në maj të vitit 2016.

**72.** Në datën 04.08.2016, nëpërmjet Kontrates Nr. 6248 Rep., Nr. 3815 Kol., date 04.08.2016, Integrated Technology Services sh.p.k, në pronësi të shtetasit Klodian Zoto, i shet 100% të kuotave të shoqërisë shtetasit Loran Dusha (administrator aktual i Inceneratorit të Tiranës) dhe tashmë administrator i shoqërisë emërohet shtetasi Arenc Myrtezani. Nga dokumentacioni i administruar në Komision Hetimor nga Qendra Kombëtare e Biznesit, faktohet se shtetasi Loran Dusha ka qënë përfaqësues i shoqërisë Hermes Communication sh.p.k në vitin 2010, shoqëri në pronësi të ministrit Arben Ahmetaj.

**73.** Shoqëria C.G.C shpk, me NIPT L32307002J, themeluar në 07.11.2013, me kapital themeltar 100.000 lekë, me administrator Loran Dusha dhe pronar Stela Gugallja, me objekt të veprimtarisë “Ngritje laboratoresh, investim, import eksport te materialeve te ndryshem qe kane lidhje me objektin e veprimtarise. Import eksport e tregtim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem industriale te perdorimit te gjere, kerkim, zbulim mineralesh, prodhim dhe ngritje industrie per prodhimin e qelqit dhe ambalazheve te qelqit, aktivitete komisionimi, tregti te pergjithshme , sherbime konsulence, magazinim dhe transport hidrokarburesh. Ndertimi dhe menaxhimi i stallave dhe impianteve per rritjen intensive te te gjitha kafsheve, zhvillimi i teknologjive te reja ne fushen e rritjes, perpunimit, therjes dhe tregtimit te mishit te te gjitha kafsheve, mish i cili tregtohet ne tregun vendas e te huaj. Import-eksport te ketyre produkteve, si psh mish vici, derri, lope etj. Import- eksport i produkteve me te cilat ushqehen te gjitha llojet e kafsheve. Import-eksport i makinerive dhe mjeteve qe sherbejne per stallat, impiantet e rritjes ,perpunimit,therjes dhe tregtimit te te gjitha kafsheve. Importimi i desinfektanteve ushqimore, vaksinave te ndryshme te shpendeve, kafsheve, dhe te gjitha produktet e tjera medicinale te nevojshme per zhvillimin e aktivitetit te rritjes se kafsheve te ndryshme dhe shpendeve. Tregtim i gazit natyror (shitje me shumice).Prodhim i energjise elektrike ne ambientet e prodhimit të HEC, tregtim i energjise elektrike, vetefinancim, projektim, ndertim, venie ne pune, administrim dhe mirembajtje të Hidrocentraleve. Ndertim dhe zbatim i projekteve të ndertimit. Inxhinieri civile, instalime elektrike, ndertim i projekteve te inxhinierise civile. Aktivitete sherbimi te tilla si transportim, magazinim dhe sherbime mbeshtetese. Informacion dhe komunikim. Sherbime konsulence administrimi. Marredhenie me qera e makinerive dhe pajisjeve qe sherbejne per ndertimin dhe inxhinierine civile. Aktivitet arkitekturore dhe inxhinierike dhe konsulenca perkatese teknike”, me adresë “Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit, Sky Toëer, Kati 13, Zyra 13/2” (e njëjta adresë me Inceneratorin e Elbasanit dhe Fierit). Në 06.03.2017, shtetasja administrator i

shoqërisë emërohet shtetasi Mirel Mërtiri dhe largohet Loran Dusha. Në 06.09.2018, Stela Gugallja i shet shoqërinë shtetaset Ilir Dedja, i cili në 06.07.2021 i shet shoqërinë Integrated Technology Services sh.p.k, në pronësi të Klodian Zotos.

**74.** Në 18.07.2016, publikohet shpallja e kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 28, por pa publikuar datën e hapjes së garës, pavarësisht kësaj, nga dokumentat faktohet se datën e hapjes së garës shoqëria Building Construction & Green Energy shpk nuk paraqitet në garë dhe në datë 15.09.2016, Ministria e Mjedisit kualifikon fituese JV “Integrated Technology Services shpk & Energy 2 SRL”.

**75.** BUILDING CONSTRUCTION shpk, me NIPT L11401034P, është themeluar në 01.02.2011, me kapital themeltar 109.510.000 lekë, me administrator dhe zotërues shtetasin Imer Memetaj; me objekt të aktivitetit “Aktivitet ne fushen e ndertimit te objekteve te ndryshme industriale dhe civile, private apo publike, marrja e te drejtave dhe cdo lloj avantazhi ne cdo lloj forme ligjore qe eshte e domosdoshme per realizimin e qellimeve te shoqerise si dhe shfrytezimin e te gjitha sipermarrjeve qe kane te bejne me veprimtarine e mesiperme ne kufijte e lejuar nga ligji. Aktivitet ne fushen e sherbimeve elektro-mekanike, inxhinierike ne makineri dhe pajisje te ndryshme, ne vepra civile, montime dhe cmontime teknike, kullash metalike te tensionit, punime montime impiante te prodhimit te energjise elektrike dhe shperndarjes se saj, konstruksione te ndryshme. Zhvillim zonash me qellime rezidenciale dhe tregtare, shitjeblerje e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme. Ushtrimi i cdo lloj operacioni dhe transaksioni ne lidhje importimin, eksportimin, prodhimin, tregtimin, shitjen, shperndarjen e pajisjeve dhe materialeve te ndryshme elektronike, elektromekanike, materiale ndertimi, plastike apo materiale te tjera ne fushen e ndertimit dhe sherbimeve elektro-mekanike, si me shumice dhe pakice, ne formen e lendes se pare, gjysme te gatshme ose te gatshme, makineri dhe pajisje, teknologji, etj. Shoqeria mund te ushtroje veprimtari ne fushen e turizmit duke investuar ne kete fushe per krijimin e qendrave, pikave dhe fshatrave turistike, si dhe infrastrukturen e tyre brenda dhe jashte vendit. Studimi, projektimi, vleresimi, konsulenca, monitorimi ne kerkimin, zbulimin, shfrytezimin, perpunimin dhe tregtimin ne import dhe eksport te mineraleve metalore dhe jometalore, rera bituminoze, materiale ndertimore. Aktivitet ne fushen e kerkim-zbulimit dhe shfrytezimit te mineraleve metalore, jometalore, qymyret, bitumet, ndertimor, te çmuar dhe gjysme te çmuar. Import-eksport mobilje, tavolina, mobileri, veshje, MDF, mobilim sallash konference, parket, moket. Ndrichim, import-eksport, ndrighim tavanesh. Rikonstruksion, sistemim - asfaltim rruge. Aktivitet në fushën e studimit, projektimit dhe zbatimit të punimeve në pyje, kullota dhe zona të mbrojtura.”.

**76.** Në datën 15.09.2016, Ministria e Mjedisit kualifikon si fituese të koncesionit/ppp me objekt “Dhenie me koncesion e ndertimit e administrimit te impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhim energjie” JV Integrated Technology Services shpk (90%) dhe Energy 2 SRL (10%) dhe formulari i njoftimit të fituesit publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 38, datë 26.09.2016. Theksojmë se, datën e hapjes së garës nuk është paraqitur shoqëria që kishtë përfituar Bonusin prej 10% të pikëve shoqëria Building Construction & Green Energy shpk.

**77.** Integrated Technology Services shpk, me NIPT L02302032C, është themeluar në 02.11.2010, me administrator dhe pronar shtetasin Klodian Zoto, i cili në 29.01.2018 ka emëruar si përfaqësuese të përgjithshme shtetasen Denisa Tollkuçi dhe në datë 18.06.2020 si administrator të shoqërisë; me objekt të veprimtarisë “Ndertime te llojeve te ndryshme. Ndertime impiantesh teknologjike, impiante te prodhimit te energjise se rinovueshme, landfillesh per perpunimin e mbetjeve urbane dhe te rrezikshme, ndertime te impianteve te trajtimit mbetjeve me djegie (incenerator). Ndertim te rrjeteve hidraulike, ujesjellesash, kanalizimesh, elektrike si dhe impiante te ndryshme qe kane lidhje me to. Ndertim impiantesh per pastrimin dhe mbrojtjen ujore dhe lumore. Perpunim, trajtim, menaxhim dhe transport i mbetjeve. Ngritje dhe instalim i rrjeteve me fije pa fije per uje, energji elektrike, kablllovak dhe ëireless etj, ngritje e sistemeve te netëork-u per matjen e utiliteteve. Realizimin e laboratoreve, softëareve, mirembajtjen e sistemeve te realizuar prej saj dhe te trete. Ndertim stacionesh dhe nenstacionesh elektrike. Ndertim dhe rikonstruksion i objekteve te rendesise se vecante si dhe objekteve te tjera. Ndertim rrugeshe dhe strukturash te ndryshme. Import, eksport i materialeve, te mallrave qe kane te bejne me objektin e aktivitetit. Transporte te ndryshme. Projektme, sherbime konsulence, studime mjedisore e studime te ndryshme. Import, eksport, shitje, blerje te makinerive te ndryshme. Bonifikim dhe trajtime terrenesh te ndotura. Dhenie me qera dhe nenqera te ambjenteve te tipeve te ndryshme”, me adresë ushtrimi aktiviteti “Rruga "Abdi Toptani", Tirane godina "Torre Drin", nr. 31/1”.

**78.** Në 28.07.2016, shton në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “Ndertim i impianteve te trajtimit te mbetjeve me djegie (Incenerator) dhe landfillesh per perpunimin e mbetjeve urbane dhe te rrezikshme”.

**79.** E njëjta fjali është përdorur edhe në ekstraktin e shoqërisë përfituese të bonusit Building Construction & Green Energy shpk dhe shoqërisë EcoAlb FR shpk në pronësi të punonjësës së Klodian Zoto, shtetasës Sevi Zani.

**80.** Në 24.08.2018, shton në objektin e veprimtarisë edhe “Ndertime te llojeve te ndryshme. Ndertime impiantesh teknologjike, impiante te prodhimit te energjise se rinovueshme, landfillesh per perpunimin e mbetjeve urbane dhe te rrezikshme, ndertime te impianteve te trajtimit mbetjeve me djegie (incenerator)”.

**81.** Sipas të dhënave të bilanceve të shoqërisë, shoqëria Integrated Technology Services sh.p.k ka pasur xhiro vjetore dhe fitim para tatimit si më poshtë:

Në vitin 2012 ka pasur xhiro vjetore 73.079.342 lekë dhe fitim para tatimit 48.670.770 lekë

Në vitin 2013 ka pasur xhiro vjetore 585.496.010 lekë dhe fitim para tatimit 7.916.686 lekë

Në vitin 2014 ka pasur xhiro vjetore 162.018.802 lekë dhe fitim para tatimit – 24.355.214 lekë

Në vitin 2015 ka pasur xhiro vjetore 364.865.718 lekë dhe fitim para tatimit 78.561.501 lekë

Në vitin 2016 ka pasur xhiro vjetore 1.310.168.613 lekë dhe fitim para tatimit 43.437.249 lekë

Në vitin 2017 ka pasur xhiro vjetore 1.284.191.748 lekë dhe fitim para tatimit 61.705.416 lekë

Në vitin 2018 ka pasur xhiro vjetore 1.076.913.263 lekë dhe fitim para tatimit 84.063.552 lekë

Në vitin 2019 ka pasur xhiro vjetore 1.009.529.760 lekë dhe fitim para tatimit 121.362.600 lekë

Në vitin 2020 ka pasur xhiro vjetore 1.097.381.445 lekë dhe fitim para tatimit 276.638.362 lekë

**82.** Energy 2 srl, person juridik italian, regjistruar në Itali me NIPT 0237506981, me seli në adresën “Carpenedolo (BS) Via Colombo, 27 CAP 25013, përfaqësuar nga Ernesto Granelli, i cili del edhe tek Inceneratori i Elbasanit dhe Inceneratori i Tiranës.

**83.** Në datë 24.10.2016, lidhet kontrata midis Ministrisë së Mjedisit dhe SPV Integrated Technology Waste Treatment Fier sh.p.k (është JV i formuar në Subjekt për Qëllim të Veçantë), me adresë fizike Rr. “Ibrahim Rugova”, Sky Toëer, kati 13, zyra 13/2 Tirane, e njëjta adresë me Inceneratorin e Elbasanit. Kjo shoqëri ka si administrator shtetasin Loran Dusha, i cili del tek shoqëria EcoAlb FR, pasi ja ble shoqërinë Klodian Zotos, i cili më herët ja ka blerë ish-punonjëses së tij Sevi Zani. Nga dokumentacioni i administruar në Komision nga Qendra Kombëtare e Biznesit, faktehet se shtetasi Loran Dusha ka qënë përfaqësues i shoqërisë Hermes Communication sh.p.k në vitin 2010, shoqëri në pronësi të ministrit Arben Ahmetaj.

**84.** 5 ditë pas lidhjes së kontratës koncesionare, shoqëria Energy 2 srl shet kuotat shoqërisë Ndërtim Montim Patosi sh.p.k e cila ble gjithashtu edhe 20% të kuotave të shoqërisë Integrated Technology Services sh.p.k, për vlerën 30.000 lekë. Shoqëria përfituese e Inceneratorit të Fierit është SPV në pronësi 70% Integrated Technology Services sh.p.k dhe 30% Ndërtim Montim Patos sh.p.k.

**85.** Ndërtim Montim Patos sh.p.k, themeluar në vitin 1996, me NIPT J63229454K, me administrator dhe pronar shtetasi Ellton Kollozi, me objekt veprimtarie “Ndërtim montime te veprave industriale, sociale kulturore, prodhim material ndërtimi dhe konstruksione metalike, si dhe aktivitet tregtar. Grumbullim transport te te gjitha llojeve te mbetjeve urbane”. Xhirot vjetore 2016 – 2020:

Në vitin 2016 ka pasur xhiro vjetore 976.468.808 lekë dhe fitim para tatimit 47.750.666 lekë

Në vitin 2017 ka pasur xhiro vjetore 231.454.255 lekë dhe fitim para tatimit 12.516.711 lekë

Në vitin 2018 ka pasur xhiro vjetore 349.821.021 lekë dhe fitim para tatimit 19.464.330 lekë

Në vitin 2019 ka pasur xhiro vjetore 171.889.091 lekë dhe fitim para tatimit 9.549.116 lekë

Në vitin 2020 ka pasur xhiro vjetore 32.339.833 lekë dhe fitim para tatimit 1.655.225 lekë

**86.** Në 10.11.2016, Integrated Technology Services sh.p.k dhe Ndërtim Montim Patos sh.p.k i blejnë për 15 milionë euro shoqërisë Energy Recuperator spa, impiantin e përpunimit të plehrave .

**87.** Personat e përfshirë tek inceneratori i Fierit:

Stela Gugallja

Klodian Zoto

Ernesto Granelli

Erton Kaleshi

Denisa Tollkuçi

Aris Goxha

Sevi Zani

Arenc Myrtezani  
Loran Dusha  
Ellton Kollozi  
Arjola Kodra  
Denisa Tollkuçi

### C. INCENERATORI I TIRANËS

**88.** Nëpërmjet VKM nr. 855, datë 07.12.2016, jepet Bonus prej 8%, shoqërisë Integrated Energy BV. Nga relacioni i Ministrisë së Mjedisit rezulton se shoqëria përfituese e bonusit është e përbërë nga Integrated Technology Services sh.p.k, në pronësi të Klodian Zoto, Energy Recuperator spa ne pronësi të Ernesto Granelli dhe Paul Ęurth Itala spa. Kjo shoqëri është krijuar 2 muaj para përfitimit të Bonusit në 30.08.2016.

**89.** Ortakja e kësaj shoqërie, Energy Recuperator spa, me administrator Ernesto Granelli (i) është ortakë në bashku me Stela Gugallja dhe me administrator Mirel Mërtirin tek shoqëria E.R One Albania sh.p.k; (ii) ka degë të saj në të njëjtën seli me E.R.One Albania sh.p.k; (iii) ka blerë me impiantin e Elbasanit dhe më pas atë të Fierit. Koncesioni i Inceneratorit të Tiranës u shpall nga Ministria e Mjedisit në Buletinin nr. 16, datë 24.04.2017.

**90.** Integrated Energy BV SPV, me NIPT L72031013B është themeluar në 30.08.2017, me kapital themeltar 100.000 lekë, me administrator shtetasit Giuseppe Ciaffaglione dhe Arjola Kodra, me objekt aktiviteti “Ndertimi, administrimi, operimi dhe transferimi i impiantit te trajtimit te mbetjeve ne Tirane dhe prodhimi i energjise per autoritetin kontraktues, duke perfshire financimin, ndertimin, venien ne pune, furnizimin, transmetimin, shperndarjen, shitjen dhe eksportin e energjise elektrike ne kete kontrate koncesioni si dhe çdo lloj tjetër aktiviteti tregtar qe lidhet dhe ushtrohet sipas kesaj kontrate, gjithashtu dhe çdo aktivitet tjetër qe kontribuon ne zhvillimin dhe administrimin e projektit”.

**91.** GeoGenix BV (Ish Integrated Energy B.V), nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e të drejtës tregtare Holandeze, e regjistruar ne daten 19.08.2016, me numer ne regjistrin tregtar te Amsterdemit 66671752, me adrese ne Joop Geesinkëeg 701, Amsterdam, me administrator Georgi Leonidovich Birman dhe Simone Dormio. Klodian Zoto ka qene administrator i shoqerise ne periudhen 2016-2018. Shoqeria ka ndryshuar emrin ne 13.02.2020, nga “Integrated Energy BV” ne “Geogenix BV”. Burimi i te dhenave, date 14.02.2022

**92.** Sipas Ekstraktit Historik te Regjistrit te Pronarit Përfitues publikuar në QKB, dokument i terhequr ne daten 14.02.2022, pronare Përfitues të shoqërisë Integrated Energy BV SPV, rezultojnë:

(i) Giuseppe Ciaffaglione, shtetas Italian, datelindje prill 1968, Pronar Përfitues për 30% të Pronësisë pasi zotëron GeoGenix (mëma e Integrated Energy BV SPV) për 30% të Pronësisë.

(ii) Salvatore Russelli, shtetas Italian, datëlindje mars 1975, zotëron si Pronar Përfitues 25 % të pronësisë pasi zotëron 100 % Hydros SRL (numër identifikimi 01380110765), pronar direkt për GeoGenix.

(iii) Alberto Prezezzi, shtetas italian, datëlindje 1969, Pronar Përfitues për 43% të Pronësisë së Integrated Energy BV SPV përmes Ponarit Indirekt BrunoPrezzi SPA (shoqëri aksionere 07118380158) dhe Franco Tosi Meçanica SPA (shoqëri aksionare 09020510963).

(iv) 2 % aksioneve të Mëmës GeoGenix nuk janë identifikuar pronarët pasi janë me më pak se 25 % të Pronësisë.

**93.** Tre pronaret perfitues jane deklaruar si zoterues ne daten 31.08.2017. Pronaret e shoqerise GeoGenix BV per periudhen nga data e regjistrimit te saj ne gusht te 2016 deri ne gusht te 2017 (kur jane deklaruar pronaret ekzistues) nuk behen te ditur ne dokumentacionin zyrtar te Qendres Kombetare te Biznesit per pronaret perfitues.

**94.** Shoqëria ECO RECYCLING, me NIPT L71920025R, themeluar në 20.07.2017, është në pronësi të Integrated Energy BV SPV (Inceneratorit të Tiranës) dhe ECO TIRANA sha (Bashkia Tiranë) dhe ka si objekt veprimtarie “Perpunim, tregtim, mbledhje, transportim, magazinim i perkohshem dhe jo te perkohshem, trajtim dhe seleksionim i mbetjeve te te gjitha llojeve, kategorive dhe tipeve, edhe per llogari te te treteve, qofshin keto ente publike apo private, si dhe te materialeve te siguruara nga mbetjet te te gjitha llojeve, kategorive dhe tipeve. Ofrimin e sherbimeve per entet publike dhe private, konsulence lidhur me administrimin e impianteve te seleksionimit, shkrirjes, trajtimit dhe magazinimit te mbetjeve te te gjitha llojeve, kategorive dhe tipeve; Aktivitete lidhur me kryerjen e analizave te mbetjeve te te gjitha llojeve, te mbetjeve dhe tymeve edhe nepermjet ndertimit dhe drejtimit te laboratoreve. Ndertimin, administrimin dhe mirembajtjen e impianteve te shkarkimit, impianteve te shkrirjes, impianteve te pastrimit, impianteve te trajtimit te mbetjeve te te gjitha llojeve, kategorive dhe tipeve: Blerje, tregtim, qira, vendosje e aparaturave dhe materialeve qe kane lidhje me aktivitetet e siperpermendura. Blerje, shitje, administrim, drejtim dhe lokalizim te cdo lloj pasurie te paluajtshme. Bonilikim dhe rehabilitim i territorit. Autotransport te sendeve, edhe per llogari te te treteve. Kerkime, studime dhe zhvillim lidhur me reduktimin e mbetjeve, skarcove, te reduktimit te efekteve negative, si dhe ne realizimin e teknikave te reja te mbledhjes se diferencuar, te impianteve te reja te shkrirjes dhe trajtimit me teknologji komplekse, perfshire edhe kalimin e "knoë hoë" te perdorimit dhe transferimit te te drejtave te shfrytezimit te patentave ne fushen e trajtimit te plehrave ne pergjithesi. Administrimin e sherbimeve ambientale ne fushen e mbeturinave, referuar ne vecanti kujdesjes, valorizimit dhe permiresimit te ambientit, duke u realizuar edhe nepermjet studimeve, projekteve dhe kerkimeve. Shoqeria mund te marre pjese gjithashtu, ne menyre direkte ose indirekte ne ente, siper marrje ose shoqeri te themeluara ose duke u themeluar, objektivat e te cilave jane ne perputhje me ato te Shoqerise, me seli si ne Shqiperi, ashtu edhe jashte saj. Per arritjen e objektiveve te saj, Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimi tregtar, veprime me pasuri te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, financiare etj., qe konsideron nga organi administrativ te nevojshme per vijimin e aktivitetit te shoqerise ne lidhje me te cilin mund te jape cdo lloj garanci qe kerkohet. Ushtrimi i aktivitetit te siperpermendur mund te ushtrohet si ne menyre te drejteperdrejte ashtu edhe jo drejteperdrejt, ose ne cdo lloj cilesie tjeter”.

**95.** Personat e përfshirë tek inceneratori i Tiranës:

Stela Gugallja

Klodian Zoto  
Mirel Mërtiri  
Ernesto Granelli  
Arjola Kodra  
Giuseppe Ciaffaglione  
Sevi Zani

### III. FOLLOW THE MONEY

**96.** Kompanitë e krijuara disa ditë përpara se të fitonin koncesionet e inceneratorit të Elbasanit, Fierit dhe Tiranës kanë ngritur një skemë të qartë të qarkullimit të parave duke krijuar një skemë të madhe të evazionit fiskal, qarkullimit fiktiv të TVSH-së dhe gjithashtu edhe abuzimit me mbi 100 mln euro që janë paguar deri më tani nga buxheti i shtetit.

**97.** Analiza e mëposhtme ka ardhur duke u bazuar në skemën e cila trajton si fluks hyrës në kompanitë e inceneratorëve pagesat e marra nga buxheti i shtetit, në rastin e inceneratorëve të Elbasanit dhe Fierit ku Autoritet Kontraktor ka qenë fillimisht Ministria e Mjedisit dhe më tej Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës.

**98.** Ndërkohë që në rastin e inceneratorit të Tiranës, flukset hyrëse janë të ndara ku një pjesë e zë Bashkia Tiranë (e cila paguan këto flukse prej buxhetit të saj – rritja e tarifës së pastrimit nga Keshilli Bashkiak për perballimin e kostove të inceneratorit VKB-ja Nr 158 date 26/12/2019 si dhe prej buxhetit të shtetit përmes Transfertës së pakushtëzuar). Përpos Bashkisë Tiranë e ardhur për kompaninë e koncesionit të Inceneratorit të Tiranës, Integrated Energy BV SPV, janë edhe institucionet shtetërore që kryejnë punime si pasojë e monopolit të dherave që ka kompania. Në fund, por jo nga rëndësia, kompania Integrated Energy BV SPV ka fluks hyrës edhe të ardhurat që fiton nga kompanitë e ndërtimit që përbëjnë një zë të rëndësishëm në bilancet e kompanisë.

**99.** Nga flukset dalëse të kompanisë, pra pagesat që kompanitë kanë kryer, jemi bazuar në librat e blerjes që kompanitë kanë dërguar në Drejtorinë e Tatimeve. Duke u bazuar në këto të dhëna kemi mundur që të kryejmë një analizë se ku dhe si janë shpërndarë të ardhurat e kompanive koncesionare, si ka qenë raporti i shpenzimeve.

**100.** Nga të dhënat e Bilanceve publike të nxjerra në QKB rezulton që kompania Albtek Energy, që ka qenë koncesionare e inceneratorit të Elbasanit, ka deklaruar një fitim prej 1.6 mln eurove ndërkohë që në “Pasqyrat Financiare” rezultojnë ende shpenzime të periudhave të ardhshme të paraqitura dhe të apdetuaraj në vlerën e 4.3 mln eurove. Nga të njëjtat pasqyra rezulton



një vlerë e konsiderueshme e Aktiveve afatgjata materiale në vlerën e thuajse 1 mln eurove që nuk janë detajuar në shpjegimet e duhura dhe që krijojnë mundësi abuzimi me të dhënat në PASqyrat Financiare.

**101.** Në lidhje me kompaninë e Integrated WasteTreatment Fier, koncesionari i inceneratorit të Fierit, ka një mungesë të plotë informacioni dhe transparence në lidhje me pasqyrat financiare të vitit 2020. Si pasojë e këtij raportimi të cunguar dhe jo në përputhje me ligjin janë indicie të qarta se mund të kemi një manipulim të mundshëm tek “Pasqyrat Financiare”. Nga të dhënat e kompanisë në bilance vërehet që kompania në vitin 2016 ka faturuar një shumë prej thuajse 1 mln euro (892.751 euro sipas librave të shitjes). Një vlerë e tillë është shumë e dyshimtë duke qenë se kompania kishte 1 të punësuar dhe pjesa më e madhe e kësaj pagese i ka shkuar aksionarit Integrated Technology Services (në pronësi të Klodian Zotos).

**102.** Nga analiza e raporteve të pasqyruara në QKB rezulton që kompania ka pasur në vitet në vijim një përputhje çuditërisht ekzakte deri në shifrat e presjes dhjetore në lidhje midis të ardhurave dhe shpenzimeve.

**103.** Kompania që ka në pronësi koncesionin e Inceneratorit të Tiranës, Integrated Energy BV SPV rezulton që të ketë një buxhet të konsoliduar ndonëse pa përfunduar ende projektin e inceneratorit. Investimet e inceneratorit kapin shifrën e 5.000.000 eurove ndërkohë që zërin kryesor të investimeve të mjeteve e ka zënë makinat që kapin shifrën e 17.000.000 lekëve ( 140.000 Eur).

**104.** Një zë të veçantë në kompanitë e inceneratorëve zënë edhe financimi i publicitetit dhe marketingut të kompanive të incenerimit në mediat e shkruara dhe ato vizive. Shpenzimet për media kapin shifrën e gjysmë milion dollarë ndërkohë që udhëtimet kapin shifrën e 800 mijë dollarëve.

**105.** Hulumtimi i imtësishëm i pasqyrave financiare e shtyu Komisionin Hetimor që të bënte një kërkesë të detajuar ndaj bankave të nivelit të dytë në lidhje me levizjet në llogaritë bankare të kompanive të inceneratorëve dhe gjithashtu edhe pronarëve të tyre. Fatkeqësisht një pjesë e bankave refuzuan të sjellin materialin e kërkuar nga Komisioni Hetimor ndërkohë që Mirel Mërtiri, një nga përfituesit e këtyre koncesioneve, u kërkoi publikisht bankave që t’i shmangeshin detyrimit ligjor për t’iu përgjigjur pozitivisht kërkesës së Komisionit Hetimor bazuar në Ligjin për Komisionet Hetimore Parlamentare.

**106.** Komisioni Hetimor dërgoi dhe dy kërkesa zyrtare drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ku i kërkonte informacion në lidhje me Librat e Shitjes, Librat e Blerjes dhe Listpagesat e kompanive koncesionare të inceneratorit të Fierit, Elbasanit dhe Tiranës. Komisioni Hetimor morri një përgjigje pozitive me një CD që kishte brenda librat e shitjeve dhe blerjes për kompanitë koncesionare por duke mos permbushur kerkesen tjeter ne lidhje listpagesat e kompanive sikundër ishte shprehur në kërkesë. Mungesa e këtij informacioni të rëndësishëm nuk e lejoi Komisionin Hetimor që të kryente hetime edhe më të thelluara në lidhje me shpenzimet e parave publike në lidhje me pagat dhe raportin e tyre në kohë me shpenzimet e tjera.

**107.** Pas marrjes së këtyre materialeve Komisioni Hetimor nisi kqyrjen e të dhënave dhe kryqëzimin e tyre duke ndjekur paratë dhe çfarë vjen pas tyre. Nga analizimi i të dhënave rezultojnë që kompanitë koncesionare të inceneratorëve kanë përdorur tre mënyra për të qarkulluar paratë e buxhetit të shtetit duke krijuar një skemë të madhe piramidale dhe evazioni fiskal me qëllim përfitime të paligjshme.

**108.** Rruga e parë është ndërtuar duke pasur parasysht tre komponentë kyç mbi të cilat është ngritur kjo skemë. Së pari kompanitë e inceneratorëve kanë përdorur buxhetin e shtetit për të tërhequr paradhënie shumicën e shumës së premtuar në formën e paradhënies, ky përfundim u arrit nga analiza e vetë pasqyrave financiare dhe më tej ato kanë importuar mallra më pak se sa ajo e zotuar në kontrata.

**109.** Ruga e dytë përmes së cilës ato kanë vepruar është ajo e transferimit të parave jashtë vendit nëpërmjet faturave të shërbimeve me jashtë. duke krijuar kështu mundësinë që paratë e buxhetit shqiptar të dalin jashtë territorit të vendit pa kryer punën.


**110.** Rruga e tretë është ajo e krijimit të një miksi mes krijimit të kompanive fiktive dhe emetimit të fatura fiktive të TVSH-së dhe gjithashtu transferimi i parave në një grup kompanish në pronësi të Gugallja dhe Zoto (përkatësisht ITS, Zoto Consulting dhe SE Consulting). Këto kompani janë përdorur si guaska përmes së cilës janë shpërndarë paratë në të tjera kompani deri në rikthimin e “Cash-it” tek pronaret apo zyrtarët.

#### A. VLERA KONTRAKTUALE DHE IMPORTET

**111.** Kompania koncesionare, Integrated Waste Management Fier që ka për aksionarë kompaninë ITS dhe kompaninë Ndërtim Montim Patos, ka deklaruar në zërin “Arkëtime për paradhënie për porosi” shumën prej 1,986,476,980 Leke = 20’000’000 USD apo 16.2 mln euro si formë parapagimi nga qeveria shqiptare.

**112.** Kjo do të thotë që nga buxheti i shtetit është parapaguar një vlerë sa 57% e vlerës totale të kontratës koncesionare. Sikundër vërehet nga librat e shitjes kompania në fjalë ka marrë këstin e parë të pagesës brenda 6 ditë-ve pas firmosjes së kontratës, përmes një kësti prej 518 mijë eurosh.


**113.** Ndonëse Leja e Ndërtimit për inceneraotrin e Fierit është miratuar thujse një vit pas nënshkrimit të kontratës koncesionare, rezultojnë nga libri i shitjeve që kompania e Integrated Waste Treatment Fier të ketë marrë nga qeveria ka marrë thujse 800 mln lekë.



**114.** Nga librat e shitjes së kompanisë që fitoi koncesionin e inceneratorit të Fierit, rezulton se janë importuar (zhdoganuar) mallra me vlerën e 4.5 mln euro ndërkohë që vlera e impiantit sipas kontratës për ndërtimin e impiantit të incenerimit vlera e tij do të ishte 15 mln euro. Kështu kompania që morri përsipër ndërtimin e impiantit të incenerimit dhe landfillimit ka importuar produkte në vlerë thuhet 3.3 herë më të ulëta se sa vlera e paraqitur në kontratë.

**115.** Një mosrakordim i tillë shfaqet edhe në rastin e inceneratorit të Elbasanit, kompania koncesioanre ka nënshkruar një kontratë me “Çelësa në dorë” me një kompani italiane për ta sjellë impiantin e inceneratorit nga Italia me po të njëjtën vlerë të impiantit të incenerimit sa ajo e Fierit.


**116.** Nga analiza e librave të blerjes të kompanisë Albtek Energy, pronare e kooncesionit të Inceneratorit të Elbasanit, rezulton që ka importuar (zhdoganuar) mallra me vlerë 7.3 mln euro duke pasur një diferencë të pajustificuar thuhet 8 mln euro në raport me kontratën që i ka paraqitur Autoritetit Kontraktor.



**117.** Ndërkohë që inceneratori i Tiranës, Lejen e Ndërtimit të së cilës, e ka marrë më vonë se sa pritej, ka zhdoganuar vetëm 1 mln euro nga viti 2018 deri në vitin 2021, kjo është sa 3% e

vlerës që ajo ka përfituar nga të ardhurat prej Bashkisë Tiranë bazuar në të dhënat e siguruar nga Librat e Shitjeve.

**118.** Nga kjo analizë kuptohet se vlera totale e zhdoganimeve për të marrë impiantin e inceneratorit në të tre veprat koncesionare është e barabartë me 12.8 mln euro që është shuma e shpenzuar nga të tre kompanitë koncesionare ndërkohë që shuma që ato kanë përfituar nga buxheti i shtetit përmes Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Bashkisë Tiranë, bashkisë Durrës kapin shifrën e 95.3 mln eurove.



**119.** Rezultoni që kompanitë koncesionarëve të inceneratorit të kenë shpenzuar sa 13% të vlerës totale të marra deri më tani nga buxheti i shtetit për zhdoganime. Kompania Integrated WasteTreatment Fier ka shpenzuar 24% të vlerës së marrë nga buxheti i shtetit për të kryer zhdoganimet e një impianti incenerimit.

**120.** Ndërkohë që kompania e incenerimit të Elbasanit, Albtek Energy, ka shpenzuar 18% të vlerës së marrë nga buxheti i shtetit zhdoganime ndonëse vetëm impianti i incenerimit për të cilën ajo ka nënshkruar një kontratë kushton sa dyfishi i vlerës së zhdoganuar.

## B. TRANSFERTA E KAPITALIT JASHTË

**121.** Një tjetër metodë se si kompanitë kanë përdorur për transferimin e kapitaleve është ajo transferimit të tyre jashtë vendit. Ky proces nënkupton që një kompani të marrë shërbime nga kompani të saja “guackë ” e të rregjistruara në vendet të njohura si parajsë fiskale. Kjo është zakonisht një mënyrë se si kompanitë që kanë bija në një vend përdorin për të kryer transferime të kapitalit apo parave në kompanitë mëma jashtë vendit. informacionet në lidhje me këto lëvizje janë shumë të qartë për t’u gjetur nga përpunimi i të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme

e Tatimeve. Në total, prej analizës së kryer, kompanitë koncesionare kanë deklaruar të paktën 94 fatura të tilla sherbimesh në Librat e tyre me një vlerë totale prej 24.48 mln euro, apo mesatarisht 260 mijë euro për një faturë.

**122.** Në kompaninë Albtek Energy vihet re që transferta e kapitalit jashtë nuk është shumë i përhapur dhe kjo është e kuptueshme pasi kompania e themeluar pak ditë pasi u shpall emergjenca mjedisore ka qenë në pronësi të zonjës Gugallja. Vlera totale e kapitalit të dalë jashtë është ajo e 54.499.779 lekësh që ka qenë e shpërndarë në dy vitet 2017 dhe 2018 që kanë qenë në fakt dhe vitet ku janë kurorëzuar dhe dy impiantet e tjera nisjen e punimeve të tyre.


**123.** Të njëjtën strukturë si kompani Albtek Energy ka dhe kompania Integrated WasteTreatment Fier. Ajo zotërohet nga dy aksionerë shqiptarë. Gjithsesi kompania ka manxhuar që të transferojë kapitalin e saj financiar jashtë kompanisë në një vlerë më të lartë se sa inceneratori i Elbasanit, duke prekur shifën e thujtë 2 mln eurove dhe kjo transfertë është e përqëndruar përgjithësisht në periudhën 2018-2020 ku vlera e transferuar jashtë ka qenë mesatarisht 5.4% e totalit të Blerjeve që kompania ka pasur.

**124.** Për t'u vërejtur është fakti se kompania "Ndërtim Montim Patos" nuk ka qenë që në gjenezë të kompanisë Integrated Technology WasteTreatment Fier pasi sipas të dhënave të QKB ajo ka blerë aksionet e kompanisë italiane Energy SRL 2 pak ditë pasi u nënshkrua kontrata koncesionare nga kompania fituese. Në librat e shitjes së Albtek Energy u vu re se ajo kishte pasur flukse hyrëse të ardhurash nga kompania "Ndërtim Montim Patos" me vlerë 627 908 400 lekë (5 mln euro). Në sasinë e flukseve hyrëse rezulton që kjo kompani të jetë e dyta në vlerën e pagesave të kryera ndaj kompanisë Albtek Energy.

**125.** Në këtë pasqyrë ndryshon vetëm kompania Integrated Energy SPV BV, kompania në fakt është degë e një joint venture që ka adresën e saj në offshore të Hollandës. Sipas ekstraktit të QKB kompania zotërohet nga tre përfitues që e kanë blerë kompaninë pak ditë pas nënshkrimit të kontratës koncesionare.

**126.** Nga analiza e librave të shitjeve dhe blerjeve rezulton se për periudhën kohore 2017-2021 ka transferuar 2 657 109 148 lekë (21.95 mln euro) apo sa 38.7% e totalit të blerjeve që kompania kryer për një periudhë 5 vjeçare. Kompania koncesionare e inceneratorit të Tiranës duket se ka transferuar jashtë vendit tek pronarët e saj përfitues 54.8% të parave që ka përfituar nga buxheti i shtetit deri më tani.

**127.** Nëse do të analizonim të treja kompanitë koncesionare së bashku, vlera e transferuar kap shifrën e 2.942.179.713 lekë (24.31 mln euro) dhe në këtë shumë peshën më të madhe e ka kompania Integrated Energy BV SPV me rreth 90% të transfertave.



### C. TRANSFERTA E PARAVE BRENDIA VENDIT

**128.** Në 20.02.2015 kompania fituese e koncesionit të Elbasanit, Albtek Energy, do të nënshkruante një kontratë me kompaninë Integrated Technology Services SHPK (nga këtu ITS) ku kjo e fundit do të ishte nënkontraktore për të kryer punimet në impiantin e trajtimit të mbetjeve Elbasan.

**129.** Kompania ITS është në pronësi të Klodian Zotos, njeriut që do të përfitonte kontrata të majme si nënkontraktor i kompanive koncesionare të inceneratorëve. Sipas kontratës së firmosur nga vetë Stela Gugallja, kompania ITS do të kryente punime gërmimi, punime në shtresa të ndryshme, betonarmeje, sistemim argjinature dhe pastrim e mirëmbajtjes së dampës.

**130.** Në vitin 2015 kur kompania ITS nënshkroi kontratën e punimeve një vitin pararendës kompania ITS do ta mbyllte me një humbje prej 24.3 mln lekësh ndërsa xhiroja e saj do të ishte më e ulëta në historinë e deklarimeve të saj.

**131.** Kompania ITS do merrte nga kompania Albtek Energy e Stela Gugalljas që në vitin e parë 331 101 776 lekë (2.73 mln euro) që është një shifër sa 79% e volumit total të blerjeve të kompanisë Albtek Energy. Por kjo nuk është pagesa e vetme që ka marrë Klodian Zoto nga inceneratori I Elbasanit, librat e blerjeve tregojnë se ai ka përfituar në harkun kohor të 5 viteve 1.29 mld lekë (10.77 mln euro).

**132.** Dokumentet që ka disponuar Komisioni Hetimor vënë në dukje një fakt tejet interesant. Në 17/01/2017 mes investitorit të punimeve “Albtek Energy” dhe sipërmarrësit të tyre “Integrated Technology Services” Akt Marrje në Dorëzim të impiantit të Trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë. Sipas këtij akt-dorëzimi të firmosur nga


Gugallja dhe nga Zoto, kostoja e punimeve të realizuara nga 20.02.2015 e deri në firmosjen e kësaj aktmerrveshje ka qenë 6,496,502 euro pa përfshirë TVSH.

**133.** Ndonëse kompania ITS përfundoi punimet e saj dhe Albtek Energy, si investitor mundi të marrë shërbimin e paguar, sërishmi kompania në pronësi të Klodian Zotos rezulton të ketë marrë pagesa nga kompania në pronësi të inceneratorit. Arsyet e këtyre pagesave mbeten të paqarta pasi nuk ka asnjë informacion mbi punimet e kompanisë në pronësi të Zotos gjatë vitit 2017 e deri në 2020. Gjatë kësaj periudhe kohore kompania ka përfituar 402.167.133 mln lekë (3.3 mln euro) që janë pagesa të pafaturuara dhe për të cilat nuk ka një arsyetim kontraktual për t'u kuptuar nga Komisioni Hetimor se përse janë ekzekutuar nga Albtek Energy.

**134.** ITS nuk ka qenë e vetmja kompani që ka përfituar shuma të dyshimta nga llogaritë e koncesionarit të ineneratorit të Elbasanit që u pagua nga taksat e shqiptarëve. Një tjetër kompani është ajo në pronësi e aksionare së vetme të Albtek Energy, Stela Gugallja, që mesa duket përpos Zotos ka menduar që të paguajë edhe kompaninë e sak që nga inceneratori i Elbasanit ka përfituar 21.6 mln lekë për 5 vite me radhë.

**135.** Logjika e transferimit të kapitaleve financiare në tre kompani duket se ka qenë një rrugë e shkelur shpesh për të tre kompanitë e inceneratorëve. Analiza e librave të shitjeve tregon se kompanitë e Zotos dhe Gugalljas të kenë pasur transfertat me shifra të larta nga kompanitë që kanë pasur në pronësi inceneratorët.

**136.** Në këtë mënyrë, kompania ITS që është edhe aksionere në Integrated Waste Treatment Fier, që ka në pronësi inceneratorin e Fierit ka mundur të marrë nga kompania mëmë 1 055 049 450 lekë (8.7 mln euro) duke e marrë pagesën e parë që në vitin 2016 pak ditë pasi kompania ishte paguar me këstin e parë nga buxheti i shtetit. Çifti përfitues Gugallja-Zoto kanë përfituar në total në inceneratorin e Fierit rreth 10 mln euro nga viti 2016 deri në 2021, ajo çka vërehet është se kompania e Gulljas (SE Consulting) ka marrë në mënyrë të vazhdueshme pagesa konstante për punën e saj si audituese njësoj si kompania e Zoto Consulting.



**137.** Në të njëjtën datë në të cilën Bashkia e Tiranës në prani të një përfaqësie të saj drejtuar nga Anëtari i Komisionit të Koncesionit, Taulant Tusha, do t'i dorëzonte kompanisë Integrated Energy BV SPV truallin mbi të cilin do të ngrihej inceneratori, kompania në fjalë nënshkruan një

kontratë me kompaninë e Klodian Zotos. Nën të njëjtin stil dhe mënyrë të kontratës së nënshkruar dy vite më parë mes Albtek Energy dhe ITS. Nga kjo kontratë kompania ITS ka përfituar nga inceneratori i Tiranës, 2.071.099.907 lekë (17.11 mln euro) ndërkohë që dy kompanitë e tjera kanë përfituar në total 54.83 mln lekë.

**138.** Këto kompani kanë përfituar nga të tre kompanitë e inceneratorëve 4.581.176.322 lekë (37.86 mln euro) që është një vlerë e barabartë me 34% të vlerës që kanë marrë këto kompani nga buxheti i shtetit. Ndërkohë që në këtë përlllogaritje nuk është futur të ardhurat që kompania Integrated Energy BV SPV përfiton nga monopoli i depozitimit të dherave jo të rrezikshëm.

#### D. SKEMA ME FATURAT E TVSH

**139.** Në vitin 2018 Prokuroria e Tiranës lajmëroi se kishte prangosur 30 persona në një aksion kundër evazionit fiskal nëpërmjet ngritjes së skemave të mashtrimit. Skema e përshkruar nga organi i akuzës ishte ajo e krijimit të disa kompanive prej qytetarëve të thjeshtë, më pas këto kompani prodhonin fatura fiktive TVSH-je që ia jepnin kompanive nga ku kryhej pagesa. Ndërkohë që pagesat cash ose përmes bankës i shkonin një kompanie tjetër e cila në fund të transaksionit kryente një pagesë simbolike karshi kompanive që prodhonin fatura fiktive TVSH-je për mundimin.


**140.** Nga të dhënat e para që rrodhën në media u mësua se kompania ITS në pronësi të Klodian Zotos ishte një burim financimi për këto kompani sikundër dhe inceneratorët. Ajo çka është e çuditshme dhe që deri më tani nuk kanë dhënë shpjegim, është fakti se kompanitë e përfshira në skemat e mashtrimit fiskal të identifikuar si nga Prokuroria edhe nga Gjykata nuk mund të vepronin vetëm. Mënyra e ngritjes së skemës duhet të thellonte hetimet për të kuptuar se kush janë kompanitë përfituese nga ky mashtrim që në rastin tonë janë kompanitë e Inceneratorëve që kanë kryer pjesën më të madhe të pagesave. Përpara këtij mashtrimi institucionet përgjegjëse si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e Financave nuk ndërmorrën asnjë veprim për të shkuar deri tek përfituesi final i parave.

**141.** Gjatë dëgjësës anëtarët e komisionit hetimor morrën në pyetje disa herë përfaqësuesit e kompanisë dhe jo vetëm në lidhje me kompanitë që kishin kryer evazion fiskal. Nga të dhënat e mbledhura nga ky komision rezulton se kompania Albtek Energy ka paguar 11 kompani nga ato që janë zbuluar me mashtrim tek faturat tatimore. Vlera totale e pagesave kundrejt kompanive fiktive rezulton të jetë 483 448 754 lekë (3.9 mln euro).

**142.** Kompania Integrated Technology Waste Treatment Fier ka paguar për këto kompani vlerën e 463 213 557 lekësh (3.8 mln euro) ndërkohë që kompania Integrated Energy BV SPV ka paguar një shumë të vogël, 33 333 333 lekësh vetëm për kompaninë Pupa Services. Në total vlera që kanë paguar të tre kompanitë që zotërojnë koncesionet e inceneratorëve është 8 mln euro.



## Mashtrimi me faturat e TVSH



**143.** Të dhënat e siguruar nga librat e blerjes për të treja kompanitë tregojnë se kompanitë e proceduara për evazion fiskal dhe mashtrim me faturat e TVSH kanë pasur marrëdhënie me kompanitë Albtek Energy dhe Integrated Technology Waste Treatment Fier. Përfituesja më e madhe në bazë të të dhënave duket se është kompania PIVOT-04 e cila është e vetmja që kemi evidentuar dhe që ka përfituar nga të tre inceneratorët shifrën e 227.2 mln lekësh.

### E. KONKLUZIONE

**144.** Përgjatë 8 viteve tre individë që kanë lidhje të afërta dhe historike me njëri tjetrin, duke përfituar nga miqësitë në sferat e larta të politikës kanë mundur që të sigurojnë 3 kontrata me vlerë mbi 430 mln euro për të ndërtuar tre impiante incenerimi në vend.

**145.** Që nga momenti i nënshkrimit të kontratës e në të tre kompanitë është shfaqur i njëjti person me të njëjtën kompani që ka nënshkruar një kontratë si nënkontraktor. Më tej kompanitë që do të kryenin investimin ndonëse kanë pasur emra të ndryshëm kanë adaptuar të njëjtën taktikë duke i dërguar paratë në të njëjtën formë në bazenin fundor.

**146.** Duke përdorur metodat e përmendura më sipër; transfertën e kapitalit me jashtë, transfertën e parave brenda vendit, përdorimin e formave fiktive të faturave të TVSH me kompani

fiktive dhe gjithashtu duke manipuluar me kontratat e nënshkruara për impaintin e inceneratorit. Këto tre kompani të zotëruara nga i njëjti grup njerëzish kanë përfituar padrejtësisht nga buxheti i shtetit shumë prej 88 348 287 euro.

**147.** Përpos kësaj qeveria shqiptare përmes pushteti vendor ka mundur t'i sigurojë kompanisë Integrated Energy BV SPV një monopol që deri më tani i ka sjellë të ardhura shtesë prej 48.9 mln euro dhe kjo shifër e con në total të ardhurat për inceneratorin e Tirans në 137 mln euro.

**148.** Megjithëse shifrat të dala nga buxheti i shtetit janë të larta, siaps edhe vetë raporteve të KLSH, e ndonjëherë jo të bazuara në llogarinë e Kosto-Përfitim (siç qe rasti i Inceneratorit të Fierit) ato nuk janë justifikuar.

**149.** Si konkluzion nëse do të përlllogarisim një dëm ekonomik ku do të përfshinim të gjitha zërat e përcaktuar më sipër arrijmë në përfundimin që deri më tani këto veprime të kompanive të inceneratorëve i kanë kushtuar 8.52 mld lekë apo 70.42 mln euro duke qenë sa 79.7% e financimit që ka ardhur nga buxheti i shtetit nga viti i parë deri më tani.

<b>Lloji demit</b>	<b>Vlera (lek)</b>
Mashtrim me kontratat	18 500 000
Pagesat Zoto-Gugallja	4 581 176 322
Trasnferta jashte	2 942 179 713
Faturat fiktive TVSH	980 013 644
<b>Demi Ekonomik</b>	<b>8 521 869 679</b>

#### IV. IMPIANTI I TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE ELBASAN

##### A. PROCEDURAT

**150.** Në datën 04.07.2014 Bashkia Elbasan, i dërgon një shkresë me nr protokolli 2437 drejtuar Ministrisë së Mjedisit me lëndë “Kërkesë Emergjente për zgjidhje Konçesionare partneritet publik privat për trajtimin e mbetjeve urbane.

**151.** Me shkresën 7594/1 të datës 09.07.2014 Ministria e Mjedisit i kthen një përgjigje Bashkisë Elbasan duke shtuar se do të ndërtohet një impiant që do ketë për qëllim edhe prodhimin e energjisë nga mbetjet urbane.

**152.** Në datën 11.08.2014 shoqëria “Albtek Energy” i drejtohet Ministrisë së Mjedisit me kërkesë për shprehje interesi për dhënie koncesioni, në mbështetje të së cilës ka depozituar edhe projektin Teknik-Ekonomik të datës 26/06/2014.

**153.** Në vijim të kësaj kërkesë, Këshilli i Bashkisë Elbasan, është shprehur me vendimin me nr. 70 datë 18/09/2014 “Për shpalljen e emergjencës mjedisore për menaxhimin e mbetjeve”, i nënshkruar nga Kryetarja e Këshillit znj. Desantila Tahiraj. Nga proces verbali i mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Elbasan, i datës 18/09/2014, rezulton se të gjithë anëtarët e këshillit kanë votuar pro duke miratuar kështu vendimin e sipërcituar.

**154.** Në datën 22/09/2014 Kryetari i Bashkisë Elbasan i komunikon vendimin e sipërcituar Ministrisë së Mjedisit me shkresën me nr. 36/4 Prot, e cila merr përgjigje nga Sekretari i Përgjithshëm z. Alqi Bllako për caktimin e anëtarëve të komisionit për dhënie koncesioni me objekt: “Dhënie koncesioni për ndërtimin e impiantit të përpunimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit”. Dy ditë më vonë z. Bllako i dërgon shkresë për anëtarë në Komisionin e Koncesioneve Ministrisë së Energjitikës dhe Industrisë, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Tregtisë e Sipërmarrjes dhe Bashkisë Elbasan.

**155.** Në datën 3/10/2014 Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit, i drejtohet Ministrisë së Mjedisit me shkresën me nr. 5721/1 Prot përmes të cilët caktohet përfaqësuesi i kësaj ministrie si anëtar i komisionit të dhënies së koncesionit “Për ndërtimin e impiantit të përpunimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit”, znj. Etleva Kondi, Drejtore e Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit. Ndëkohë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, përmes shkresës me nr. 6926/1 Prot, datë 08/10/2014 informon z. Alqi Bllako për përfaqësuesin e saj në komisionin e dhëniessë koncesionit, i cili do të jetë konkretisht z. Zamir Stefani, Drejtor i Drejtorisë së Privatizimit. Në datën 14/10/2014, Ministria e Mjedisit, shprehet me Urdhërin me nr. 1933, datë 14/10/2014 “Për ngritjen e komisionit për dhënie e koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisë”, në të cilin do të merrnin pjesë: z. Pëllumb Abeshi, z. Zamir Stefani, znj. Etleva Kondi, Znj. Jonida Zeqo, znj. Lediane Karalliu, Z. Bardhi Capiri, z. Stefan Papa. Në këtë kuadër, theksojmë se Ministria e Mjedisit i është drejtuar Ministrisë së Financave me shkresën me nr.10351/1 Prot datë 30/10/2014 duke e njoftuar për fillimin e procedurave për dhënie e koncesionit duke kërkuar miratimin paraprak të (i) Studimit Teknik; (ii) Përshkrimin financiar; (iii) Planin e biznesit. Për përgjigje të kësaj shkresë Ministria e Financave shprehet me shkresën e datës 7/11/2014 për mos miratimin paraprak, pasi nuk plotësohen kërkesat ligjore lidhur me rezultatet e studimit të fizibilitetit që realizohet nga Autoriteti Kontraktor.

**156.** Në datë 11.11.2014 Ministri Koka i dërgon një shkesë zyrtare tre ministrive, Damian Gjijnurit në cilësinë e Ministrit të Eneergjistikës dhe Industrisë, Arben Ahmetaj si Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Teknologjisë dhe Sipërmarrjes, Nasip Naços si ministër i Djretësisë, Shkëlqim Canit si Ministër Financash dhe Eduart Ahmeti si dejtör në Agjencinë e Përgjithshme të Prokurimeve. Ministri Naço shprehet në parim dakord dhe e përcakton projektvendimin për këtë procedurë me karakter individual. Ndërkohë që ministri Gjijnuri shprehet parimisht dakord dhe deklaron se procedura e ndjekur deri më tani është konform ligjit. Nga ana tjetër ministri Ahmetaj shprehet gjithashtu dakord në parim pa komentuar procedurën. Ndërsa ministri Cani shprehet kundër, njësoj shprehet dhe dejtori i APP Eduart Ahmeti që në përgjigjen e tij për procedurën jo ligjore të ndjekur nga Koka ka vendosur dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kryeministrisë, z. Ëngjëll Agaçi.

**157.** Lidhur me sa më sipër, Ministri z. Lefter Koka i drejtohet me disa shkresa të tjera Ministrit të Financave për miratimin e studimit të fizibilitetit dhe draft-kontratës. Në përgjigje të tyre, z. Shkëlqim Cani shprehet me shkresën me nr. 17042/1 Prot datë 10/12/2014 dakordësinë e tij në parim për mbështetjen financiare të propozuar në studimin e fizibilitetit. Arsyeja e letërkëmbimit të gjatë ms ministrit Cani dhe ministrit Koka lidhet së pari me procedurën e ndjekur nga ministri Koka, negociim pa shpallje, e më tej me pasojat financiare të këtij projekti dhe mangësitë e shpejgimeve të zotit Koka në lidhje me këtë koncesion.

**158.** Ndërkohë rezulton se në datën 12/12/2014 është mbledhur përsëri komisioni për dhënien e koncesionit, për të cilën është mbajtur edhe procesverbali me të njëjtën datë. Në këtë procesverbal shprehet se pasi u mor konfirmimi i Ministrit të Mjedisit koncesioni në fjalë do të jepet duke ndjekur procedurën “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit” dhe gjithashtu është vendosur t’i drejtohen shoqërisë “Albtek Energy” shpk me “Ftesë për Ofertë”. Sa më sipër kemi cituar, është vendosur dhe votuar pro nga anëtarët e komisionit si vijon: Z. Pëllumb Abeshi, z. Zamir Stefani, znj. Etleva Kondi, Znj. Jonida Zeqo, znj. Lediana Karalliu, Z. Bardhi Capiri, z. Serafin Papa.

**159.** Në vazhdim të sa më sipër, Ministri i Mjedisit i është drejtuar z. Ëngjëll Agaci, Sekretarit të Përgjithshëm, Këshilli i Ministrave me shkresën me nr. 11902 Prot datë 17/12/2014, me lëndë “dërgohet projektvendimi për shqyrtim e miratim”. Shkresa në fjalë kërkon miratimin e projektvendimit “Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë”. Përmes kësaj shkresën dërgohet: Projektvendimi, relacioni dhe kontrata koncesionare e nënshkruar.

**160.** Ndërkohë, nga dokumentacioni i disponuar rezulton të kemi në dispozicion dy projektvendime. Njëri nga projektvendimet i nënshkruar nga Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, parashtron në mënyrë eksplicite se nuk mund të respektojnë afatet e procedurave të zakonshme për dhënien e koncesionit për këtë arsye theksohet se do të ndiqet “procedura me negociom pa shpallje paraprake të njoftimit”. Gjithashtu, disponohet edhe një projektvendim tjetër parashtron, po ashtu, në relacionin bashkëngjitur se nuk mund të respektohen afatet e procedurave të

zakonshme për shkak të emergjencës duke propozuar një koncesion të përzierër. Po kështu në këtë projekt vendim, rezulton të jetë sugjeruar për miratim ndjekja e procedurës me negociim pa shpallje paraprake, duke referuar në mënyrë të gabuar të kundraligjeshme tek ligjit 125/2013. Pra, shkurtimisht, theksojmë se duke marrë në shqyrtim tërësinë e dokumentacionit të disponuar, rezulton se në këtë rast është ndjekur procedura me negociim pa shpallje.

**161.** Në vazhdim të shkresës të sipërcituar, drejtuar z. Engjëll Agaci, theksojmë se është marrë vendimi i Këshillit të Ministrave me nr. 724, datë 02/11/2014 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm, të rishikuar 2015-2017”, i nënshkruar nga Kryeministri z. Edi Rama, Ministri i Financave z. Shkelqim Cani, Sekretari i Përgjithshëm z. Engjëll Agaci. Në këtë buxhet janë reflektuar zëra për financimin e ndërtimit të Inceneratorit të Elbasanit, gjë e cila provon se është miratuar kërkesa për financimin e projektit dhe gjithashtu është aprovuar procedura e propozuar nga Ministri i Mjedisit.

**162.** Për më tepër, theksojmë se Këshilli i Ministrave është shprehur me vendimin me nr. 907, datë 17/02/2014 “Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të elbasanit dhe prodhimin e energjisë”. Marrja e këtij vendimi, miraton kërkesën e sipërcituar për mbështetje financiare dhe aprovimin e procedurës së propozuar për dhënien e koncesionit. Vlen të theksohet se ndërkohë që realizohen korrespondencat e sipërcituara, Autoriteti Kontraktor (Ministria e Mjedisit) dhe shoqëria “Albtek Energy” shpk kanë nënshkruar Draft Kontratën e Koncesionit në datën 16/12/2014.

**163.** Sic kemi cituar më sipër, në këtë rast shoqëria “Albtek Energy” shpk i është drejtuar Autoritetit Kontraktor (Ministria e Mjedisit), për dijeni të Bashkisë Elbasan, me kërkesë për shprehje interesi për dhënie koncesioni. Në kuptim të ligjit, ky do të konsiderohet një “propozim i pakërkuar”. Për të vlerësuar nëse organet publike kanë vepruar në përputhje me ligji në fuqi do të marrim në analizë: (i) Procedurën e zgjedhur nga Autoriteti Kontraktor për të dhënë këtë koncesion; (ii) Procedurën e ndjekur për ndryshimin e kontratës; (iii) Afati brenda të cilës është mbyllur procedura në fjalë; (iv) Kriteret, parimet mbi të cilat mbështeten procedura e dhënies së koncesionit; (iv) Specifikat e një koncesioni me mbështetje financiare, etj.

**164.** Së pari, ligji me nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” trajton konceptin e “Propozimit të Pakërkuar”, i parashikuar konkretisht tek neni 25 i këtij ligji. Pra, një subjekt mund të drejtohet Autoritetit Kontraktor me një propozim për dhënie koncesioni. Në përputhje me këtë dispozitë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë ta shqyrtojë këtë propozim dhe gjithashtu të bëjë një vlerësim paraprak. Nëse pas këtij vlerësimi, rezulton se ka interes për dhënien e koncesionit, atëherë Autoriteti Kontraktor mund të nis procedurat e përcaktuara në ligj.

**165.** Duke ju kthyer rastit në fjalë, theksojmë se pas vlerësimit paraprak, Autoriteti Kontraktor doli në konkluzionin se ka interes konkret në implementimin e propozimit të shoqërisë “Albtek Energy” shpk, duke vijuar kështu me përgatitjen e: (i) Draftin e kontratës së koncesionit; (ii) Projektvendimin; (iii) Relacionin bashkëngjitur projektvendimit. Në pikën “VI” të këtij

relacioni, i emërtuar “Përmbledhje shpjeguese të përmbajtjes së projektaktit”, parashtrohet se në referencë të nenit 22, pika 3 e ligjit me nr. 125/2013 dhe nenit 33 të ligjit me nr. 9643 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor, mund të zgjedh të ndjek “procedurën me negociim pa shpallje paraprake”. Qëndrim i Autoritetit Kontraktor ose më saktë, zgjedhja e kësaj procedure, konstatohet edhe nga tërësia e korrespondencës midis Autoritetit Kontraktor dhe organeve të tjera publike të sipërcituara.

**166.** Për të vlerësuar nëse Ministria e Mjedisit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka vepruar në përputhje me ligjin në fuqi, duhet të marrim në analizë nenin 22 të ligjit 125/2013. Paraprakisht bëjmë me dije se dispozitat e aplikueshme, në këtë rast, janë ato të ligjit me nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin public privat” pasi në këtë rast objekti i ndërtimit është dhënë me koncesion. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga z. Eduard Ahmeti, i cili në shkresën drejtuar Ministrit të Mjedisit orienton Autoritetin Kontraktor që të respektohen dispozitat e ligjit për koncesionet.

**167.** Përsa i përket parashikimeve të nenit 22 të ligjit 125/2013, në të cilën është bazuar Autoriteti Kontraktor për ndjekjen e procedurës “me negociim, pashpallje paraprake”. Pika 1 e këtij neni parashikon se procedura për dhënien e koncesionit fillon me publikimin e njoftimit të kontratës dhe përfundon me publikimin e njoftimit të fituesit. Pra, qartësisht kjo pikë parashikon detyrimin e Autoritetit Kontraktor për të ndjekur një procedurë me publikimin e njoftimit të kontratës. Më tej, pika 3 e kësaj dispozite, përcakton në mënyrë eksplicite se cilat janë procedurat që mund të ndjek Autoriteti Kontraktor për dhënien e koncesionit, të cilat listohen si në vijim: (i) Procedurë e hapur; (ii) Procedurë e kufizuar; (iii) Procedurë me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

**168.** Pra, qartësisht, neni 22 i ligjit me nr. 125/2013 përcakton në mënyrë ezauruese alternativat e procedurave që mund të zgjedh Autoriteti Kontraktor për dhënien e koncesionit dhe ashtu sic rezulton nga listimi i mësipërm, në asnjë moment nuk parashikohet procedura “me negociim pashpallje paraprake”.

**169.** Në interpretim të nenit 22 theksojmë se ky ligj ofron këto procedura për dhënien e koncesionit edhe për shkak të faktit se parimet bazë në të cilat mbështetet dhënia e koncesionit, sipas nenit 23 të ligjit dhe nenit 14 të VKM 575/2013, janë: (i) Transparenca; (ii) Konkureca e lirë; (iii) Oferta më e favorshme; (iv) Tarifa më e mirë koncesionare. Pra, shkurtimisht theksojmë se procedura e zgjedhur nga Autoriteti Kontraktor jo vetëm që bie në kundërshtim me ligjin në fuqi, por çënon edhe parimet bazë mbi të cilat mbështeten dispozitat e këtij ligji.

#### **Cilët janë personat përgjegjës për zgjedhjen e kësaj procedure?**

**170.** Në përgjigje të pyetjes së sipërcituar, bëjmë me dije se në datë 14/10/2014 Ministria e Mjedisit është shprehur me Urdhërin me nr. 1933, datë 14/10/2014 i Ministrisë së Mjedisit “Për ngritjen e komisionit për dhënien e koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan, për prodhimin e energjisë”. Në këtë urdhër përcaktohet qartësisht se anëtarët e komisionit (përfaqësues të disa Ministrive dhe drejtorive) do

të ishin: z. Pëllumb Abeshi, z. Zamir Stefani, znj. Etleva Kondi, Znj. Jonida Zeqo, znj. Lediana Karalliu, Z. Bardhi Capiri, z. Stefan Papa.

**171.** Në këtë akt, përcaktohen gjithashtu detyrat e komisionit, disa prej të cilave i rendisim si në vijim: (i) Hartimin e studimit të fizibilitetit për koncesionin; (ii) Përcaktimin e procedurës së zbatueshme për dhënien e koncesionit; (iii) Shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të pranuar; (iv) Ndjek zbatimin e procedurës për dhënien e koncesionit, etj.

**172.** Pra, bazuar në sa më sipër, rezultojnë përgjegjës për zgjedhjen e procedurës për dhënien e koncesionit e kishin pikërisht anëtarët e komisionit: z. Pëllumb Abeshi, z. Zamir Stefani, znj. Etleva Kondi, Znj. Jonida Zeqo, znj. Lediana Karalliu, Z. Bardhi Capiri, z. Stefan Papa. Duke zgjedhur një procedurë të kundraligjshme për dhënien e koncesionit, këto subjekte rezultojnë të kene kryer veprën penale: 1. “shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; 2. Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike Neni 259 i K.Penal në kuadër të grupit të strukturuar kriminal; 3. Mashtrim me pasoja të rënda neni 143/3 I K Penal në kuadër të grupit të strukturuar kriminal; vepra të cilat janë të dënueshme sipas ligjit penal.

**A shtrihet kjo përgjegjësi në funksionarë të tjerë?**

**173.** Në përgjigje të kësaj pyetje, sjellim në vëmendjen tuaj se anëtarët e komisionit të sipërcituar, janë njëkohësisht edhe përfaqësues të Ministrive apo Bashkive, sic do të parashtrijmë në vijim. Pjesëmarrja e tyre në këtë komision bëhet e mundur përmes një urdhëri të Ministrit apo Sekretarët e Përgjithshëm. Urdhri i Ministrit të Mjedisit, z. Lefter Koka me nr. 1933, datë 14/10/2014 bën me dije se:

- Z. Pëllumb Abeshi, vepron si Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Mjedisore dhe Jetësimi të Prioriteteve.
- Z. Zamir Stefani vepron si përfaqësues i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
- Znj. Etleva Kondi, vepron si përfaqësuese e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.
- Znj. Jonida Zeqo, vepron si specialist e sektorit të prokurimeve.
- Znj. Lediana Karalliu, specialist në Sektorin e Mbetjeve dhe Aksideteve Industriale.
- Z. Bardhi Capiri, përfaqësues i Bashkisë Elbasan.
- Z. Serafin Papa përfaqësues i Bashkisë Elbasan.

**174.** Pra, sa më sipër kemi cituar, vlen të theksohet se përvec anëtarëve që kanë vepruar si përfaqësues të Ministrit të Mjedisit, anëtarët e tjerë të komisionit kanë vepruar si përfaqësues të: (i) Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes z. Arben Ahmetaj; (ii) Ministri i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë z. Damian Gjijnuri; (iii) Kryetari i Bashkisë Elbasan z. Qazim Sejdi. Pra, qartësisht konstatohen se Ministrat e përmendur më sipër kanë patur dijeni të plotë për shkeljet proceduriale që ishin duke u kryer. Ky konstatim përforcohet edhe nga fakti se këta Ministra kanë marrë dijeni të drejtëpërdrejtë për procedruën e dhënies së këtij koncesioni përmes korrespondencës së tyre me Ministrinë e Mjedisit, përmes së cilës këta

fuksonarë japin mendimin dhe miratimin e tyre për dhënien e koncesionit në fjalë. Një nga shkresat që mund të citojmë në këtë rast është shkresa me nr.10843 Prot, datë 11/11/2014. Në rastin e Ministrit z. Arben Ahmetaj konfirmimi i projektvendimit është kryer përmes shkresës me nr. 7975/1 Prot, të datës 14/11/2014. Ndërkohë, Ministri z. Damian Gjikhuri ka dhënë miratimin e tij me shkresën e datës 17/11/2014 në të cilën shprehet se parimisht është dakord, duke deklaruar më tej se procedura e përzgjedhur është e saktë dhe në përputhje me ligjin (pra procedura me negociim pashpallje), gjë e cila qartësisht bien ë kundërshtim me ligjin.

**175.** Në dijeni të plotë të kësaj procedure të kundraligjshme ka qenë edhe Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit z. Ëngjell Agaçi. Ai ka qenë i informuar për këtë procedurë pasi Eduart Ahmeti në përgjigjen e drejtuar Lefter Kokës e ka vendosur z. Agaçi në Dijeni. Jo vetëm kaq por z. Agaçi në bazë të Ligjit 9000/2003 Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Ministrave” në nenin 9 gërma b) detyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave është ajo e “ndjekjes së procesit vendimmarrës së Këshillit të Ministrave, që nga paraqitja e projektakteve për shqyrtim e derisa aktet të marrin fuqi ligjore, në kuptimin e kushtetutës”. Për rrjedhojë një nga detyrat e zotit Agaçi ka qenë ajo e administrimit dhe shqyrtimit të akteve dhe relacionit mbi të cilin u dorëzua projektvendimi që më pas u shndërrua në VKM 907 të datës 17.12.2014. Ndonëse Sekretari i Përgjithshëm deklaroi në dëgjuesën publike përpara këtij Komisioni Hetimor se procedura e ndërmarrë në kundërshtim me ligjin nga Ministri Koka nuk vazhdoi më tej, faktet dhe provat konfirmojnë të kundërtën. Ndërkohë që z. Agaçi dhe asnjë dëshmitar tjetër nuk mundi të paraqesë përpara Komisionit fakte dhe prova përmes shkresave në lidhje me procedurën tjetër të presupozuar. Vlen të theksohet gjithashtu që gjatë dëshmisë së tij në Komisionin Hetimor z. Agaçi u shpreh se procedura për këtë koncesion ka nisur në Korrik 2014, duke ripohuar edhe një herë faktin se kemi të bëjmë me vetëm një procedurë. Për rrjedhojë z. Agaçi është përgjegjës po ashtu për miratimin e një projektvendimi që është ngritur mbi procedura jo ligjore dhe ka vepruar kështu ndonëse ka qenë i informuar më parë nga drejtori i APP.

**176.** Pra, nga sa analizuam më sipër, në përputhje me nenin 248 të Kodit Penal, rezulton se jemi para veprës penale të: 1. “shpërdorimit të detyrës” parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; 2. Korrupsion pasiv i zyrtarëve të lartë dhe i të zgjedhurve lokalë që ushtrojnë funksione publike Neni 259 i Kodit Penal në kuadër të Grupit të Strukturuar Kriminal; 3. Mashtrim me pasoja të rënda neni 143/3 i Kodit penal në kuadër të GRupit të Strukturuar Kriminal; 4. Pastrim i produkteve të veprës penale në kuadër të grupit të strukturuar Kriminal, parashikuar nga neni 28, pika 4 dhe 333/a e Kodit Penal nga: “z. Lefter Koka, z. Arben Ahmetaj, z. Damian Gjikhuri, z. Engjell Agaci, Z. Qazim Sejdini, z. Alqi Bllako (bazuar kjo në të gjitha provat e administruara nga Komisioni si shkresore edhe dëshmitë në Komision); z. Pëllumb Abeshi, z. Zamir Stefani, znj. Etleva Kondi, znj. Jonida Zeqo, znj. Lediana Karalliu, Z. Bardhi Capiri, z. Stefan Papa.

**177.** Sa përmendur më sipër, pra, zyrtarë të lartë në cilësinë e ministrit, kryetarët e bashkive, sekretarin e përgjithshëm në kryeministri dhe atë në Ministrinë e Mjedisit dhe anëtarë të Komisionit. Pavarësisht veprave të cilat ndryshojnë sipas individualiimit dhe rolit të gjithsecilit në këtë skemë kanë vepruar në kuadër të një Grupi të Strukturuar Kriminal që në bashkëpunim me



njëri-tjetrin në mënyrë direkte dhe indirekte për të vepruar. Këto dyshime përforcohen edhe më tepër nëse do të marrim në konsideratë edhe arrestimin e ish ministrit z. Lefter Koka, nga Struktura e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

**178.** Së dyti, një element i rëndësishëm i procedurës është dhe respektimi i afateve ligjore për dhënien e koncesionit. Në këtë drejtim duhet të citojmë nenin 26 të ligjit me nr. 125/2013 i cili parashikon se autoriteti kontraktor nuk mund të lidh kontratën para skadimit të periudhës së pritjes së ankesave. Pika 2 e këtij neni parashikon se lidhja e kontratës para përfundimit të afatit të njoftimit të klasifikimit apo para se të ketë përfunduar shqyrtimi administrativ e bën atë absolutisht të pavlefshme. Për të verifikuar nëse këto afate janë respektuar nevojitet që të analizojmë veprimet e kryera nga Autoriteti Kontraktor, si dhe nga organe të tjera publike.

**179.** Konkretisht, në datën 16 Dhjetor 2014, në kuadër të dhënies së këtij koncesioni, janë kryer 17 veprime procedurale brenda një dite pune. Në këtë ditë është shpallur fituese e shoqëria “Albtek Energy” shpk. Nga ky cast, në përputhje me ligjin e kohës, operatorët ekonomik duhet të kishin në dispozicion një afat 7 ditor (ditë pune) për të ushtruar të drejtën e ankimit. Autoriteti Kontraktor e ka mbyllur këtë hapsirë ligjore po ashtu brenda datës 16 (ditë kur është shpallur fituesi) me arsyetimin se nuk është paraqitur asnjë ankesë (ndërkohë afati për paraqitjen e ankesave fillonte po nga kjo datë). Po brenda datës 16 Dhjetor hartohet Draft Kontrata, e cila brenda ditës i dërgohet për mendim Ministrisë së Financave z. Shkelqim Cani, Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë z. Damian Gjoknuri dhe Ministrit të Drejtësisë z. Nasip Naco. Po ashtu brenda datës 16, draft kontrata në fjalë i dërgohet për mendim edhe Agjencisë së Prokurimit Publik z. Eduard Ahmeti si dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave z. Ëngjëll Agaci. Brenda datës 16 Dhjetor merret gjithashtu përgjigja nga Ministri i Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

**180.** Pra sa më sipër kemi cituar, është më se e qartë se në këtë rast jo vetëm që janë shkelur në mënyrë flagrante dispozitat ligjore lidhur me afatet, por në mënyrë të paprecedent janë kryer 17 veprime nga Ministri të ndryshme vetëm për arritjen e këtij qëllimi, e cila imponon dyshime të forta për bashkëpunimin e Ministrive në nivel drejtues dhe jo vetëm për dhenien e këtij koncesioni në kundërshtim me ligjin e kohës.

**181.** Gjithashtu, në kontekstin e afatit për dhënien e koncesionit vlerësojmë me rëndësi thelbësore interpretimin e dispozitave të VKM-së me nr. 575/2013. Ky akt parashikon në mënyrë të qartë se vlerësimin paraprak që i bëhet propozimit të pakërkuar, konkretisht neni 12 i saj, do të kalojë në disa faza. Në fazë e parë do të bëhet vlerësimi për të parë nëse plotësohen kushtet ligjore për realizimin e propozimit të bërë. Ndërkohë, gjatë fazës së dytë do të vlerësohet analiza e parashtruar në studimin paraprak për të verifikuar nëse mund të arrihen objektivat e projektit apo nëse i shërben interesit public, etj. Në vijim pika 6 e këtij neni parashikon se rezultatet e të dhënave paraprake materializohen në një studim paraprak për të cilin duhet të merret një periudhë jo më e gjatë se 90 ditë nga data e paraqitjes së propozimit.

**182.** Në vazhdim theksojmë se jo vetëm që nuk është respektuar afati kohor i fazave të sipërcituara, por e gjithë procedura filluar nga propozimi i pakërkuar i datës 11/08/2014, deri në nënshkrimin e draft kontratës në datën 16/12/2014 është zhvilluar në vetëm 4 muaj, ku vlen të theksohet se vetëm brenda datës 16 janë ezauruar 17 procedura tepër të rëndësishme për dhënien e koncesionit. Qartësisht nga sa kemi cituar më sipër, rezulton se jemi para një shkeljeve flagrante e dispozitave ligjore.

### *A implikohen funksionarë të tjerë nga kjo ngjarje?*

**183.** Ashtu sic bëjmë me dije edhe më sipër, brenda datës 16 projektvendimi, draft kontrata, relacioni përkatës u është dërguar për mendim, vec të tjerëve edhe Z. Engjëll Agaci, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave. Ndryshe nga subjektet e tjera, z. Engjëll Agaci ka një pozitë më të vecantë pasi ka dhënë miratimin (përmes nënshkrimit) e tij për supportin financiar të koncesionit, e cila lidhet drejtëpërdrejtë me shpërdorimin e fondeve publike.

**184.** Në këtë kuadër, evidentojmë se Z. Agaci, ashtu si dhe subjektet e sipërcituar, kishte dijëni të plotë për faktin se koncesioni ishte duke u dhënë me anë të një procedure të kundraligjshme dhe përvec se nuk e kallzoi veprën penale të shpërdorimit të detyrës, me veprime aktive ai është përfshirë edhe vetë në këtë skemë. Pra, shkurtimisht bëjmë me dije se nga dokumentacioni i disponuar dhe nga analiza e kryer, rezulton se z. Egjëll Agaci, ka konsumuar veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe gjithashtu dyshohet për korrupsion pasiv, mashtrim dhe pastrim paash që janë pjesë esenciale të grupit të strukturuar kriminal, për të cilin kemi akuzuar sipas paraqitjes së kryer më sipër.

**185.** Së katërti, përse i përket procedurës që duhet të ndiqej për ndryshimin e kontratës. Ashtu sic konstatohet nga dokumentacioni i disponuar, “Draft kontrata e koncesionit” ka pësuar ndryshim përmes “Aneksit D”, me nr. 11026/19 Prot, datë 12/05/2015 i emërtuar “Ndryshimi i kontratës së Koncesionit të formës BOT (Ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit”.

**186.** Referuar nenit 31 të ligjit 125/2013 ndryshimi i kontratës është i mundur vetëm nëse dicka e tillë është parashikuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Duke mos e patur në dispozicion DST e kësaj procedure tenderimi, nuk mund të verifikojmë nëse është i parashikuar mundësia e ndryshimit apo jo. Pavarësisht kësaj, theksojmë se nëse ndryshimi i sipër cituar, nuk do të ishte i parashikuar në DST-në e tenderit atëherë ndryshimi i kontratës do të kërkonte ndjekjen e një procedure të re për dhënien e koncesionit.

**187.** Për më tepër theksojmë se neni 23 i VKM-së 575/2013, i emërtuar “Miratimi i ndryshimeve ose i transferimeve të kontratës” referuar një rasti të tillë, parashikon se ndryshimi i kontratës së koncesionit mund të kryhet vetëm me miratimin e Ministrit të Financave, të cilit i bëhen me dije shkaqet e ndryshimit dhe i jepet mundësia të vlerësojë impaktin që do të ketë në

buxhetin e shtetit. Pra, qartësisht edhe nëse nuk verifikohet dot mundësia e ndryshimit të kontratës bazuar tek parashikimet e DST-së, përsëri arrijmë në konkluzionin që Autoriteti Kontraktor ka vepruar në shkelje të ligjit pasi nuk rezulton të jetë marrë miratimi paraprak i Ministrisë të Financave.

**188.** Përsa i përket procedurës dhe kriteret e vlerësimit për projektet me koncesion që kërkojnë mbështetje financiare: neni 17 i VKM 575/2013, i emërtuar “Miratimi para shpalljes së procedurës së dhënies me koncesion”, parashikon se projektet të cilat kërkojnë mbështetje financiare dorëzohen pranë Ministrisë së Financave për miratim, pavarësisht nëse këmi të bëjmë me një propozim të kërkuar apo jo. Pika 2 e këtij neni, parashikon se Autoriteti Kontraktor (Ministria e Mjedisit) kërkon miratimin paraprak para shpalljes së procedurës për dhënie e koncesionit. Pra, evidetohen dy element: (i) Marrja e miratimit të Ministrisë të Financave; (ii) Në këtë rast procedura duhet të jetë me shpallje.

**189.** Nga dokumentacioni i disponuar evidetojmë Ministri i Mjedisit i është drejtuar Ministrisë të Financave me disa shkresa për miratimin. Ky i fundit rezulton të jetë përgjigjur me shkresën me nr. 17042/1 Prot, datë 10/12/2014 përmes të cilës bëhet me dije dakortësia në parim për mbështetjen financiare të propozuar në studimin e fizibilitetit. Ndërkohë, theksojmë këtu se dispozitat e VKM-së 575 nuk kërkojnë një miratim në parim përmes një korrespondence të thjeshtë. Pika 3 e nenit 18 të këtij akti parashikon se Ministria e Financave duhet të shprehet me vendim për rastin në fjalë dhe t’ja njoftoj atë Autoritetit Kontraktor.

**190.** Në vazhdim të sa më sipër, vlen të theksohet gjithashtu se nëse pas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, Ministria e Financave nuk shprehet me vendim brenda afateve ligjore (brenda 45 ditësh), atëherë projekti do të konsiderohet i miratuar. Në rastin në fjalë vlerësojmë se ky parashikim nuk aplikohet, pasi edhe nëse do të hipotetizojmë duke argumentuar se projekti është miratuar në heshtje duke mos e refuzuar mbështetjen financiare brenda afatit, përsëri do të rezultonte se jemi para shkeljes së dispozitave ligjore pasi Autoriteti Kontraktor ka nënshkruar kontratën e koncesionit para përfudimit të afatit 45 ditor. Pra, shkurtimisht theksojmë se kërkesa e Ministrisë së Mjedisit për miratimin e projektit mban nr. 11026/3, datë 10/12/2014, ndërkohë kontrata e koncesionit është nënshkruar në datën 16/12/2014. Pra, konkretisht brenda 6 ditëve është ezauruar e gjithë procedura.

**191.** Për rrjedhojë, vlerësojmë se jemi para dy skenarëve:

- (i) Skenari nr. 1: Ministri i Financave ka miratuar mbështetjen financiare në kundërshtim me formën e kërkuar nga ligji i kohës;
- (ii) Skenari nr.2: Ministri i Financave nuk është shprehur me vendim për miratimin e mbështetjes financiare, ka synuar miratimin në heshtje dhe përsëri rezulton që Ministria e Mjedisit të ketë nënshkruar kontratën e koncesionit në kundërshtim flagrant të dispozitave procedurale, pa kaluar afati 45 ditor.

**192.** Një element thelbësor në kuadër të mbështetjes financiare në këtë rast është edhe miratimi nga Këshilli i Ministrave për sigurimin e financimit. Konkretisht theksojmë se në datën

17/12/2016, pra një ditë pas nënshkrimit të kontratës, Këshilli i Ministrave është shprehur me vendimin me nr. 907 “Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë”. Praktikisht, përmes këtij vendimi, të nënshkruar nga z. Niko Peleshi, në cilësinë e Zëvendës Kryeministrit, me porosi të Kryeministrit z. Edi Rama, është miratuar sigurimi i mbështetjes financiare për koncesionin në fjalë, pavarësisht të gjitha shkeljeve procedurale të cilat provojnë shpërdorimin e detyrës dhe të fondeve publike me qëllim përvetësimin e tyre. Ashtu sic mund të verifikohet edhe nga vendimi në fjalë, si nënshkruer i tij rezultojnë të jetë edhe Sekretari i Përgjithshëm, z. Ëngjell Agaci si dhe Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka.

**193.** Qartësisht Kryeministri z. Edi Rama, Zv. Kryeministri z. Niko Peleshi, Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, Ministri i Financave, Sekretari i Përgjithshëm z. Engjell Agaci rezultojnë të konsumuar veprën penale të shpërdorimit të detyrës me veprime aktive, përmes të cilës i kanë shkaktuar një dëm të jashtëzakonshëm buxhetit të shtetit.

**194. Konkluzion:** Bazuar në analizë e sipërcituar, rezultojnë se funksionarë të lartë dhe jo vetëm, të kenë kryer shkelje flagrante të dispozitave ligjore, duke dhënë një koncesion në kundërshtim të plotë me ligjin. Shkeljet procedurale të konstatuara sjellin si rrjedhojë pavlefshmëri absolute të akteve dhe vendimeve të mara. Nga hulumtimi i zhvilluar rezultojnë se është konsumuar vepra penale e shpërdorimit të detyrës nga: Kryeministri z. Edi Rama, Zv. Kryeministri z. Niko Peleshi, sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit z. Ëngjell Agaçi Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, Sekretari i Përgjithshëm z. Engjell Agaci, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Damian Gjoknuri, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes z. Arben Ahmetaj, Sekretari i Përgjithshëm i ministrit të Mjedisit z. Alqi Bllako, anëtarët e komisionit z. Pëllumb Abeshi, z. Zamir Stefani, znj. Etleva Kondi, znj. Jonida Zeqo, znj. Lediana Karalliu, Z. Bardhi Capiri, z. Stefan Papa.” Sic është argumentuar më sipër, ekzistojnë dyshime të arsyeshme që funksionarët e sipërcituar të kenë kryer veprën penale të korrupsionit pasiv për të realizuar përfitime të parregullta, të kundërligjshme në dëm të buxhetit të shtetit, duke paraqitur rrethana të rreme apo duke prezantuar fakte të pavërteta, në bashkëpunim me njëri tjetrin në formën e grupit të strukturuar kriminal, me të vetmin qëllim përvetësim e padrejtë të të ardhurave dhe përfitimeve të buxhetit të shtetit dhe më pas vënin në qarkullim të këtyre të ardhurave produkt i veprave penale, duke konsumuar kështu edhe veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale.

#### **Lidhur me dëmin e shkaktuar buxhetit të shtetit**

**195.** Duke u bazuar tek parashikimet e ligjit me nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin public privat” si dhe tek VKM 575/2013 rezultojnë se procedura e ndjekur për dhënien e këtij koncesioni vjen në kundërshtim të plotë dhe në shkelje flagrante të ligjit të kohës.

**196.** Bazuar në analizën e sipërcituar, rezultojnë se kontrata e koncesionit e nënshkruar në datën 16/12/2014 si dhe amendimet e saj janë absolutisht të pavlefshme në kuptimin e ligjit

shqiptar. Qartësisht, cdo fond apo mbeshtetje financiare që është alokuar apo do të alokohet në kuadër të këtij koncesionit do të përlllogaritet si dëm kundrejt buxhetit të shtetit.

**197.** Për më tepër, dëmi që pëson buxheti i shtetit reflektohet edhe në një aspekt tjetër. Nëse për një moment do të konsiderohenim që Autoriteti Kontraktor do të ndiqte një procedurë të rregullt e cila do të nxiste pjesëmarrjen e Operatorëve të ndryshëm Ekonomik, të synonte pranimin e ofertës më të favorshme, tarifës më të lartë koncesionare etj, përfitimet e shtetit, në këtë rast, do të ishin më të larta dhe shpenzimet nga Buxheti pa pasur nje produkt akoma edhe sot do ishin më të vogla.

## B. ZBATIMI I KONTRATËS

**199.** Së pari, referuar Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për auditimin e ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë” rezulton se janë konstatuar disa parregullsi referuar kontratës me objekt “Ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë”. Nga parashtrimet e bëra në faqen 49 të këtij raporti rezulton se një pjesë e mirë e punimeve të kryera nga shoqëria “Albtek Energy” shpk në kuadër të ndërtimit të impiantit nuk janë të shoqëruara me faturat tatimore përkatëse nga operatori. Më tej, raporti vijon duke parashtruar se: Nuk ka një raport përmbledhës mbi punimet e kryera deri në periudhën raportuese nga mbikqyrësit, në rastin konkret nga njësia e zbatimit të projektit. Ndërkohë, pavarësisht kësaj parregullsie, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vijuar me lëshimin e urdhër pagesave, në favor të shoqërisë “Albtek Energy” shpk, për të likujduar vlerën e punimeve që janë pretenduar si të kryera. Vlen të theksohet se urdhër pagesat janë nënshkruar nga Ministri, z. Damian Gjijnuri. Pra shkurtimisht, theksojmë se shoqëria “Albtek Energy” shpk ka pretenduar kryerjen e punimeve të caktuara për ndërtimin e impiantit, por ndërkohë nuk dispononte asnjë faturë tatimore për të dëshmuar kostot e ndërtimit. Pavarësisht këtij fakti, Z. Damian Gjijnuri ka vazhduar të lëshojë urdhër pagesart për mbulimin e kostove të punimit.

**200.** Në vazhdim, theksojmë se duke ju referuar këtij raporti, konstatohet se në memon e datës 30/11/2017 drejtuar Ministrit z. Damian Gjijnuri jepet informacion i plotë për zbatimin e kontratës. Në këtë memo bëhet me dije, ndër të tjera, se bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Ministria e Mjedisit rezulton se projekti teknik është implementuar dhe disbursuar deri në muajin shtator 2017 në vlerën 10 mln Euro, e cila përbën 40% të vlerës totale të projektit të realizuar nga koncesionari. Pavarësisht kësaj, bëhet me dije se nuk ka një raport përmbledhës mbi punimet e kryera deri në periudhën raportuese nga mbikqyrësi.

**201.** Qartësisht evidentimet e bëra në Raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit nxjerrin në pah problematika serioze lidhur me zbatimin e kontratës dhe gjithashtu ngrenë dyshime serioze për korrupsion.

**202.** Në vijim të analizës, rezulton se përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës janë pikërisht Ministrinë përkatëse të sipërcituara, si: (i) Ministria e Mjedisit e cila mban cilësinë e

Autoritetit Kontraktor; (ii) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; (iii) Ministria e Financave; (iv) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

**203.** Së dyti, përsa i përket ndërtimit të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike, operimit të tij dhe transferimit të aseteve e të drejtave tek Autoriteti Kontraktor në përfundim të afatit të koncesionit.

**204.** Fillimisht rikujtojmë se shoqëria “Albtek Energy” shpk ka nënshkruar kontratën e koncesionit me nr. 11026/7 Prot datë 16/12/2014 të formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit. Pra, qartësisht kjo kontratë është lidhur për ndërtimin, operimin dhe në vijim, në përfundim të afatit të koncesionit, transferimin e aseteve. Referuar Aneksit A, pika 4, e emërtuar “Periudha e Koncesionit” parashikohet se ky koncesion jepet për një periudhë 7 vjecare. Më tej, po e njëjta pikë parashikon dy rastë në të cilat do të bëhej e mundur shtyerja e afatit të koncesionit, të cilat janë si në vijim: (i) Kur jemi para rastit të mospagesës nga Autoriteti Kontraktor; (ii) Kur jemi para ngjarjeve të forcës madhore, e cila mund të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur ngjarja plus kohën e nevojshme për riparimin e dëmeve.

**205.** Qartësisht në rastin në fjalë nuk provohet asnjë nga kushtet që do të lejonte shtyerjen e afatit të koncesionit dhe për këtë arsye konkludojmë se afati i këtij koncesioni do të përfundonte në vitin 2021, kohë në të cilën duhet të kishte përfunduar transferimin e aseteve.

**206.** Pika 26 e kontratës së koncesionit parashikon se 6 muaj para përfundimit të afatit 7 vjecar, do të fillojë periudha kalimtare, në të cilën fillon procesi i transferimit të aseteve, pra të dorëzimit të impiantit. Pika 26.2 i kësaj kontratë parashikon se; (i) cdo impiant duhet të jetë në gjëndje të mirë, i mirëmbajtur, i aftë të plotësojë kushtet minimale teknike, ejt. (ii) Të drejtat e koncesionit automatikisht shuhet dhe Koncesionari nuk ka të drejtë të përdori dhe të gëzojë impiantet përkatëse; (iii) Koncesionari menjëherë i transferon Autoritetit Kontraktues, pa pagesë dhe pa barrë apo peng të gjitha të drejtat e koncesionarit. Pra, shkurtimisht referuar parashikimeve kontraktore, me përfundimin e periudhës kalimtare duhet të kishte përfunduar transferimi i plotë i të gjitha aseteve dhe të drejtave mbi impiantet tek Autoriteti Kontraktor.

**207.** Nga dokumentacioni i disponuar rezulton se në datën 31.10.2016 është nxjerrë Akt Miratimi i Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës me nr. 4557/7, të lëshuar nga z. Damian Gjijnuri, me titull “Ndërtimi dhe shfrytëzimit i impiantit me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane, në qytetin e elbasanit, nga shoqëria “Albtek Energy” shpk i shoqëruar nga Vendimi me nr. 792, datë 09/11/2016 “Për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane, në qytetin e elbasanit, nga shoqëria Albtek Energy shpk”.

**208.** Aktet në fjalë i japin të drejtën shoqërisë “Albtek Energy” shpk për të ndërtuar impiantin me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane brenda një periudhë 18 mujore. Në pikën 7 të këtij akti, parashikohet se kohëzgjatja e këtij miratimi vlen për një afat 25 vjecar dhe në këmbim shoqëria “Albtek Energy” shpk do t’i paguajë cdo vit ministrisë përgjegjëse për

energjinë (Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës) një “royalty” të barabartë me 2% të sasisë vjetore të energjisë së prodhuar ose vlerën në lekë të kësaj sasive së bashku me cdo përfitim tjetër shtesë.

**209.** Nga një analizë e thelluar rezulton se përmes akteve të sipërcituara Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës ka dhënë një koncesion të dytë, në favor të shoqërisë “Albtek Energy” shpk, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit për një afat 25 vjetë, kundrejt një royalty, e cila laun rolin fee-së koncesinare.

**210.** Theksojmë paraprakisht se e gjithë procedura e dhënies së këtij koncesioni është kryer është në kundërshtim të plotë me ligjin në fuqi, për sa do të analizojmë në vijim. Pra, shkurtimisht rezulton të jemi para këtyre rrethana fakti:

(i) Shoqëria “Albtek Energy” shpk ka lidhur një kontratë koncesioni për ndërtimin, operimin dhe transferimin e impiantit të energjisë në qytetin e Elbasanit, të cilës i mbaronte afati në vitin 2021, kohë në të cilin duhet të ishte konkluduar transferimi i aseteve dhe të drejtave tek Autoriteti Kontraktor;

(ii) Pa përfunduar afati i kontratës së koncesionit, pra në vitin 2016, rezulton të jetë dhënë një koncesion i dytë mbi këtë impiant nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, konkretisht nga Ministri z. Damian Gjikhuri, për një afat 25 vjeçar, kundrejt një fee-je koncesionare prej 2% të prodhimit vjetor;

(iii) Pavarësisht se ka përfunduar afati i kontratës së parë koncesionare, rezulton se nuk janë transferuar asetet dhe të drejtat tek Autoriteti Kontraktor, por madje koncesionari do të ketë të drejtën e shfrytëzimit të impiantit të energjisë deri në fund të afatit 25 vjeçar;

(iv) Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, e cila tashmë shfaqet në cilësinë e Autoritetit Kontraktor rezulton të ketë dhënë një koncesion pa respektuar procedurat e përcaktuara nga ligji me nr. 125/2013, në shkelje të parashikimeve të VKM-së 575/2013 dhe pa garë. Sjellim në vëmendje se analizën ligjore referuar procedurës për dhënien e koncesionit e kemi trajtuar më sipër në pikën “II. PROCEDURA”, konkretisht pika 11-44 të këtij materiali. Për rrjedhojë nuk do të ndalemi më gjatë në këtë pikë;

(v) Gjithashtu, Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “Albtek Energy” shpk, palë të kontratës së koncesionit me nr. 11026/7 Prot datë 16/12/2014, rezultojnë të kenë vepruar në shkelje të plotë të detyrimeve kontraktore.

**211.** Vlen të theksohet se Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës është bazuar tek vendimi me nr. 822, datë 07/10/2015 i titulluar “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”. Vendimi në fjalë trajton rastet e impianteve apo kapaciteteve të reja prodhuese, të cilat nuk janë objekt koncesioni dhe qartësisht referimi tek parashikimet e këtij Vendimi me nr. 822, datë 07/10/2015 janë të pabazuara pasi impianti i prodhimit të energjisë me rikuperim nga trajtimi i mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit ishte dhënë me koncesion me kontratës e datës 16/12/2014, e cila kishte një afat 7 vjeçar, që konkludohej me transferimin e të gjithë aseteve dhe të drejtave. Pra, qartësisht nuk mundet, kurrsesi, të jepet me koncesion 2 herë, i njëjti objekt, për ndërtim, shfrytëzim dhe transferim.

**212.** Shkurtimisht, theksojmë se aktet e nxjerra dhe procedurat e ndjekura për dhënien e këtij koncesioni me afat 25 vjecar, përbëjnë një shkelje të paprecedentë dhe vijnë në kundërshtim të hapaur me: (i) ligjin me nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe pratneritetin public privat; (ii) VKM 575/ 2013; (iii) Kontratën e Koncesionit me nr. 11026/7 Prot datë 16/12/2014, e cila ka fuqinë e ligjit për palët; (iv) Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, etj.

**213.** Qartësisht, nga analiza e sipërcituar, rezulton se Ministri i Energjisë dhe Infrastrukturës ka konsumuar veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe gjithashtu vlen të theksohet se ka dyshime të arsyeshme dhe gati të pamohueshme për kryerjen e korrupsionit pasiv nga Ministri në fjalë dhe të korrupsionit aktiv nga shoqëria “Albtek Energy” shpk, për përfitimin e këtij koncesioni me afat 25 vjecar, në kundërshtim të plotë me ligjin në fuqi. Sic është e ditur, veprimet e kundraligjshme të cituara më sipër janë të dënueshme nga ligji penal dhe gjithashtu dëshmojnë një dëm thelbësor të buxhetit të shtetit.

**214.** Së treti, sjellim në vëmendjen tuaj se parregullsitë lidhur me zbatimin e kontratës së koncesionit vijonë edhe më tej. Duke ndërtuar impiantin e prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria “Albtek Energy” shpk kërkon të pajiset me licensë nga Enti Rregullator i Energjisë, i cili rezulton të jetë shprehur me vendimin me nr. 51, datë 31/03/2017 për “Licensimin e shoqërisë “Albtek Energy” shpk në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti i përpunimit të mbetjeve urbane, me fuqi të instaluar 2850KËH”.

**215.** Në vazhdim të sa më sipër, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, shprehet me vendimin me nr.27, të datës 17/01/2018 për përcaktimin e metodologjisë për përlllogaritjen e cmimit, në vijim të të cilit, bazuar në ligjin me nr. 7/2017, shoqëria “Albtek Energy” shpk, i drejtohet Entit Rregullator të Energjisë me kërkesë për llogaritjen dhe përcaktimin e cmimit të energjisë elektrike. Nga shqyrtimi kërkesës të këtij subjekti ERE konstaton (referohju vendimit me nr. 156, datë 29/10/2019) se vendimi i këshillit të ministrave parashikon se: “Teknologjitë e prodhimit të energjisë së rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme të Mbetjeve të Ngurta mund të llogaritet në nivelin nga 1 deri në 2 MË impiante locale të instaluar pranë depozitave të MNU, të cilat janë fleksibël për zinxhirin e asgjësimit të këtyre mbetjeve të biodegradueshme në përqëndrimet pranë qendrave relativisht të mëdha në vëndin tonë”.

**216.** Nga analiza e vendimit të sipërcituar, ERE ka arritur në konkluzionin se përlllogaritja e cmimit sipas metodologjisë se përcaktuar nga Këshilli I Ministrave në vendimin me nr. 27, datë 17/01/2018 do të nxirte për rrjedhje një cmimi të pajustificuar pasi metodologjia i referohet impianteve me kapacitet prodhimi nga 1 deri në 2 MË, ndërkohë që impianti në fjalë ka kapacitet prodhimi me të lartë, kontretisht 2850 KË ose 2.85 MË. Bazuar në sa më sipër, ERE ka refuzuar kërkesën e shoqërisë “Albtek Energy” shpk për përcaktimin e cmimit të shitjes së energjisë elektrike nga impianti i përpunimit të mbetjeve urbane me fuqi të instaluar 2850 KË.

**217.** Nga analiza e sipërcituar, lindin dyshime të arsyeshme për shkelje të metejshme të dispozitave ligjore në fuqi pasi shoqëria “Albtek Energy” ka vijuar me shitjen e energjisë



elektrike. është i sakte ky informacion, sepse nuk mund të shitet energji pa marrë miratim nga ERE? Dhe pyetja që lind është çfare aktiviteti po ushtrojnë këta të pakontrolluar nga operatorët shtetërorë që pasjell edhe një sërë veprash të tjera penale. Duhet verifikuar informacioni.

**218.** Lind pyetja: Si është përcaktuar cmimi i energjisë elektrike për këtë subjekt? Qartësisht neni 10, pika 3, i ligjit me nr. 10/2017 parashikon se kompetencën për caktimin e cmimit për prodhuesit me kapacitet me të lartë se 2MË e ka ERE, bazuar në metodologjinë e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Aktualisht, nuk rezulton të jetë nxjerrë një vendim tjetër nga Këshilli i Ministrave për të korigjuar të metat e metodologjisë të vendimit 27/2018.

**219.** Në vazhdim, theksojmë se nëse cmimi i energjisë elektrike është përcaktuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në metodologjinë e parashikuar tek vendimi me nr. 27/2018 i K.M, atëherë bëjmë me dije se kjo do të binte në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe në tejkalim të kompetencave të organeve publik, pasi qartësisht kjo kompetencë i është njohur Entit Rregullator të Energjisë.

**220.** Së katërti, vlerësojmë me rëndësi të trajtojmë edhe një çështje të fundit lidhur me Inceneratorin e Elbasanit. Nga dokumentacioni i disponuar kemi arritur të evidetojmë edhe 1 shkelje tjetër, që po ashtu është e rëndësishme dhe dëshmon shkeljen e ligjit në fuqi.

**221.** Autoriteti Kontraktor Ministria e Mjedisit, por në vijim edhe Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës i kanë dhënë me koncesion shoqërisë “Albtek Energy” shpk të drejtën e ndërtimit operimit dhe transferimit të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike, sic kemi cituar edhe më sipër koncesionet në fjalë janë dhënë respektivisht në vitin 2014 dhe vitin 2016, kohë nga e cila koncesionari ka filluar me ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit.

**222.** Në vazhdim, konkretisht në datën 25/11/2019, shoqëria “Albtek Energy” shpk, ka nxjerrë Vendimin nr. 5 të Asamblesë së Ortakëve për ndryshimin e objektit të veprimtarisë nga “ndërtim banësash dhe rezidencash”, në “impiant i përpunimit të mbetjeve, incinerator”. Kjo nënkupton se Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka dhe Ministri i Energjisë dhe Infrastrukturës z. Damian Gjoknuri, ashtu si edhe të gjithë funksionarët e cituar në këtë analizë kanë lidhur kontratë koncesioni me një subjekt, i cili nuk e ka patur të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve, gjë e cila konsiderohet si një nga kërkesat dhe garancitë më esenciale të legjislacionit shqiptar për të siguruar përmbushjen e qëllimit të kontratës së koncesionit.

**223.** Lidhur me sa më sipër kemi cituar, rezultojnë organet publike, funksionarët e lartë shtetëror kanë vepruar në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore duke konsumuar kështu vepra penale të dënueshme nga ligji shqiptar dhe gjithashtu i kanë shkaktuar një dëm serioz buxhetit të shtetit.

## V. IMPIANTI I TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE FIER

### A. PROCEDURAT

#### A.1 PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK DHE KONTRATA E KONCESIONIT

**224.** Shoqëria Buidling Construction & Green Energy ka aplikuar nëpërmjet procedurës së thirrjes së pakërkuar për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Fierit dhe prodhimin e energjisë duke depozituar një projekt teknik, financiar dhe mjedisor pranë Ministrisë së Mjedisit. Kompania në momentin e aplikimit ka qenë në pronësi të Sevi Zanit, një juriste në kompaninë ITS dhe e njohur me Klodian Zoton, sipas dëshmisë së referuar nga Arenc Myrtezani dhe dokumentet e QKB.

**224.** Në referim të pikës 6 të nenit 25 të ligjit nr. 125/2013 është përgatitur projektvendimi për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut

Fier dhe prodhimin e energjisë. Ky projektvendim i Z. Lefter Koka, Ministër i Mjedisit, është nisur për mendim në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizimit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes si dhe Ministrisë së Shtetit për Mardhëniet për Parlamentin. Ndërkaq me anë të shkresës nr. 561/1 prot., datë 22.01.2016, Ministri i Financave Z. Shkëlqim Cani ka kthyer përgjigje duke u shprehur dakort në parim pasi ai nuk prodhon efekte financiare për buxhetin. Megjithatë ky ministër ka shprehur rezervat e tij lidhur me subjektin dhe seriozitetin e investimit të tij pasi ky projekt propozim duhet të shoqërohet edhe me një relacion shpjegues për statusin juridik të shoqërisë dhe kapacitetin e saj për ta realizuar projektin.

**225.** Në vijim, me anë të shkresës nr. 5553 prot., datë 30.08.2016, Ministri i Mjedisit Z. Koka ka ridërguar projektin për miratimin e procedurës së dhënjes me koncesion të inceneratorit të Fierit duke i bashkëlidhur edhe Studimin e Fizibilitetit përkatës. Në përmbajtje të shkresës, Ministri Koka garanton se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbuluar kostot e këtij projekti duhet e përfshirë atë të Projekt Buxheti Afatmesëm 2017-2019. Në përgjigje të sa më sipër, Ministri i Financave Z. Arben Ahmetaj, me anë të shkresës nr. 8264/4 prot., datë 08.09.2016, ka konstatuar se projekti koncesionar është i përballueshëm ekonomikisht nga Autoriteti Kontraktor i qëndrueshëm dhe fizibël në aspektin fiskal, duke u shprehur kështu për rrjedhojë në parim dakort me vijimin e procedurave të mëtejshme koncesionare. Nga ana tjetër është kërkuar që të merret miratimi i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë në cilësinë e institucionit përgjegës për politikën në fushën e energjisë elektrike dhe pronarit të KESH sha për përballimin e riskut nga cmimi i energjisë elektrike (feed in tariff).

**226.** Në shtator 2016, Ministria e Mjedisit nëpërmjet sistemit të APP-së ka bërë thirrjen për kontratë të punëve publike me objekt “Dhënie me koncesion të ndërtimit dhe administrimit të impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Fierit dhe prodhimin e energjisë (kontratë e formës Build Operate and Transfer).

**227.** Kompania fituese e projektit të sipërcituar ishte bashkimi i operatorëve ekonomik JV Integrated Technology Services shpk & Energy 2 SRL shpk të cilët themeluan SPVnë Shoqëria Integrated Technology Waste Treatment shpk e themeluar në 03.10.2016 me aksioner 70% Integreted Technology Services me aksioner të vetëm Klodian Zoto dhe 30% shtetasi Italian Ernesto Graneli. Në tetor të vitit 2016, është firmosur Kontrata e Koncesionit midis Ministrisë së Mjedisit dhe subjektit fitues të sipërcituar.

**228.** Vlen të theksojmë se ashtu sic edhe Raporti Përfundimtar i KLSH ka konkluduar, kompania fituese e koncesionit është regjistruar si operator për këtë shërbim në QKL 15 ditë pas shpalljes së tenderit, fakt ky i denoncuar publikisht në median e shkruar si dhe atë online . Ndërkaq kompania e cila kishte përfituar 10% e bonusit të pikëve duke qenë se kishte aplikuar me thirrjen e pakërkuar nuk kishte aplikuar fare në këtë procedurë prokurimi. Ky fakt ngre dyshime të forta lidhur me mungesën e aftësisë teknike të shoqërisë, ekspertizën për të zbatuar projektin, por njëkohësisht ngrihen dyshime se shkakun pse kjo JV kishte aplikuar përfituar projektin ishte në fakt një aferë korruptive për të patur mundësi të përfitonte bonusin dhe për tia dorëzuar kompaninë sic edhe ndodhi fituesive të vërtetë të procesit Klodian Zotos dhe Mërtirit.

**229.** Autoriteti Kontraktor (Ministria e Mjedisit), i është drejtuar zyrës së Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit bazuar në nenin 5/1/a të ligjit nr. 10081 “Për Avokaturën e Shtetit” me një kërkesë për dhënie mendimi për procedurën e zhvilluar nga ana e Ministrisë së Mjedisit me objekt Ndërtimin dhe Administrimin e Impiantit të Mbetjeve Urbane të Qarkut të Fierit, bashkëlidhur dhe Draft Kontrata e negociuar por ende përpara nënshkrimit nga palët dhe fillimit të efekteve juridike të saj. Nga ana e Zyrës së Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me shkresën me nr. 1183/1 port., datë 20.10.2016, i është kthyer përgjigje AK-së dhe i jepen mendim për disa nene të draft kontratës. Ashtu sic edhe KLSH ka raportuar në përfundim të auditit të saj, asnjë nga pikat e mendimit të Avokaturës nuk është reflektuar në kontratën përfundimtare të firmosur mes palëve.

**230.** Komentet e Avokaturës të gjitha ne i gjejmë tërësisht të mbështetura në ligj, mosparashikimi i tyre e bën me përgjegjësi solidare si bashkëpunëtorë në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, jo vetëm 7 anëtarët e Komisionit për dhënien me Koncesion të ngritur me Urdhërin nr. 6869 prot., datë 16.12.2015 me përbërje (Z. Pëllumb Abeshi nga Ministria e Mjedisit, Znj. Sabina Cenameri nga Ministria e Mjedisit, Znj. Etleva Kondi nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, Z. Florian Mucaj nga Bashkia Fier, Z. Azem Shatëri nga Bashkia Fier, Z. Erjon Mrataj nga Atrako dhe Znj. Armida Ali po ashtu nga Atrako), me Ministrin e Mjedisit Z. Lefter Koka në cilësinë e drejtuesit të Autoritetit Kontraktor dhe me anëtarët e tjerë të qeverisë dhe bashkive të përfshira.

**231.** Neni 5.2.2 i Kontratës: Koncesionari mund të vendosë si garanci për financim vetëm të drejtat e tij që rrjedhin nga Kontrata e Koncesionit dhe jo asetet që do të krijohen pasi ato janë pronë e Shtetit, me detyrim rikthimin tek shteti në fund të periudhës koncesionare dhe në rast të mospagimit të shumës së financimit mund të konfiskohen. Kjo pasi neni 27 pika 3 e ligjit nr. 125/2013 i ndryshuar parashikon se “kontrata duhet të hartohet në përputhje me dokumentet e tenderit dhe informacionet që gjenden në njoftimin e kontratës, me ofertën e zgjedhur dhe me njoftimin e dhënies së kontratës”. Ky është një parim bazik në kontratat e koncesionit pasi Shteti nuk mund të rrezikojë asetet për të cilin po investon për shkak të keqmenaxhimit të kompanisë nga ana e Koncesionarit. Sic edhe ka ndodhur në rastin konkret ku asetet (impianti i instaluar) është lënë si garanci nëpërmjet Marrëveshjes Siguruese nr. 5694/1 për llogari të Bankës Credins sha për një vlerë deri në 15 milion Eur (pa tvsh). Kjo mund të shkaktojë një dëm financiar deri në 15 milion Euro shtetit duke qenë se Banka do të përpiqet të ekzekutojë marrëveshjen e saj kontraktore në kushtet kur shoqëria është në pamundësi për të shlyer detyrimet e saj ndaj bankës.

**232.** Pika 6.5.3/D/F e Kontratës: Koncesionari nuk ka të drejtë të hipotekojë tokat e shpronësuara, të lihen këto të fundit peng ose të lihen si garanci tek huadhënësi si sigurim për borxhin që do të merret nga koncesionari për realizimin e projektit. Ky veprim mund të ketë kosto për buxhetin e shtetit nëse Koncesionari nuk arrinë të shlyeje në afat kredinë, deri në vlerën e shpronësimit të tokës për afërsisht 47,000,000 lekë (shih analizën më poshtë lidhur me çështjen e shproësimit). Ky nen në Kontratën e Koncesionit bie ndesh me nenin 27 pika 3 të ligjit 125/2013 i ndryshuar (me ndryshimet deri në vitin 2015 – parimi i zbatimit të ligjit në kohë).

**233.** Neni 6.6.2 dhe 10.9/c/g i Kontratës: në këtë nent të Kontratës, nuk përcaktohet saktësisht sipas ligjit mbyllja e afateve financiare nga ana e Koncesionarit. Duhet të përcaktohen sipas nenit 1 pika b e ligjit nr. 125/2013 ku citohet: “zgjdhja e koncesionit ndërpritet, kur PPP dështon në sigurimin e financimit brenda 12 muajve nga nënshkimi ose hyrja në fuqi e kontratës. Ky nen në Kontratë bie ndesh sërish me nenit 27 pika 3 të ligjit nr. 125/2013.

**234.** Neni 17.4.3 dhe 18.2.2 i Kontratës: Ky nen parashikon si Gjykatë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Gjykatën e Arbitrazhit në Paris. Sipas kreut II neni 37 i ligjit nr. 9953 datë 14.07.2008 “Kodi i Procedurës Civile” citohet: “Juridiksioni i Gjykatave Shqiptare nuk mund të kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj” dhe neni 46 i ligjit nr. 125/2013 citon “në cdo rast, ligji i zbatueshëm është ligji shqiptar në fuqi. Ky nen në Kontratën e Koncesionit sërish bie ndesh me nenit 27 pika 3 të ligjit nr. 125/2013.

**235.** Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni për Dhënien e Koncesionit në DSK nuk ka përcaktuar saktë kushtet në bazë të të cilave rregullohet të drejtat e pronësisë së tokës ku do të ndërtohet impianti. Këto kushte duhet të përcaktoheshin si rrjedhojë e respektimit të nenit 38 pika 2 të ligjit nr. 125/2013.

**236.** Kontrata Koncesionare e nënshkruar paraqet mangësi sa i përket mbrojtjes thelbësore të shtetit, vërehet se ka mungesë të theksuar ndërmjet Kontratës dhe DSK-së. Këto nene të DSK-së që nuk janë reflektuar në Kontratë mund të sjellin në të ardhmen pasoja ekonomike për buxhetin e shtetit. Disa nga nenet e përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme të DSK-së dhe jo në Kontratën e Koncesionit janë si më poshtë, nenit 4, 6, 13, 18, 20, dhe 21.

**237.** Mënyrë e përcaktuar në nenin 6.2 të Kontratës për përzgjedhjen e supervizorit të punimeve bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643 “Për prokurimin Publik” dhe ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e Konfliktit të Interesit” duke qenë se sipas kësaj dispozite supervizori zgjidhet nga AK por pas propozimit të vetë Koncesionarit të tre studiove të ndryshme (në kushtet e konfliktit pasi nuk mund të zgjedhë vetë Koncesionari studion që do monitorojë punimet e tij).

**238.** Avokatura njëkohësisht ka bërë me dije se AK-ja ka gabuar në terminologjinë e përdorur duke e cilësuar rastin në fjalë si procedurë Koncesioni dhe jo si procedurë Partneriteti Publik Privat në shkelje kështu të definicioneve që ka përcaktuar ligji për këto dy procedura në nenet 3 dhe 8 të ligjit nr. 123/2013.

**239.** Disa shkelje të tjera gjatë procedurës së prokurimit publik të konstatuara gjatë hetimit të këtij komisioni janë si vijon:

(i) Nga auditimi i ushtruar në dokumentacionin respektiv të BOE dhe referuar edhe gjetjeve të KLSH-së, rezultoi se Subjekti Integrated Technology Services shpk” është pajisur me licencë A, veprimi i cili bie në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për miratimin dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, lidhja 4 pasi kategoria A i

takon punimeve deri në 20 milion lekë ndërkohë që kjo shoqëri duhet të kishte kategorinë F (401 – 800 milion lekë) pasi vlera e kontratës është 28,000,000 EUR pa tvsh, në të tilla kushte ky Operator Ekonomik nuk plotëson kushtet teknike dhe kapacitetet e nevojshme për të kryer investimit.

(ii) Ky fakt tregon edhe një herë shkeljen flagrante të dispozitave ligjore përsa i përket procedurës së përzgjedhjes së Koncesionarit dhe dyshimit të arsyeshëm se në kushtet e shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit Drejtuesi i Autoritetit Kontraktor Z. Lefter Koka si dhe të gjithë anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes së Koncesionit sipërcituar kanë shkelur dispozitat e ligjit nr. 125/2013 me qëllim për të zgjedhur këtë subjekt si shoqërinë fituese të projektit.

(iii) Nuk është përckatuar emri i shoqërisë nënkontraktore, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9643 për “prokurimin publik” si dhe VKM-në nr. 915, datë 29.12.2014 neni 75 pika 4.

(iv) Referuar sistemit elektronik të APP rezultoi se nuk është bërë njoftimi i kontratës brenda 5 ditëve nga data e lidhjes së saj në 24.10.2016 veprim i cili bie në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 neni 25 pika 1.

(v) Kriteret e vecanta të kualifikimit nuk kanë parashikuar deklaratë të disponueshmërisë së mjeteve sipas shtojcës 8 të DSK-së gjithashtu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk disponohen dëshmi për fuqinë punëtore të Operatorit Ekonomik Integrated Services shpk veprim që bie në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik neni 46 pika 1 gërma (b) si dhe VKMnë 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 26, pika 8, gërma a, b dhe c si dhe neni 28 pika 5 gërma c dhe c.

(vi) Njëkohësisht nga dokumentat e vëna në dispozicion si dhe në referim të konkluzioneve të KLSH-së në raportin e saj, rezultoi se Autoriteti Kontraktor nuk ka respektuar kërkesat e ligjit nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” datë 20.11.2006, neni 38 pika 2 duke mos bërë njoftimet në të paktën një gazetë ndërkombëtare me shpërndarje në Europë për prokurimet me vlerë mbi kufirin e lartë monetar.

**240.** Të gjitha shkeljet e mësipërme të çojnë në përfundimin se e gjithë procedura e tenderit si dhe përzgjedhjes së Operatorit Ekonomik fitues është bërë në shkelje të legjislacionit në fuqi. Njëkohësisht, Kontrata e Koncesionit ka shkelje të rënda përsa i përket parashikimeve në kontratë të cilat vijnë në kundërshtim me DSK-në si dhe legjislacionin në fuqi sipërcituar. Të gjitha këto veprime bëjnë me përgjegjësi individuale direkte për 7 anëtarët e Komisionit për dhënien me Koncesion të ngritur me Urdhërin nr. 6869 prot., datë 16.12.2015, përkatësisht Z. Pëllumb Abeshi nga Ministria e Mjedisit, Znj. Sabina Cenameri nga Ministria e Mjedisit, Znj. Etleva Kondi nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, Z. Florian Mucaj nga Bashkia Fier, Z. Azem Shatëri nga Bashkia Fier, Z. Erjon Mrataj nga Atrako dhe Znj. Armida Ali po ashtu nga Atrako. Mbi të gjitha përgjegjësia duhet të ngarkohet në vecanti edhe ndaj Ministrisë të Mjedisit Z. Lefter Koka në cilësinë e drejtuesit të institucionit (Autoritetit Kontraktor) të Kontratës objekt hetimi por edhe vetë drejtuesve të institucioneve të anëtarëve të Komisionit sipërcituar.

**241.** Nga të gjitha faktet e sipërcituara në tërësi ka dyshime mjaft të forta se e gjithë procedura e prokurimit si dhe përzgjedhjes së fituesit ka ardhur në kushtet e shpërdorimit të detyrës nga ana e zyrtarëve të sipërcituar dhe madje dyshimit të arsyeshëm të një afere korruptive. Dëmi

eventual që këto veprime do i shkaktojnë buxhetit të shtetit mund të arrijë deri në vlerën totale të Kontratës së Koncesionit, përkatësisht 28,000,000 Euro.

## B. ZBATIMI I KONTRATËS

### B.1 VENDNDODHJA E PROJEKTIT

**242.** Në 27.07.2015, Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Fier, përkatësisht Drejtoresha e Përgjithëshme Znj. Gazmira Plesati ka dërguar një shkresë ku është shprehur për domosdoshmërinë e mbylljes së venddepozitimit aktual të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Fier e cila shtrihej në veri-perëndim të qytetit të Fierit. (Shkresa nr. 1 – Bashkia Fier “mbi domosdoshmërinë e mbylljes së venddepozitimit aktual të mbetjeve të ngurta të Bashkisë Fier”) Sipas shkresës, shkak i kësaj nevojë ishte koha e gjatë e përdorimit si dhe afërsia e madhe me qendrën e bankuar e pikës aktuale. Ky vendim erdhi njëkohësisht edhe si rrjedhojë e Vendimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, e datës 05.02.2014 “Për shpalljen e emergjencës mjedisore në territorin e RSH dhe marrjen e masave të nevojshme për rehabilitimin e cilësisë së mjedisit”.

**243.** Në vijim të sa më sipër, në datën 26.10.2015, Këshilli i Bashkisë Fier, me anë të Vendimit nr. 40, datë 26.10.2015, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Fier vendosi të shpallë emergjencën Mjedisore në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve në qytetin e Fierit. Ndërkaq sipas pikës 2 të këtij vendimi, zona në të cilën do të realizoheshin projektet për menaxhimin e mbetjeve ishte “njësia administrative Portëz, Fshati Plyk, zona kadastrale 3000, ngastra 8 dhe ngastra 6”.

**244.** Ndryshimi i parë i vendodhjes së projekteve në fushën e menaxhimit të mbetjeve ndodhi me anë të Vendimit nr. 25, datë 26.02.2016 të Këshillit të Bashkisë Fier, pas propozimit të Kryetarit të Bashkisë Fier, nëpërmjet të cilit u caktua që vendodhja e re e projekteve në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ishte “Njësia administrative Portëz, Fshati Mbyet, zona kadastrale 2637, ngastrat me nr. 212, 212/1, 227, 222, 223, 224, 225, 226, 228, 229 dhe 230.

**245.** Në shtator 2016, Ministria e Mjedisit nëpërmjet sistemit të APP-së ka bërë thirrjen për kontratë të punëve publike me objekt “Dhënie me koncesion të ndërtimit dhe administrimit të impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Fierit dhe prodhimit të energjisë (kontratë e formës Build Operate and Transfer). Sipas faqes së dytë të Njoftimit publik, koordinatat gjeografike ku do të zhvillohej projekti janë 41°24'12.2" Veri 2°10'26.5" Lindje, pikërisht në destinacionin e përcaktuar sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 25 sipërcituar. Kjo vendodhje përmendet edhe në pikën 1.1/a (Pozicioni gjeografik i projektit).

**246.** Kompania fituese e projektit të sipërcituar ishte bashkimi i operatorëve ekonomik JV Integrated Technology Services shpk & Energy 2 SRL shpk të cilët themeluan SPVnë Shoqëria Integrated Technology Waste Treatment shpk e themeluar në 03.10.2016 me aksioner 70%

**247.** Në tetor të vitit 2016, është firmosur Kontrata e Koncesionit midis Ministrisë së Mjedisit dhe subjektit fitues të sipërcituar. Në aneksin VII të Kontratës është përcaktuar dhe plani dhe koordinatat e sheshit ku do të zhvillohej projekti. Pra qartazi si nga ana e Autoritetit Kontraktor ashtu edhe nga ana e Shoqërisë fituese ishte shumë e qartë dhe e dakortësuar vendodhja e projektit.

**248.** Edhe në shkresat midis Minisrit të Mjedisit Z. Lefter Koka me anë të shkresës nr. 5553/2 datë 30.09.2016 dhe Z. Armando Subashi me shkresën nr. 6580/1 datë 12.10.2016 është konfirmuar pozicioni gjeografik i projektit në ZK 2637, fshati Mbyet sipas VKB 25 sipërcituar.

**249.** Pavarësisht se përpara kemi analizuar më sipër pozicioni ku do të zhvillohej projekti ishte i ditur që përpara nisjes së projektit të Koncesionin, ishte i miratuar me VKB, ishte përcaktuar edhe në DSK-të e projektit gjithashtu edhe në Kontratën e Koncesionit të firmosur dhe të dakortësuar mes palëve, në datën 01.11.2016 Shoqëria Integrated Technology Waste Treatment Fier shpk dërgon shkresën me nr. Prot. 29 (protokolluar në bashki me nr. 7323) drejtuar Z. Lefter Koka, dhe Z. Armando Subashi, nëpërmjet të cilës kërkon shqyrtimin e një alternative tjetër vendndodhje për ngritjen e impiantit për shkak se: (i) topografia e terrenit të përzgjedhur e bën problematike dhe mjaft joefikase për procesin e kërkuar teknologjik të ndërtimit të impiantit; (ii) largësia nga pika e lidhjes me energji elektrike është tepër e madhe dhe bën praktikisht shumë të vështirë realizimin e teknologjisë së prodhimit të energjisë; (iii) bazuar në studime gjeologjike, pjerrësisë së terrenit si dhe afërsisë me lumin Gjanica, mendohet se mund të ketë shkarje të cilat do të vinin në rrezik projektin nga ana konstruktive duke cuar në një situatë të papëlqyeshme mjedisore. (Shkresa nr. 8 – Kërkesa prot., 29, datë 01.11.2016 e Koncesionarit për të ndryshuar vendndodhjen e projektit) Vendodhja e projektit ishte e ditur nga Koncesionari përpara se të aplikonte për Koncesionin në fjalë si dhe njëkohësisht ishte e dakortësuar prej tij në Kontratën e Koncesionit kështu kjo kërkesë krijon dyshime të arsyeshme për qëllimin e saj real.

**250.** Menjëherë më pas, mund të vihet re fare qartë se si i gjithë aparati shtetëror vihet në dispozicion të kërkesës së sipërcituar të Koncesionarit cka ngre dyshime të arsyeshme që të gjitha vendimet vijuese janë marrë në kushtet e shpërdorimit të detyrës dhe ndikimit të drejtëpërdrejtë në vendimarrjet publike

**251.** Me anë të Relacionit nr. 7508, datë 07.11.2016, Z. Edmond Leka, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike i është kërkuar Këshillit Bashkiak ngritja e një komisioni për të përcaktuar vendodhjen e re të projektit, ndërkohë që po në këtë datë, është njoftuar nga ana e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Z. Ervis Sema që të futet në rendin e ditës së mbledhjes së po asaj date në orën 10:00 ndryshimi i VKB-së 25 për caktimin e vendodhjes së projektit sipërcituar.

**252.** Në Procesverbalin nr. 7503/1 të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 07.11.2016 është votuar unanimisht nga të gjithë këshilltarët propozimi për të ngritur një grup ekspertësh për të përcaktuar vendodhjen e projektit. (Mbledhja e këtij këshilli mbyllet në oran 14:00 ndërkohë që po në këtë datë në një kohë rekord dhe në gadishmëri të plotë të kërkesave të Koncesionarit,



Kryetari Z. Armando Subashi ka nxjerrë Urdhërin nr. 752, datë 07.11.2016 “Për ngritjen e komisionit për evidentimin dhe propozimin e zonave të përshtatëshme teknikisht për realizimin e projektit [të impiantit të Fierit]” me 7 anëtarë duke kërkuar nga këta të fundit të përgatisin një material propozues me disa variante brenda datës 10.11.2016.

**253.** Në vijim të sa më sipër, me antë Relacionit nr. 7657, datë 11.11.2016 Komisioni i ngritur nga Urdhëri i sipërcituar ka depozituar përzgjedhjen e 10 varianteve të mundëshme për përcaktimin e vendit ku mund të realizohej impianti. Nga këto 10 variante 7 prej tyre ishin në tokë shtet ndërkohë vetëm 3 variante ishin të përcaktuara në truall privat.

**254.** Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak nr. 7654/1 prot., datë 11.11.2016, të thirrur nga Kryetari i Bashkisë Z. Subashi, janë diskutuar edhe 10 variantet e propozuara nga Këshilli sipërcituar. Edhe pse 7 variante ishin në tokë shtet cka do të mundësonte që buxheti i shtetit mos të rëndohej me fatura shpronësimesh në mënyrë arbitrare dhe të paligjshme është miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 99, datë 11.11.2016, me 24 vota pro dhe 10 kundër, 1 abstenim varianti 4 i propozuar përkatësisht në zonën e Mbrostarit në ZK 2636, parcela me nr. Pasurie 24/10-13 dhe 40/1-12.

**255.** Me anë të shkresës nr. 7838 datë 18.11.2016 të Z. Armando Subashi, ky i fundit i është drejtuar Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier me një kërkesë për gjendjen juridike të pasurive të miratuara me Vendimin e Këshillit Bashkiak sipërcituar. (Shkresa nr. 14 – Kërkesa për informacion për gjendjen juridike nr. 7838 prot., datë 18.11.2016) Në përgjigje të kësaj kërkesë, me anë të shkresës nr. 9407/1 prot., datë 21.11.2016, Z. Gani Bendo, Regjistruesi i këtij institucioni ka njoftuar Bashkinë se pronari i pasurive është Nevin Godo (Vrioni), tokë e llojit arë sipas certifikatave të pronësisë bashkëlidhur shkresës.

**256.** Jo rastësisht, duke qenë në kontroll të plotë të vendimarrjes së qeverisë vendore dhe qëndrore, Koncesionari i është drejtuar me një kërkesë këtij të fundit dhe Z. Lefter Koka për caktimin e vendndodhjes së projektit në pasurinë ZK2636, vol. 10, faqe 63, lloji i pasurisë Arë, me sipërfaqe 113 564 m<sup>2</sup> pajisur me certifikatë pronësie datë 15.10.2010 në emër të Nevin Godo (Vrioni).

**257.** Edhe një herë, në mënyrë jo rastësore të dy institucionet të cilët ka dyshime të arsyeshme se urdhërohen nga Koncesionari, kthejnë përgjigje brenda të njëjtës ditë në të cilën ka marrë kërkesën. Me anë të shkresës nr. 7660/1 prot., datë 22.11.2016, Z. Lefter Koka ka njoftuar Administratorin e Koncesionarit se e vlerësojnë parcelën e re të përshtatëshme për zhvillimin e këtij projekti. Kjo përgjigje ngre dyshime të arsyeshme se është e ndikuar drejtëpërsëdrejti nga Koncesionari pasi institucioni qartazi nuk kishte mundësi objektive të bënte vlerësimin përkatës për “përshtatshmërinë ose jo” të parcelës për zhvillimin e projektit. Në po të njëjtën datë, me anë të shkresës kthim përgjigje nr. 7902/1 prot., datë 22.11.2016, Kryetari i Bashkisë Z. Armando Subashi, i kthen përgjigje Ministrisë së Mjedisit Z. Koka se është dakort me përcaktimin e parcelës së kërkuar nga Koncesionari duke kërkuar kështu nga ky i fundit nisjen e procedurave të shpronësimit të pasurive.

**258.** Me anë të shkresës nr. 7660/3 prot., datë 30.11.2016, Kryetari i Komisionit të Posacëm të Shpronësimeve Z. Pëllumb Abeshi ka njoftuar Z. Subashi se pasuria e kërkuar nga Koncesionari sipas shkresës së datës 22.11.2016 gjithsej një sipërfaqe prej 111 564 m2 ka një vlerë totale shpronësimi 46,299,060 lekë. Sipas kësaj shkrese, Ministria kërkon konfirmimin e Bashkisë që disponon këto fonde në buxhetin e saj ndërkohë që kjo e fundit me shkresën e datës 01.12.2016 e ka konfirmuar që disponon fondet e nevojshme për shpronësimin përkatës.

**259.** Paralelisht me sa më sipër, në datën 21.11.2016, nëpërmjet shkresës me nr. 7882, Kryetari i Bashkisë Fier, Z. Armando Subashi i është drejtuar pronarit të truallit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak duke kërkuar nga kjo e fundit pëlqimin për shpronësimin e pronës së saj sipas cmimeve të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore sipas zonave kadastrale. Me anë të shkresës protokolluar në Bashkinë Fier me nr 7882/1, datë 01.12.2016, Znj. Godo ka pranuar propozimin e Bashkisë për shpronësimin e pasurisë së saj kundrejt shpërblimit të propozuar nga Ministria e Mjedisit në vlerën 46,299,060 lekë.

**260.** Me anë të Vendimit nr. 951, datë 28.12.2016, Kryeministri Z. Edi Rama, Sekretari i Përgjithshëm Z. Ëngjëll Agaci dhe Z. Kledi Xhaxhiu (në mungesë dhe me porosi të Ministrit të Mjedisit Z. Lefter Koka), ka firmosur vendimin e Këshillit të Ministrave nëpërmjet të cilit ka vendosur të shpronësojë për interes publik, pasurinë e Znj. Godo sipërcituar. Në pikën 2 të këtij vendimi kjo pasuri është cilësuar si tokë truall dhe është shpronësuar me një vlerë të përgjithshme 46,299,060 lekë. Sipas listës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi, sipërfaqja e pasurisë është 111,564 dhe vlera totale është llogarit me një cmim për m2 prej 415 lekësh. (Shkresa nr. 22 – Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 951, datë 28.12.2016 për shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme pronë private që preket nga realizimi i projektit “Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qarkut të Fierit dhe prodhimin e energjisë) Ligji i kohës që rregullonte çështjen e shpronësimeve është ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohëshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” me ndryshimet e ligjit nr. 20/2016 datë 10.03.2016. Ndërkaq cmimin referencë për zonat e caktuara të shpronësimit përcaktohen nga VKM nr. 89 datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kësaj VKM-je cmimi i tokës truall dhe tokës bujqësore (arë) kanë një diferencë mjaft të lartë. Kështu për zonën kadastrale 2636 në Mbrostar të Fierit, cmimi i referencës për tokë truall është në vlerën 2390 lekë për m2 ndërkohë për tokën bujqësore (arë) është në vlerën 269 lekë për m2. Sipas certifikatave të pasurive përkatëse, lloji i truallit në fjalë është tokë bujqësore arë dhe për rrjedhojë cmimi i përcaktuar në këtë VKM si dhe kategorizimi i tokës si truall dhe jo tokë bujqësore vjen në shkelje të hapur dhe flagrante të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohëshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” si dhe VKM nr. 89 datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

**261.** Së fundi, ndërmjet Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktor është firmosur Aneks IX, përkatësisht Ndryshimi i Kontratës së Koncesionit. Sipas Nenit 1 të këtij Amendimi, është ndryshuar Aneksi VII ku përcaktohet Plani dhe Koordinatat e sheshit ku do të realizohej projekti

në përputhje me VKM nr. 951, datë 28.12.2016, e firmosur nga Z. Lefter Koka dhe Administratori i Koncesionarit.

**262.** Në referim të sa më sipër, duke parë të gjitha materialet dhe faktet në tërësinë e tyre ka dyshime të arsyeshme për të ngarkuar me përgjegjësi individuale personat në vijim:

(i) Duke qenë se të gjitha veprimet janë kryer në një kohë rekord, duke vepruar kështu në dëm të interesit publik dhe vetëm në shërbim të Koncesionarit, Z. Evis Sema, Kryetar i Këshillit të Bashkisë Fier, në referencë të shkresës nr. 9 sipërcituar, ka futur në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 11.11.2016 kërkesën e Koncesionarit për të ndryshuar vendndodhjen e projektit. Për të njëjtin shkak, Z. Edmond Leka, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Fier, ka përgatitur dhe dërguar relacionin pranë Këshillit Bashkiak për iniciimin e procedurës së ndryshimit të vendndodhjes së projektit. Ndërkaq, në referim të shkresës nr. 12 sipërcituar, Anëtarët e Komisionit të ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, Z. Erald Filipi, Znj. Fioralba Dalipaj, Znj. Adriana Vrekaj, Z. Aleksandër Ruko, Z. Elisidor Prifti, Znj. Luljeta Ngresi, Z. Lefter Muskaj kanë përgatitur raportin me 10 variantet e vendndodhjes së re të projektit, ku fakti që një nga propozimet është pikërisht edhe ai i kërkuar nga vetë Koncesionari me Shkresën nr. 39, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se kanë dëmtuar interesin publik nën ndikimin e drejtëpërdrejtë të interesave të Koncesionarit;

(ii) Ministri i Mjedisit Z. Lefter Koka, në referim të shkresës nr. 17 sipërcituar, ka vepruar në kohë rekord (kthim përgjigje brenda ditës së kërkesës), duke e ka klasifikuar pasurinë e shpronësuar si të përshtatëshme pa bërë asnjë vlerësim objektiv lidhur me këtë konstatim. Gjithashtu, Z. Koka, në referim të shkresave 21 dhe 22, në shkëlqe të përgjegjesisë së tij të përcaktuar në nenin 17 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohëshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” ka vlerësuar me cmim më të lartë se ai i përcaktuar në VKM nr. 951 datë 28.12.2016, duke bërë dhe klasifikimin e gabuar të pasurisë (nga tokë bujqësore në tokë truall), për pasurinë e shpronësuar me qëllimin për të rritur në mënyrë fiktive vlerën e shpronësimit. Të gjitha sa më sipër, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se veprimet e Z. Koka janë kryer në kushtet e shpërdorimit të detyrës, shpërdorimit të fondeve publike, dhe në ndikimin e drejtëpërdrejtë të Koncesionarit duke krijuar dyshime edhe për veprën penale të korrupsionit. Z. Koka me veprimet e tij aktive i ka shkaktuar një dëm financiar të drejtëpërdrejtë buxhetit të shtetit në vlerën 46,299,060 lekë;

(iii) Kryetari i Bashkisë Z. Armando Subashi, ka propozuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak ndryshimin e vendndodhjes së projektit duke përcaktuar pikërisht atë të propozuar edhe nga Koncesionari, në tokë private edhe pse në 10 propozimet e ardhura 7 prej tyre ishin në tokë shtet. Z. Subashi, ka aprovuar vlerën e shpronësimit të truallit të zgjedhur për zhvillimin e projektit si dhe i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e sipërcituara në kohë rekord. Të gjitha sa më sipër, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se ky i fundit ka vepruar nën ndikimin korruptiv dhe të drejtëpërdrejtë të Koncesionarit, si dhe ka shpërdoruar detyrën e besuar ndaj tij nga qytetarët;

(iv) Në referim të fakteve analizuar më sipër, të gjitha veprimet e ndërmarra nga funksionarët publikë, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se janë kryer në bashkërendim të plotë me njëri tjetrin si një grup i strukturuar në dëm të interesit publik.

## B.2 NGRITJA E NJËSISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTIT

**263.** Me anë të shkresës nr. 2853 prot., datë 06.12.2017, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Z. Gentian Këri i ka nisur një shkresë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ku i kërkon kësaj të fundit të caktojë anëtarin e saj në Njësinë e Zbatimit të Projektit sic e parashikonte nenit 6/1 i Kontratës së Koncesionit. Ndërkaq në datën 12.12.2017, me anë të shkresës nr. 1776/1, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit ka caktuar si anëtar të NJZP-së Z. Pëllumb Abeshi, Drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit. (Kërkesa dhe Përgjigja për caktimin e anëtarit të NJZP-së nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit)

**264.** Në vijim të kërkesës përkatëse, edhe Bashkia e Fierit me anë të shkresës nr. 5492/1 prot., datë 04.07.2017 ka caktuar dy anëtarë të saj të NJZP-së përkatësisht Z. Arjan Ndreu Inxhinier Ndërtimi, dhe Z. Endri Breshani Jurist. (Kërkesa dhe Përgjigja për caktimin e anëtarit të NJZP-së nga ana e Bashkisë Fier)

**265.** Në vijim të sa më sipër, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë Z. Damian Gjicknuri ka nxjerrë Urdhërin nr. 317, datë 14.12.2017 “Për krijimin e njësisë së Zbatimit të Projektit për [Koncesionin e Impiantit të Mbetjeve Fier]”, ku në shtesë të tre anëtarëve të sipërcituar caktoi edhe dy anëtarët e NJZP-së së Ministrisë së drejtuar prej tij përkatësisht Z. Bledar Karoli dhe Z. Artan Leskoviku. Sipas këtij urdhëri, Kryetari i NJZP-së tashmë me 5 anëtarë, do të ishte Z. Arjan Ndreu nga Bashkia Fier. (Urdhëri nga Ministri për caktimin e anëtarëve të NJZP-së nga ana e MIE dhe krijimi i NJZP-së me 5 anëtarë)

**266.** Pavarsisht se Kontrata ishte firmosur që në Tetor të vitit 2016, për thujtje 1 vit Autoriteti Kontraktor (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) nuk kishte ngritur Njësinë e Zbatimit të Projektit në përputhje me parashikimet e nenit 6/1 të Kontratës së Koncesionit (parashikon ngritjen e kësaj njësie 1 muaj pas nënshkrimit të kontratës). Kjo vjen në shkelje të hapur të ligjit dhe Kontratës së Koncesionit nga ana e Autoritetit Kontraktor që pas nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit ka qenë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Njëkohësisht, vetë drejtuesi i këtij Institucioni Z. Damian Gjicknuri, edhe në referim të VKM nr. 504, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrisë së infrastrukturës dhe energjisë”, ka përgjegjësi direkte individuale pasi ky i fundit në kushtet e mosveprimit ka shpërdoruar detyrën duke e lënë Kontratën e Koncesionit pa një strukturë të posacme që monitoronte mbarvajtjen e projektit.

### B.3 AMENDIMET E KONTRATËS SË KONCESIONIT

**267.** Kontrata e Koncesionit për këtë projekt ka pasur edhe dy amendime të tjera në shtesë të amendimit të parë përse i përket vendndodhjes së projektit të cilin e kemi analizuar më sipër.

**268.** Me anë të Autorizimit nr. 5683/2 prot., datë 29.10.2019, Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë Znj. Belinda Balluku, duke qenë Autoriteti Kontraktor në kuptim të mbikqyrjes së Kontratës së Koncesionit ka konstatuar se: “mbikëqyrësi i punimeve të kontratës koncesionare ka kërkuar shtyrjen e afatit të punimeve dhe të afatit të kontratës për një periudhë 9 mujore.” Ndërkaq

edhe ZNJP-ja në memon nr. 29/10 datë 29.10.2019 është shprehur dakort me kërkesën për shtyrjen e punimeve dhe afatit të kontratës. Për shkak të sa më sipër, Ministria ka autorizuar AKUM-në të vlerësojë kërkesën e mbikëqyrësit dhe Z. Alqi Billako është autorizuar të nënshkruaj cdo dokument/akt që është i nevojshëm për trajtimin e kërkesës së shoqërisë.

**269.** Në datën 03.12.2019, Drejtori i AKUM-së Z. Alqi Billako ka nënshkruar amendimin e kontratës së koncesionit protokolluar me nr. 3628 duke ndryshuar grafikun e punimeve dhe duke shtyrë kështu me një afat 9 muaj afatin e punimeve dhe njëkohësisht edhe afatin e kontratës. (Amendimi i parë i Kontraktës së Koncesionit duke shtyrë afatin e kësaj kontrate dhe të punimeve me 9 muaj)

**270.** Sërisht në 2020, në datën 31.08.2020 me anë të Autorizimit nr. 5583/4 Znj. Belinda Balluku, Ministre e Infrastrukturës dhe Mjedisit, ka konstatuar se pranë këtij institucioni ka ardhur sërisht një kërkesë tjetër nga ana e Koncesionarit për shtyrjen e afatit të punimeve me 120 ditë për shkak të pandemisë. Edhe NJZP-ja me shkresën e saj nr. 1927/1 datë 05.08.2020 është shprehur dakort për miratimin e kërkesës së Koncesionarit dhe mbikëqyrësit të punimeve për shtyrjen e afatit të punimeve dhe njëkohësisht edhe afatin e Koncesionit. Në këtë kontekst, Ministria ka autorizuar Z. Alqi Billako Drejtor i Përgjithshëm i AKUM-së për të vlerësuar dhe nënshkruar cdo dokument të nevojshëm në kuadër të trajtimit të kërkesës së Koncesionarit.

**271.** Në datën 11.09.2020, vetëm 10 ditë nga data e marrjes së Autorizimit, Drejtori i AKUM-së Z. Alqi Billako ka nënshkruar amendimin e kontratës së koncesionit protokolluar me nr. 2238/3 duke ndryshuar grafikun e punimeve dhe duke shtyrë kështu me një afat 8 muaj afatin e punimeve dhe njëkohësisht edhe afatin e kontratës. Duhet të vëmë në vëmendje se kjo shtyrje është edhe më e gjatë se kërkesa e vetë Koncesionarit (Amendimi i parë i Kontraktës së Koncesionit duke shtyrë afatin e kësaj kontrate dhe të punimeve me 120 ditë)

**272.** Ndërkaq me anë të shkresës nr. 117 prot., datë 16.07.2020 Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përkatësisht Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve ka bërë me dije Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë se kjo e fundit nuk ka përmbushur detyrimin e saj ligjor sipas pikës 10 të VKM-së nr. 211 datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat” ku sipas të cilit Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të përcjellë një kopje të ndryshimeve të kontratave të koncesionit të shoqëruara me anekset përkatëse brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të tyre, pranë Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve. Duke qenë se kjo gjë nuk ka ndodhur, edhe Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve nuk ka përmbushur detyrimin e saj të transparencës për këtë Kontratë Koncesioni sipas parashikimit të sipërcituar të VKM-së 211. (Shkresa nga ATRAKO për mosnjoftimin e amendimeve të kontratës së Koncesionit)

**273.** Në referim të sa më sipër, është e qartë se ka dyshime të arsyeshme që e gjithë administrata shtetërore është vënë në dispozicion të Koncesionarit dhe interesave të tij duke shpërdoruar kështu detyrën dhe në dyshime të forta për përfshirje në korrupsion kanë çënuar interesin publik. Konkretisht, Z. Alqi Billako, të cilin jo rastësisht e ndjek Kontrata e Koncesionit,

nga koha kur ai punonte si Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit edhe kur ai ndërroi pozicion pune si Drejtor i Përgjithshëm i AKUM-it, Kontrata e Koncesionit menaxhohej de fakto nga ai. Në dy raste, dhe në një kohë rekord, i autorizuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Z. Bllako ka shtyrë afatin e Kontratës së Koncesionit dhe punimeve për lejen e ndërtimit përkatësisht me 9 muaj dhe 8 muaj duke e shtyrë efektivisht afatin e punimve deri në 31 Mars 2021 + 8 muaj. Kjo shtyrje është bërë me kërkesë të Koncesionarit dhe interesave të tij, duke mos bërë asnjë analizë të thelluar lidhur me shkakun e kërkesave përkatëse dhe zhvillimit të punimeve për këtë projekt. Së bashku me Z. Bllako edhe anëtarët e NJZP-së të projektit përkatësisht Z. Arjan Ndreu, Z. Endri Breshani, Z. Bledar Karoli, Z. Artan Leskoviku, dhe Z. Pëllumb Abeshi kanë ndihmuar në këtë shkelje duke dhënë opinion pozitiv lidhur me shtyrjen e Kontratës së Koncesionit.

#### B.4 LEJA E NDËRTIMIT NGA KKT

**274.** Agjencia e Zhvillimit të Territorit me anë të shkresës nr. 3078/2 prot., datë 18.12.2017, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Bashkisë Fier, ju njofton Vendimin nr. 15, datë 16.10.2017 të KKT-së “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin e ndërtimit dhe administrimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë me vendndodhje në Bashkinë Fier”. Kjo leje është firmosur nga Kryetari i KKT-së Z. Edi Rama si dhe nga Z. Damian Gjinkuri në cilësinë e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoritetit Kontraktor të projektit).

#### B.5 PROCEDURA E VNM, DEKLARATËS MJEDISORE DHE KONSULTIMET PUBLIKE

**275.** Nenet 23, 48 dhe 56 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përshkruajnë të drejtën e garantuar të qytetarit për t’u informuar në lidhje me gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, por edhe me veprimtarinë e organeve shtetërore. Njëkohësisht, nenet 51-55 të Kodit të Procedurës Administrative parashikojnë të drejtën për tu informuar si dhe njëkohësisht detyrimin e organeve shtetërore për të qënë transparent me qytetarët. Po kështu e drejta për informim dhe për përfshirje të drejtëpërdrejtë të qytetarëve në politikbërje sidomos në politikat që lidhen me mjedisin janë të parashikuara edhe në ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 për ratifikimin e “Konventës së Aarhus-it për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, Neni 13 i ligjit për mbrojtjen e mjedisit, VKM-në 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”. Këto parashikime vijnë në kohezion me parimin e njohur jo vetëm në legjislacionin shqipëtar por edhe atë European dhe Ndërkombëtarë – parimin e subsidiaritetit.

**276.** Në Gusht të Vitit 2016, është përgatitur Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e Impiantit të djegies së mbetjeve të ngurta në Fier por duke u përshtatur kjo VNM me vendodhjen e parë të projektit pra atë të fshatit Portëz. Ndërkohë që Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i Thelluar është lëshuar për projektin sipas vendodhjes së re atë të Prill 2017.

**277.** Përkatësisht në datën 13.04.2017, me anë të shkresës me nr. Prot., 860, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (institucion varësie i Ministrisë së Mjedisit) firmosur nga Drejtori i AKM-së Z. Julian Beqiri, ka dërguar një shkresë me objekt “mendim për vlerësimi ndikimi në mjedis të thelluar”. Raporti i Thelluar është përgatitur nga shoqëria Environmental Management Consulting ltd (EMC studio) po ashtu në Prill 2017 vetëm për disa ditë ndërkohë që afati minimal sipas parashikimeve ligjore është 3 muaj (kjo nënkuptohet edhe nga vetë termi VNM e thelluar ndërkohë që është e qartë se në disa ditë është teknikisht e pamundur të përgatisësh një raport të thelluar për një projekt kaq të madh) Këto fakte tregojnë urgjencën me të cilën janë përgatitur të gjitha dokumentat për vijimin e projektit.

**278.** Bazuar në sa më sipër, në datën 08.05.2017 pra vetëm 1 javë më pas, me anë të shkresës nr. 3764 prot., datë 08.05.2017, Z. Lefter Koka Ministër i Mjedisit ka lëshuar Deklaratën Mjedisore për shoqërinë Integrated Technology Waste Treatment Fier shpk. Ky fakt provon edhe më tej se Ministri Koka ka qënë në shërbimin e Koncesionarit dhe jo të interesit publik duke miratuar një Deklaratë Mjedisore në kohë rekord, në shkelje të afateve minimale të parashikuara nga ligji, dhe krijuar riskun iminent që projekti të shkaktojë ndikim negativ në mjedisin e zonës ku do të zhvillohej. Kështu Ministri, ka shpërdoruar detyrën e tij për të mbrojtur mjedisin dhe interesin publik.

**279.** Në shtesë të sa më sipër, një nga kërkesat më themelore në procedurën e VNM-së dhe lëshimit të Deklaratës Mjedisore, në referim të ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, VKM-s 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” si dhe VKM-së nr. 247 datë 30.04.2014 “Për përcakimin e rregullave të kërkesave, e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”, është pikërisht konsultimi me publikun dhe zonat përreth vendodhjes së projektit.

**280.** Së pari, ashtu sic theksuam edhe më sipër, çështja e parë problematike lidhur me këtë projekt është se përpara nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit dhe planifikimit për zhvillimin e këtij projekti nuk është zhvilluar asnjë konsultim publik me banorët e zonës ku ishte planifikuar projekti dhe kjo shkaktoi edhe protestat nga ana e qytetarëve kur u informuan lidhur me këtë projekt.

**281.** Së dyti, sipas shkresës me nr. Prot. 664, datë 24.03.2017 të AKM-së, me objekt “Raport i posacëm i dëgjësës me publikun”, për zhvillimin e këtij projekti konstatohet se janë bërë dy takime në datën 20.03.2017 dhe 23.03.2017. Takimi i parë ka dështuar pasi banorët e zonës janë larguar në momentin që janë informuar që një projekt i tillë po zhvillohej pranë zonës së tyre. Ndërkaq takimi i dytë është në prani të një numri shumë të limituar individësh (20 pjesëmarrës kryesisht punonjës shteti) dhe ashtu sic është konstatuar edhe nga KLSH në Raportin e saj “megjithëse ka disa data takimesh dhe foto për prezantimin e impiantit të Fierit, por realisht nuk rezulton që janë bërë 3 konsultime me banorët e komunitetit përreth, respektivisht me tre fshatrat e Qarkut të Fierit (Vajkan Vërri dhe Kallm) nga AKM-ja dhe ARM-ja e Fierit.

**282.** Mungesa e konsultimit publik ka krijuar një situatë mjaft të rëndë me banorët e zonës të cilët me anë të shkresës me nr. Prot., 2405, datë 27.03.2017 kanë nisur një peticion pranë Kryeministrit, Ministrit të Mjedisit, Kryetarit të Bashkisë Fier dhe AKM-së ku kërkojnë pezullimin e punimeve dhe që ky projekt mos të zhvillohet në zonat pranë tyre. Në këtë peticion është konstatuar edhe fakti që i gjithë projekti është bërë pa dijeninë e banorëve të zonës ku do të zhvillohej projekti dhe për rrjedhojë pa konsultimin e tyre. Ky peticion është firmosur nga një numër shumë i konsiderueshëm qytetarësh. Por banorët nuk janë ndalur me kaq, ata kanë inicuar edhe nje proces gjyqësor pranë Gjykatës Administrative.

**283.** Në përfundim, në bazë të të dhënave të sipërcituara mund të shihet qartë se procedura e përgatitjes së VNM-së dhe lëshimi i Deklaratës Mjedisore:

(i) Vjen në kundërshtim me detyrimin ligjore të VKM-së nr. 247 datë 30.04.2014 “Për përcakimin e rregullave të kërkesave, e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore” përkatësisht Kreut II të saj. Në vecanti fatit që konsultimet publike nuk janë mbajtur në një vend afër zonës së zhvillimit të projektit por në qendrën e Fierit (te Hotel Fieri), nuk janë mbajtur 3 konsultime publike, këto të fundit kanë karakter tërësisht formal dhe nuk kanë një pjesëmarrje publike të gjerë të të gjithë zonave të prekura nga projekti, takimet janë mbajtur jashtë afatit të përcaktuar nga VKM (jo më afër se 30 ditë nga data e njoftimit);

(ii) Procedura është koordinuar ndërmjet Z. Lefter Koka Ministër i Mjedisit, dhe Z. Julian Beqiri Drejtor i Përgjithshëm i AKM-së të cilët nën dyshimin e bashkëpunimit direkt, në kushtet e shpërdorimit të detyrës së tyre besuar nga qytetarët, në shkelje të procedurave ligjore sipërcituara për lëshimin e VNM-së së thelluar dhe për rrjedhojë edhe të Deklaratës Mjedisore, në shërbim të Koncesionarit dhe duke mos vënë parësor interesin publik, kanë vënë në rezik mjedisin në zonën e zhvillimit të projektit.



## VI. IMPIANTI I TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TIRANË

**284.** Në këtë seksion do të analizojmë procedurën e ndjekur nga Autoriteti Kontraktor, Ministria e Mjedisit për dhënien me koncesion të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Tiranës, nga momenti i paraqitjes së propozimit të pakërkuar deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, si dhe zbatimin e kontratës nga momenti i nënshkrimit deri në datën e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë për ngritjen e Komisionit. Analiza bazohet vetëm në dokumentacionin e administruar zyrtarisht dhe dëshmitë e marra nga Komisioni. Në tërësinë e tyre, faktet, të dhënat, dokumentet dhe dëshmitë provojnë se projekti i impiantit të Tiranës ishte faza e tretë e një skeme mirëfilltazi kriminale, ku u përfshinë zyrtarët më të lartë shtetërorë, duke filluar nga kryeministri, ministri i Mjedisit, ministri i Financave, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kryetari i Bashkisë Tiranë, në bashkëpunim me tre persona privatë, pronarë të kompanive koncesionare të inceneratorëve të Elbasanit dhe Fierit.

**285.** Në vijim, do të detajojmë veprimet dhe mosveprimet e paligjshme të zyrtarëve publikë dhe personave privatë. Sic është e kuptueshme, për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion, mungesës së qëllimshme të vënies në dispozicion të dokumenteve të kërkuara, pengimit apo refuzimit të dëshmitë, Komisioni ishte i kufizuar në zbardhjen e plotë të së vërtetës dhe individualizimin e përgjegjësive penale të të gjithë personave të përfshirë. Ndaj, një hetim i plotë dhe i gjithëanshëm i Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për këtë çështje, do t'i japë mundësi opinionit publik të kuptojë se si taksat e tyre nuk shkojnë për më shumë mirëqënie dhe zhvillim, por për pasurimin e zyrtarëve të korruptuar dhe personave privatë të lidhur me ta.

### A. PROCEDURAT

**286.** Në datën 23 Qershor 2016, tre kompani, përkatësisht “Energy Recuperator S.P.A.”, “Paul Ēurth Italia S.P.A.” dhe “Integrated Technology Services”, i drejtuan Ministrisë së Mjedisit, një shkresë me lëndë “*Letër interesi për projektpropozimin*”, ku ato shpreheshin të interesuara për rehabilitimin e landfillit ekzistues të Sharrës, ndërtimin e landfilleve të reja dhe inceneratorit për

prodhimin e energjisë elektrike (*shih shkresën nr. 16/044 prot., datë 23.06.2016*). Vetëm 5 ditë më pas, ministri i Mjedisit, Lefter Koka, pasi e *shqyrtoi* propozimin, vendosi t'i përgjigjet shoqërive propozuese se “Në vlerësimin e këtij propozimi Ministria e Mjedisit, shprehet se propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm dhe paraqet interes publik. Ministria e Mjedisit, ju fton të paraqesni të dhëna të tjera të nevojshme dhe të detajuara për projektin e propozuar.” (*shih shkresën nr. 4101/1 prot., datë 28.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit*). I vetdijshëm se kjo procedurë kërkonte domosdoshmërisht përfshirjen e bashkisë Tiranë, për dijeni të kësaj shkrese është edhe kryetari i Bashkisë, Erion Veliaj, cka në fakt provon se ai ka qenë në dijeni të kësaj procedure qysh prej fillimeve të saj.

**287.** Megjithëse, përgjigja nga shoqëritë propozuese nuk kishte mbërritur akoma, në datën 24 Gusht 2016, ministri Koka i kërkon bashkisë Tiranë, ATRAKO dhe Ministrisë së Energjisë (në vijim “MIE”), që të caktojnë përfaqësuesit e tyre në komisionin e koncesionit me objekt “Për dhënien me koncesion/PPP ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese (*shih shkresën nr. 5474 prot., datë 24.08.2016 të Ministrisë së Mjedisit*). Kërkesat e ministrit Koka rezultojnë me një mangësi të rëndësishme, pasi në to thjesht kërkohet caktimi i anëtarëve, pa u paraqitur informacione të detajuara lidhur me projektin. Konkretisht, neni 3, pika 3 e VKM nr. 575/2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion partneritet publik privat”, përcakton se “Kërkesa për caktimin e anëtarëve shoqërohet me një informacion të detajuar për projektin.” Kjo nuk ka ndodhur, dhe nuk kishte si të ndodhte, pasi vetë Ministria nuk kishte siguruar akoma informacionin e detajuar nga shoqëritë propozuese. Duket qartazi nguti për të cuar përpara këtë procedurë, duke mos respektuar edhe kërkesat minimale të ligjit. Pasi propozimet e ministrive mbërrijnë, ministri Koka urdhëron ngritjen e komisionit të koncesionit, me përbërje 2 anëtarë nga bashkia Tiranë, 2 nga ATRAKO dhe një nga MIE, me kryetare znj. Valbona Ballgjini (*shih urdhërin nr. 169, datë 05.09.2016 të ministrit të Mjedisit*).

**288.** Në ndërkohë, në datën 1 Shtator 2016, shoqëria koncesionare “Integrated Energy B.V.” vë në dispozicion të Ministrisë së Mjedisit dokumentacionin shtesë për propozimin e pakërkuar, duke informuar gjithashtu se kjo shoqëri ishte formuar nga kompanitë nismëtare të projektit dhe kishte për qëllim një implementim të rregullt të projektit për Zonën e Trajtitimit të Mbetjeve Tiranë (*shih shkresën nr. 4101/2 prot., datë 01.09.2016*). Fakti që tre shoqëritë kishin krijuar tashmë një kompani, të regjistruar në Hollandë, për implementimin e projektit krijon bindjen se ato ishin të sigurt se do të shpalleshin fituese në këtë procedurë të sapofilluar. Ndërkohë, mbetet e dyshimtë vazhdimi i procedurës në një kohë, kur për efekt të ligjit kemi të bëjmë me një person të ri juridik, me të cilin Ministria nuk kishte pasur asnjë marrëdhënie deri në atë moment.

**289.** Katër ditë pas ngritjes së komisionit të koncesionit, ky i fundit zhvilloi mbledhjen e parë në datën 9 Shtator 2016, në të cilën anëtarët u njohën me dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “Integrated Energy B.V.” dhe iu la detyrë për paraqitjen e komenteve të tyre, me qëllim hartimin e një studimi të plotë fizibiliteti (*shih procesverbalin nr. 1, datë 09.09.2016*). Në fakt, duket e çuditshme se si komisioni fillon të diskutojë që në mbledhjen e tij të parë lidhur me studimin e fizibilitetit, ndërkohë që detyra e parë sipas nenit 3, pika 4 të VKM nr. 575/2013, është

përgatitja e një raporti përmbledhës i cili përqëndrohet vecanërisht në aspekte të domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë së idesë së projektit. Dhe vetëm pasi përgatitet ky raport, ministri vendos shtyrjen ose refuzimin e plotë të zbatimit të projektit; ose vazhdimin e procedurave me përgatitjen e studimit të fizibilitetit. Në rastin më optimal, jemi përpara rastit kur anëtarët e komisionit nuk njohin legjislacionin e fushës. Megjithatë, veprimet e mëtejshme do të provojnë se anëtarët e komisionit ishin të qartë për rezultatin final të kësaj procedure dhe procedura që po kryenin ishte thjesht fiktive.

**290.** Në mbledhjen e rradhës të datës 20.09.2016, komisioni pasi ka dëgjuar prezantimin e detajuar nga përfaqësuesit e shoqërisë, rezulton se *“Nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë, u ngrit problematika e mungesës së të ardhurave të këtij institucioni për të përballuar kostot e implementimit të projektit. Sipas tyre, tarifat e pastrimit që mblidhen nga ky institucion, nuk mjaftojnë të përballojnë as shpenzimet që ka sot ky institucion për kryerjen e këtij shërbimi.”* (shih procesverbalin nr. 2, datë 20.09.2016). I njëjti konstatim nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë u ngrit edhe në mbledhjen e datës 23.09.2016 të komisionit të koncesionit (shih procesverbalin nr. 3, datë 23.09.2016). Në këtë mbledhje, u vendos që në kushtet kur projekti kërkon mbështetje financiare, t’i dërgohet për njoftim dhe miratim paraprak Ministrisë së Financave. Gjithashtu, Komisioni vendosi të marrë kohën e nevojshme deri në datë 01.11.2016 për përfundimin e studimit të fizibilitetit.

**291.** Nga sa më sipër, evidentohet qartazi që në shkelje të parashikimit të nenit 3, pika 4 të VKM nr. 575/2013, komisioni i koncesionit nuk është ndaluar për asnjë moment në hartimin e një raporti përmbledhës lidhur me propozimin e pakërkuar, i cili më pas do t’i paraqitej ministrit për miratim apo refuzim. Vetëm pas kësaj vendimmarrjeje, mund të vazhdonte procedurat për hartimin e studimit të fizibilitetit. Miratimi nga ana e ministrit është marrë e mirëqenë nga ana e komisionit, që ka vijuar me punën për hartimin e studimit të fizibilitetit. Nga ana tjetër, raporti sipas gërmave “g” dhe “gj”, të pikës 4, sipërcituar, duhet të përmbante dy elemente të rëndësishme, përkatësisht vlerësimet paraprake të kostos së projektit dhe të qëndrueshmërisë financiare, dhe analizën paraprake financiare dhe/ose ekonomike bazuar në informacionet në dispozicion. Nëse këto analiza do të ishin kryer nga komisioni, do të ishte konstatuar në fakt, se sic deklarojnë përfaqësuesit e bashkisë Tiranë në dy mbledhjet e para, se kjo e fundit nuk ka mundësi financiare për përballimin e kostove të projektit, cka më pas do ta detyronte ministrin që ta refuzonte apo alternativisht ta shtynte projektin. Mungesa e një vendimi nga ana e ministrit është po ashtu një shkelje e pikës 5, të nenit 3 të VKM nr. 575/2013.

**292.** Pesë ditë, pas vendimit të komisionit, ministri i Mjedisit, Lefter Koka i drejtohet ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, duke i kërkuar miratimin paraprak të studimit ekonomiko-financiar për procedurën koncesionare me objekt *“Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë”*. Në përmbatje të kësaj shkrese ka një analizë të risqeve, ku në faqen 11 analizohet risku politik. Konkretisht, në shkresë thuhet *“Një rrezik politik ka të bëjë me marrëdhëniet e koncesionarit me bashkinë apo nësitë vendore që do të duhet të depozitohen MNU në Z.T.M.T. Kontrata e koncesionit do të përfshijë një garanci se*

të gjitha njësitë vendore do të depozitojnë mbeturinat vetëm në Z.T.M.T.” (shih shkresën nr. 5474/5 prot., datë 28.09.2016 të ministrit të Mjedisit).

**293.** Tregues i faktit se lidhur me këtë projekt nuk ka pasur një studim të mirëfilltë janë edhe fjalitë që i referohen procedurave të mëparshme. Për shembull, në faqen 16 të shkresës nr. 5474/5 prot., datë 28.09.2016, ku kërkohet miratimi paraprak i studimit ekonomik-financiar për projektin e impiantit të Tiranës, thuhet “Sa më sipër, mbetemi në pritje të miratimit paraprak nga ana juaj për vazhdimin e procedurave për dhënien me koncesion, pasi projekti i propozuar është shumë prioritar për Bashkinë e Fierit dhe për të gjithë Qarkun.” Jo vetëm pronarët dhe përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktues janë gjithmonë të njëjtët, po edhe projektet dhe dokumentet bashkëlidhur tyre janë copy-paste, provë e qartë e fiktivitetit të procedurave dhe vendimmarrjeve të paracaktuara.

**294.** Në fq. 17 – 18 të shkresës së sipërcituar, thuhet se “Të ardhurat e projektit janë raportuar në kapitullin 1.2 të Planit të Biznesit dhe janë si më poshtë: - Të ardhurat nga prodhimi i energjisë; - Të ardhurat nga riciklimi i materialeve; dhe - Cmimi për depozitim të mbetjeve urbane.” Në fq. 19 thuhet “...pasi zona e propozuar për realizimin e impiantit është e barabartë me rreth 120 hektarë (1200000 m<sup>2</sup>), pjesë të cilës janë pronë private, përkatësisht toka e propozuar është private në 39.9% të sipërfaqes dhe 60.1% të saj është pronë shtet, pjesë e Bashkisë Tiranë, Njësia Administrative Vaqarr, Zona Kadastrale 3321.” Në fq. 19 thuhet “Nga ana tjetër, kjo procedurë është e pajisur me një Vendim të Këshillit të Ministrave për dhënien e bonusit prej 10 pikësh shoqërisë që ka bërë propozimin e pakërkuar, akt i cili përpara se të miratohej është përcjellë për mendim në disa ministri, përfshi edhe atë Energjisë dhe Industrisë. Pas dhënies së shpjegimeve përkatëse, përfshi edhe detyrimin që KESH të bëjë blerjen e detyruar të energjisë elektrike të përfuar nga impianti, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka shprehur dakordësinë e saj për vazhdimin e procedurave për miratimin e aktit në KM dhe vijueshmërinë e realizimit të projektit koncesionar.” Kjo shkresë është e datës 28.09.2016, ndërkohë sic do të shohim në vijim shkresa e parë që u dërgohet ministrive për miratimin e bonusit është e datës 07.11.2016. Një tjetër fakt ky, që provon se procedurat për mbledhjen e mendimeve të ministrive për dhënien e bonusit janë thjesht fiktive.

**295.** Në datën 17 Tetor 2016, ministri Ahmetaj i përgjigjet ministrit Koka se “...praktika e paraqitur është një studim fizibiliteti jopërfundimtar dhe e pashoqëruar me draft-kontratën. Për sa më sipër, Ministria e Financave nuk mund të shprehet për këtë projekt koncesionar/PPP, për sa kohë që nuk janë plotësuar kushtet, kriteret dhe dokumentacioni i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”.” (shih shkresën nr. 13118/1 prot., datë 17.10.2016 të ministrit të Financave). Ndaj, kësaj kërkesë për vënien në dispozicion të studimit të fizibilitetit dhe draft-kontratës së projektit, ministri Koka nuk kthen asnjë përgjigje. Në fakt, sic del e qartë nga procesverbalet e komisionit të koncesionit, studimi i fizibilitetit dhe draft-kontrata ishin akoma në hartim e sipër, dhe nuk kishin si t’i viheshin në dispozicion ministrit Ahmetaj. Por, ajo që bie në sy është nxitimi i ministrit Koka për përmbylljen e kësaj procedure, edhe pse në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 125/2013 dhe VKM nr. 575/2013.

**296.** Në datën 4 Nëntor 2016, komisioni i koncesionit zhvilloi mbledhjen e pestë të tij, gjatë të cilës u vendos t'i propozohet ministrit të Mjedisit hartimi dhe fillimi i procedurave për dhënien e bonusit prej 8 pikësh shoqërisë “Integrated Energy B.V.”, ndërkohë që vazhdonte puna për përfundimin e studimit të fizibilitetit dhe hartimin e draft-kontratës (shih procesverbalin nr. 5, datë 04.11.2016). Në fakt, duket disi e paqartë dhënia e këtij bonusi prej 8 pikësh shoqërisë propozuese, në një kohë kur projekti tashmë kishte shfaqur dy probleme thelbësore: (i) *përballueshmëria*; përfaqësuesit e bashkisë Tiranë shpreheshin se kjo e fundit nuk i ka mundësitë për të përballuar kostot e projektit; dhe (ii) *pronësia e tokës*: ku do të zhvillohej projekti: 40% e sipërfaqes ishte në pronësi private. Sjellim në vëmendje që komisioni akoma nuk ishte njohur me mendimin e ministrit të Financave, i cili kishte kërkuar t'i vihej në dispozicion studimi i fizibilitetit dhe draft-kontrata, që ishte akoma e papërfunduar.

**297.** Megjithatë, pa pasur aspak në vëmendje, shkeljet që po konsumoheshin nga ana e komisionit të koncesionit, tre ditë pas mbledhjes së komisionit, në datën 7 Nëntor 2016, ministri Koka i përcjellë për mendim ministrit të Drejtësisë, Ylli Manjani, ministrit të Financave, Arben Ahmetaj, ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Milva Ekonomi, ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ermonela Felaj dhe ministrit për Energjinë dhe Industrinë, Damian Gjinkuri, projektvendim për miratimin e bonusit prej 8% shoqërisë “Integrated Energy B.V.” në procedurën konkurruese për ndërtimin dhe operimin e impiantit të Tiranës. Bashkëlidhur kësaj shkresë është projektvendimi dhe relacioni përkatës (shih shkresën nr. 5474/8 prot., datë 07.11.2016). Në fq. 5 të relacionit thuhet “Në bazë të të dhënave të projekt propozimit, objektivi i projektit të propozuar është përpunimi i mbetjeve urbane të Qarkut të Tiranës, gjenerimi i energjisë dhe krijimi i venddepozitimit të ri të mbetjeve pas rehabilitimit mjedisor të venddepozitimit ekzistues.” Ndërsa në fq. 12 të relacionit thuhet se “Implementimi i këtij projekti do të fillojë në vitin 2017, impianti vihet në punë në fillim të vitit 2018.” Në fq. 15 të relacionit thuhet se “...kurrësesi ky akt nuk parashikon efekte shtesë në buxhetin e shtetit.” Sic do të shohim më pas, ky konstatim se ky akt nuk parashikon kurrësesi efekte shtesë në buxhetin e shtetit rezulton krejtësisht i rremë.

**298.** Në datën 30 Nëntor 2016, ministri Ahmetaj i përgjigjet ministrit Koka, ku pasi citon se në relacion thuhet se ky projekt nuk ka asnjë efekt shtesë në buxhetin e shtetit, konstaton se “...nuk del e qartë nëse Bashkitë e Qarkut e kanë të parashikuar mbulimin e tarifës së depozitimit mbi bazë të sasisë së mbetjeve në buxhetin afatmesëm 2017 – 2019”. Gjithashtu, duke i rikujtuar shkresën nr. 13118/1 prot., datë 17.10.2016, sipërcituar, për të cilën akoma nuk ka një përgjigje, ministri Ahmetaj konkludon se “...sugjerojmë që përpara dhënies së miratimit të bonusit, nëse rezulton që projekti i Koncesionit/PPP kërkon mbështetje financiare, në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” të ndryshuar, ju duhet të merrni miratimin paraprak nga Ministria e Financave, përpara shpalljes së procedurës.” (shih shkresën nr. 15402/1 prot., datë 30.11.2016 të Ministrit të Financave). Qartazi pra, ministri i Financave nuk e miraton dhënien e bonusit përpara dhënies së një miratimi paraprak nga Ministria e Financave.

**299.** Megjithë sugjerimin e ministrit Ahmetaj për të marrë miratimin paraprak të Ministrisë së Financave, pas shqyrtimit të studimit të fizibilitetit dhe draft-kontratës, përpara dhënies së miratimit të bonusit prej 8 pikësh, rezulton se Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 855, datë

07.12.2016 ka vendosur miratimin e bonusit prej 8% të pikëve për shoqërinë “Integrated Energy B.V.” në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të ndërtimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Tiranës (shih vendimi nr. 855, datë 07.12.2016 i Këshillit të Ministrave).

**300.** Në datën 27 Dhjetor 2016, ministri Koka i ka ridërguar për miratim ministrit Ahmetaj studimin për procedurën e dhënies me koncesion të impiantit të Tiranës. Megjithëse, në relacionin e përcjellë me shkresën nr. 5474/8, datë 07.11.2016 thuhej se ky akt nuk parashikon asnjë kosto shtesë për buxhetin e shtetit, në faqen 5 të shkresës së datës 27.12.2016 parashikohen kostot që do të përballojë Qeveria qendrore dhe bashkia Tiranë për projektin. Në vitin e parë, Qeveria qendrore do të ofrojë një mbështetje prej 6.422.275 Euro dhe vit pas viti në një trend rënës deri në vitin e 30-të, ku qeveria ofron një mbështetje buxhetore prej 2.303.775 Euro. Ndërsa, bashkia Tiranë do të përballojë një kosto prej 1 milionë euro në vitin e parë, me një trend rritës vit pas viti, duke arritur në vlerën 5.118.500 Euro në vitin e 30-të. Në total, Bashkia Tiranë merre përsipër një detyrim financiar në vlerën 91.784.500 Euro (shih shkresën nr. 5474/20 prot., datë 27.12.2016 e Ministrisë së Mjedisit).

**301.** Në datën 23.01.2017, ministri Ahmetaj i është përgjigjur ministrit Koka se “Në lidhje me statusin ligjor të tokës, në Studimin e Fizibilitetit sqarohet se në tokën në të cilën do të ndërtohet impianti i riciklimit, Shteti është pronar me 60.1% të sipërfaqes, kurse pjesa tjetër prej 39.9% është pronë private, e cila do të shpronësohet me një kosto totale prej 214 milionë lekë, kosto e cila nuk del qartë nga do të përballohet. Nëse kjo kosto do të përballohet nga Buxheti i Shtetit, duhet të garantohet dhe futet në përlogaritje krahas mbështetjes buxhetore, duke përcaktuar qartësisht përbalimin e saj brenda fondeve buxhetore të miratuara të institucionit përgjegjës.”

**302.** Më tej, në shkresë thuhet se “Projekti koncesionar/PPP i paraqitur nuk rezulton i planifikuar brenda tavaneve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Mjedisit, parakusht i vendosur në nenin 22 të VKM-së nr. 575/2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, me qëllim procedimin e mëtejshëm për miratimin paraprak të projektit. Kjo pasi konstatohet se në studimin e fizibilitetit parashikohet që pagesa totale për një kohëzgjatje të projektit prej 30 vjetësh të mbulohet përkatësisht nga: - Qeveria Shqiptare në masën 130.883.750 Euro pa TVSH; dhe - Nga buxheti i bashkive në masën 91.784.500 Euro pa TVSH, për të cilat nuk ka ndonjë konfirmim zyrtar në lidhje me marrjen përsipër të këtij angazhimi buxhetor.” Ministri Ahmetaj risjell në vëmendje korrespondencën e mëparshme, ku ministri Koka shprehej se “Vetë procedura koncesionare nëse do të ketë një ofertues fitues dhe një kontratë të lidhur, nuk do të ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit, pasi kemi të bëjmë tërësisht me një investim privat... Për sa më sipër, do të kërkonim sqarimet dhe argumentat përkatës lidhur me këtë kontradiktë të konstatuar.” (Shih shkresën nr. 13118/3 prot., datë 23.01.2017 e Ministrisë së Financave).

**303.** Në datën 1 Shkurt 2017, ministri Koka i është përgjigjur ministrit Ahmetaj, se “Kosto e shpronësimit do të përballohet nga Bashkia Tiranë dhe prona do të kalojë në favor të bashkisë Tiranë në funksion të realizimit të projektit.” Më tej thuhet se “Sigurisht Bashkia Tiranë është ajo që do të ketë peshën kryesore në këtë proces, prandaj përlogaritjet janë bërë mbi bazë të sasive të mbetjeve që gjeneron ky institucion dhe ky i fundit do të marrë përsipër të mbulojë kostot e

depozitimit për minimum 700 ton mbetje në ditë. Përkatësisht, për vitin e parë të operimit, Bashkia Tiranë ka marrë përsipër që do të vërë në dispozicion të pagesave për depozitimin e mbetjeve vlerën prej 1.000.000 Euro që e konvertuar në ton mbetjeve është e barabartë me pagesat që nevojiten për 34.365 ton/mbetje në vit.” (Shih shkresën nr. 5474/23 prot., datë 01.02.2017 e Ministrisë së Mjedisit).

**304.** Në datën 14 Shkurt 2017, ministri Ahmetaj i është përgjigjur ministrit Koka se “Projekti koncesionar duhet të planifikohet brenda tavaneve buxhetore vjetore të Ministrisë së Mjedisit të miratuar nga Kuvendi si dhe brenda tavaneve të shpenzimeve për periudhën afatmesme të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave...” (Shih shkresën nr. 13118/5 prot., datë 14.02.2017 e Ministrisë së Financave).

**305.** Shtatë ditë më vonë, në datën 21 Shkurt, ministri Koka i është përgjigjur ministrit Ahmetaj se “Bashkia Tiranë, si autoriteti më i madh i përdorimit të këtij impianti, do të përballojë shpenzimet përkatëse të depozitimit të mbetjeve dhe të shpronësimit të tokës ku do të ndërtohet impianti me anë të grandit të pakushtëzuar që qeveria qëndrore alokon për qeverisjen lokale.” Më tej, në shkresë thuhet se “...kurse pjesa tjetër prej 39.9% është pronë private, e cila do të shpronësohet me një kosto totale prej 214 milionë lekë, kosto e cila do të përballohet nga Bashkia Tiranë dhe prona do të kalojë në favor të bashkisë Tiranë në funksion të realizimit të projektit. Pra në kuptim të Ministrisë së Mjedisit projekti nuk ka efekt në buxhet, pavarësisht se kemi të bëjmë me efekte shtesë në buxhetin e Bashkisë Tiranë, si pasojë e kostove të shpronësimit dhe kostove të depozitimit të mbetjeve.” (Shih shkresën nr. 5474/25, datë 21.02.2017 e Ministrisë së Mjedisit).

**306.** Korrespondenca e ministrave Koka – Ahmetaj ka vijuar më tej, ku në datën 2 Mars 2017, ministri i Financave kërkonte që “...duke qenë se në studimin e fizibilitetit shpreheni se Qarku i Tiranës është financuesi dhe përfituesi kryesor i projektit, kërkojmë nga ana Juaj marrjen e miratimit me shkrim nga ky Qark, referuar modelit financiar të propozuar në studimin e fizibilitetit.” (Shih shkresën nr. 13118/7 prot., datë 02.03.2017 e Ministrisë së Financave).

**307.** Në fakt, dy ditë përpara kërkesës së ministrit të Financave, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Alqi Bllako ka kërkuar nga kryetari i Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave koncesionare me objekt “Ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë”, sipas modelit financiar të propozuar në studimin e fizibilitetit që i është dërguar bashkëlidhur shkresës (shih shkresën nr. 5474/26 prot., datë 28.02.2017). Megjithëse nga studimi i fizibilitetit ishte e qartë se Bashkia Tiranë merrte përsipër detyrime në vlerën në 91.784.500 Euro për depozitimin e mbetjeve, dhe 214 milionë lekë për shpronësimin e pronave private, me shkresën nr. 3275/1 prot., datë 27.03.2017, kryebashkiaku Veliaj është shprehur “...parimisht dakord për sa i përket rolit të saj, referuar Studimit të Fizibilitetit të paraqitur nga ana juaj.” (Shih shkresën nr. 3275/1 prot., datë 27.03.2017 e kryetarit të Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj).

**308.** Një ditë më pas, në datën 28.03.2017, ministri Koka i përcjell ministrit Ahmetaj, një kopje të dhënies së dakordësisë të kryetarit të Bashkisë Tiranë për vazhdimin e procedurës

*koncesionare për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i vendepozitimeve ekzistuese Tiranë (Shih shkresën nr. 5474/29 Prot., datë 28.03.2017 e Ministrisë së Mjedisit).*

**309.** Në datën 06.04.2017, ministri Ahmetaj ka kërkuar sërish nga ministri Koka “*Marrjen e miratimit nga njësitë e qeverisjes vendore që përfshihen në këtë projekt, lidhur me përballimin prej tyre të riskut të mosplotësimit të sasisë së mbetjeve për t’u trajtuar nga koncesionari.*” (shih shkresën nr. 13118/9 prot., datë 06.04.2017 e Ministrisë së Financave). Në fakt, ministri Koka është mjaftuar me dakordësinë e marrë nga kryetari i Bashkisë Tiranë dhe nuk ka kërkuar ndonjë miratim nga njësitë e tjera vendore që prekeshin drejtpërdrejtë nga ky projekt, përkatësisht bashkitë Kamëz, Vorë, Kavajë dhe Rrogozhinë.

**310.** Në të njëjtën shkresë, ministri Ahmetaj ka kërkuar që të merret edhe miratimi nga MIE, në cilësinë e institucionit përgjegjës për politikën në fushën e energjisë elektrike dhe pronarit të KESH sh.a. për përballimin e riskut nga cmimi i energjisë elektrike (feed-in-tariff). Kjo kërkesë i është përcjellë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë në datën 11.04.2017, duke i kërkuar dhënien e miratimit si institucion përgjegjës për politikën e energjisë elektrike (shih shkresën nr. 5474/31 prot., datë 11.04.2017). Në datën 26 Maj 2017, Ministria e Energjisë dhe Industrisë i është përgjigjur ministrit Koka se lidhur me miratimin e MEI-t për përballimin e riskut nga cmimi i energjisë elektrike, njohur ndryshe si “feed-in-tariff”, t’i drejtohen Enti Rregullator të Energjisë në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*” (Shih shkresën nr. 2221/1 prot., datë 26.05.2017). Edhe ky miratim nuk rezultoi të jetë marrë.

**311.** Megjithë mangësitë dhe parregullsitë e shumta që ministri Ahmetaj ka evidentuar në korrespondencën e gjatë me ministrin Koka, sërish ai ka vendosur të japë “*dritën jeshile*” për projektin e inceneratorit të Tiranës. Në fakt, ky ndryshim qëndrimi i ministrit Ahmetaj ngjan mjaft i cuditshëm, megjithatë ajo që ne do të analizojmë në vijim të këtij raporti janë përgjegjësitë ligjore që ka ministri i Financave në një procedurë koncesionare, cka duket se nuk janë respektuar nga ana e ministrit Ahmetaj. Mosrespektimi i këtyre detyrimeve e ngarkon këtë të fundit me përgjegjësi ligjore dhe penale, sepse si gardian i financave publike, ishte detyra e tij që të shmangte risqet dhe humbjet që do të sillte ky projekt për buxhetin e shtetit.

**312.** Konkretisht, neni 42 i ligjit nr. 125/2013 “*Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*” parashikon se projekti që ka nevojë për mbështetje financiare kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave, në lidhje me përballueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal. Ministria e Financave, nga ana e saj, sipas neni 4/2 të ligjit nr. 8336, datë 26.06.2008 “*Mbi Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” ka detyrimin të vlerësojë dhe miratojë paraprakisht, të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe cdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve në buxhetin e shtetit.

**313.** Më tej, detyrimet e Ministrit të Financave janë reflektuar në VKM nr. 575/2013 “*Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat*”. Konkretisht, neni 17 përcakton se Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP) nga pikëpamja e implikimeve



për buxhetin e shtetit. Neni 18 përcakton se kërkesa për miratimin e Ministrisë së Financave paraqitet me shkrim dhe shoqërohet me studimin e fizibilitetit dhe draft-kontratën. Neni 20 i VKM nr. 575/2013 përcakton të gjithë elementët që duhet të përmbajë analiza ekonomiko-financiare e Ministrisë së Financave, ndërsa në nenin 21 parashikohet në përfundim të kësaj analize ministri i Financave miraton projektin nëse shuma e parashikuar dhe mënyra e pagesës së mbështetjes financiare janë të përballueshme dhe të qëndrueshme, në të kundërt ministri refuzon projektin. Sic do të shohim në vijim, rezulton se ministri Ahmetaj, në kundërshtim me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 125/2013, ligji nr. 8336/2008, dhe VKM nr. 575/2013, ka dhënë miratimin e projektit.

**314. Konkretisht, rezulton se:**

(i) Nga ana e MFE me shkresë nr. 13118/9 prot., datë 06.04.2017 i është kthyer përgjigje Ministrisë së Mjedisit në të cilën është cituar që shprehet pa komente për sa kohë që financuesi dhe përfituesi kryesor i projektit është Bashkia Tiranë, e cila ka shprehur parimisht dakortësinë (këto terma nuk njihen nga VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar). Shprehja në lidhje me këtë rast është realizuar duke mos adresuar kërkesat e paraqitura më parë, duke qenë se Bashkia Tiranë përbën vetëm një nga njësitë e vetqeverisjes vendore të Qarkut Tiranë (*pra është kryesori por jo i vetmi*); (shih edhe fq. 14 – 15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Përputhshmërisë “Drejtoria e Koncesioneve – Ministria e Financave dhe Ekonomisë”);

(ii) Një studim fizibiliteti nuk mund të kalojë pa përfshirjen e të gjitha njësive të cilave u preken fondet përkatëse si rezultat i zbatimit të projektit koncesionar dhe pa siguruar që këto njësi i kanë këto fonde disponibël. Detyra e MFE lidhet pikërisht me vlerësimin e përballueshmërisë së projektit për Buxhetin e Shtetit (*dhe njësitë e vetqeverisjes vendore të prekura nga ky projekt janë pjesë e Buxhetit të Shtetit*). Përdorimi i fondit rezervë të Buxhetit të Shtetit në vitin 2018 sipas VKM nr. 811, datë 26.12.2018 për përballimin e kostove të shpronësimit të inceneratorit është pikërisht fakti që tregon “*mosparashikimin e këtyre kostove në momentin e miratimit nga MFE të këtij projekti*” dhe miratimin megjithë papërballueshmërinë e tij për Buxhetin e Shtetit. (shih edhe fq. 16 të Raportit të KLSH-së);

(iii) Gjithashtu në pikën 3 të nenit 7 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 është përcaktuar qartë që “*Kostot e drejtpërdrejta të investimeve lidhen në mënyrë specifike me ndërtimin e objekteve të reja dhe mund të përmbajnë, por nuk kufizohen në shpenzimet fillestare për përgatitjen e projektit, duke përfshirë shërbimet financiare, ligjore, të prokurimit, teknike dhe të menaxhimit të projektit, kostot e projektimit, kostot e tokës apo të blerjes së një aseti të ri, kostot e përgatitjes së truallit, kostot e ndërtimeve dhe të vënies në funksion, duke përfshirë edhe lëndët e para, pajisjet, instalimet, fuqinë punëtore, menaxhimin dhe trajnimin, dhe rrethana të tjera.* (shih edhe fq. 16 të Raportit të KLSH-së);

(iv) Mosangazhimi i Ministrisë së Financave në bazë të detyrës që i takon, pra si gardian i financave publike, ka sjellë si pasojë mosparashikimin e kostove të shpronësimit në buxhetin përkatës dhe për rrjedhojë përdorimin e fondeve rezervë të buxhetit të shtetit për të shpronësuar pronat e prekura (shih edhe fq. 17 të Raportit të KLSH-së);

(v) Megjithëse është parashikuar mbështetje buxhetore nga qeveria në studimin e fizibilitetit, konstatohet që në momentin e miratimit të studimit nga ana e MFE është dhënë një

miratim edhe pse këto fonde nuk kanë qenë disponibël në buxhetin e shtetit. Pra janë miratuar pagesa pa qenë paratë në buxhet. . (shih edhe fq. 17 të Raportit të KLSH-së);

(vi) MFE, për pjesën e projektit të financuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, është shprehur pa koment, duke mos e kundërshtuar projektin, bazuar vetëm në “dakortësinë në parim mbi studimin e fizibilitetit” të kryetarit të Bashkisë Tiranë. Angazhimi për dakortësinë duhet të përfshijë marrjen e vendimit nga Këshilli Bashkiak përkatës, si autoriteti kompetent për miratimin e buxhetit, ndërkohë që aprovimi është dhënë nga autoriteti i kryetarit të Bashkisë që ka për kompetencë vetëm propozimin e buxhetit në këshill.” (shih edhe fq. 19 të Raportit të KLSH-së);

(vii) Duke qenë se projekti koncesionar përfshin përdorimin e fondeve të njërive të vetëqeverisjes vendore të të gjithë Qarkut Tiranë (duke qenë se analiza në studim fizibiliteti është kryer mbi të dhëna të gjeneruara për këtë Qark), marrja e dakortësisë/miratimit duhet të përfshinte të gjitha ato autoritete publike të cilat janë të përfshira në këtë projekt (sikur është kërkuar edhe nga MFE) me anë të shkresës nr. 13118/7 prot., datë 02.03.2017 i ka kërkuar Ministrisë së Mjedisit që të “...marrë miratimin me shkrim nga ky Qark (i Tiranës), referuar modelit financiar të propozuar në studimin e fizibilitetit”. MFE nuk mund të miratojë një projekt për të cilin nuk është paraqitur përfshirja në buxhetin e miratuar të njërive të vetëqeverisjes vendore të fondeve që implikojnë zbatimin e projektit. Miratimi i buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore kryhet nga Këshilli Bashkiak sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenet 9 dhe 54 të të cilit është përcaktuar: “...Neni 9 Të drejta dhe përgjegjësitë 1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: ...c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre. Neni 54 Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak Këshilli Bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca: ...dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.” (shih edhe fq. 20 të Raportit të KLSH-së);

(viii) Ministria e Financave ndërsa ka dhënë dakordësinë e saj për një projekt me kosto fillestare 339 mln euro nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar, për sa i përket procedurës së analizës së përballeshmërisë dhe miratimit të projektit. Këto veprime nuk janë në përputhje me nenet 20 dhe 21 të VKM nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar, në (shih edhe fq. 21 të raportit të KLSH-së);

(ix) Qarku Tiranë përfshin katër njësi të vetëqeverisjes vendore që nuk janë shprehur në lidhje me dakortësinë me këtë projekt dhe jo vetëm Bashkinë e Tiranës. Për rrjedhojë, miratimi i këtij projekti është dhënë pa marrë konfirmimin nga strukturat e përfshira në projekt dhe organet përkatëse vendimmarrëse për qëllime të buxhetimit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë “është shprehur pa komente” për projektin koncesionar/PPP dhe nuk e ka kundërshtuar projektin megjithëse nuk ka pasur konfirmim nga ana e njërive të tjera të vetëqeverisjes vendore të prekura nga ky projekt në lidhje me garantimin e e sasisë minimale të mbetjeve të trajtuara që do të trajtohen nga projekti. Studimi i fizibilitetit i ka ndërtuar të gjitha supozimet në lidhje me sasinë e mbetjeve të trajtuara nga Qarku Tiranë ndërkohë që miratimi është marrë vetëm për Bashkinë Tiranë, me dakordësinë në parim nga kryetari i Bashkisë Tiranë. Për rrjedhojë, pagesat e nevojshme për realizimin e shërbimit janë ekspozuar përballë riskut të kërkesës, duke krijuar mundësinë e pagesave për pjesën e kompensimit të sasisë minimale të garantuar në rast se ajo nuk arrihet sipas parashikimeve (shih edhe fq. 22 të Raportit të KLSH-së);

(x) Në studimin e fizibilitetit, është projektuar sigurimi i të ardhurave nga shitja e energjisë së prodhuar nga trajtimi i mbetjeve në shumën 133.546.693 Euro me cmimin e parashikuar për t'u shitur 70 euro/MËh. Në dokumentacionin shoqërues të paraqitur për miratim nuk disponohet asnjë evidencë që justifikon aplikimin e cmimit të shitjes prej 70 euro/MËh dhe nga ana tjetër nuk ka asnjë marrje konfirmimi nga autoritetet publike përgjegjëse për politikën e energjisë. Projektimi i këtij fluksi hyrës është me efekt të përgjithshëm në secilin prej viteve në të cilat është planifikuar që të prodhohet energji dhe njëkohësisht në përcaktimin e cmimit për njësi për trajtimin e mbetjeve (shih edhe fq. 22 të raportit të KLSH-së);

(xi) Kostot e fryra në studimin e fizibilitetit në lidhje me konsulencën (2.115.000 euro), telekomunikacionin (507.600 euro) dhe mbi të gjitha shpenzimeve të tjera administrative të cilat janë paraqitur në vlerën (58.556.632 euro). Përfshirja e kostove administrative në masën 20% të vlerës totale të kostove të operimit të paargumentuara dhe të pambështetura paraqet dyshime në lidhje me fluksin dalës të projektuar për to me ndikim të drejtpërdrejtë në vërtetësinë e llogaritjeve të kryera për përcaktimin e tarifës së ofrimit të shërbimit (shih edhe fq. 25 të raportit të KLSH-së);

(xii) Në projektstudimin e orezantuar kostoja reale për njësi përlllogaritje në vlerën e 2.9 euro/njësi duke u përkthyer në 29 euro/ton ndërkohë që realisht kostoja për njësi është 14.46 euro/njësi dhe kostoja për tonë është 40.61 euro. Për rrjedhojë pretendimi se kostoja për pastrimin e qytetit është 29 euro/ton është i pasaktë. (shih edhe fq. 25 të raportit të KLSH-së);

(xiii) Gjatë gjithë dëgjësive në Komisionin Hetimor ministrat dhe kryeministri kanë pretenduar se investimi në Impianitin e përpunimit të Mbetjeve të Qarkut Tiranë është një investim privat dhe se paguhet vetëm tarifa. Praktikisht buxheti i shtetit për çdo vit parashikon në tabelat e tij buxhetore fondet që nevojiten për koncesionet/PPP dhe në to është e pranishme dhe Inceneratori i Tiranës. Gjithashtu rezulton që projekti në fjalë të ketë paguar rreth 10 mln euro investime pa nisur projektin. Kjo përkthehet në rreth 7 milion euro të ardhura vjetore si fluks hyrës në dispozicion të projektit, megjithëse investimet nuk kanë filluar ende. Një parashikim i tillë i modelit financiar e vendos Buxhetin e Shtetit përballë risqeve të shpenzimit pa marrë në këmbim investim dhe në të njëjtën kohë mundëson krijimin e kapitalit për financimim e investimeve me kapital shtetëror me impakt direkt në fizibilitetin e projektit. (shih edhe fq. 25 – 26 të raportit të KLSH-së);

(xiv) Në lidhje me riskun e kërkesës, sipas studimit është parashikuar vetëm rasti i paraqitjes së mbetjeve të reduktuara në krahasim me sasinë minimale të garantuar, duke mos bërë asnjë parashikim në rastet e tejkalimit të kësaj sasive minimale të garantuar. Rasti i tejkalimit të kësaj sasive e vendos në risk thelbësor Buxhetin e Shtetit në lidhje me pagesat e nevojshme përtej nevojës së planifikuar si dhe rrit fitimet e koncesionarit në mënyrë të pakufizuar. Nga auditimi konstatohet se MFE nuk ka marrë asnjë masë përsa i përket këtij risku për Buxhetin e Shtetit duke miratuar studimin e fizibilitetit që nuk parashikon asnjë efekt financiar të këtyre skenarëve të mundshëm. (shih edhe fq. 31 të raportit të KLSH-së);

(xv) Nga ana e MFE pranohet efektet financiare në Buxhetin e Shtetit si pasojë e ndryshimit të kursit të këmbimit, referuar edhe shkresës nr. 13118/1 prot., datë 6.4.2019 duke kërkuar që të përlllogariten plotësisht brenda tavaneve buxhetore, ndërkohë që një gjë e tillë do të përfshinte supozime për një periudhë 30 vjecare. Ndonëse risqe të tilla janë të pranishme rezulton nga auditimi i KLSH se MFE nuk ka kryer asnjë analizë por e ka miratuar këtë projekt edhe pse mundësia për ta shmangur këtë rrezik mbi paratë e taksapaguesve ishte i mundur. (shih edhe fq. 34 të raportit të KLSH-së);

(xvi) Vetëm nga mbartja e riskut të inflacionit për Buxhetin e Shtetit, efekti total në pagesat e nevojshme nga Buxheti i Shtetit nuk do të ishte 222.668.250 euro, por 301.107.440 euro, me një diferencë prej 78.439.190 euro më shumë të pa marrë në analizë. Ky fakt nuk është marrë parasysh në analizën që duhet të ishte bërë nga MFE përpara vendimmarrjes në lidhje me qëndrueshmërinë fiskale dhe analizën e risqeve sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”. (shih edhe fq. 36 të raportit të KLSH-së).

**315.** Argumentet e mësipërme provojnë katërcipërisht se ministri i Financave, Arben Ahmetaj, në shkelje të detyrimeve ligjore, që rrjedhin nga legjislacioni për koncesionet/partneritetin publik privat, nuk ka kryer analizat e nevojshme dhe marrë masat e domosdoshme për të ruajtur të pacënuar qëndrueshmërinë, përbalueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal (shih nenin 20 të VKM nr. 575/2013). Duke mos vepruar kështu, ai e ka vendosur Buxhetin e Shtetit përballë një sërë risqesh, të cilat janë provuar reale në fazën e zbatimit të kontratës koncesionare, ndërkohë që probabiliteti është i lartë që edhe risqe të tjera të shfaqen në të ardhmen.

**316.** Nuk duhet nënvlerësuar dhe as minimizuar fakti që ministri Ahmetaj gjatë kohës që ka qenë në detyrë dhe gjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate ka udhëtuar me Mirel Mërtirin dhe Klodian Zoton. Miqësia e tyre dhe udhëtimet e shpeshta edhe në të njëjtin automjet janë një tregues në kuadrin e provës për lidhjen e tyre të ngushtë që mund të ketë çuar në anashkalimin e kaq shumë procedurave nga një ministër që konsiderohet si gardiani i financave publike.

**317.** E gjithë kjo veprimtari e paligjshme e ministrit Ahmetaj, me qëllim favorizimin e kompanisë koncesionare, me pronarët e të cilës rezultojnë lidhje të ngushta miqësore, të cilat dëshmitari Ahmetaj nuk i mohoi përpara Komisionit Hetimor, ka krijuar një dëm shumë të rëndë financiar për buxhetin e shtetit. Ky i fundit do të paguajë përmes formës së Trasnfertës së Pakushtëzuar shumën totale të koncesionit/PPP që shkon në 370 mln euro që ajnë pagesa që qeveria qendrore do t’i disbursojë pushtetit vendor.

**318.** Nga sa rezulton më sipër nga hetimi i Komisionit hetimor në bazë të provave të administruara janë konsumuar tërësisht elementët e veprave penale që shpjegojmë në seksionet e mëparëshme të këtij materiali, pra veprat penale të: 1. “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal; 2. “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; 3. “Mashtrimi” me pasoja të rënda parashikuar nga neni 143 paragrafi 3 i Kodit Penal; 4. “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga nenet 143, 248, 259, dhe 287 të Kodit Penal, të kryera në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 28, pika 4 dhe 333/a e Kodit Penal.

**319.** Sipas roleve dhe përgjegjësisë individuale të gjithsecilit qartësisht kemi provuar se veprimet dhe mosveprimet kriminale të zyrtarëve të lartë shtetërorë është drejtëpërdrejtë e lidhur me pasojën kriminale të ardhur dhe veprimet e tyre janë kryer vetëm për një qëllim të vetëm, grabitjen e parave publike nga ana e funksionarëve të lartë publikë si Zv Kryeministri Aktual Arben Ahmetaj dhe kryetari i Bashkisë Erion Veliaj.

**320.** Në datën 12.06.2017, rezulton se komisioni i koncesionit ka zhvilluar një mbledhje gjatë të cilës është paraqitur oferta e shoqërisë “Integrated Energy B.V.”. Mbledhja ka zgjatur vetëm 5 minuta, përkatësisht 11:00 – 11:05, shenjë e qartë kjo se procedurat e këtij komisioni ishte thjesht burokratike sepse vendimmarrja ishte e paracaktuar (shih procesverbalin nr. 9, datë 12.06.2017). Në datën 17.08.2017, komisioni i koncesionit ka vendosur t’i paraqesë ministrit të Mjedisit vlerësimin përfundimtar të procedurës (shih procesverbalin nr. 11, datë 17.08.2017), ndërsa në datën 25.08.2017, komisioni ka filluar procedurën e negocimit të kontratës koncesionare me shoqërinë “Integrated Energy B.V.” (shih procesverbalin nr. 12, datë 25.08.2017). Është më interes fakti se gjatë kësaj mbledhjeje, shoqëria kërkoi një miratim me shkrim nga ana e bashkive pjesë e procesit, përpara lidhjes së kontratës, kërkesë e cila u hodh poshtë nga ana e anëtarëve të komisionit pasi e mendonin “*pa vend*”. Në fakt, sic kemi argumentuar gjërësisht më lart, marrja e një miratimi të tillë është një kërkesë minimale, në kushtet kur projekti prekte edhe këto njësi dhe madje ngarkonte për to detyrimin e eskuzivitetit.

**321.** Tre ditë më pas, në datën 28.08.2017, komisioni u mbledh sërish për të vazhduar negocimin e kontratës, në përfundim të të cilës vendosi që draft-kontrata t’i përcillet për mendim Avokaturës së Shtetit. Kjo e fundit, ktheu përgjigje në datën 31.08.2017, duke evidentuar disa problematika të rëndësishme në draftin e paraqitur. Konkretisht:

(i) Avokatura e Shtetit i kërkon Autoritetit Kontraktor që të rishohë vendosjen e garancisë për impiantet nga ana e koncesionarit. Duke këmbëngulur që koncesionari mos të vendosë garanci impiantet dhe asetet e tij por të drejtat që rrjedhin nga kontrata.. Pra duhet të saktësohet në këtë nen të kontratës, por edhe në nene të tjera ku flitet për vendosjen si garanci të shesheve dhe asetëve (shkronja “c” e pikës 6.5.2, shkronja “f” e pikës 6.5.3, pika 16.3 dhe pika 26.1 e kontratës) se vetëm e drejta e përdorimit të shesheve dhe asetëve mund të lihet peng ose garanci tek huadhënësit për të njëjtin afat për të cilin e posedon edhe Koncesionari për realizimin e projektit, por në përfundim të këtij afati sheshet dhe cdo aset do t’i kthehet Autoritetit Kontraktor, i ciliuar nga cdo barrë ose garanci nga huadhënësi ose palë të treta. (shih shkresën nr. 2373/I prot., datë 31.08.2017 të Avokates së Shtetit);

(ii) Në nenin 5.4.3 të kontratës është parashikuar si detyrim i Autoritetit Kontraktor që “të garantojë Koncesionarin nëpërmjet Ministrisë përgjegjëse për energjinë, nëse kërkonte nga ky i fundit, mbi realizimin e detyrimit të subjektit të furnizimit të energjisë elektrike për të blerë energjinë elektrike të prodhuar nga Impianti i Përpunimit të Mbetjeve, kusht ky i cili do të konsiderohet thelbësor për mbarëvajtjen e kësaj kontrate. Mirëpo këtë pikë Avokatura e shtetit e kundërshton pasi Ministria përgjegjëse për Energjitikën nuk ka qenë autoritet kontraktues (ndonëse duhet të ishte i tillë) . Për më tepër, në kushtet edhe kur subjekti i blerjes së energjisë elektrike nuk është Ministria përgjegjëse për energjinë; (ii) po ashtu kjo dispozitë nuk parashikon bazën ligjore ku mbështetet vendosja e detyrimit të një organi shtetëror për të garantuar blerjen e energjisë elektrike nga ky impiant. Kujtojmë që tashmë dispozitat e garantimit të shitblerjes së energjisë elektrike rregullohen nga ligji nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Ky ligj mundëson vendosjen e detyrimit për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar vetëm nga burimet e rinovueshme të energjisë. Në këtë kontratë koncesioni nuk jepet informacion nëse energjia e prodhuar është apo jo e rinovueshme.

**322.** Në të njëjtën ditë, me shkresën e Avokatit të Shtetit, komisioni zhvilloi mbledhjen e rradhës, në të cilën thuhet “...u trajtuan komentet e ardhura nga Avokatura e Shtetit dhe u bënë reflektimet në draftin e kontratës” (shih procesverbalin e nr. 15, datë 31.08.2017). E vërteta është se asnjëra prej dy komenteve të sipërcituara nuk u reflektua në draftin final të kontratës apo kontratën koncesionare që u nënshkrua në datën 31.08.2017. Edhe në këtë rast, jemi në kushtet kur komisioni paraqet fakte dhe rrethana të rreme në një akt zyrtar të shtetit shqiptar.

**323.** Në procesverbalin e datës 31.08.2017 të komisionit të koncesionit, rezulton gjithashtu se “Diskutimi që pati debat ishte ai i ngritur nga znj. Ballgjini, znj. Temali dhe z. Murataj, të cilët kërkuan futjen në kontratë të detyrimit për miratimin e kontratës me vendim të Këshillit Bashkiak, përpara hyrjes në fuqi të saj. Si nga shoqëria, ashtu edhe nga përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë në këtë proces, ky propozim nuk u mbështet si i panevojshëm dhe për pasojë nuk u fut si pjesë integrale e kontratës.”

**324.** Në fakt, sic kemi shpjeguar më lart, mungesa e një miratimi nga ana e Këshillit Bashkiak është në kundërshtim me nenin 54 të ligjit për vetëqeverisjen vendore. Përgjegjësia për shkeljen e ligjit qëndron jo vetëm mbi kryetarin e Bashkisë Tiranë, ministrat Ahmetaj dhe Koka për injorimin e këtij fakti, por edhe anëtarët e komisionit që në paligjshmëri rrëzojnë kërkesën ligjore për miratimin e kontratës në Këshill Bashkiak në kushtet kur krijonte detyrime të qarta ligjore.

**325.** Në të njëjtën datë, komisioni vendosi t'i përcillte draft-kontratën ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, i cili e nënshkroi po në 31 Gusht 2017 me shoqërinë koncesionare “Integrated Energy B.V. SPV” sh.p.k. Në fakt, nxitimi i komisionit të koncesionit dhe ministrit Koka për të konkluduar kontratën koncesionare nuk lidhet me asnjë interes publik, por me faktin se tashmë ishin zhvilluar zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, dhe në Shtator 2017 fillonte detyrën një kabinet i ri qeveritar, pjesë e të cilit nuk do të ishte më ministri Koka. Prandaj, duhej që megjithëse me shkelje, mangësi e paregullsi të shumta, kjo kontratë të nënshkruhej dhe hynte në fuqi, me një dëm kolosal për buxhetin e shtetit dhe takspaguesit shqiptarë, vecanërisht ata të qarkut Tiranë. Bashkëlidhur kësaj kontratë dhe pjesë përbërëse e saj, ishte edhe Aneksi IX – Forma e Angazhimit mbi Detyrimet e Njësive Vendore të Qarkut Tiranë, i cili do të nënshkruhej nga kryetari i Bashkisë Tiranë vetëm 7 muaj më pas në Mars 2018, për të filluar kryerjen e pagesave në Prill 2018, të cilat sic do të shpjegojmë në kapitujt në vijim kryheshin për një shërbim që nuk ofrohej. Edhe në këtë rast, kryetari i Bashkisë Tiranë do të merrte përsipër angazhimet që rrjedhnin nga kontrata, pa qenë i pajisur apo autorizuar paraprakisht nga një vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë.

**326.** Në mbledhjen e Komisionit Hetimor, kryetari i bashkisë Tiranë deklaroi se ai ka marrë një miratim nga Këshilli Bashkiak përmes VKB nr 106 datë 28.09.2017. mirëpo një pohim i tillë nuk u vërtetua kurrë nga Komisioni Hetimor të cilit Erion Veliaj nuk ia mundësoi marjen e kësaj prove duke mos e dorëzuar. Gjithsesi, në dokumentet që disponon Komisioni Hetimor rezulton se në datën 11.09.2017 ministri Koka i ka dërguar një shkresë Bashkisë Tiranë bashkangjitur me Kontratën e Koncesionit të Tiranës. Në këtë shkresë ministri Koka thekson se po i dërgohet kopja

e bashkisë “për ndjekje, vazhdimin dhe egzekutimin e kontratës me Nr. Prot 6597 datë 31.08.2017” duke konfirmuar se Bashkia ka marrë përsipër një detyrim financiar pa e kaluar atë në Këshillin Bashkiak.

**327.** Në kundërshtim me Ligjin për pushtetin vendor, Erion Veliaj i kthen përgjigje në emër të Qarkut Tiranë dhe Bashkisë Tiranë pa e dërguar kërkesën e Ministrisë së Mjedisit në Këshillin Bashkiak. Pra ka miratuar një projekt me kosto në buxhetin e bashkisë 91 milionë euro pa e mbledhur Këshillin Bashkiak.

**328.** Problemi në lidhje me dëmin financiar që paguajnë qytetarët shqiptarë. Veliaj në kundërshtim me Ligjin për Manaxhimin e Sistemit Buxhetor merr përsipër një “Angazhim Financiar”, pra merr përsipër detyrimet financiare të bashkive të qarkut Tiranë për t’ia paguar koncesionarit. Pra Veliaj zotohet se do të paguajë jo vetëm pjesën e Bashkisë Tiranë prej 91.8 mln euro por gjithashtu edhe pjesën tjetër të pagesës për bashkitë e tjera të qarkut Tiranë. Të gjithë këto pagesa bëhen nga buxheti i bashkisë apo nga buxheti i shtetit, pra nga taksat e qytetarëve kua to të Tiranës paguajnë dy herë koncesionarin. Kjo është një shkelje e dyfishtë, pasi Veliaj jo vetëm ka marrë angazhim për Bashkinë Tiranë pa thërritur Këshillin bashkiak por ka marrë angazhim edhe për bashkitë e tjera ndonëse nuk është në tagrin e tij apo bashkisë Tiranë. Në nenin 9.4 të kontratës së firmosur në prani të dy anëtarëve të Bashkisë Tiranë.

**329.** Nga analiza e mësipërme rezulton qartësisht e provuar përgjegjësia penale e zyrtarëve të lartë të përfshirë në skemën e vjedhjes së parave të buxhetit, me anë të grupit të strukturuar kriminal: 1. “shpërdorimit të detyrës” parashikuar në nnin 248 të Kodit Penal në bashkunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; 2. . Korrupsion pasiv i zyrtarëve të lartë dhe i të zgjedhurve lokalë që ushtrojnë funksione publike Neni 259 i Kodit Penal në kuadër të Grupit të Strukturuar Kriminal; 3. Mashtrim me pasoja të rënda neni 143/3 i Kodit penal në kuadër të GRupit të Strukturuar Kriminal; 4. Pastrim i produkteve të veprës penale në kuadër të grupit të strukturuar Kriminal, parashikuar nga neni 28, pika 4 dhe 333/a e Kodit Penal nga: Kryeministri z. Edi Rama, Zv. Kryeministri z. Niko Peleshi, Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, Ministri i Financave, Sekretari i Përgjithshëm z. Engjell Agaci, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Damian Gjijkuri, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes z. Arben Ahmetaj, Sekretari i Përgjithshëm i MM z. Alqi Bllako, kryetari I Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj në bashkëpunim me njëri tjetrin Në kuadër të grupit të strukturuar criminal kanë bashkëpunuar me anëtarët e Kimisoneve koncesionare z. Pëllumb Abeshi, z. Zamir Stefani, znj. Etleva Kondi, znj. Jonida Zeqo, znj. Lediana Karalliu, Z. Bardhi Capiri, z. Stefan Papa. Si dhe Valbona Ballgjini, Pëllumb Abeshi, Etleva Kondi, Erjon Murataj, Sidita Temali, Namik Simixhiu, Taulant Tusha.

## B. ZBATIMI I KONTRATËS

**330.** Në këtë seksion, do të analizojmë të gjitha veprimet dhe mosveprimet e organeve publike, përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, Bashkisë Tiranë, Bashkisë Durrës, Agjencisë Kombëtare të Ujesjellës Kanalizime dhe Trajtimit të Mbetjeve (AKUM), shoqërisë koncesionare “Integrated Energy B.V. SPV” dhe shoqërisë supervizore “AVE

Consulting”. Në tërësinë e saj, kjo analizë do të provojë se në fazën e kryerjes së procedurave për dhënie me koncesion të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Tiranës, u kryen shkelje të tilla ligjore, që krijojnë një impakt të drejtpërdrejtë në zbatimin e saj. Po ashtu, gjatë zbatimit të kontratës ka pasur/vazhdon të ketë një sërë shkeljesh të parashikimeve kontraktore, me dëm të konsiderueshëm në buxhetin e shtetit dhe interesat financiare publikë. Analiza e këtij seksioni do të organizohet në pesë pjesë të vecanta: (i) Fillimi i punimeve; (ii) Dëmtimi i Buxhetit të Shtetit; (iii) Mbetjet e Bashkisë Durrës; (iv) Depozitimi i dherave dhe (v) Mosfunksionimi i NjZP-së.

## B.1 FILLIMI I PUNIMEVE

**331.** Rreth dy muaj pas nënshkrimit të kontratës, në datën 23 Tetor 2017, Bashkia Tiranë i përcjell një shkresë shoqërisë koncesionare “Integrated Energy B.V. SPV” sh.p.k., nëpërmjet të cilës i shpreh gatishmërinë e saj për dorëzimin e venddepozitimit të mbetjeve në Sharrë (*shih shkresën nr. 38367 prot., datë 23.10.2017*). Megjithatë, dorëzimi i venddepozitimit nga Bashkia Tiranë rezulton të jetë bërë vetëm në datën 07.12.2017, pra tre muaj pas nënshkrimit të kontratës (*shih procesverbalin nr. 44121 prot., datë 07.12.2017*). 20 ditë më pas, në datën 27.12.2017, shoqëria koncesionare “Integrated Energy B.V.” ka njoftuar Bashkinë Tiranë se duke filluar nga data 01.01.2018, landfilli i Sharrës do të jetë në menaxhim të plotë të shoqërisë koncesionare (*shih shkresën nr. 48, datë 27.12.2017*). Mbetet e paqartë se cila ishte arsyeja apo arsyet që vonuan dorëzimin e venddepozitimit dhe fillimit të menaxhimit nga shoqëria koncesionare, për mëse katër muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

**332.** Marrja në dorëzim e venddepozitimit, nënkuptonte, sipas kontratës koncesionare, angazhimin e menjëhershëm të shoqërisë koncesionare për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe dorëzimin e kërkesës për t’u pajisur me leje ndërtimi në mënyrë që të fillonin punimet. Në fakt, sic rezulton nga një shkresë e vetë shoqërisë koncesionare, aplikimi për marrjes e lejes së ndërtimit pranë KKT-së është kryer vetëm në datën 27.08.2018, pra një vit pas nënshkrimit të kontratës. Pothuajse një vit pas këtij aplikimi, në datën 17 Maj 2019, KKT ka miratuar vendimin nr. 14 për lejen e ndërtimit për shoqërinë “Integrated Energy B.V.” (*shih vendimin nr. 14, datë 17.05.2019 të KKT*). Por, për zbardhjen e kësaj leje është dashur sërish mëse një vit e gjysmë, duke u bërë e mundur vetëm në datën 24.11.2020. Kjo në fakt tregon se shoqëria koncesionare është pajisur me lejen e ndërtimit mbi tre vite pas nënshkrimit të kontratës koncesionare.

**333.** Shoqëria është justifikuar se vonesat në zbardhjen e lejes së ndërtimit kanë ardhur si pasojë e vonesave në kryerjen e procesit të shpronësimeve dhe mospajisjes së shoqërisë me lejen mjedisore nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) me vendimin nr. 5, datë 31.01.2020. Sa për të parën në fakt, rezulton se ndryshe nga sa kishte marrë përsipër, Autoriteti Kontraktues nuk ka përmbushur detyrimin e tij për përmbylljen e procesit të shpronësimeve në një kohë të shkurtër. Kryerja e shpronësimeve është bërë nëpërmjet dy vendimeve të Këshillit të Ministrave, përkatësisht VKM nr. 811/2018 dhe 1154/2020.



**334.** Ndërsa, sa i përket pajisjes me leje mjedisore, kjo në fakt nuk duket të jetë faji i Autoritet Kontraktues, por i shoqërisë koncesionare që ka kërkuar të pajiset me leje për ndërtimin e një landfilli të mbetjeve të rrezikshme jo radioaktive, cka nuk parashikohej në kontratën koncesionare. NjZP ka konstatuar së në kontratën koncesionare nuk është parashikuar ndërtimi i venddepozitimit të mbetjeve të rrezikshme jo radioaktive apo përpunimi i tyre (*shih shkresën nr. 26/5 prot., datë 26.06.2020*). Në fakt, AKM ka kërkuar shpjegime qoftë nga koncesionari, ashtu nga Autoriteti Kontraktues lidhur me këtë çështje, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Shtimi i një karakteristike në projekt kërkon detyrimisht dhënien e pëlqimit të AK, ndërsa ndryshimi i objektit të kontratës, mund të bëhet vetëm nëpërmjet një amendimi. Në konkluzion, mund të thuhet se si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve si dhe shmangies nga detyrimet e përcaktuara në kontratë si nga AK, ashtu edhe nga Koncesionari, janë shkaktuar vonesa të konsiderueshme në afatin e fillimit dhe vijimit të punimeve të projektit.

**335.** Megjithëse leja e ndërtimit është zbardhur vetëm në datën 24.11.2020, shoqëria “Integrated Energy B.V.” ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e punimeve në datën 20.05.2019, pas marrjes së lejes së ndërtimit nr. 756/8, datë 24.11.2020, sipas Vendimit nr. 14, datë 17.05.2019 të KKT-së (*shih shkresën nr. 364 prot., datë 11.12.2020*). Kjo shkresë në fakt ngjan absurde për nivelin e paligjshmërisë dhe mungesës së seriozitetit në komunikimin institucional. Së pari, thuhet që punimet kanë filluar në Maj 2019, për një leje ndërtimi që është zbardhur në Nëntor 2020, pra më shumë se 1 vit më pas. Kjo do të thotë se koncesionari ka kryer punime pa leje ndërtimi, cka do të përbënte veprën penale të ndërtimit të paligjshëm. Së dyti, shkresa është dërguar në Dhjetor 2020, megjithëse pretendohet që punimet kanë filluar që në Maj 2019, pra 1 vit e 7 muaj pasi kishin filluar punimet. Këto kontradikta të kësaj shkrese, flasin për qartë për nivelin e paligjshmërisë dhe mungesës së seriozitetit në trajtimin e parave të taksapaguesve shqiptarë.

**336.** Ndërkohë që, gjatë vizitës që anëtarët e Komisionit kryen në impiantin e Tiranës, një përgjegjës teknik informoi deputetët se leja ishte zbardhur në fund të 2020-tës dhe punimet kishin filluar në fillim të 2021. Mbetet e paqartë se kush thotë të vërtetën në këtë histori kur kemi një shkresë të vetë shoqërisë që kundërshton veten, pasi deklaroi punime përpara marrjes së lejes së ndërtimit, e cila gjithësesi është kërkuar nga vetë shoqëria të ndryshohet dhe ka pësuar ndryshime në Shkurt 2021, dhe deklarimeve të përgjegjësve teknikë të impiantit. E paqartë lidhur me fillimin e punimeve ishte edhe administratorja e koncesionarit, Arjola Kodra, ku deklaroi se punimet kanë filluar përpara marrjes së lejes së ndërtimit, por sipas asaj këto punime ishin kryer sipas deklaratës së punimeve paraprake. Megjithatë, për këdo është e qartë se deklarata e punimeve paraprake parashikon vetëm kryerjen e disa punimeve të mirëmbajtjes dhe jo punime të mirëfillta në kuptim të ndërtimit të veprave të objektit. Pra, qartazi ose jemi përpara veprës penale të ndërtimit të paligjshëm, ose mashtrimit, por në cdo rast në paligjshmëri të plotë.

**337.** Më pas, shoqëria “Integrated Energy B.V.” ka informuar mbikëqyrësin e punimeve “Ave Consulting” sh.p.k. se në datën 12.12.2017, Bashkia Tiranë e ka pajisur me Deklaratën e Punimeve Paraprake me Nr. R-33782/1, për disa punime të cilat kryhen vetëm me anë të kësaj deklarate si përforcim i rrethimit ekzistues, ndërtimit i strukturave të cilat janë instaluar vetëm për

nevojat të castit me materiale të cmontueshme (*shih shkresën nr. 143/2 prot., datë 28.05.2021*). Megjithatë, në të njëjtën shkresë, administratorja, Arjola Kodra informon se shoqëria ka kryer punimet si më poshtë: 1. Nisje e procesit të mbylljes së venddepozitimit ekzistues; 2. Nisja e punimeve për impiantin e diferencimit të mbetjeve; 3. Punime për sheshe, rrugë aksesi etj.; 4. Punime shtesë. Megjithëse, saktësia e këtyre pohimeve duhet verifikuar aq më tepër në kushtet kur vetë autoriteti kontraktor është njoftuar për fillimin e punimeve vetëm në datën 14.12.2010 për punime të filluara në datën 20.09.2019, ndërsa tani pohohet se punimet kanë filluar në datën 12.12.2017, megjithëse leja e ndërtimit është zbardhur vetëm në datën 24.11.2020, dhe përgjegjësi teknik informoi anëtarët e Komisionit se punimet kanë filluar në Janar 2021. Kemi pra, katër data, të gjitha të pohuara nga e njëjta shoqëri lidhur me fillimin e punimeve.

**338.** Ndërkohë, që fillimi i punimeve mbetet akoma i paqartë, fakti është se pagesat kanë filluar që në Prill 2018, dhe tarifa 29 euro/ton ka përfshirë të gjitha operacionet e trajtimit të mbetjeve, përfshirë incenerimin, i cili akoma edhe sot nuk kryhet. Kjo e ngarkon me përgjegjësi jo vetëm shoqërinë, supervizorin, por edhe Autoritetin Kontraktues, dhe Bashkinë Tiranë, e cila kryen pagesat për një shërbim që nuk ofrohet. Në datën 03.06.2021, nga një komunikim i përfaqësueses së NjZP me Autoritetin Kontraktues rezulton se janë kryer vetëm 14% e punimeve, ku faji kryesor lihet mbi institucionet shtetërore për shkak të vonesave në zbardhjen e lejes së ndërtimit, e cila është bërë vetëm në datën 24.11.2020. Qartazi, jemi në një situatë ku vazhdon të mbetet e paqartë se kur kanë filluar realisht punimet në landfillin e Sharrës, në ç'fazë janë këto punime dhe kur parashikohen të mbyllen të gjitha punimet sipas projektit të miratuar. Ajo që dihet me siguri është se pagesat për inceneratorin e Tiranës kanë filluar në Prill 2018 dhe kanë vijuar rregullisht, pa ndërprerje, duke arritur në muajin Shkurt 2022 në vlerën rreth 36 milionë euro. Kjo shumë në fakt përfaqëson afërsisht 28% të shumës totale prej 128 milionë euro, që është planifikuar të investohet në projekt. Megjithëse, kontrata i ngarkon NjZP detyrën për të monitoruar përmbushjen e detyrimeve nga shoqëria koncesionare, duket se kjo strukturë është në rastin më të mirë e paaftë ose në rastin më të keq, por në të dyja rastet në shkelje, për të raportuar me saktësi përmbushjen e detyrimeve nga ana e koncesionarit.

## B.2 DËMTIMI I BUXHETIT TË SHTETIT

**339.** Në seksionet e mësipërme, kemi shpjeguar pamundësinë financiare që kishte bashkia Tiranë për përballimin e kostove të implementimit të këtij projekti. Kjo në fakt rezulton të jetë e pranuar dhe ngritur si shqetësim edhe nga 2 anëtarët përfaqësues të Bashkisë Tiranë në komisionin e koncesionit. Nga një kontroll paraprak i kryer nga KLSH-ja në vitin 2020, ka rezultuar se në vitin 2015, kostot e bashkisë për depozitimin e mbetjeve në landfill ishin 150.000.000 lekë, për të arritur në vitin 2020 me një kosto prej 1.080.000.000 lekë. Vlerat janë të pakrahasueshme dhe shihet qartë pesha e rëndësishme që zë ky shpenzim në buxhetin e bashkisë Tiranë. Në fakt, konstatimet e KLSH-së tregojnë se bashkia Tiranë ka arritur ta përballojë e vetme shpenzimet vetëm në 2 vitet e para, 2017 – 2018, ndërsa në vitet 2019 – 2020 ka kërkuar detyrimisht mbështetje nga buxheti i shtetit nëpërmjet transfertave të pakushtëzuara. Qartazi, ky projekt ka krijuar vështirësi financiare sa i përket përballueshmërisë nga bashkia më e madhe në vend.

**340.** Por, ajo që e bën edhe më të theksuar paligjshmërinë, është fakti që bashkia Tiranë prej mëse tre vitesh, është duke paguar për një shërbim, të cilin nuk e merr si rezultat i faktit se punimet në impiantin e trajtimit të mbetjeve nuk kanë përfunduar akoma. Ndër shërbimet që paguan bashkia, është edhe incenerimi, por sic në fakt është konstatuar gjatë vizitës në terren dhe pranuar nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë koncesionare, inceneratorët nuk janë ndërtuar akoma. Tarifa prej 29 euro/ton mbetje urbane, për të cilën nuk ekziston asnjë provë apo evidencë që të jetë diskutuar apo negociuar me shoqërinë koncesionare, ka krijuar vështirësi serioze në mbulimin e kostove për depozitim të mbetjeve në landfill. Kjo tarifë e paguar për 2018 – 2020 llogaritet në vlerën prej 3.234.124.798 lekë, e cila ka dyfishuar shpenzimet e Bashkisë Tiranë dhe MIE si transferues i Transfertës së Pakushtëzuar, për zërin e pastrimit të qytetit. Qytetarët e Tiranës janë sot duke paguar për shërbimin e incenerimit të mbetjeve urbane, ndërkohë që vetë procesi i incenerimit do të zhvillohet në një periudhë më vonë, sepse inceneratori si objekt industrial ende nuk është ndërtuar.

**341.** Nga ana tjetër, konstatohet se edhe vetë koncesionari ka vështirësi financiare në përmbushjen e detyrimeve të kontratës. Konkretisht, në planin e biznesit të paraqitur nga ky i fundit për miratimin e projektit, në pikën 5 të tij “Mënyra e financimit (burimet e financimit)” përcaktohet se kosto e projektit do të përballohet në vlerë të plotë nga kapitali i shoqërisë dhe nga burimet e brendshme të saj, pa patur nevojë të merret kredi bankare. Ndërkohë nga auditimi rezultoi se me shkresën nr. 304 prot., datë 14.10.2020, koncesionari “Integrated Energy B.V.” i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duke e vënë në dijeni se është financuar me dy kontrata kredie afatgjatë dhe afatmesme për vijimin e projektit. Pra, sipas planit të biznesit është përcaktuar në mënyrë eksplicite se koncesionari nuk ka nevojë për financime shtesë. Për më tepër, në shkresën e sipërcituar, përcaktohet se këto kredi do të garantohen duke vënë në garanci të ardhurat që do të gjenerohen nga kontrata koncesionare në fjalë, duke përbërë një risk të mundshëm për vijimin e projektit në rast se për çfarëdo shkak koncesioni nuk do të arrijë të gjenerojë sasinë e nevojshme të të ardhura të vëna në garanci për kredinë.

**342.** Një tjetër dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit lidhet me procesin e shpronësimit të pronave private të nevojshme për realizimin e projektit. Konkretisht, në studimin e fizibilitetit të paraqitur nga ministri i Mjedisit dhe të hartuar nga komisioni i koncesionit ishte parashikuar që kostoja e shpronësimeve do të ishte në shumën 214 milionë lekë. Në fakt, sic rezulton nga VKM nr. 811/2018 dhe nr. 1154/2020, kostoja e shpronësimit ka arritur në shumën 325 milionë lekë ose 111 milionë lekë më shumë, nga fondi që parashikohej në studim. Kjo shumë ka sjellë rritjen e kostove të projektit për Buxhetin e Shtetit.

**343.** Nga shuma totale, rreth 40 milionë lekë është parashikuar të përballohen nga bashkia Tiranë, duke e garantuar edhe këtë të fundit me detyrime buxhetore shtesë. Në datën 26.11.2021, kryetari i Bashkisë Tiranë i është përgjigjur Komisionit Hetimor se “...procedurat e shpronësimit janë ndjekur, jo nga ana e Bashkisë Tiranë, por nga shoqëria koncesionare “Integrated Energy B.V.”, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.” (shih shkresën nr. 45217/2 prot., datë 26.11.2021). Kjo në fakt nuk rezulton e vërtetë pasi nga të dy vendimet e Këshillit të Ministrave, sipërcituar, është e qartë se pas alokimit të buxhetit në rastin e parë, dhe përballimit të

buxhet shtesë nga vetë bashkia në rastin e dytë, kjo e fundit ka qenë përgjegjëse për ndjekjen e procedurave të shpronësimit të banorëve të Sharrës.

### B.3 MBETJET E BASHKISË DURRËS

**344.** Në vijim do të analizojmë një tjetër skemë të paligjshme dhe korruptive, ku përfshihen drejtues të institucioneve qendrore dhe pushtetit vendor, me qëllim të vetëm pasurimin e kompanisë koncesinare dhe pronarëve të saj, në dëm të Buxhetit të Shtetit. Në datën 10.07.2018, me vendimin nr. 533, Këshilli Bashkiak Durrës ka vendosur t'i kërkojë Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve shpalljen e emergjencës mjedisore në territorin e Bashkisë Durrës; gjetjen e një alternative për depozitimin e mbetjeve dhe autorizimin e kryetarit të Bashkisë Durrës të bashkëpunojë me shoqërinë koncesionare të inceneratorit të Tiranës për gjetjen e një zgjidhjeje efikase. (shih vendimin nr. 533, datë 10.07.2018 i Këshilli Bashkiak Durrës).

**345.** Megjithatë, duket se deri në 20 Qershor 2019, kur Këshilli Teknik i Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (në vijim "AKUM"), institucion i drejtuar nga shtetasi Alqi Bllako, u mblodh për të vendos mbylljen e venddepozitimit të mbetjeve të Porto Romanos, nuk ka pasur ndonjë zhvillim tjetër.

**346.** Në vijim të kësaj mbledhjeje, në datën 16 Tetor 2019, AKUM hapi një procedurë prokurimi për mbylljen e venddepozitimit të Porto Romanos dhe ndërtimin e EKO-PARK (shih Buletini i Njoftimeve Publike nr. 42, datë 21 tetor 2019, faqja 15), por tenderi u anulua 3 ditë përpara hapjes së ofertave më 6 Dhjetor (shih Buletini i Njoftimeve Publike nr. 50, datë 16 dhjetor 2019, faqja 229). Tenderi do të rihapej më 16 Dhjetor, pas vendimit të kryeministrit Rama për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga tërmeti. Në 27 Dhjetor 2019, fituese të tenderit u shpall shoqëria De Mare Srl, e cila është hartuese e projektit të Inceneratorit të Tiranës (shih Buletini i Njoftimeve Publike nr. 3, datë 27 janar 2020, faqja 254). Tenderi është zhvilluar me procedurën e prokurimit "me negociim, pa shpallje paraprake", duke e argumentuar "për shkak të nevojës ekstreme në të cilën ndodhemi pas ngjarjeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019", me një operator në garë pra pa garë. Në bazë të të dhënave zyrtare, vlera e tenderit ishte parashikuar 1.68 miliardë lekë (të reja) pa TVSH, një vlerë e përafërt me 15 milionë euro.

**347.** Në datën 13.01.2020, Këshilli Kombëtar i Territorit miratoi vendimin për dhënien e lejes së ndërtimit për mbylljen e venddepozitimit të Porto Romanos dhe ndërtimin e ECO-PARK (shih vendimin nr. 6, datë 13.01.2020 të KKT). Megjithatë, në kushtet kur nuk kishte asnjë zgjidhje alternative, Bashkia Durrës vazhdoi depozitimin e mbetjeve në Porto Romano. Kjo solli që në 15 Maj, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë paralajmëroi Bashkinë Durrës të ndalonte depozitimin në Porto Romano, në të kundërt do të kishte pasoja ligjore.

**348.** Kjo bëri që Bashkia Durrës të shqyrtonte mundësinë që mbetjet të depozitoheshin në vendgrumbullimet të tjera brenda territorit të bashkisë, sic ishin Vadardha, Fushë Biza dhe Grykë Miniera në Manzë. Megjithatë, banorët e këtyre zonave kundërshtuan me forcë dhe protesta këtë variant, cka solli që Bashkia Durrës nga data 03.06.2020 – 07.06.2020, të mos pastrohej për 4 ditë

në kulmin e pandemisë. Në këto kushte, në datën 07.06.2020, dy ndërmarrjet publike, nën varësi të Bashkisë Durrës, përkatësisht Ndërmarrja e Shërbimeve Komonale Durrës dhe Ndërmarrja Komonale Plazh, iu drejtuan shoqërisë koncesionare “Integrated Energy B.V.”, duke kërkuar që të lejohen për të depozituar mbetjet e tyre pranë landfillit të Sharës (*shih shkresën nr. 346 prot., datë 07.06.2020*).

**349.** Në mungesë të një studimi fizibiliteti nga ministria e linjës dhe për shkak të emergjencës mjedisore, më 1 gusht 2020, Bashkia e Durrësit iu drejtua Kryeministrit duke i propozuar 3 alternativa për t’i dhënë fund situatës kritike ku ndodhej. Alternativa e parë ishte ndërtimi i një landfilli sanitar në Sukth-Radë, bazuar në një propozim të pakërkuar për PPP nga kompanitë ‘A.S.A International Environmental Services GmbH’ dhe ‘GeoTest’. Alternativa e dytë ishte ndërtimi i një landfilli në fshatin Gjepalaj, bazuar në studimin e kompanisë ‘Taulanti’ Sh.p.k, dhe alternativa e tretë është dërgimi i mbetjeve në Landfillin e Sharrës (*shih VKB nr. 68, datë 10.06.2021*).

**350.** Landfilli i Sukthit parashikohej të kishte një kosto investimi prej 11 milionë euro, Landfilli i Gjepalajt prej 5.2 milionë euro, ndërkohë që dërgimi i mbetjeve në Sharrë u vlerësua nga Bashkia se ka një kosto prej 51.1 milionë euro, përfshirë tarifën e transportit prej 4 euro.

**351.** Në datën 08.06.2020, shoqëria koncesionare pranon depozitimin e mbetjeve për një javë nga data 07.06.2020 – 14.06.2020, pa tarifë (*shih shkresat nr. 159 prot., nr. 160 prot., datë 08.06.2020*). Katër ditë, pasi depozitimi i mbetjeve kishte filluar, kryetarja në detyrë e bashkisë Durrës, Emiriano Sako, i propozoi Këshillit Bashkiak miratimin e propozimit të emergjencës mjedisore për shkak të mbylljes së Porto Romanos, dhe autorizimin e kryetares së bashkisë për të bashkëpunuar me institucionet shtetërore dhe koncesionarin e zonës së trajtimit të mbetjeve në Tiranë (*shih vendimin nr. 50, datë 11.06.2020 të KB Durrës*).

**352.** Një ditë më pas, kryetarja Sako i dërgon një shkresë shoqërisë “Integrated Energy” me objekt shprehjen e interesin për tarifën e depozitimit të mbetjeve në landfillin e Sharrës. Në përgjigje të kësaj shkrese, shoqëria propozon tarifën koncesionare prej 24 euro/ton për periudhën e emergjencës. Megjithatë, nga ky moment e në vijim duket që ka një përpjekje të vazhdueshme të shoqërisë koncesionare për të pasur një përgjigje nga bashkia, por pa sukses.

**353.** Në të njëjtën kohë, Bashkia Durrës dhe AKUM kishin ngritur një grup pune të përbashkët, i cili pas zhvillimit të një mbledhjeje në datën 08.06.2020, i përcjell një raport Bashkisë dhe AKUM-it, në përfundim të të cilit përfaqësuesit e AKUM i rekomandojnë kryetarit të Bashkisë Durrës të hyjë në negociata me Koncesionarin e Sharrës për zgjidhjen e situatës (*shih shkresën nr. 1375 prot., datë 09.06.2020*). Për t’u pasur parasysh, është fakti se në atë kohë AKUM drejtohej nga Z. Alqi Bllako, ish-sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit në kohën e nënshkrimit të kontratës koncesionare, si dhe i biri i Z. Edmond Bllako, i punësuar si inxhinier pranë inceneratorit të Tiranës, me pagë mujore 982.545 lekë, duke përfituar për gati 15 muaj punë, një vlerë prej 14.964.900 lekë.

**354.** Po në datën 08.06.2020, shoqëria koncesionare informon Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me kërkesën nga Bashkia Durrës për depozitimin e mbetjeve, dhe kërkon nga ana e Ministrisë marrjen e masave për zgjidhjen e kësaj situatë (*shih shkresën nr. 168 prot., datë 08.06.2020*). Mbetet e paqartë në fakt, se çfarë masash konkretisht kërkon koncesionari që të marrë Ministria. Në datën 24.06.2020, Ministria ia përcjell për ndjekje shkresën Njësisë së Zbatimit të Projektit (*shih shkresën nr. 4314/1 prot., datë 24.06.2020*). Kjo e fundit, sqaron se sipas kontratës koncesionare, të nënshkruar në datën 31.08.2017, mbetjet urbane që mund të trajtohen gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate janë vetëm ato të Bashkisë Tiranë, dhe cdo ndryshim tjetër i objektit përkatës kërkon reflektimin me aktin juridik përkatës (*shih shkresën nr. 4314/2 prot., datë 01.07.2020*).

**355.** Për efekt të analizës, po sjellim në vëmendje një praktikë të ndjekur me bashkinë Shijak, ku koncesionari refuzon pranimin e mbetjeve përsa kohë nuk ka një miratim nga ana e Autoritetit Kontraktues, Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës. Me shkresën nr. 217/1 prot., datë 20.07.2020, shoqëria “Integrated Energy B.V.” i është përgjigjur një kërkesë të Bashkisë Shijak me nr. 5548 prot., datë 17.07.2020, për lidhjen e një akt-marrëveshjeje për depozitimin e mbetjeve të saj pranë landfillit të Sharrës, duke u shprehur se “...duke qenë se Bashkia Shijak është Njësi Vendore jashtë Qarkut Tiranë dhe në bazë të kontratës koncesionare me Nr. 6597 prot., datë 31.08.2017 “Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese në Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike” ndërmjet “Integrated Energy B.V.” sh.p.k. dhe Ministrisë së Mjedisit, kaluar në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, është ky i fundit i cili duhet të vendosë nëse shoqëria koncesionare duhet të presë apo jo mbetje të Njësisë Vendore të cilat nuk bëjnë pjesë në Qarkun Tiranë. Nëse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të aprovojë kërkesën tuaj, sigurisht që do të keni mbështetjen maksimale nga ana jonë për të gjithë hapat e mëtejshëm.”

**356.** Qartazi, miratimi nga Autoriteti Kontraktues nuk është një standard i shoqërisë koncesionare, por përdoret varësisht nga interesi i saj ekonomik. Sepse sigurisht, që sasia e mbetjeve të bashkisë Shijak është irrelevante krahasur me sasinë e bashkisë Durrës. Nga ana tjetër, sic është shprehur NjZP është e qartë se marrja e mbetjeve jashtë qarkut Tiranë, kërkon të reflektohet nëpërmjet një amendimi kontraktor, cka nuk rezulton të ketë ndodhur në rastin e marrëveshjes me bashkinë Durrës.

**357.** Sic kemi theksuar edhe më parë, shoqëria koncesionare ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme që marrëdhënia ndërmjet saj dhe bashkisë Durrës të rregullohej nëpërmjet një akt-marrëveshjeje që do të rregullonte të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Kjo referuar një sërë shkresash që disponohen nga ana jonë, me të njëjtën përmbajtje. Shkresa e fundit mban datën 07.06.2021, ku bashkia informohet se nga ajo datë e në vijim janë në pamundësi për të pranuar mbetjet e bashkisë Durrës me zero tarifë depozitimi (*shih shkresën nr. 13/6 prot., datë 07.06.2021*). Pranimi i mbetjeve nga bashkia Durrës përgjatë një viti 07.06.2020 – 07.06.2021, duket e çuditshme parë qoftë nga ana e koncesionarit, ashtu edhe nga ana e bashkisë. Sa për të parën, është e pakuptueshme se cili ishte interesi ekonomik dhe çfarë fshihej pas kësaj “bujarie”, ndërsa për të dytën ka një

pikëpyetje se cila është arsyeja që për mëse një vit nuk u mor asnjë masë për zgjidhjen e problematikës. Faktet e mëvonshme tregojnë se shoqërisë i ishte premtuar *shpërblimi i bujarisë*.

**358.** Kjo situatë e parregulluar duket të ketë vazhduar deri në datën 09.08.2021, kur bashkia njoftoi procedurën e prokurimit me objekt “*Depozitim i mbetjeve urbane*”, si procedurë “me negociim, pa njoftim”, me vlerë 287.216.000 lekë (pa TVSH), e cila, bazuar në dokumentacionin e publikuar, parashikonte zbatimin e kontratës për një periudhë 12 mujore. Kjo procedurë prokurimi nuk u finalizua me një fitues, pavarësisht se në sistemin e prokurimit publik nuk figuron si procedurë e anuluar apo pezulluar (*shih Shpallja në sistemin e prokurimit publik në muajin gusht dhe shtator 2021*).

**359.** Në datën 11.09.2021, Bashkia Durrës shpall sërish procedurën e prokurimit me objekt “*Depozitim i mbetjeve urbane*”, sërish si procedurë “*me negociim, pa njoftim*” por tashmë vlera e fondit limit është 4-fishuar në 1.148.864.000 lekë (pa TVSH), duke 4-fishuar edhe kohëzgjatjen e kontratës, konkretisht në 48 muaj. Sipas kësaj procedure prokurimi, sasia e pritshme e depozitimit të mbetjeve është 320.000 ton.

**360.** Sipas formularit të njoftimit të fituesit, në garë ishte vetëm shoqëria Integrated Energy BV SPV, pra pa garë, e cila do të shpallej në datën 27.09.2021 (15 ditë pas hapjes së garës) fituese e kësaj kontrate prokurimi publik me vlerë rreth 10 milionë euro (*shih Formulari i njoftimit të fituesit*). Kjo e fundit, krahas të drejtës për depozitimin e mbetjeve të qarkut Tiranë, fiton të drejtën edhe për përfitimin e mbetjeve të bashkisë Durrës.

**361.** Emergjencia është shpallur në datën 11.06.2020, ndërsa procedura e prokurimit është shpallur fillimit në gusht të vitit 2021 dhe më pas në shtator të vitit 2021, në të dyja shpalljet lloji i procedurës së përzgjedhur është “me negociim, pa njoftim”, me motivaicionin e emergjencës. Kjo procedurë prokurimi është zhvilluar në kundërshtim të hapur me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014. Në një situatë të tillë, ligji parashikon zhvillimin e procedurës në bazë të nenit 33 “Procedurë e hapur”, si dhe duke qënë mbi kufirin e lartë monetar, bazuar në nenin 8 të LPP, afati i paraqitjes së ofertave duhet të ishte 52 ditë.

**362.** Në një përgjigje zyrtare nga Bashkia Durrës drejtuar medias Faktoje.al, rezulton se kjo bashki prodhon 38.146 ton mbetje në vit. Ndërkohë, sipas tenderit me negociim pa njoftim, ku është shpallur fituese shoqëria koncesionare e Tiranës, në lanfillin e Sharrës do të depozitohen 80.000 ton mbetje në vit me një vlerë 29 euro për ton. Diferenca midis sasisë së prokuruar dhe asaj të deklaruar nga Kryetarja e Bashkisë është 41.854 ton në vit, e cila pasjell edhe një rritje fiktive të vlerës për ton me të paktën 2-fish.

#### B.4 DEPOZITIMI I DHERAVE

**363.** Me vendimin nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, Këshilli i Ministrave ka vendosur: “6. *Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t’i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1,*

*bashkëlidhur ligjit nr. 10449, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta. 15. Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm ose lëndfillët e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore. 20. Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbetjeve në lëndfille dhe venddepozitimet e përkohshme, janë të detyruar të raportojnë pranë NJQV-ve dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e mbetjeve që trajtojnë.” (shih vendimin nr. 575, datë 24.06.2015 i Këshillit të Ministrave).*

**364.** Në faqen zyrtare të shoqërisë “Integrated Energy B.V.” janë përcaktuar tarifat për secilën kategori të mbetjeve urbane, përfshirë mbetjet inerte. Konkretisht, me kodin 20 02 02, janë përcaktuar mbetjet e llojit “Dhera dhe gurë”, me cmim 350 ALL plus TVSH deri në 20.000 ton, dhe 300 ALL plus TVSH mbi 20.000 ton (shih tarifat e depozitimit sipas tipologjisë së mbetjeve).

**365.** Nga librat e shitjeve të dërguar elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe të administruara nga Komisioni, rezulton se vetëm nga shërbimi i depozitimit të dherave në periudhën 2018 – 2021, shoqëria koncesionare “Integrated Energy B.V.” ka siguruar të ardhura në vlerën 48.911.498 Euro (shih të ardhurat e shoqërisë “Integrated Energy B.V.” nga depozitimi i dherave).

**366.** Në datën 15.02.2022, përpara Komisionit Hetimor, u thirr për të dëshmuar shtetasi Luigj Aleks, me detyrë kryetar i Shoqatës së Ndërtuesve, i cili deklaroi se “Me një vendim që nuk e dimë, një vendim që nuk ekziston, nga bashkia detyrohen ndërtuesit që të lidhin një marrëveshje të vecantë me përfaqësuesit e landfillit dhe duhet të paguajnë për të gjitha llojet e dherave që gërmojmë, një taksë sikur këto janë mbetje inertesh. Nuk japin leje ndërtimi nëse nuk shkojmë të nënshkruajmë marrëveshje me kompaninë koncesionare. I kemi kërkuar sqarim bashkisë, por ata bëjnë të paditurin...kur në fakt ata miratojnë cmimin, në fakt ata na detyrojnë të shkojmë të bëjmë marrëveshje me landfillin.”

**367.** Faktet e mësipërme provojnë se pa pasur një ndryshim të kontratës, dhe përtej objektit të saj, shoqëria koncesionare ka përfitur miliona euro në vit si rezultat i ofrimit të shërbimit të depozitimit të dherave. Kjo është bërë e mundur vecanërisht nëpërmjet kushtit të paligjshëm që bashkia Tiranë imponon ndaj ndërtuesve për depozitimin e dherave në këtë landfill, në rast të kundërt ata nuk mund të pajisjen me lejen e ndërtimit. Cka është akoma më flagrante është fakti se bashkia Tiranë, në kundërshtim me detyrimet që rrjedhin nga VKM nr. 575/2015 nuk ka miratuar tarifat e depozitimit, duke e lënë këtë krejtësisht në vlerësimin arbitrar të shoqërisë koncesionare “Integrated Energy B.V.”.

**368.** Modeli ekonomik sipas të cilit shoqëria ka përlogaritur tarifën e depozitimit të mbetjeve prej 29 euro/ton bazohej mbi tri burime të ardhurash: (i) të ardhurat nga tarifa e depozitimit të mbetjeve vetëm të qarkut Tiranë; (ii) të ardhurat nga shitja e skrapit; dhe (iii) të



ardhurat nga shitja e energjisë. Por, në fakt gjatë zbatimit të kontratës së lidhur më 31.08.2017, kemi parë që shoqëria ka shtuar edhe dy burime të tjera të ardhurash, përkatësisht: (i) të ardhurat nga tarifat e depozitimit të mbetjeve të bashkisë Durrës; dhe (ii) të ardhurat nga depozitimi i dherave. Së pari, sic me të drejtë është shprehur NjZP-ja, sipërcituar, do të duhej që shtimi i këtyre burimi të ardhurash të refleктоhej si amendim në kontratën koncesionare; dhe së dyti, kjo do të sillte edhe një ndryshim të modelit ekonomik duke shkuar drejt një tarife më të leverdishme depozitimi, duke qenë në kushtet që shoqëria koncesionare jo vetëm garantonte kthimin e “investimit”, por edhe siguronte një fitim të arsyeshëm. Duke mos vepruar kështu, qoftë shoqëria koncesionare, ashtu edhe Autoriteti Kontraktues kanë dëmtuar interesat ekonomike të shtetit.

## B.5 MOSFUNKSIONIMI I NJZP

**369.** Në pikën 6.1.1 të kontratës koncesionare parashikohet se brenda një muaji nga data efektive, palët krijojnë NjZ-në, e cila do të përbëhet nga pesë anëtarë që caktohen si më poshtë: dy anëtarë nga Autoriteti Kontraktues, një anëtar nga MIE dhe dy anëtarë nga Bashkia Tiranë. Më tej, pika 6.1.2 përcakton se NjZP-ja monitoron përmbushjen nga koncesionari të detyrimeve të tij, në lidhje me përmbushjen e objektit të kësaj kontrate dhe konform detyrave të caktuara të tij. Sipas përcaktimeve të sipërcituara do të duhej që NjZP të ngrihej jo më vonë se data 30.09.2017, pra një muaj pas nënshkrimit të kontratës, por në fakt rezultojnë se kjo strukturë është ngritur tre muaj me vonesë. Pra, në tre muajt e parë të kontratës, nuk ka pasur asnjë strukturë monitoruese nëse palët po përmbushin detyrimet e marra përsipër në kontratë.

**370.** Dhe sikur të mos mjaftonte vonesa e krijuar në ngritjen e saj, rezultojnë se NjZP-ja nuk ka funksionuar edhe për një periudhë mëse 1-vjecare, duke e lënë kështu kontratën koncesionare dhe veprimtarinë e shoqërisë “Integrated Energy B.V. SPV”, tërësisht jashtë kontrollit dhe vëmendjes së institucioneve shtetërore. E gjithë problematika e mosfunksionimit të NjZP-së ka ardhur si pasojë e largimit nga detyra të kryetarit të NjZP-së, Z. Pëllumb Abeshi në Tetor 2020, për shkak të angazhimit të tij me kohë të plotë në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Ky fakt i është bërë e ditur sekretares së përgjithshme të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 11.11.2020. Rezultojnë se gjatë kësaj periudhe as znj. Haxhiademi, as ministri i Infrastrukturës, nuk kanë marrë asnjë masë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues për zgjidhjen e kësaj situate. Ky fakt provohet edhe me shkresën nr. 1114 prot., datë 27.01.2021 që Sekretarja Haxhiademi i dërgon shoqërisë koncesionare, në të cilën e informon se raportimi 3-mujor nuk është marrë akoma në shqyrtim si pasojë e largimit të anëtarit të NjZP-së dhe moszëvendësimit të tij.

**371.** Në kushtet kur ministria e Mjedisit dhe ministria e Energjisë nuk kanë arritur të gjejnë gjuhën e përbashkët për zëvendësimit e kryetarit të NjZP-së, Sekretarja Haxhiademi ka kërkuar asistencë juridike nga Avokatura e Shtetit lidhur me situatën e krijuar për shkak të moszëvendësimit të anëtarit të NjZP, Pëllumb Abeshi (shih shkresën nr. 2981 prot., datë 29.03.2021). Me shkresën nr. 1384/1 prot., datë 9.4.2021, Avokatura e Shtetit është përgjigjur se nuk është në kompetencë të saj që të japë opinione juridike lidhur me mosmarrëveshjet e kompetencave që kanë lindur ndërmjet institucioneve të ndryshme (ministrive në këtë rast).

**372.** Në kushtet kur nuk është arritur gjetja e një zgjidhjeje, Sekretarja Haxhiademi ka kërkuar sërish zëvendësimin e anëtarit përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, duke vënë për dijeni edhe Kryeministrinë (*shih shkresën nr. 155/1 prot., datë 05.07.2021*), e cila sipas ligjit është organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që krijohen ndërmjet ministrive (*neni 27, pika 2, gërma "a" e Kodit të Procedurave Administrative*). Qartazi, ky fakt provon se nga Tetori 2020 deri në Korrik 2021, NjZP nuk ka kryer detyrat e saj monitoruese për shkak të mungesës së kuorumit të plotë të saj. Shkresa e MIE, i është përcjellë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për ndjekje dhe kompetencë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrisë, Engjëll Agaci me shkresën nr. 3295/1 prot., datë 27.07.2021.

**373.** Me shkresën nr. 5293/1 prot., datë 30.08.2021, MTM është përgjigjur se në kushtet kur fusha e përgjegjësisë, por edhe dosja e impiantit të Tiranës i kaluar MIE, është detyrë e kësaj të fundit që të procedojë me emërimin e anëtarit të ri të NjZP, duke qenë se MIE është Autoritet Kontraktues. Ky arsytim duket i saktë në kushtet kur pika 6.1.1 përcakton se 2 anëtarë caktohen nga Autoriteti Kontraktues dhe nuk ka parashikuar shprehimisht ministrinë e Mjedisit. Në kushtet kur AK kishte ndryshuar, edhe kjo e drejtë ishte transferuar tek MIE. Por, ajo që e bën flagrante shkeljen është fakti se për një vit NjZP-ja nuk ka funksionuar dhe ministrinë kanë qenë të paafta të zgjidhin një çështje kaq të thjeshtë juridike. Nga ana tjetër, kryeministri, i cili sipas ligjit, kishte detyrimin e zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshjeje mjaftohet me përcjelljen e kësaj shkrese te ministria e Mjedisit, duke shmangur kështu përgjegjësitë që i ngarkonte ligji. E gjitha kjo veprimtari në kundërshtim me ligjin, ka sjellë një dëm të rëndë të interesave të shtetit, sepse përgjatë një viti shoqëria ka vepruar pa pasur asnjë monitorim apo kontroll nga institucionet shtetërore.

**374.** Personat drejtëpërdrejtë përgjegjës madhe për vjedhjen e parave të buxhetit të shtetit sipas shpegimeve të dhëna hollësisht më lart, ku kemi përcaktuar edhe përgjegjësitë individuale të gjithsecilit në kuadër të Grupit të Strukturuar Kriminal janë: Kryeministri z. Edi Rama, Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, Oltjana Ifti, zv MM, Komiteti i Menaxhimit të integritetit të mbetjeve, Sekretari i Përgjithshëm i KM z. Engjëll Agaci, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Damian Gjijkuri, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes z. Arben Ahmetaj, Sekretari i Përgjithshëm i MM z. Alqi Bllako, kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj, kryetarja e Bashkisë Durrës Emirjana Sako, z. Pëllumb Abeshi anëtar i KK, z. Zamir Stefani anëtar i KK, znj. Etleva Kondi anëtar i KK; znj. Jonida Zeqo anëtar i KK, znj. Ledian Karalliu anëtar i KK, z. Bardhi Capiri anëtar i KK; z. Stefan Papa anëtar i KK; Zj Valbona Ballgjini, Erjon Murataj anëtar i KK; Sidita Temali anëtar i KK; Namik Simixhiu anëtar i KK; Taulant Tusha anëtar i KK; Arjola Kodra, administratore e Impiantit të Përpunimit të Mbetjeve Qarkut Tiranë; Loran Dusha, administrator i Impiantit të Përpunimit të Mbetjeve të Qarkut Fier; Sevi Zani, ish aksionarë e kompanisë Build Construction and Green; Arenc Myrtezani, ish administrator i Impiantit të Përpunimit të Mbetjeve të Qarkut Fier; Giuseppe Ciaffaglione administrator i Impiantit të Mbetjeve të Qarkut Tiranë; Erton Kaleshi aksionar në koompaninë SE Consulting; Julia Demneri aksionarenë kompaninë SE Consulting; Denisa Tollkuçi administratore e kompanisë Zoto Consulting; dhe Ernesto Granelli aksionar në Energy Recuperator.

## VII. KONKLUSIONE PËRFUNDIMTARE

**375.** Zyrtarë të lartë qeveritarë, përfshirë Kryeministrin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe ministrat e tij, drejtues të njësive të qeverisjes vendore dhe zyrtarë të tjerë administrativë, kanë shkelur ligjin dhe procedurat për dhënien me koncension të landfilleve në Elbasan, Fier dhe Tiranë, duke i shkaktuar Buxhetit të Shtetit një dëm ekonomik që vlerësohet paraprakisht 430 milionë euro dhe që do të rritet në mënyrë progresive.

**376.** Kompanitë përfituese të tre kontratave koncensionare për ndërtimin e impianteve të përpunimit të mbetjeve në Elbasan, Fier dhe Tiranë, janë shpallur fituese, në mungesë të përvojës profesionale dhe, mbi të gjitha, pa kapacitetet e nevojshme financiare për të përmbushur detyrimet kontraktuale.

**377.** Shuma e përfituar nga këto kompani përmes kontratave koncensionare abuzive janë mbi 430 mln euro, të cilat janë të shpërnadara në këtë formë; Impianti i përpunimit të mbetjeve Qarku Elbasan me vlerë 24.7 mln euro me TVSH, Impianti i përpunimit të mbetjeve qarku Fier me vlerë 30.6 mln euro dhe Impianti i Përpunimit të Mbetjeve qarku Fier me vlerë 377 mln euro.

**378.** Kompanitë koncensionare, në pronësi të një grupi shtetasish, Mirel Mërtiri-Klodian Zoto-Stela Gugallja, të lidhur ngushtësisht ndërmjet tyre, kanë krijuar një skemë gjigande financiare, për të përfituar në mënyrë abuzive nga Buxheti i Shtetit.

**379.** Dy prej ministrave përgjegjës për procedurat koncensionare, shtetasi Arben Ahmetaj dhe shtetasi Damian Gjoknuri, rezultojnë të jenë njohje shoqërore dhe kontakte të vazhdueshme me dy prej personave kryesorë të kompanive koncensionare, përkatësisht shtetasit Klodian Zoto dhe shtetasi Mirel Mërtiri.

**380.** Nga hetimi i Komisionit rezultoi se kompanitë koncensionare në bashkëpunim të ngushtë me funksionarët më të lartë të qeverisë shqiptare krijuan një skemë masive të vjedhjes së parave të qytetarëve shqiptarë, në bashkëpunim të ngushtë me njëri-tjetrën, në formën e grupit të strukturuar kriminal. Një hetim i plotë dhe i gjithëanshëm i organit të akuzës (SPAK) do të zbardhë të plotë personat, rolin dhe përfitimet e secilit, të përfshirë në aferën e inceneratorëve.

**KRYETARJA**

**Jorida TABAKU**